

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Rast Studimor: Republika e Kosovës

Ruzhdi Jashari

Dorëzuar:

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoraturës në
Fakultetin e Shkencave Sociale, me Profil në Marrëdhënie Ndërkombëtare,
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Pajtim RIBAJ

Numri i fjalëve: 59,420

Tiranë, Dhjetor 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj me përgjegjësi morale, materiale dhe personale se ky është punimi im. Punimi nuk është i kopjuar, nuk është botuar më parë dhe nuk është prezantuar asnjëherë para asnjë institucioni për t'u vlerësuar. Punimi është autentik, nuk përmban asnjë material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç citimeve dhe referimeve, sipas rregullave të shkrimit shkencor akademik.

Ruzhdi Jashari

Tiranë, 2016

ABSTRAKT

Grumbullimin e të dhënave personale e bëjnë institucionet e ndryshme, në sektorin privat dhe atë shtetëror, për ushtrimin e veprimtarive të ligjshme. Ndërkaq, ndërhyrjet në të dhëna dhe grumbullimet e paligjshme të të dhënave personale, sot, i bëjnë edhe individë e grupe të ndryshme, përmes rrugëve të ndryshme, përmes ndërhyrjeve të teknologjisë së automatizuar, “krimeve kibernetike”. Këto rrethana nxisin dhe inkurajojnë ngritjen e platformës unike për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale në nivel global. Me gjithë sfidën e mbrojtjes së të dhënave personale në epokën e zhvillimeve kolosale të teknologjisë së komunikimit, internetit dhe shpikjeve të mëdha të pajisjeve të mençura portative të lëvizshme dhe statike, ekziston shpresa dhe besimi për një botë me privatësi të mbrojtur. Megjithatë, mbrojtja dhe siguria e të dhënave personale vjen si rezultat këmbëngulës i njohjes së rregullave në të gjitha nivelet nga kornizat ligjore kombëtare e ndërkombëtare, njohjes së të drejtave dhe detyrimeve të të gjitha institucioneve, qofshin ato publike apo private. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe ngritja e njohurive në këtë drejtim, përmes sistemit edukativ-arsimor dhe formave tjera, padyshim e forcojnë mbrojtjen e të dhënave personale në të ardhmen. Liritë e njeriut, drejtësia dhe siguria, si nocione të përhapura në vendin tonë-Kosovë, janë detyrime kushtetuese e ligjore që i japin stabilitet vendit. Mirëpo, fuqizimi institucional e ligjor, në këtë drejtim, me kompaktësi veprimi (ndërveprimi) në mes autoriteteve kompetente në kuadër të shteteve, rajonit tonë dhe autoriteteve kompetente të segmentit të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejtësisë dhe atyre të sigurisë të BE-së, KE-së dhe Parlamentit European, padyshim që do të sjellë sukses në tejkalimin e sfidës, nëpër të cilën po kalon mbrojtja e të dhënave personale. Forcimi i Autoriteteve Kombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale dhe lirisë së informacionit, është dhe mbetet, inputi kryesor për drejtësinë, liritë e njeriut dhe sigurinë, si standarde tashmë të vlerave globaliste.

FJALËT KYÇE: Mbrojtja e të dhënave personale, siguria, liritë dhe të drejtat e njeriut, drejtësia.

Abstract

To exercise their legitimate activities, various institutions in the private and public sector make the collection of the personal data. Meanwhile, data interference and illegal collections of the personal data, today, are made even by the different individuals and groups, through a range of methods, mainly by intervening by means of automated technology interventions i.e. “cybercrime”. These circumstances encourage the establishment of a unique platform for the protection of privacy and personal data at a global level. Despite the challenge of protecting personal data in the era of huge developments in communication technology, the Internet and important inventions of portable smart devices, which might be mobile and static, there is hope and faith for a world with protected privacy. However, the protection and security of the personal data is a result of implementing the rules at all levels of national and international legal frameworks, recognizing the rights and obligations of all institutions - public or private ones. The rights and fundamental freedoms, as well as the increases of knowledge in this regard, through the educational system and other forms, undoubtedly will strengthen the protection of the personal data in the future. Human freedom, justice and security, as notions prevalent in our country–Kosovo, are constitutional and legal obligations to provide stability to the country. However, institutional and legal strengthening, in this regard, with compact action (interaction) between the competent authorities in the framework of states, our region and the competent authorities for the human rights, freedoms, justice and security of EU, EC and European Parliament will bring about success in overcoming the challenge faced by the protection of the personal data. Strengthening of National Authorities related to the personal data protection and freedom of information, is and remains the main input for justice, freedoms and security – as standards of actual global values.

KEY WORDS: Protection of personal data, security, freedom and human rights, justice

FALËNDERIM

Në shenjë respekti për të drejtat, liritë themelore të njeriut dhe dinjitetit të individit, në shenjë respekti për vendin ku u linda, u rrita, më dha emër e më dha nder, në shenjë nderimi për Kosovën e martirizuar, e cila dha aq shumë për lirinë e saj, falënderoj familjen time, shokët dhe miqtë e mi, mentorët dhe udhëheqësin e disertacionit Prof. Dr. Pajtim Ribajn, me të cilët ndaj suksesin tim në këtë drejtim. Mungesa ime për të qenë pranë familjes dhe rrethit shoqëror gjatë gjithë kohës deri në përfundimin të këtij projekti, tashmë më në fund mendoj se arsyetohet me finalizimin e këtij punimi të doktoraturës.

LISTA SQARUESE E PËRDORIMIT TË SHKURTESAVE

1. ADN – Shkurtesë e përdorur për analiza, për verifikim të identitetit
2. ADP – Automatic Data Processing (Përpunimi Automatik i të Dhënave)
3. AKI- Agjencia Kosovare e Inteligjencës
4. AMDhP (AMDh) - Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
5. ARC - Agjencia e Regjistrimit Civil
6. AShMDhP (AShMDhP) - Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
7. ARKEP- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
8. AZOP – Agjencia za Zaštitu Osobnih Podataka
9. BE – Bashkimi European
10. BND – Agjencia Gjermane e Inteligjencës
11. “BCC” – Kopja e Karbonit të Verbër (shprehje e përdorur gjatë komunikimit sidomos në outlook)
12. “CC” – Kopja e Karbonit të Dukshëm (gjithashtu, shprehje e përdorur gjatë komunikimit në outlook)
13. CIA – Central Information Agency (Agjencia Qendrore e Kundërzbulimit)
14. CD – Disketa (disqe) Carboni për incizim
15. CPDP – Kompjuterizimi, Privatësia dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale (Computers, Privacy and Data Protection)
16. CV – Curriculum Vitae (Shënime për biografinë personale)
17. DES – Data Encryption Standard (shkurtesa për standardet inkriptuese)

18. DUDNJ/DUDLNj - Deklarata Universale e të Drejtave (dhe Lirive) të Njeriut
19. DZLP - Direktorat na Zaštita na Ličnite Podatoci
20. EDPS – European Data Protection Supervisor
21. EU – European Union
22. EC - European Commission
23. ECHR – European Convent for Human Rights,
24. ENISA – European Network Information Security Agency
25. FBI – Byroja Federale e Hetimit
26. FTC – Federal Trade Comission
27. HTML - Gjuha e komunikimit sipas metodës së rrjetëzimit të informacionit
28. IE - Integritet Europiane
29. ISO - International Standardising Organization – Organizata Ndërkombëtare Standardizuese
30. ISMS- Information Security Menagment Standard – Standardi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit
31. IT – Information of Technology – Informacioni i Teknologjisë
32. IP – Information of Processing – Informacioni i Përpunuar
33. JHA – Shifra të shkronjave të vendosura pranë numrit të Vendimit Kornizë të Bashkimit European që lidhen me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në prokurori, gjyqësor dhe polici
34. KEBS - Konferenca Europiane për Siguri dhe Bashkëpunim
35. KMDhP - Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

- 36. KE - Komisioni European
- 37. KEDNJ – Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
- 38. KNDNJ- Konferenca Ndërkombëtare e të drejtave të Njeriut
- 39. LMDHP – Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- 40. LMDH – Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave
- 41. MASHT – Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
- 42. MPB- Ministria e Punëve të Brendshme
- 43. MPJ – Ministria e Punëve të Jashtme
- 44. MPMS- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- 45. MDhP- Mbrojtja e të Dhënave Personale
- 46. MDh- Mbrojtja e të dhënave
- 47. mdh-mbrojtja e të dhënave
- 48. mdhp-mbrojtja e të dhënave personale
- 49. PNDCP – Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
- 50. PESM - Politikat Europiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes.
- 51. PhD – Kandidati studiues për gradën e doktorit të shkencave
- 52. DhP/ dhp- Të dhënat Personale/ të dhënat personale
- 53. OAS - Organizata e Shteteve Amerikane të të Drejtave të Njeriut
- 54. OSBE (OSCE) – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim European
- 55. OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara
- 56. ONP- Organizata Ndërkombëtare e Punës

- 57. OECD – Organisation for Economic Co-operation and Development
- 58. PET – Technology Privacy Enhancing (Modernizimi i Teknologjisë mbi Privatësinë)
- 59. RK-së – Republika e Kosovës
- 60. SHBA/ShBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës
- 61. SMS/sms – Shkurtesa për shprehjen e mesazheve të shkruara përmes, tel. apo email-it
- 62. TBC – Sëmundja e Tuberkulozit (shkurtesë e përdorur në mjekësi)
- 63. TKE - Traktati i Këshillit European
- 64. TV – Shkurtesa për televizionin
- 65. TAIEX – Technical Assistance and Information Exchange (Instrumente të Projekteve Mbështetëse nga Bashkimi European në fushën e sundimit të ligjit)
- 66. TFEU – Treaty on the Functioning of the European Union (Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit European)
- 67. TN – Tribunali Ndërkombëtar
- 68. TI/IT- Teknologjia Informative (në anglishte IT)
- 69. UE – Unioni European
- 70. UDHR – Universal Declaration of Human Rights (Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut)
- 71. ZMDH – Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave
- 72. ZMDHP –Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
- 73. GjED – Gjykata Europiane e Drejtësisë
- 74. GjDE – Gjykata e Drejtësisë Europiane
- 75. GjEDNj – Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Deklarata e autorësisë

Abstrakti në gjuhën shqipe

Fjalët kyçe

Abstrakti në gjuhën angleze

Key works

Letër falënderimi

Lista sqaruese e përdorimit të shkurtesave

KAPITULLI I: VËSHTRIMI I PROBLEMIT OBJEKTIVAT HIPOTEZA METODOLOGJIA PËRKUFIZIMI DHE IMPAKTI I STUDIMIT

1.1 Problemi.....	13
1.2 Korniza teorike e mbështetjes së punimit.....	14
1.3 Qëllimi dhe objektivat e studimit.....	19
1.4 Pyetjet kërkimore.....	21
1.5 Metodologjia-Modeli konceptual i studimit.	27
1.6 Mbledhja dhe analiza e të dhënave.....	33
1.7 Përkufizimi operacional i termave.....	35
1.8 Impakti shkencor i studimit.....	43
1.9 Limitet e studimit.....	44
1.10 Parathënie	45

KAPITULLI II: HISTORIK I SHKURTËR I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE TË DHËNAVE PERSONALE DHE TË SIGURISË NË KËTO TË DREJTA

2.1 Zanafilla e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.....	47
2.2 Historik i shkurtër mbi mbrojtjen e të dhp dhe të privatësisë.....	55
2.3 Të drejtat personale dhe të drejtat themelore të njeriut.....	59
2.4 Të dhënat personale dhe të dhënat identifikuese.....	60
2.5 Zëri si e dhënë personale identifikuese.....	62
2.6 Karakteristikat biometrike.....	63
2.7 Siguria dhe dimensionimi i saj te mbrojtja e të dhënave personale.....	66

KAPITULLI III: KUPTIMET THEMELORE MBI PRIVATËSINË DHE PARIMET E MBROJTJES DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE PERSONALE

3.1 Kuptimi themelor mbi privatësinë.....	69
3.2 Privatësia dhe të dhënat personale në të drejtat e njeriut.....	71
3.3 Parimet e mbrojtjes së të dhënave personale.....	73
3.4 Përpunimi i të dhënave personale.....	76
3.4.1 Përpunimi i thjeshtë i të dhënave personale.....	77
3.4.2 Përpunimi automatik i të dhënave personale.....	78
3.5 Subjekti i të dhënave personale.....	79
3.6 Kontrolluesi i të dhënave personale.....	81
3.7 Përpunuesi i të dhënave personale.....	84

3.8 Mbrojtja e të dhë të organet publike dhe zyrtari i mbrojtjes së të dh.	86
3.9 Sistemi i dosjeve.	88
3.9.1 Sistemet dhe katalogu i sistemit të dosjeve.	88
3.9.2 Njoftimi për regjistrim dhe kontrolli paraprake.	90
3.9.3 Ndërlidhja e sistemit të dosjeve dhe zbulimi i të dh.	92
3.10 Marrja e pëlqimit për përpunimin dhe mdhp të personat e vdekur.	93

KAPITULLI IV: KRONOLOGJI E AKTEVE NDËRKOMBËTARE DHE NDIKIMI I TYRE TE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

4.1 Njohuri themelore mbi kronologjinë e zhvillimit të drejtave të njeriut....	95
4.2 Rregullat për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhë në BE dhe integriteteve evropiane....	100
4.3 Akte juridike të rëndësishme ndërkombëtare që derivuan mdhp dhe të privatësisë.	103
4.4 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB-së (DUDNJ).....	104
4.5 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i OKB-së (PNDKP).....	105
4.6 Deklarata e Teheranit, 13 Maj 1968.....	106
4.7 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.....	107
4.8 Konventa për Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me Përpunimin Automatik të dhë.	109
4.9 Direktiva EC 95/46 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e vitit 1995.....	112
4.10 Deklarata e Vjenës për të Drejtat e Njeriut dhe Plani i Veprimit, 23 Qershor, 1993.	114

KAPITULLI V: ZHVILLIMI I TI, DOKUMENTET PERSONALE, MEDIUMET INFORMATIVE DHE MBROJTJA E TE DHËNAVE PERSONALE

5.1 Roli dhe efektet e teknologjisë në fushën e të dhp dhe të privatësisë.....	117
5.2 Telefonia.....	117
5.3 Videoincizimi.....	118
5.4 Audioincizimi.....	120
5.5 Dokumentet personale.....	121
5.6 Librat e regjistrimit dhe librat publikë.....	124
5.6.1 Librat e regjistrimit.....	125
5.6.2 Librat publik.....	125
5.7 Interneti dhe intraneti.....	126
5.8 Mediumet informative.....	168
5.8.1 Mediumet e shkruara “Gazetaria”.....	129
5.8.2 Mediumet radiofonike “Radiogazetaria”.....	131
5.8.3 Mediumet radiovizuale “Radiotelevizioni”.....	132
5.8.4 Komunikimi elektronik, multimediat dhe mediat online.....	133

KAPITULLI VI: FUSHA E VEPRIMTARISË SË ORGANEVE QË PËRPUNOJNË TË DHËNA PERSONALE DHE ASPEKTE KRAHASUESE NË RAJON

6.1 Njohuritë bazike mbi fushë-veprimtarinë e të dhp.....	135
6.2 Institucionet e mbrojtjes së të dhp (aspekte krahasuese).....	136
6.3 Krahasimet kushtetuese.....	140
6.4 Krahasimet ligjore në fushën e mbrojtjes e të dhp.....	144

6.5 Të drejtat e subjektit të të dhp.....	160
6.6 Përpunimi i të dhënave personale në fushën e arsimit.....	161
6.7 Përpunimi i të dhënave personale në fushën e shëndetësisë.....	163
6.8 Përpunimi i të dhënave personale në administratën publike.....	166
6.9 Përpunimi i të dhënave personale për qëllime sociale dhe të punës.....	170
6.10 Përpunimi i të dhënave personale në qendrat e regjistrimit civil.....	172
6.11 Përpunimi i të dhënave personale në ambasada dhe konsullata.....	176
6.12 Përpunimi i të dhënave personale në telekomunikacion.....	177
6.13 Përpunimi i të dhënave personale në sistemin bankar.....	180
6.14 Përpunimi i të dhënave personale në polici dhe prokurori.....	182
6.15 Përpunimi i të dhënave personale në turizëm dhe hotelieri.....	185

KAPITULLI VII: TË DHËNAT SENSITIVE PERSONALE DHE KUFIZIMET GJATË PËRPUNIMIT TË TYRE

7.1 Aspekte vështroese mbi të dhënat e ndjeshme / sensitive.....	187
7.2 Përpunimi i të dhënave të ndjeshme personale.....	188
7.3 Përpunimi i të dhp nga partitë politike dhe organizatat sindikale.....	189
7.3.1 Përpunimi i të dhënave personale nga partitë politike.....	189
7.3.2 Përpunimi i të dhënave personale nga organizatat sindikale.....	190
7.4 Përpunimi i të dhp nga shoqatat humanitare dhe bashkësitë fetare.....	191
7.5 Përpunimi i të dhënave personale të pacientëve dhe të sëmurëve.....	191
7.5.1 Përpunimi i të dhënave personale të dënuarve.....	192

7.5.2 Përpunimi i të dhënave personale të pacientëve të sëmurë	192
7.6 Përpunimi i të dhp për qëllime shkencore, statistikore dhe veprimtari botuese..	193
7.7 Kufizimet e mdhp për arsye të mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë nacionale....	194
7.8 Kufizimet të mbrojtjes së të dhënave personale për shkaqe të sigurisë publike..	198
7.9 Përjashtimet dhe masat tjera kufizuese të mbrojtjes së të dhp në sektorët tjerë.	200

KAPITULLI VIII: PAJISJET QË PËRPUNOJNË TË DHËNA PERSONALE DHE MASAT MBROJTËSE DHE SIGURISË SË TYRE

8.1 Pajisjet që përpunojnë të dhëna personale.....	202
8.2 Pajisjet kompjuterike.....	203
8.3 Pajisjet telefonike – telekomunikuese.....	204
8.4 Pajisjet video vëzhguese	206
8.5 Pajisjet inkriptuese dhe dekriptuese.....	207
8.6 Pajisjet bartëse: fleshat, CD-të, disketat, kasetat, zip-drajverat etj.....	209
8.7 Serverët.....	211
8.8 Pajisjet shtypëse dhe skanuese.....	213
8.9 Masat mbrojtëse dhe të sigurisë me rastin e përdorimit të pajisjeve kompjuterike gjatë përpunimit të dhp.....	214
8.10 Masat e sigurisë për mbrojtjen e të dp gjatë punës.....	217
8.11 Masat e sigurisë gjatë punës me kompjuter.....	218
8.12 Masat e sigurisë gjatë dërgimit të e-mailave.....	219
8.13 Masat e sigurisë gjatë dërgesave me faks.....	220
8.14 Masat tjera plotësuese të sigurisë.....	221

KAPITULLI IX: TRANSFERIMI I TË DHËNAVE PERSONALE RREGULLAT E MBROJTJES DHE NDIKIMI I TYRE NË INTEGRIMET EUROPIANE SIGURINË KOMBËTARE DHE RAJONALE

9.1 Transferimi ndërkombëtar i të dhp-njohuri themelore.....	224
9.2 Përcaktimi i nivelit të duhur për mdhp.....	225
9.3 Lista e vendeve dhe organizatave me nivel të duhur të mbrojtjes së të dhp.....	227
9.4 Vendimmarrja dhe autoriz. për vendet dhe organizatat me nivelin e duhur të mdh.....	229
9.4.1 Vendimmarrja.....	229
9.4.2 Autorizimet	231
9. 5. Bashkëpunimi me organet tjera.....	233
9.5.1 Memorandumet dypalëshe (bilaterale).....	234
9.5.2 Memorandumet shumëpalëshe (multilaterale).....	234
9.6 Dispozita të veçanta.....	235
9.7 Kodi i etikës për zyrtarët e mbrojtjes së të dhp.....	236
9.7.1 Kodi etikë normative.....	237
9.7.2 Kodi etik metaetik	238
9.8 Kodi i fshehtësisë—ruajtja e konfidencialitetit.....	241
9.9 Roli i mbrojtjes së të dhp në sigurinë rajonale dhe atë ndërkombëtare.....	243
9.10 Mbrojtja e të dhp në proceset integruese.....	245

KAPITULLI X: NJOHURI TE PËRGJITHSHME MBI MEKANIZMAT NDËRKOMBËTAR TË MROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

10.1 Mekanizmat ndërkombëtarë të mbrojtjes së të dhp.....	248
10.2 Konferenca ndërkombëtare e mbrojtjes së të dhp.....	248
10.3 Konferenca Pranverore e Autoriteteve Europiane të MDhP.....	250
10.4 Konferenca e Autoriteteve “frankofone” të mbrojtjes së të dhp.....	251
10.5 Konferenca ndërkombëtare për mdhp të Autoriteteve “anglosaksone”.....	253
10.6 Komiteti Konsultativ i Konventës 108.....	254
10.7 Konferenca e Autoriteteve të MDhP të Europës Qendrore dhe Lindore.....	255
10.8 Grupi i Berlinit për mdhp në fushën e telekomunikacionit.....	256
10.9 Grupi Punues sipas artikullit 29 të Direktivës EC 95/46 të KE-së “Working Group 29”.....	257
10.10 Grupi Ndërkombëtar i Rrjetëzimit të Autoriteteve të MDhP “GIPEN”.....	258
10.11 Konferenca ndërkombëtare të karakterit shkencor për mdhp dhe të privatësisë.....	260
10.12 Organizime të tjera rajonale e ndërkombëtare në fushën e mdhp.....	261

KAPITULLI XI: KONKLuzionET REKOMANDIMET DHE LITERATURA E PËRDORUR

11.1 Konkluzione.....	263
11.2 Rekomandime.....	265
Literatura e përdorur.....	270

KAPITULLI I: VËSHTRIMI I PROBLEMIT, OBJEKTIVAT, HIPOTEZA METODOLOGJIA, PËRKUFIZIMI DHE IMPAKTI I STUDIMIT

1.1 Problemi

Rrethanat që më shtynë për të shtjelluar këtë punim shkencor janë disa nga problemet aktuale të shoqërisë lidhur me abuzimin me të dhënat personale dhe sigurinë e individit në këtë drejtim. Në kohën e zhvillimit të madh të teknologjisë digjitale, qytetari ynë, në jetën e tij të përditshme, çdo ditë e më tepër, po ballafaqohet me keqpërdorimin e të dhënave personale. Ndërkaq, janë disa nga shkaqet kryesore që do t'i veçoj lidhur me problemin dhe përcaktimin tim për zhvillimin e këtij projekti të disertacionit:

- Mungesa e njohurive dhe nevoja e madhe për zhvillimin e kësaj fushe në Kosovë, një fushë, e cila më parë ishte e panjohur në nivel kombëtar dhe, për më tepër, është e re edhe për Rajonin e Ballkanit dhe më gjerë.
- Niveli dhe brishtësia e Institucioneve të Kosovës në këtë stad të ngritjes dhe zhvillimeve të tyre, në një kohë kur kërkohet dije dhe njohuri themelore lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen ligjore të dhënave personale në përmbushje të detyrimeve kushtetuese të sigurisë dhe lirive themelore të të drejtave të njeriut;
- Obligimet shtetërore të shoqërisë kosovare në përmbushje të standardeve në rrafshin e kërkesave të Liberalizimit të Vizave dhe Stabilizim-Asocimit për Kosovën, janë detyrime gjithashtu të shtruara nga BE-ja dhe KE-ja për t'u përmbushur në shtyllën e LIRISË-SIGURISË DHE DREJTËSISË, ku mbrojtja dhe siguria e të dhënave personale ka prioritet të veçantë në këtë fushë;
- Rreziqet që po sjell automatizmi i teknologjisë, pa nënvlerësuar përfitimet e mëdha për njerëzimin, po ndikojnë që të çenohet ashpër privatësia e individit. Andaj preokupimi i

qytetarëve për sigurinë individuale, liritë dhe të drejtat e tyre në sferën e mdhp janë attribute themelore në zhvillimin e demokracisë, të lëvizjes së lirë të individit, të qarkullimit të lirë të mallrave dhe të shërbimeve, duke nënkuptuar mbrojtjen dhe sigurinë e të dhp;

- Pozicioni im në këtë fushë, si Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror në AShMDhP në Republikën e Kosovës, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e rregullave dhe masave për mdhp në nivel vendi, ka ndikuar në përcaktimin tim për zhvillimin e kësaj teme.
- Ballafaqimi i përditshëm me shkeljet dhe abuzimet me të dhp të individit, në të dy sektorët (shtetëror dhe privat), është kompleks, ndërkohë që siguria e qytetarit si subjekt i të dhp dhe siguria e kontrolluesve si institucione është shndërruar në brengë serioze etj.

1.2 Korniza teorike e mbështetjes së punimit

Studimi lidhet kryesisht me shkencat bashkëkohore të sigurisë. Të dhënat janë mbledhur në shumë mënyra, kryesisht përmes metodës së teorisë së bazuar për mbledhjen e të dhënave. Kjo teknikë në përgjithësi, “përdoret për hulumtime cilësore, ndonëse nuk ka ndonjë arsye pse mos të përdoret edhe për hulumtime që përdorin metoda të përziera” (Matthewsk:137) ku të dhënat tona janë të shumta, dhe vijnë nga burime të ndryshme.

Pse shërben kjo qasje?

- Idetë kryesisht janë të nxitura nga institucionet e fuqishme ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.
- Idetë janë të lidhura të modifikuara dhe përdoren si alternativa të vlefshme.
- Mbledhja dhe analiza e të dhënave ndodhin në të njëjtën kohë.
- I jep mundësi hulumtuesit të punoi me burime dhe tipe të ndryshme të dhënash në të njëjtën kohë.
- Bënë të mundur që procesi i krahasimit të dhënave të jetë i vazhdueshëm, nga burime të ndryshme, kohë dhe vende të ndryshme për të mbështetur analizën, së bashku me kërkimin e rasteve negative.

- Mundësohet procesi i shënimit ose identifikimit të të dhënave për analizë të mëtejshme, por i ndarë në tri përmasa të dobishme (i hapur, boshtor dhe me përzgjedhje) në këtë rast.
- Ngopja me të dhëna-koncept i rëndësishëm, që thotë se ka mënyra se si hulumtuesi mund të siguroi që është bërë hulumtimi 'i mjaftueshëm', etj.

Në këtë shpjegim të këtij procesi, teoritë e përdorura gjatë këtij punimi, me përjasje historike të analizës në vështrim të problemit të shtruar për studim; cënimi i të dhp nga teknologjia e informimit, dobësitë e institucioneve dhe respektimi i te drejtave të njeriut, i janë përshtatur në tërësi rastit tonë të studimit. Ato janë:

- Shkolla e Kopenhagenit, duke qenë se përkufizimin e sigurisë e zgjeron përtej çështjeve ushtarake, ku katër prej pesë koncepteve ndaj sigurisë i përkasin kërcënimeve jo-ushtarake të sigurisë (Collins 2013:151) ku theksohet se çështje të sigurisë janë edhe siguria politike, siguria ekonomike, siguria shoqërore dhe siguria mjedisore; andaj, siguria individuale, e rrezikuar nga cenimi i të dhënave personale, është në qendër të këtyre koncepteve. Studimi në mbështetje të Shkollës së Kopenhagës përfshin individin si objekt referues (sigurinë njerëzore-antropocentrike), ndërsa institucionet si aktorë (sigurinë shtetocentrike), që u cenohet siguria gjatë abuzimit të dhp.

- Qasja konstruktiviste shkollës së Frankfurtit në thelb është në natyrë emancipuese. Botth thekson: “Siguria dhe emancipimi janë dy anë të së njëjtës monedhë. Prandaj emancipimi dhe jo rendi apo fuqia, është ai që prodhon fuqinë e vërtet të sigurisë. Kësisoj teorikisht emancipimi është siguri.” (Boot, 1991:320). Qasja jonë shumëdimensionale - sociale, juridike, ekonomike, e sigurisë etj - favorizohet në analizën e koncepteve të sigurisë edhe nga David A. Boldwin, ku thuhet: “Siguria Ekonomike, Siguria e Ambientit, Siguria e Identitetit, Siguria Sociale dhe Siguria Ushtarake janë fusha të ndryshme të sigurisë, por nuk janë koncepte thelbësore të ndryshme” (Boldwin, D.A, 1997:23). Përderisa hipoteza standarde e studimeve të sigurisë është: “njerëzit janë të sigurt kur shteti është i sigurt”, atëherë kur shqetësimet tona ndërlidhen me sigurinë e shtetit. Por çka ndodh në rast se “cenohet siguria e individëve brenda shtetit”?, kur siguria e shtetit nuk

është e rrezikuar dhe frika nga kërcënimi i individit është tashmë në rritje, ku cenimi i privatësisë është pjesë e debatit bashkëkohor? Prandaj përmes analizimit të problemit në funksion të diversitetit bashkëkohor synojmë arritjen e objektivit në sigurinë dhe mdhp.

- Në mbështetje të Konceptit të Shkollës së Uellsit pretendimet tona, “përfshinë nxjerrjen në pah të interesave për dije, me qëllim ndryshimin social” (Collins, 2013:102), lidhur me njohuritë dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave personale. Përmes konceptit konstruktivist teorik, disertacioni “arrin kuptimin konceptual dhe praktik për të njohur se kujt i shërbejnë pretendimet për dije” (Collins, 2013:102), të cilat në tërësinë e problemit i shërbejnë sigurisë individuale e institucionale në nivel shtetëror, rajonal e ndërkombëtar, dhe forcojnë demokracinë e re në Kosovë.

- Në përputhje të zhvillimeve të teknologjisë digjitale dhe teorive moderne të përfaqësuara nga teoria e liberalizmit dhe perëndimorizimit modern, “marrëdhëniet sociale dhe burimet teknologjike përbëjnë atë që quhet bazë ose infrastrukturë” (Keesing, Strathern, 2008:257). Ndërsa “teknologjia e shtyu njerëzimin drejt një kulture të përbashkët të karakterizuar nga aeroplanët, televizorët dhe kompjuterët, ndërsa polarizimi në mes botës ‘së zhvilluar’ dhe ‘në zhvillim’ e ndan globin, stili perëndimor është bërë aspirata universale që e bashkon këtë glob” (Keesing, Strathern, 2008:257), ku zhvillimi i teknologjisë së informimit dhe automatizimi i përpunimit të të dhp përmes makinës kërkuese të internetit po e cenon tej mase jetën private të individit dhe ka rrezikuar të dhënat e tij personale. Punimi reflekton njohuri bazike për problemin , objektin refereus (individin) dhe aktorët (institucionet publike dhe privatë).

- Me zhvillimin e madh të tregtisë së lirë dhe të fuqisë së informacionit, demokracia e shtetit të ri të Kosovës pas luftës `98, `99; e dalë nga sistemi komunist jugosllav-serb, sikurse post-komunizmi i të gjitha shteteve që na rrethojnë, në konsolidimet e reja demokratike iu kanë dhënë prioritet lirive universale të njeriut. Me të drejtë thuhet se “liria është nëna e rendit”, por në brishtësitë e këtyre demokracive të reja, shkallës së ultë të zhvillimit ekonomik, ato kanë shënuar rritje korrupsioni, papunësie dhe varfërie si trende negative dhe faktorë që ndikojnë drejtpërdrejtë në sigurinë njerëzore. Fluksi i madh i

qarkullimit ndërkombëtar i të dhp, ka bërë që krimi transnacional të kaloi kufijtë shtetërorë “që po prekin juridiksionin e shteteve fqinje” (Konventa e Kombeve të Bashkuara, Kundër Krimin të Organizuar Transnacional, 2000) dhe arsyeton krahasimin tonë në kapitullin VI të institucioneve dhe kornizat juridike të shteteve të rajonit.

- Në mbrojtje të sigurisë dhe lirive individuale të individit, në zhvillimet e sotme të liberalizmit modern, Kosovës por edhe shteteve të Rajonit me shpejtësi u duhen institucione të besueshme ku “Kushti (`sine qua non`) i domosdoshëm i shtetit liberal, në të gjitha versionet e tij, është se pushteti dhe autoriteti i qeverisë kufizohet nga një sistem kushtetues rregullash, në të cilin respektohen liria individuale dhe barazia e njerëzve para ligjit” (Gray, 1986:107), ku dituria për ekzistencën e institucioneve kushtetuese dhe rregullave që kufizojnë autoritetin në rastin e shkeljeve të sigurisë dhe lirive individuale e mbulon tërë punimin, përmes zbatimit të Kushtetutës së Kosovës, nenit 36 të saj që merr në mbrojtje privatësinë e individit dhe të dhp.

- Ndërsa realizmi si teori e fuqisë, që kryesisht ndërlidhet me sovranitetin e shtetit dhe fuqinë e tij për garantimin e sigurisë shtetërore, tashmë pas luftës së ftohtë është zbehur dhe shumë pak ka vend si teori gjatë zhvillimit të këtij disertacioni.

- Teoria e Marrëdhënieve Ndërkombëtare duke qenë bazë mbështetëse e studimeve të bashkëkohore të sigurisë në theksim të shkollës së Frankfurtit të Teorisë Kritike, se: “Teoria kritike e sigurisë përbën njëkohësisht një angazhim teorik dhe një orientim politik. Si angazhim politik teorik ai përfaqëson një grup idesh, duke u angazhuar në një hulumtim kritik dhe të vazhdueshëm të ontologjisë, epistemologjisë dhe praktikës së sigurisë, të komunitetit dhe të emancipimit në politikën botërore. Si orientim politik rrjedh nga synimi i forcimit të sigurisë nëpërmjet politikave emancipuese dhe rrjeteve të komunitetit në të gjitha nivelet, përfshi bashkësinë potenciale të komuniteteve-racën e përbashkët njerëzore” (Booth, 2005:268).

- Përdorimi i literaturës Juridike; duke filluar nga: Bello (2010), Përmbledhja e instrumenteve ndërkombëtare (pjesa e parë), Kombet e Bashkuara, New York-Gjenevë (1994), Puto (2010), Gruda (2009), European Data protection Law, Kuner (2007,2012)

etj., marrim impute rreth analizës komplekse mbi liritë dhe te drejtat fundamentale te njeriut me fokus “mbrojtjen e lirive individuale” ne aspektin e bashkëpunimit detyrues ndërkombëtar, ku këto të drejta bëhen pjesë e të drejtave pozitive ndërkombëtare dhe “ato njëherë e përgjithmonë pushojnë të jenë çështje e kompetencës ekskluzive të shteteve dhe bëhen çështje e preokupimit të ligjshëm të bashkësisë ndërkombëtare” (Gruda:421)

- Në këtë drejtim Konventa 108/1981 e mdhp dhe Direktiva EC 95/46, janë pjesë e studimit dhe obligimeve tona të përputhshme, me citimin e shprehur nga Booth (2005), ku qytetari dhe institucionet që përpunojnë të dhp të njihen me detyrimet e tyre karshi konventave dhe rregullave që tashmë kapërcejnë kufijtë nacionalë-kombëtarë që përkufizojnë shtetin në kuptimin gjeografik. Aplikimi i Konventës Europiane të Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (1953), veçmas neni 8, i saj, lidhur me të drejtën e korrespondencës mbi privatësinë e komunikimeve dhe jetës personale, në mbështetje të Handbook an European Data Protection Law, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2014 dhe përdorimit të shumë kornizave tjera nga hapësira juridike e UE dhe Rajonit, na ndihmojnë në sistemimin dhe trajtimin teorik të mdhp.

- Gjithsesi, në botën e zhvillimit shumë të shpejtë të komunikimit, ndërvarësisë me internetin dhe rrjetet sociale të komunikimit edhe siguria edhe privatësia e individit të ndërvarura me institucionet e shoqërisë, prekin gjithandej “qëndrueshmërinë” e të gjitha sistemeve të shoqërisë njerëzore, duke filluar nga ato kombëtare deri te ato ndërkombëtare. “Në një epokë, në të cilën siguria është kaq e rëndësishme dhe disa prej praktikave të sigurisë kaq problematike për ata që janë të përkushtuar ndaj lirisë dhe drejtësisë—pra ndaj tipareve karakteristike të demokracisë—studimi i sigurisë kërkon një nivel kritik, madje edhe me njohjen e faktit se nuk siguron një destinacion që mund të arrijmë përfundimisht.” (Collins, 2013:104).

- Analiza është referuar edhe përmes shumë rasteve praktike të hulumtuara nga, vendime e ligje të ndryshme, faqja zyrtare e Komisionerit European te mdhp, ueb faqet e institucioneve të ndryshme nga Kosova, Rajoni dhe më gjerë.

Mbi këtë kornizë teorike, të studimit tonë, plotësohen kriteret e Goldsten-it (2003) i cili argumenton, se marrëdhëniet ndërkombëtare kryesisht mbështeten mbi 4 nivele të analizës:

- Nivelin individual,
- Nivelin shtetëror,
- Nivelin ndërshtetëror dhe
- Nivelin Global.

Mbështetja e studimit mbi teoritë e theksuar sipas (Matthews:138) pretendon të ofroi një sistem njohurish për të gjykuar nëse “teoria” e përdorur (rezultuese) është e “mirë” apo “jo”. Pra këto mënyra janë të ndryshme nga ato me të cilat jemi mësuar. Strauss-i dhe Corbin-i (1990), parashtruan katër kërkesa kryesore për procesin e kontrollit të hulumtimit mbi qasjen e teorisë së bazuar:

1. Teoria duhet të jetë e përshtatshme për dukurinë që po studiohet,
2. Teoria duhet të jetë e kuptueshme dhe të sjell kuptim,
3. Teoria duhet të jetë e përshtatshme për një gamë të gjërë kontekstesh,
4. Teoria duhet të përfshin një përshkrim të kushteve në të cilat vepron, ku ne *Përshkrimin më të ezauruar e japim në përputhje të pyetjeve themelore dhe hipotezave në artikullin 1.4 të punimit.*

Përmbyllja e këtyre kërkesave që nga faza fillestare e punimit deri te faza e finalizimit, na siguron se ky model i përshtatet projektit tonë.

1.3 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Liritë dhe të drejtat e njeriut janë referim i studimeve të shumta të shkencave sociale. Bazuar në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, sot diplomacia bashkëkohore promovon në praktikë dhe teori sigurinë njerëzore në nivel ndërkombëtar, mbështetur në parimet bazë të Deklaratës universale mbi Liritë dhe të Drejtat e Njeriut. Arsyeja kryesore lidhur me përcaktimin për këtë temë është problemi aktual i abuzimit me të dhp, ku tashmë cënimi i privatësisë nga teknologjia digjitale dhe rrjetet sociale është përditshmëri dhe shqetësim i ngritur në nivel global.

Qëllimet e studimit janë:

- Mbrojtja dhe siguria e të dhp;
- Emancipimi i qytetarëve dhe institucioneve lidhur me mdhp; dhe
- Vendosja e aspekteve të reja teorike në këtë fushë.

Ndërsa, për arritjen dhe realizimin e qëllimit, të mdhp dhe sigurisë së tyre, kam synuar arritjen e këtyre objektivave specifike:

- Sjellja e njohurive të reja në mdhp për vet subjektin e të dhp;
- Njohuri të reja për përdoruesit dhe përpunuesit e të dhp në sektorin privat dhe publik.
- Siguria, të drejtat dhe obligimet e institucioneve karshi qytetarëve, me rastin e operimit, përpunimit dhe mbajtjes së të dhp të individit.
- Siguria dhe mdhp në epokën digjitale.
- Njohuri të përgjithshme mbi zhvillimet historike dhe aspekte krahasuese në Rajon nga këndvështrimi i instrumenteve ligjore në funksion të mdhp.
- Fuqizim dhe konsolidim të sigurisë kombëtare

Për arritjen e qëllimit emancipues, punimi, gjatë gjithë shtjellimit të tij, jep njohuri bazike për individin dhe institucionet, lidhur me mdhp. Kështu veçmas do të trajtohen aspektet e sigurisë dhe mdhp, ku në kapitullin III flitet për këto objektiva.

- Subjektin e të dhp dhe
- Kontrolluesit e të dhp

Vendosja e bazave të reja në këtë fushë kaq të gjerë, multidisiplinore, jep njohuri veç e veç nëpër sektorë të ndryshëm, lidhur me aksesin e të dhp, ndërhyrjen e teknologjisë së informimit-internetit, ku objektiv mbetet në vazhdimësi siguria dhe liritë themelore të individit, në përmbushje të obligimeve të Konventës 108/1981 të KE-së, lidhur me përpunimin automatik të të dhp dhe protokolleve të saj, Konventës së Lirive Themelore të Drejtave të Njeriut të vitit 1953 dhe Protokolleve të saj, Direktivës 95/46 të KE-së të mdhp, Deklaratës Universale të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të OKB-së të

v.1948 dhe obligimeve Kushtetuese të Kosovës lidhur me të drejtat e secilit individ për garantimin e privatësisë së tyre.

“Kështu që objektivi parësor i sigurisë njerëzore nuk është rritja e sigurisë shtetocentrike në vetvete, por garantimi që njerëzit të mos vuajnë prej atyre versioneve të sigurisë shtetocentrike që e injorojnë dhunën e brendshme dhe shkaqet e saj” (Collins, 2013:140). Synimet tona shkojnë në përmbushje të obligimeve të dala nga Raporti i Progresit për Kosovë, nga KE-je dhe BE-ja në realizimin e MSA-së lidhur me IE në Bllokun e SIGURISË-LIRISË-DREJTËSISË¹

1.4 Pyetjet kërkimore

Pyetjet themelore kërkimore të studimit janë:

1. Pse rrezikimi dhe cënimi të dhp po përballlet me limitim të sigurisë dhe të menaxhimit të informacionit?
2. Si pasojë e moszbatimit të rregullave dhe masave të mdhp, pse po dobësohen organet që përpunojnë të dhp dhe a cënohet siguria e individit?
3. Pse janë të rrezikuara liritë dhe të drejtat e njeriut nga mbrojtja e dobët e të dhp?
4. Si ndikon niveli i ulët i njohurive në lidhje me mdhp te siguria e individit dhe institucioneve?

Hipoteza/t e punimit janë:

H.1) Rrezikimi dhe cënimi i të dhp nga krimi kibernetik përmes zhvillimit të shpejtë të teknologjisë së informacionit dhe rrjeteve sociale, me vërshimin e madh të miliarda informacioneve me të dhp, nga kontrolli i limituar i informacionit, po e rrezikon sigurinë e sektorëve jetikë - publikë e privatë - të shoqërisë.

H.2) Moszbatimi i rregullave dhe masave të mdhp, nga institucionet mbikëqyrëse, krijon pasiguri te individi, dobëson shkallën e sigurisë së organeve që përpunojnë të

¹ Raporti i KE-së dhe BE-së i vitit 2015, për Kosovën në fushën e LV dhe MSA-së

dhp karshi qytetarëve, dhe ndikon në aspektin e sigurisë së përgjithshme në nivel shtetëror, rajonal e ndërkombëtar.

H.3) Siguria e individit dhe mbrojtja efikase e të dhp të tij nga ana e organeve shtetërore e private e rrit nivelin e sigurisë njerëzore me qasje antropocentrike dhe ndikon në forcimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, forcimin e besimit në strukturat shtetërore dhe fuqizimin e demokracisë.

H.4) Niveli tepër i ulët i njohurive të organeve publike e private lidhur me sigurinë e të dhp dhe të drejtat individuale, shkaktojnë shkelje dhe abuzime me të dhënat personale, duke “krijuar teren të përshtatshëm” për zhvillimin e “*fishingut*”² dhe rrezikimin e sigurisë së individit dhe institucioneve.

Aspekte krahasimore të institucioneve të mdhp dhe të atyre ligjore e kushtetuese të analizuara në kapitullin 6 kan për qëllim nxjerrjen në pah të përparësive dhe të metave të siguria dhe mdhp në Republikën e Kosovës, përmes instrumenteve juridike. Ndërkohë që kornizat juridike dhe institucionet janë instrumente, ku *qëllimi* është mdhp, kurse *objektivi* forcimi i institucioneve dhe siguria njerëzore. Në këtë kontekst të kapitullit (6) shkrirja e hipotezave në një të vetme, në; *Siguria dhe mbrojtja e të dhënave personale në Republikën e Kosovës* shkon në favor të analizimit juridik të gjërave. Pyetjet në relacion ligjor të analizës në kapitullin 6 na ndihmojnë që të japim disa përgjigje përmes punimit që fuqizojnë pyetjet themelore dhe hipotezat e shtruara për analizë.

a) Ku ndodhet Kosova në fushën e mdhp në raport me Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë, Slloveninë, Kroacinë, Bosnje Hercegovinën, Bullgarinë dhe Serbinë?

b) Cila është dinamika e ngritjes së institucioneve të mdhp dhe kompetencat e tyre mbikëqyrëse në shtetet e rajonit dhe a jan kornizat ligjore në perputhje të plotë me *aqi komunitare* të UE?

² “*Fishingu*” është shprehja që e hasim te “peshkimi” apo “hakerimi” nga abuzuesit e ndryshëm në bazat e të dhënave në sistemet e ndryshme “jetësore dhe jo jetësore” që ndryshe quhen sulme kibernetike dhe për herë të parë u shfaqën në ShBA në vitin 2004.

c) Me cilat sfida perballen këto institucione dhe çfarë janë efektet e këtyre institucioneve në mbrojtjen e lirive individuale, si qëndron Kosova në këtë mes?

d) Si/çfarë ndikon mdhp, si e drejtë e garantuar kushtetuese, te siguria e qytetarëve në raport me organet që grumbullojnë dhe përpunojnë të dhë të subjekteve.

Në një koncept tjetër të spjegimit “të procesit shkencor përmes një ndryshimi zinxhiror; shkencë normale-revolucion shkencor-shkencë e re normale” (Abazi:242) dhe artikullit “The Structure of Scientific Revolutions” të Thomas S Kuhn, në Wikipedia-The free Encyclopedia, https://en.wikipedia.org/wiki/The_Structure_of_Scientific_Revolutions, shikuar 08.12.2016, ora 16 Kapitulli 6 në funksion të sigurisë dhe mdhp mbi bazën juridike, vjen si rezultat i “forcimit” të analizës së materjes në 5 kapitujt paraprak, të domosdoshëm për kuptimin e problemit. Ndërkohë që “fuqizohet pesha” e analizës dhe interpretimi i masave të sigurisë dhe mdhp në kapitujt pasues, 7, 8, 9, 10 dhe 11 duke përfunduar *pyetjet kërkimore themelore* dhe *hipotezat* e studimit me përdorimin e metodave cilësore, ku “merren më së shumti me histori dhe rrëfime, dhe përfshinë kuptime subjektive, ndjenja, mendime dhe bindje.”

(Matthewskit:142). Andaj kjo qasja interpretuese shkon plotësisht në favor të këtij punimi.

Përkufizimi operativ dhe zbërthimi i pyetjeve hulumtuese na ndihmon që të japim një tregues të qartë për të kuptuar dukurin e hulumtimit. “Shumica e pyetjeve hulumtuese përfshinë dhe lidhen me konceptet, me mënyrën se si duam të mësojmë më shumë për to dhe se si lidhen ato me njëra – tjetrën” (Matthews 2010:61). Andaj këto koncepte me përkufizime operative po i japim për qëllimet e hulumtimit duke ndihmuar procesin e operacionalizimit të përkufizimeve.

Rrezikimi dhe cënimi i të dhënave personale nga zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe rrjeteve sociale, sot me rastin e (keq)përdorimit abuzues të saj, në hulumtimet në fushën e shkencave shoqërore, dy janë llojet e marrëdhënieve që merren në shqyrtim. “Këto janë marrëdhëniet *shkakore* dhe ato me *shoqërizim*” (Matthews 2010:59). Ndër shkaqet e marrëdhënieve *shkakore* që cenojnë dhe rrezikojnë të dhë janë:

- qasja e paautorizuar në të dhë,
- mbrojtja e dobët nga ndërhyrjet jashtme,
- stafi i pa përgaditur,

- dëmtimet fizike,
- përgjegjësia e dhe disiplina e punës joadekuate,
- teknologjia e pa certifikuar në fushën e mdhp,
- stafi jo adekuat për mdhp etj..

Ndërsa në marrëdhëniet *shoqërizuese* janë:

- jo efikasiteti i gjyqësorit,
- mbështetja e dobëta nga legjislativi dhe shteti për autoritet e mdhp,
- njohuri dhe dije të dobëta në fushën e mdhp,
- njohuri dhe dije të dobëta në fushën e TI,
- ndërhyrjet në të dhënat tona nga qendrat e jashtme “google”, “facebook”, “Weiber” etj “.

Njohurit e ulta dhe përvoja tepër e re e institucioneve të zbatimit të ligjit duke përfshirë institucionin e mdhp dhe zyrtarët e ngarkuar me detyrën e mdhp nëpër institucione, “për hipotezën/at tonë/a zakonisht mund të na jap(in) vetëm një pikënisje për hulumtim” (Matthews 2013:59). Te kush mungojnë ato njohuri?, ku mungojnë “përvojat e punës” dhe si duhet vepruar?. Janë testimet që do të shtresohen në studim kryesisht në kapitujt 7 e 8. Duke theksuar faktin se nocioni i sigurisë shoqërore dhe njerëzore qëndron në epiqendër të Shkollës së Kopenhagës, theksojmë se akti ynë i ligjërimit vendoset kryesisht tek shoqëria dhe individi, si objekte referuese (Collins 7, 2013:158)

Moszbatimi i rregullave dhe masave mbrojtëse si dhe detyrimet ndaj subjektit të të dhp.

Moszbatimi i rregullave dhe masave për mdhp vjen, kryesisht, nga ana e institucioneve që merren me grumbullimin dhe përpunimin e të dhp të qytetarëve. Psh në tregti grumbullohen dhe profilizohen të dhëna të konsumatorëve si; numra të tel, adresa elektronike etj. dhe kur ato përdoren për “marketing” pa lejen e konsumatorit kemi përdorim të dhp në kundërshtim me rregullat. Kur promovojmë fushata të ndryshme përmes email-adresave dhe sms dërgesave telefonike, pa bazë ligjore etj. Në këtë drejtim me masa mbrojtëse do të nënkuptojmë se ne si kontrollues (institucione) kemi detyrime ndaj subjektit (qytetarit) në të drejtat e tij për: përditësimin e të dhp, për plotësimin e të dhp, për fshirjen e të dhp, korrigjimin e tyre, për shkatërrimin e tyre dhe marrjen e pëlqimit për përpunimin e tyre ligjore, për kohen e ruajtjes etj. Këto marrëdhënie pyetjesh për hulumtimin janë një lloj i vaçantë, “që në fakt nuk jan

pyetje por një pohim ose shprehje e marrëdhënieve midis dy ose më shumë koncepteve”(Matthews 4, 2010:58) me të cilat provohet vërtetësia e tyre.

Pasiguri të individit si shkak në kontekstin e mdhp, e kemi nga vjedhja e të dhënave, “thyerja e fjalëkalimeve”, abuzimi me të dhp nga “hakerimi”, kërcënimet, shantazhet, njollosjet apo stigmatizimet, përmes “email-ave” dhe “sms-ve” si dhe grumbullimi dhe kontrolli shumë i madh i të dhp dhe privatësisë së qytetarëve, nga institucionet e ndryshme të sigurisë, “në emër të sigurisë”, shpesh e tejkalon qëllimin e grumbullimit dhe kohen e ruajtjes së tyre. Këto njohuri pasigurie për individin mbështeten në prova ekzistuese që po ndodhin rreth nesh dhe ndihmojnë në; “të kuptuarit e një lënde, fakti, çështjeje.” Matthews, A2, 2010:20)

Shkelja e të dhp dhe pasiguria e tyre dobëson shkallën e sigurisë së organeve që përpunojnë të dhp, karshi qytetarëve në kontekstin e hipotezës së shtruar për studim janë përpjekje fillestare për të shqyrtuar këtë dukuri shoqërore dhe se pretendojmë që në këtë drejtim hipotezën ta vejme përball këtyre pyetjeve ndihmëse hulumtuese që: “të zbulojmë, të shpjegojmë dhe të vlerësojmë” Matthews A4 2010:57) se kurë ka shkelje të dhp, ka pasiguri te individ-qytetari. Kush mund të jetë shkelësi potencial i të dhënave? Janë ato organe që grumbullojnë më së tepërmi të dhp. Këtu bëjnë pjesë (AKI, Policia, ARC, MASHT etj.). Pasiguria e qytetarëve dhe dyshimet në shkeljen e të dhp kontribuojnë në dobësimin e shkallës sigurisë të organeve që përpunojnë të dhp të qytetarëve. “Me rastin e dyshimeve të përgjimeve të paligjshme (dhjetor–janar, 2015-2016) në ASHMDhP, brenda 15 dite, qytetarët kishin deponuar 57 ankesa me dyshimin se ishin përgjuar nga policia gjat një proteste të organizuar (dhjetor 2015) nga opozita, kundër qeverisë.” ASHMDhP (2016)

Ndikimet në aspektin e sigurisë së përgjithshme edhe përtej kufijve shtetërorë e rajonalë e deri në nivel ndërkombëtar në kontekstin e mdhp janë të ndërlidhura me *sigurinë e qytetarëve* ku është edhe synimi ynë. Nga këndvështrimi i brendshëm i sigurisë së të dhp përfitojmë: siguri individuale, siguri institucionale, siguri shoqërore (sociale) dhe siguri kombëtare. Kurse aspekti i *përgjithshëm i sigurisë* reflektohet nga faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Në faktorët e jashtëm mund të përmendën: Siguria e transferit ndërkombëtar dhe ndërkufitar të të dhp; aplikimi, harmonizimi dhe transpozimi i plotë i rregullave të KE dhe BE në kornizën e brendshme të mdhp; Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhp;

inspektimet e përbashkëta të kontrolluesit e ashtuquajtur “Big data”. MDhP forcon pohimin që “Qeveritë po e perceptojnë gjithnjë e më shumë krimin trans-nacional si kërcnim për sigurinë kombëtare duke qar në ngasje për të përdorë asete të inteligjencës dhe ushtrisë si suplementare të zbatimit të ligjit” (Collins19, 2013:454). Forcimi i sigurisë kombëtare reflekton siguri rajonale dhe ndërkombëtare.

Niveli i sigurisë së individit dhe mdhp të tij në ndërlidhje të kriterëve vlerësuese të mbrojtjes së sistemeve kompjuterike në aspektin hierarkik kemi katër kategori: kategori të sigurisë minimale, kategori të sigurisë së pjesshme, siguri sipas detyrës (mandatit), siguri e vërtetuar (verifikuar). Kontrolluesi (institucionet) duhet ta njoftojnë individin me të drejtat e tij dhe me masat mbrojtëse dhe të sigurisë për mdhp. “Përbindëshi” kibernetik nuk njihet as kufi e as rregulla ai është jashtë nesh, në “Ande” apo “Tibet”, në “Dronë”, “Satelit” apo “Avion pa pilot”. Shigjetat janë të drejtuara për “sulm” në të dhp? Kemi një përgjigje: Duhet të veprojmë në sigurinë dhe mdhp në “identifikimin të strukturave dhe mekanizmave që sjellin pabarazi ose padrejtësi, duke ofruar kështu mundësi për ndryshime shoqërore, përmes ndryshimit ose kundërshtimit të mekanizmave strukturore të identifikuar si shkaktar të këtyre ndikimeve” (Matthews A2, 2010:29) në nivelin e sigurisë individuale.

Zbatimi i rregullave lidhur me mdhp nga ana e organeve shtetërore e private nënkupton detyrimet që kanë kontrollorët³, për ta mbajtur të informuar qytetarin lidhur me të drejtat që ka subjekti⁴ i të dhp. Subjekti i të dhënave duhet të informohet për qëllimin e grumbullimit dhe përdorimit të dhp, afatin e ruajtjes. Ai duhet të njoftohet për marrësit e të dhënave, transferin e të dhp, gjithashtu kur kontrolluesi përpunon të dhëna të ndjeshme personale, zyrtari i mdhp apo operatori me të dhp, duhet të mban shënime kur janë zbuluar, për çfarë qëllimi janë përdorur dhe çasja në këto të dhëna nga kush, për çfarë arsyeje dhe kur është bërë? Zbatimi i këtyre rregullave është detyrim ligjor i organeve që merren me grumbullimin dhe përpunimin e të dhp. Përveç detyrimit kushtetues të mdhp ky është edhe detyrim ndërkombëtar për të gjitha shtetet palë të Konventës 108.

³Termi (kontrollues) i përdorur në teorinë e mdhp për institucionet, ndërmarrjet apo organet të cilat grumbullojnë dhe përpunojnë të dhp të qytetarëve, qofshin ato publike apo private.

⁴ Termi (subjekt) i përdorur në teorinë e mdhp nënkupton qytetarin apo individin të cilit i përpunohen të dhp.

Mdhp do të ngrejë nivelin e sigurisë njerëzore me qasje antropocentrike, duke ndikuar kështu në forcimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, forcimin e besimit në strukturat shtetërore dhe fuqizimin e demokracisë. Në theksim të asaj se të gjithë “mbështetësit e sigurisë njerëzore potencojnë faktin se siguria njerëzore përbën qëllimin, ndërsa siguria e shtetit (shtetocentrike) mjetin për ta arritur atë objektiv” (Collins 6, 2013:132) objekt sigurizues me këtë rast do ta kemi subjektin e të dhp (qytetarin) ndërsa aktor sigurizues do të jen autoritet e mdhp respektivisht shteti.

Implikimet e përgjithshme për secilin nivel teorik të punimit:

1. Resurset e kufizuara të njohurive në nivel shtetëror, rajonal e ndërkombëtar dhe dhuna e krimet kibernetike ndaj sistemeve të ndryshme të të gjitha fushave, duke kaluar përtej kufijve shtetërorë dhe rrezikimi i të dhënave të sistemit financiar, të sistemit të sigurisë, shëndetësisë etj, e deri te luhatja e sigurisë së përgjithshme të një vendi a rajoni.
2. E kaluara historike, përceptimet e ndryshme, kalimi nga një qasje krejt ndryshe, kur një çështje e sigurisë konsiderohet e sigurizuar, kur forca dhe fuqia e shtetit janë në epërsi dhe qasja ndaj sovranitetit bazohet me prioritetet e teorisë së realizmit. Kjo pikëpamje pas luftës së ftohtë dhe në kushtet e sotme të neoliberalizmit, zhvillimit të tregut të lirë dhe lirive fundamentale të individit, ka ndryshuar radikalisht, në një kohë kur siguria e të dhënave është duke u ndërlidhur ngushtë me sigurinë tashmë globale.
3. Brishtësia e sistemit, përvoja e dobët e institucioneve që merren me mbrojtjen e të dhënave personale, kërkesa për qasje në informata publike, gjenerata e re e teknologjisë informative dhe të telekomunikacionit, makina kërkuese e internetit, shpejtësia e qarkullimit të informacionit, mundësitë e kufizuara të menaxhimit të informacionit, përgjimet e paligjshme të qytetarëve dhe personaliteteve, marketingu i egër me të dhp etj., në kohën e zhvillimeve të hershme të demokracisë së re në Kosovë, rajon e jashtë tij, janë disa nga aspektet që përfshihen në këtë analizë.

1.5 Metodologjia

Punimi mbështetet kryesisht në disa metoda shkencore hulumtuese si: analitike, historike, krahasuese, orientuese (edukative) dhe induktive. Përzgjedhja e kësaj metodologjie

hulumtuese përshtatet me objektivat dhe qëllimin e punimit si dhe pyetjet kërkimore dhe hipotezat e shtruar për studim. “Hulumtimi mund të ndryshojë shumë nga njëri tek tjetri, në varësi nga tema, çasja teorike e përdorur, zgjedhja e metodave të mbledhjes së të dhënave e kështu me radhë” (Matthews, 2010:10), kështu që aspekti i kësaj metodologjie me qasje induktive në përdorim edhe të metodës cilësore, ku përfshihen informacione nga interneti, norma rregullash, aspekte krahasuese dhe të dhëna të shumta burimore nga libra e botime të ndryshme, ku provohet përmes fakteve se; mdhp duhet trajtuar si pjesë e *sigurisë njerëzore*, që gjeneron rekomandime dhe ide për tu shtuar në teorinë bashkëkohore të shkencave të sigurisë. Mbase debati në nivel global mund të gjeneron teorinë ndërkombëtare të mdhp, e cila tashmë nga zhvillimi i madh i teknologjisë së komunikimit është kërkesë e kohës.

Në themel të hulumtimit janë punët kërkimore kronologjike në studime të sigurisë, rregullave të mdhp, rishikimit të literaturës dhe konventave ndërkombëtare që në fokus kanë liritë universale dhe sigurinë e individit.

Në ndërlidhje të faktit se; ”Pyetja e hulumtimit mund të marrë përgjigje përmes përshkrimit dhe shpjegimit të ngjarjeve dhe mbledhjes së kuptimeve, bindjeve përvojave të pjesëmarrësve” (Matthews, R. 2010:142) dhe mungesës paraprake të studimeve të mirëfillta të kësaj fushe, përmes *metodës cilësore* arrijmë që:

- Të mësojmë më shumë në përgjithësi për mdhp.
- Gjendjen aktuale të mdhp në Kosovë.
- Ndikimin e faktorëve të jashtëm në sigurinë dhe mdhp.
- Nivelin e mdhp jashtë Kosovës.
- Rolin dhe rëndësinë e të mdhp në zhvillimin e demokracisë dhe IE.

Gjat hulumtimit janë bërë analiza dhe janë siguruar të dhëna edhe përmes, akteve dhe kornizave ligjore të ndryshme, ndërkombëtare, rajonale dhe Kosova. Në këtë relacion theksohet nga Matthews, R. 2010:142), se; “Pyetja e hulumtimit mund të marrë përgjigje përmes numërimit të ngjarjeve dhe përdorimit të analizave statistikore”. Andaj përdormi i këtyre të dhënave dhe analiza krahasimore që është bërë me 8 shtete të Rajonit në fushën e mdhp jep mundësi të përdorimit edhe *metodës sasiore* përmes së cilës:

- Mund të analizojmë aspektin e dobësive tona përmes llogaritjes së problemeve.
- Mund të hulumtojmë aspektet ligjore e nënligjore në mdhp dhe sigurinë e tyre.
- Mund të shikojmë dhe analizojmë statistika të ndryshme lidhur me abuzimet me të dhp.

Për hulumtimin tonë kjo metodë, si e veçantë pak zbatohet. Ndërkaq ne gjatë gjithë hulumtimit dhe analizës arrijmë të kemi në dorë të dy këto lloje të informacionit, ku *metoda e kombinuar* na mundëson që këto të dhëna t'i përdorim së bashku dhe punimit t'i japim, akoma, besueshmëri që ai të jetë më i mirë.

Trajtimi i qartë i pyetjeve të ngritura studimore, shpjegimi i strukturuar i problemit të sigurisë së të dhp nëpër institucione (publike e private) veç e veç deri te tërësia e problemit në nivel shtetëror procesi si çështje sigurie na jep të kuptojmë se kalon nëpër të gjitha fazat e tij: jopolitike, politike dhe çështjes që duhet sigurizuar.

Në kapërcim të sfidës së veprimit teorik, ku shpjegimi i gjërave dhe modeli i punimit, pa një “yrnek” paraprak, për temën e “Mbrotjtjes së të Dhënave Personale”, mund shtrihet në shkencat të ndryshme si: Marrëdhënie Ndërkombëtare, Shkenca Bashkëkohore të Sigurisë, Juridike, Studime të Paqes etj. Në shikim të procesit përtej sipërfaqes së gjërave, për të parë proceset, duke qenë se “marrëdhëniet sociale dhe burimet teknologjike përbëjnë atë që quhet bazë ose infrastrukturë” (Keesing dhe Strathern, 2008:257), studimi vetvetiu bazohet në hulumtimin e shkaqeve, rrethanave aktuale dhe debatit në shumë nivele që kërkon mbrojtjen nga rrezikimi i lirisë së individit dhe sigurisë së të dhp. Prandaj, vendosja e hulumtimit dhe shpjegimi i punimit është bërë në kuadër të shkencave bashkëkohore të sigurisë. Sfidat e kësaj fushe ende janë të “pamaturuara”, në kontekstin e mdhp dhe privatësisë, andaj shpjegimet tona i nxjerrim përmes rrugëve të ndryshme si të atyre: sociale, juridike, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, kibernetika-TI etj; ku synimi kryesor përmes qasjes induktive është siguria dhe mdhp.

Metoda analitike është kryesorja në këtë studim ngase përmes kësaj metode dhe fushës së studimit është edhe përshtatja e shpjegimit dhe krahasimit të gjërave lidhur me sigurinë e të dhp duke fokusuar orientimet tona për aplikimet detyruese të rregullave ndërkombëtare, veçmas atyre të BE-së dhe KE-së në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilat janë të transpozuar në formë direktivash në legjislacionet kushtetuese të vendeve të rajonit dhe BE-së, ku mdhp është e vendosur si kategori e kornizave kushtetuese.

Për secilin nivel të punimit zhvillohet analizë e veçantë, por gjithnjë në funksion të tërësisë. Në vazhdim do të jepen disa elemente konceptuale metodologjike të hipotezave të punimit, duke u nisur nga modeli i hulumtimit, përkufizimet operacionale si dhe lloji dhe natyra e të dhënave të përdorura.

1.5.1 Modeli i hulumtimit është rast studimor mbi mdhp nga përvoja praktike aktuale në Kosovë, e orientuar dhe e fokusuar në kontekstin europian. Duke u nisur nga qëllimi i punimit, objektivat, pyetja kërkimore dhe hipotezat, rasti studimor është zgjedhje adekuate, sepse ndihmon në ngritjen kolektive të vetëdijes si tek objekti referues ashtu edhe tek aktorët sigurizues, përmes identifikimit të problemeve shkak-pasojë, liri-siguri-drejtësi, ku kërkesa “mdhp” është e njëjtë për të gjitha kategoritë shoqërore dhe të gjitha institucionet, por nivelet janë të ndryshme si lokale (kombëtare), rajonale, europiane e më gjerë (ndërkombëtare).

Prandaj nënkuptohet se qëndërzimi i kërkesës së mdhp është BE-ja respektivisht, KE-ja, Shtetet e Rajonit dhe Kosova, sepse aspiratat e të gjitha këtyre shoqërive janë për integrimet europiane dhe avancimin e demokracisë. Shikuar në këtë kontekst, kemi të bëjmë me tre nivele të analizës:

- Mikro, ku fokusi është individ si aktor “shoqëror” dhe
- Makro ku fokusi është mbi institucionet, “sistemet dhe strukturat shoqërore”.

A mund të konsiderohet se zgjidhja e rastit studimor është e qëlluar?

A mund të thuhet se ka interesime të shtuara për hulumtime në këtë fushë?

A zhvillohet debat lidhur me hipotezën e shtruar lidhur me pyetjet e ngritura kërkimore?

Në përgjigje, përzgjedhja e rastit mund të thuhet se është mirë e qëlluar, ngase përshtatet me qëllimin e punimit, ndërkohë që është fushë e re, e kohës moderne, në zhvillim e sipër. Interesimet për këtë fushë janë të mëdha dhe qasjet e analizës janë të diversifikuara, në të gjitha nivelet; duke filluar nga ato kombëtare e deri te niveli ndërkombëtar. Ndërkaq debatet janë jashtëzakonisht të mëdha, ku janë të përfshirë të gjithë aktorët shoqërorë dhe liderë të politikës dhe botës akademike, ku në agjendat e liderëve botërorë si: Obama, Merkel, Kamerun etj, janë

vendosur interesimet lidhur me mbrojtjen e privatësisë. Edhe në Rajon (Maqedoni gjatë 2015-2016), cenimi i privatësisë, respektivisht, skandali i përgjimeve e tronditi skenën shtetërore.⁵

Vështrimi historik i jep koherencë punimit dhe nxjerr në pah njohuri të zhvillimeve kronologjike të mdhp. Në kontekstin kosovar, rajonal e ndërkombëtar, përmes vështimit analitik, në mbështetje të argumenteve teorike e praktike, si një rast me qasje të veçanta, e forcon qëndrueshmërinë e studimit, duke vendosur në një vend, si tërësi, mdhp, në diversitetet tepër komplekse të sistemeve të ndryshme.

Studimi synon të kontribuojë në aspektin teorik dhe atë praktik përmes analizimit dhe konstatimit të gjetjeve negative të “abuzimit” përmes teknologjisë së automatizimit me të dhp. Qasja metodologjike e kombinuar me metoda cilësore, emancipuese të punës dhe të orientuara te aktorët social ndikon në jetëgjatësinë e efektit veprues në të gjitha strukturat shoqërore dhe veçmas në mbrojtjen e dinjitetit të individit. Ndërkaq, modeli krahasues jep një pasqyrë të gjendjes reale dhe ndërlidhjen e problemit si një fakt unifikues dhe nxjerr në pah argumentin e hulumtimit për ndërtimin e konceptit unifikues për autoritet e mdhp në mbrojtje të privatësisë përmes instrumenteve dhe platformave unike të veprimit.

1.5.2 Përkufizimi i koncepteve Me qenë se mbrojtja dhe siguria e të dhp është përkufizimi kryesor që përfshihet në shumë sisteme e sektorë të jetës dhe punës, aspekti i variablave përfshin shumë dimensione si: MDhP biometrike, mdhp në videovëzhgime, mdh të ndjeshme, mdhp në librat publike, librat e hyrje daljeve, dokumentet personale etj. Qasja e punimit ka dy përkufizime bazë të koncepteve për *të drejtat e individit* dhe *sigurinë e të dhënave*. Përmes instrumenteve ligjore garantohen të drejtat në privatësi dhe siguri të të dhënave për individin, dhe në anën tjetër janë kontrollorët (institucionet) që përpunojnë të dhp, ku janë të detyruara dhe obligohen për sigurinë e të dhp dhe përpunimin e ligjshëm të tyre. Thënë ndryshe sa më të larta, standardet e mdh, aq më e lartë është siguria dhe shkalla e lirive të të drejtave të njeriut, po kështu, shumë më të avancuara janë standardet e demokracisë. Kjo problematikë e sigurisë së të dhp, e “ulët” apo “e konsoliduar”, është tregues i mirë dhe njëri nga indikatorët e zhvillimit dhe sigurisë së një vendi. Si mund të përkufizohen përfituesit nga siguria e të dhënave? Ata janë të shumëllojshëm dhe janë: brenda shtetit, rajonit dhe në nivel

⁵<http://tvklan.al/skandali-i-pergjimeve-ne-maqedoni/>, shikuar, 29.04.2016

ndërkombëtar. Ndërsa përfituesi kryesor është qytetari dhe anasjelltas përpunuesit e të dhënave dhe shteti. Në këtë kohë të zhvillimit të madh të teknologjisë ku “Për njeriun e ardhshëm do të mjaftonin si “kartë identiteti” vetëm shenjat e gishtave, të ruajtura në kompjuterët e stacioneve të policisë ndërkombëtare” (Dhima, 2008:398), padyshim që siguria e të dhp ndikohet edhe nga niveli i sigurisë së të dhënave në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Shkallë të lartë të rrezikimit të dhënave në nivel global, sot, paraqesin përpunuesit e të dhënave të ashtuquajtur “Big Data” me “transparencë të keqe të shërbimeve të `provajderve`, lokacionet e paqarta mbi të dhënat e tyre, zbulimi i të dhp . . . pamundësia e vazhdimit të implementimit të politikave të sigurisë.... Zbulimi i të dhënave gjatë transferit etj”^{6, 7}.

- Qasja ndaj aktorëve “individ” dhe “përpunuesit të dhp”, kur është kompatibël me rregullat dhe normat juridike dhe marrëdhënia midis tyre është pozitive dhe mdhp është e kënaqshme. Në të kundërt kemi të bëjmë me situatë negative-me kërcënim potencial të sigurisë.
- Aspekti tjetër vjen nga harmonizimi i normave dhe instrumenteve të brendshme me konventat dhe kornizën Europiane të privatësisë. Sa më të harmonizuara që janë këto akte, aq më e lartë është siguria dhe anasjelltas. Ky aspekt, për Kosovën dhe Rajonin, ka të bëjë me varësi pozitive dhe është në përshtatje me kërkesat e MSA-së dhe integrimet europiane. Aktorët dhe objekti sigurizues në sigurinë njerëzore dyanshëm ndikohen nga avancimi i sigurisë dhe vlerave të demokracisë.
- Autoriteti i mdhp me profesionalizëm dhe pavarësi funksionale është mënyra e duhur për ngritjen e besueshmërisë, viabilitetit dhe integritetit të “individit” dhe “përpunueseve të të dhënave personale”. Sistemi funksional dhe efikas i sundimit të ligjit është një infuzion me ndikim të madh, si te qytetarët ashtu edhe te kontrolluesit, që ndikon në cilësinë dhe nivelin e zhvillimit të demokracisë veçmas te garantimi i lirive universale të njeriut dhe sigurisë nacionale, shikuar nga pikëpamja e mdhp.

⁶www.dzlp.mk; shikuar, 30.04.2016, 24.00 h

⁷Guidelines on handling complaints and claims for infringement of personal data on social networks and in cloud computing. The project is conducted with support of the Norwegian Ministry of Foreign Affairs for the Directorate for Personal Data Protection of Macedonia and personal data protection on Cloud computing. 2015, p. 34, 35.

- Së fundi, aspekti bashkëpunues ndërinstitutional i institucioneve të mandatuara brenda një shteti (nëse ka më tepër se një autoritet kombëtar për mdhp), me institucionet e sundimit të ligjit, është në shkallën e duhur, risku i sigurisë për individin është më i ulët. Bashkëpunimi mes autoriteteve rajonale dhe ndërkombëtare përmes “platformave të përbashkëta” të veprimit kundër cenimit të privatësisë e çliron individin nga ankthi i “cenimit” të privatësisë së tij dhe e rrit sigurinë e përgjithshme. Në të kundërt kemi rrezikim të sigurisë së individit dhe të sistemeve, gjithashtu edhe shkelje të të drejtave dhe lirive të individit.

1.6 Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Mbledhja e të dhënave lidhet me hipotezën, pyetjet kërkimore, qëllimin dhe objektivat e punimit. “Në varësi të përkufizimit të koncepteve shkencore dallojmë dy tipa: a) përshkruese dhe b) precizuese” (Kocani, 1997:151). Andaj, në këtë kuadër, për rastin tonë, në përmbushje të kriterit “a”, kam përdorur literaturë parësore të botimeve mbi të drejtat dhe liritë ndërkombëtare, të kombinuara me instrumente ndërkombëtare si: Konventa, Deklarata, Traktate etj, të cilat më tepër kanë të dhëna për të hedhur dritë në aspektin “precizues” dhe cilësimin e “definimit” të problemit, për ta shikuar kronologjikisht, zhvillimin e mdhp dhe lirive individuale në kontekstin e shkurtër historik.

Në përmbushje të kriterit “b” kam shfrytëzuar literaturë kryesisht të BE-së, si dhe të dhëna nga KE-ja, Agjencitë e MDhP, Institucionet shtetërore qendrore, Konferencat Ndërkombëtare etj. Literaturë dytësore janë botimet lidhur me mbrojtjen e të dhp dhe lirive fundamentale të njeriut, dhe na japin mundësinë e analizës “cilësore”. Këto të dhëna kombinohen me të dhënat e “shkaqeve” dhe “dukurive” të abuzimit me të dhp dhe sigurinë e individit.

Kështu, na mundësohet që përgjigjjet tona t’i japim me kompetencë dhe “në përgjithësi të kuptojmë dhe shpjegojmë se si dhe pse ekziston kjo dukuri” (Matthews A4, 2010:57).

Qasja e analizës, bazuar në botime, dokumente, direktiva, ligje dhe burime tjera na ndihmon në analizimin dhe identifikimin e situatës së mdhp në kontekstin rajonal e ndërkombëtar.

“Analizimi i të dhënave përmes kombinimit të metodave sasiore dhe cilësore në mënyrën që i përshtatën më mirë projektit konkret” (Mathews B4, 2010:142), na ndihmon që pohimi ynë se furnizimi dhe sjellja e informacionit të “munguar” për “subjektin” e të dhënave dhe “kontrolluesin” e të dhënave, njëkohësisht është prurje e re për dije dhe edukim në mdhp. Ndërkaq, nga “mbledhja dhe analizimi i të dhënave anketuese, përmes pyetjeve të hapura eksploruese” (Matthews B4, 2010:210) vijmë deri te ripohimi dhe vërtetësia e kësaj sfide ku mundësohet që rekomandimet tona t’i qëndrojnë kohës.

Në përmbushje të objektivave, punimi bazohet në Konventën Europiane të MDhP gjatë Përpunimit Automatik të të Dhënave (Konventa 108:1981) dhe Direktivën Europiane të MDhP (Direktiva 95/46:1995), kryesisht duhen siguruar këto parime kryesore në mbrojtjen dhe sigurinë e të dhp:

- Që përpunimi të jetë i ligjshëm dhe të rritë sigurinë e individit.
- Që grumbullimi i të dhp të mos e kalojë qëllimin e përpunimit, dhe ato të përpunohen vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur.
- Që të mos merren dhe grumbullohen të dhëna të tepërta dhe të panevojshme.
- Të përdoren për aq kohë deri sa të arrihet qëllimi i grumbullimit të tyre.

Qasja cilësore e mbledhjes dhe përpunimit të dhënave lidhet edhe me “mbledhjen e dokumenteve” që lidhen me pyetjet e hulumtimit (Matthews B4, 2010:147), disa nga aktorët kryesorë që mbështetën në dokumente: deklaratat, rezolutat, direktivat, konferencat, rekomandimet etj, janë:

- Dokumentet e Këshillit Europian, Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të MDhP dhe Privatësisë, OECD-së, Konferenca Ndërkombëtare mbi të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, Institucione kombëtare e ndërkombëtare në kontekstin europian.
- Institucionet e mdhp, Kombëtare, Rajonale, Europiane.

- Deklarata të krerëve institucional European e Ndërkombëtar, dokumenta të institucione që përpunojnë të dhp (kontrollues) publikë dhe privatë etj.

Të dhënat që përfitohen nga përdorimi i dokumenteve, mund të jenë sasiore dhe cilësore, prandaj përdorimi i tyre ka rëndësi në funksion të punimit. Por çfarë ka rëndësi të madhe është përzgjedhja, besueshmëria, rëndësia dhe vlera e këtyre dokumenteve, si dhe pasojat që mund të vinë nga ky kufizim. Pasurimi me të dhëna të kombinuara ndikon në gjerësinë e thellësinë e punimit dhe njëkohësisht në pasurimin dhe besueshmërinë e punimit shkencorë.

1.7 Përkufizimi operacional i termave

Siguria njerëzore është një paradigmë e re që shërben për të kuptuar dobësitë globale, mbështetësit e së cilës sfidojnë nocionin tradicional të sigurisë kombëtare, duke argumentuar se referenca e duhur për sigurinë duhet të jetë individi dhe jo shteti. Siguria njerëzore thekson faktin se është e nevojshme një kuptueshmëri multi-disiplinore e sigurisë e përqëndruar tek njerëzit, që përfshin një numër të fushave kërkimore, duke përfshirë shkencat sociale, marrëdhëniet ndërkombëtare, studime strategjike dhe të drejtat e njeriut. Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Programin për Zhvillim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, një botim i vitit 1994 (Roland, 2010:87), konsiderohet si arritje në fushën e sigurisë njerëzore, duke u bazuar në argumentin se garantimi i "lirisë për të jetuar" dhe "lirisë nga frika" për të gjithë personat është rruga më e mirë për të trajtuar problemin i pasigurisë globale (Raporti, 2010).

Rrezikimi i të dhp, sot, mund të vjen nga rrugë të ndryshme ku nënkupton keqpërdorimin, vjedhjen, shkatërrimin, ndërrimin e identitetit etj. Kombinimi dhe ndërlidhja e kompjuterit me “makinenë kërkuese”- internetin në botën moderne përmes: mashtrimit, vjedhjes së programeve, futjes në programe private, zbulimit të fshehtësisë private intime, spiunazhit politik dhe industrial dhe shumë formave tjera të aktivitetit kriminal, shkakton rrezikimin e të dhp. Përveç dëmit të pariparueshëm të jetës private, vetëm për një vit nga cenimi kryesisht i të dhp, në Amerikë “nga ky kriminalitet shkaktohen dëme materiale në vlerë deri në 100 milion dollarë”, pohon autori i njohur Goldshtajn (Halili, 2005:214).

Rrezikimi dhe abuzimi i të dhëp përbën rrezikimin e sigurisë njerëzore, krijon pasiguri dhe frikë te qytetarët, ku rrezja e rrezikimit të të dhëp përmes proceseve të automatizimit i kalon kufijtë kombëtar të një vendi dhe ndryshe quhet “krim transnacional” (Collins 19, 2013:433). Strategjia Kombëtare e Sigurisë e ShBA-ve, e publikuar (1996) e paraqiti këtë fenomen si kërcënim madhor të sigurisë kombëtare. Por qeveritë çdo ditë e më tepër nuk e shohin krimin transnacional si kërcënim vetëm për individin por edhe për vet shtetin, andaj realisht mund të themi se ky krim sot përfaqëson një kërcënim madhor për sigurinë ndërkombëtare. Në Kosovë në shikim të perspektivës së shoqërisë civile, shikuar nga Qendra Kosovare e Studimeve të Sigurisë, në publikimin “Vlersimi i Sektorit të Sigurisë në Kosovë”, “Cenimi i sigurisë njerëzore në përgjithësi paraqet një nga rreziqet më të mëdha ndaj qytetarëve të Kosovës” (KCSS, 2009:39)

Zhvillimi i teknologjisë së informimit ka avancuar dhe modernizuar shpejtësinë e qarkullimit të informatës. Me futjen në përdorim të teknologjisë moderne të informacionit ka rezultuar edhe shfaqja e llojeve të reja të krimeve siç janë; kriminaliteti dhe terrorizmi kompjuterik, ndërhyrjet e paligjshme në rrjetet dhe sistemet e kompjuterëve, grabitjet e të dhënave kompjuterike, transferime të paligjshme etj. Sistemi i internetit sot mbulon tërë botën si me aplikimin e teknologjive të reja (përdorim të pajisjeve satelitore të komunikimit) ku lidhja në internet nga çdo pikë e globit është e mundur. Gjithashtu në kontekst të infrastrukturës së zhvilluar, interneti mbulon pothuajse të gjitha shtet në tërë botën, ku në këtë kuptim mund të flitet për një epokë të digjitalizuar globale. Etiketimet dhe ndërhyrjet e jashtëligjshme me anë të kompjuterit në stigmatizim dhe njollosje të individit; “pa prova, pa arsye, shkakton reagime, mosmarrëveshje, pasiguri, frikë dhe konflikte të cilat patjetër sjellin deri tek format e kriminalitetit në një shoqëri” (Halili 4, 2005:104). Këto forma të stigmatizimit në kërkimet bashkëkohore njihen si *teori të etiketimit dhe stigmatizimit apo njollosjes* ku si fenomen në raste të caktuara provokon paraqitjen e kriminalitetit dhe shndërrohet në faktor krimogjen. Sipas ankesave të paraqitura në ASHMDhP në Republikën e Kosovës nga 190 ankesa të qytetarëve gjatë vitit 2015 për shkelje të dhënave personale rreth gjysma e tyre rezultojnë nga teknologjia e informimit dhe komunikimit, theksohet në Raportin e punës (2015) të ASHMDhP. Ndërsa katër muhori i vitit 2016 shënon tendenca në rritje të ankesave në këtë drejtim ku numri i tyre arrin në 80, sa numri i të gjitha ankesave gjatë vitit 2015 të ardhura në ASHMDhP, ku

cenimi i të dhp ishte bërë përmes abuzimeve me teknologjinë e informimit. Zhvillimi i mjeteve elektronike të komunikimit, dronët, fluturaket pa pilot; “fotografitë satelitore, instrumentet e përgjimit ajror dhe instrumente tjera shumë të sofistikuar u përqendruan në zhvillimet irakiane, ndërsa agjencitë e sigurisë po interceptonin komunikime publike dhe private” (Collins 14, 2013:320), në këtë kuptim shumica e interceptimeve dhe ndërhyrjeve në jetën private të njeriut vinë pikërisht nga vet fuqia e shtetit në emër të sigurisë kombëtare dhe paqes së përgjithshme. Me këte rritet edhe rreziku i përdorimit të dhp në forma të paautorizuara dhe të jashtëligjshme, ku në kapitujt 5 dhe 7 të këtij studimi, do të flitet më shumë në këtë drejtim.

Mundësit e limituara të kontrollit janë shpeshë herë pasoj e mosnjohjes së kësaj fushe të re dhe krijimi i vonë i infrastrukturës ligjore ku në brendi të sajë mungojnë institucionet e fuqishme profesionale të specializuara, të pavarura dhe jo boll të mbështetura nga institucionet qendrore respektivisht legjislativi i shteteve. “Terrorizmi kompjuterik është kërcënim serioz i krahasuar me armët bërthamore, bakteriologjike dhe kimike dhe është një krim që ende nuk ka mundur të hetohet deri në fund. Për ta zbuluar dhe neutralizuar këtë formë virtuale të terrorizmit është shumë e vështirë për shkak se këtu nuk mbeten shumë gjurmë nëse krahasohet me botën reale ku gjurmët mbeten mjaft shumë” thuhet në artikullin “Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit kompjuterik” të gazetës *Koha Ditore*, marrë nga; <http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=69356>, shikuar më 08.06.2016, 23.30h. Ndërkaq sa për ilustrim po përmendim faktin se infrastruktura ligjore në Kosovë për mdhp është hyrë në fuqi në maj (2010), ndërsa institucioni që mbikëqyrë zbatimin në praktikë të kësaj infrastrukture ligjore ASMDhP është funksionalizuar në qershor (2011), çka do të thotë se mekanizmat për përballjen me sfidën e mdhp janë tek në fillimet punës së tyre dhe kërkohet akoma kohë për fuqizimin dhe konsolidimin e tyre, sa më parë dhe më shpejtë aq më mire për sigurinë e qytetarit, por si akt i “sigurisë politike” në favor të sigurisë njerëzore do të jetë efikas nëse në këtë proces do të kyçeshin, nga shumë nivele të shtetit dhe shoqërisë. “Kjo nënkupton që një aktor sigurizues mund të kryej akte të suksesshme ligjëruese ndërsa vendos në të njëjtën kohë t’i adresohet një kërcënim i ekzistencial nëpërmjet procedurave politike standarde se sa nëpërmjet masave të jashtëzakonshme” (Collins 7, 2013:156) me që rast sensibilizimi dhe nevoja për njohuri dhe edukim të shoqërisë në tërësi në fushën e mdhp janë kërkesa të kohës dhe se punimi si

në aspektin historikë dhe atë praktikë përmes analizimit të gjendjes, veçmas, te krahasimi dhe përdormi i instrumenteve ligjore kombëtare dhe atyre ndërkombëtare pretendon që të jep ndihmë për subjektin e të dhp.

Menaxhimi i informacionit paraqet nevojën e fuqizimit të institucioneve, publike dhe private, me ekspert të cilët janë të pajisur me njohuri profesionale të menaxhimit të bazave të të dhënave, të certifikuar në sigurinë e informacionit, të cilët menaxhojnë programet softuerike, analizojnë bazën e të dhënave, bëjnë integrimin e informacioneve dhe bashkë me zyrtarët e mdhp kujdesen në baza të përditshme për zbatimin dhe avancimin e parimeve të mdhp. Ata që menaxhojnë informata me të dhp pa marr parasysh sistemet e punës, veçmas ata që operojnë dhe përpunojnë të dhp të ndjeshme duhet ta sigurojnë pëlqimin paraprak të subjektit të të dhënave që mund të jen: “me akses të pa kufizua, me akses të kufizuar dhe me akses shumë të kufizuar” (William &W, 2013:19). Aspektet e menaxhimit dhe mdhp jan shkoqitur në kapitujt VII dhe VIII të kësaj analize. Secili zyrtar që merret me mdhp dhe menaxhimin e informatave me të dhp i detyrohet nënshkrimit të deklaratës së kofidencialitetit, sipas ligjit 03/L-172 për mdhp, në Republikën e Kosovës (2010). Gjithashtu etika e zyrtarëve lidhet nga një “grup rregullash me të cilat ata duhet të ruajnë standardet morale në punën e tyre” (Matthevs, 2010:71).

Siguria e të dhp është brenga e jonë dhe fokusi i kësaj analize synon të jap kontributin e vet ku “çdo ditë gjithkrah rreth nesh lëmë `shenja elektronike`, deri sa ne flasim me telefon, paguajmë mallin e blerë, shfrytëzojmë internetin. Përherë e më shumë evidencat e qytetarëve në mënyrë elektronike integrohen dhe lidhen në mes tyre për tu lehtësuar azhurnimi i tyre. Ndërkaq me këtë ekziston rreziku i shfrytëzimit të paautorizuar”, theksohet sipas artikullit: “Oprezno Delite Svoje Podatke” të intervistës në B92 të Jelisaveta Ćirilović, dhënë më 18.07.2012, marr nga http://www.b92.net/info/intervju/index.php?yyyy=2012&nav_id=627830 , 8.06.2016, 11.30 h, ku lehtësisht mund të vjen deri te cenimi i sigurisë së të dhp. Pasiguria e të dhënave len hpësira për abuzime, krijon stres dhe frikë te qytetarët kurse cënim të sigurisë te sistemet; e sigurisë ato financiare, shëndetësore, politike, ekonomike etj. Përfaqësuesit e Shkollës së Mbrojtjes së Re, pas luftës së dytë botërore formuan **Lëvizjen për mbrojtje shoqërore** ku në Statutin e Lëvizjes për Mbrojtje Sociale (1957), themeluar në Milano të

Italisë nga Mark Ansell dhe Filipo Gramatika, në mes tjerash thuhet se “qëllimi kryesor është mbrojtja nga kriminaliteti”. Ndërkaq në veprën ***Mbrojtja e re Sociale*** ku si ide themelore Mark Ansella parashikon mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti me “masa preventive e jo me masa tradicionale represive dhe të gjitha masat e ndërmarra dhe veprimet ndaj kriminelëve duhet të bazohen në studime dhe observime shkencore” thekson në vazhdim Ansella (Halili 4, 2005:98). Në këtë kontest në favor të këtij pohimi shkon edhe procesi i sigurizimit përmes aktit të ligjërimit dhe analizës së punimit përmes sigurisë politike pa përdorimin e mjeteve të jashtëzakonshme. Kapitulli V dhe kapitulli VIII i analizës flasin më tepër për sigurinë dhe mdhp.

Të drejtat e njeriut; janë pashmangshëm atributi dhe vlera fundamentale e kohës në të cilën jetojmë. Deklarata Universale të Drejtave të Njeriut (1948), në preambulë të saj në parimin numër një, mbi të gjitha e vendosë dinjitetin e njeriut si vlerë fundamentale. Zhvillimi historik i të drejtave të njeriut ka kaluar nëpër shumë sfida, ku për identitet dhe pavarësi, për çlirime nacionale kundër shtypjes, kundër shfarosjes, shfrytëzimeve koloniale dhe diskriminimit; janë zhvilluar luftra të përgjakshme. Në qendër të konceptit të akteve madhore ndërkombëtare dhe raporteve në marrëdhëniet ndërkombëtare, traktateve dhe marrëveshjeve të ndryshme qëndron respektimi i vlerave fundamentale të drejtave të njeriut dhe kjo vlerë kërcënohet seriozisht përmes abuzimit me të dhp. Pothuajse të gjitha kontinentet i kanë adaptuar tashmë konventat mbi të drejtat e njeriut. BE në vitin 1953, në Romë, e adaptoi Konventën për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, të cilën e hapi për aderim, për të gjitha shtet palë të kësaj konvente. Kjo Konvent, veq tjerash, në nenin 8 të saj garanton fshehtësinë e komunikimeve private dhe të drejtën e mos cenimit të këtyre komunikimeve dhe mos cenimit të privatësisë së banimit, nga askush në kundërshtim me ligjin. Shoqëritë moderne në aktet e tyre kushtetuese, kanë vendosur nën mbrojtje liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, si vlera fundamentale. Në një kapitull të veçantë edhe kushtetuta e Kosovës garanton këto të drejta ku me nenin 36 të saj garanton edhe mbrojtjen e privatësisë së individit. Mirëpo rreziku më i madh për këto të drejta dhe këto “liri vijnë kur qeveritë e shohin betejën kundër terrorizmit si luftë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, sepse qeveritë e vendeve demokratike lejojnë kufizime të mëdha mbi të drejtat e individëve në kohë lufte” (Collins 2013:383)

Shkelja dhe abuzimi me të dhp tashmë është përditshmëri, “Sipas ekspertëve të KE-së, vetëm me karta të kreditit çdo vit vidhen rreth 400 milionë dollarë. Virusët shkaktojnë rreth 12 miliardë dollarë në vit dëme, në të drejtën pronësore shkaktojnë humbje rreth 250 miliardë dollarë. Problemet e kriminalitetit kompjuterik dhe të terrorizmit kompjuterik po pengojnë organet e zbatimit të ligjit për funksionimin serioz të të gjitha shtetet ndërkombëtare” thuhet në artikullin *Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit kompjuterik*, marr nga <http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=69356>, shikuar 08.06.2016, 23.30h. Andaj tranzicioni në Kosovë që përfshin përpjekjet për modernizimin e të gjitha sferave të jetës dhe menagjimin elektronik të proceseve teknologjike, instalimin e “E Qeverisjes” në komunikim në administratë shtetërore, dhe modernizimi i shërbimeve elektronike në sektorin privat si: shëndetësi, banka, tregti, arsim, institucione të sigurimeve shoqërore, etj. rezulton padyshim edhe me lloje të reja të krimeve, përfshirë edhe mundësinë e terrorizmit kompjuterik. Shkeljet dhe abuzimet me të dhp, sipas analizës së ankesave të qytetarëve që posedon AShMDhP, janë të natyrave të ndryshme si; shkelja e të dhënave përmes vëzhgimeve me kamera, përmes përdorimit të marketingut ‘agresiv’ të jashtëligjshëm me rastin e përdorimit të SMS-ve, mesazheve përmes postës elektronike, vjedhjeve të identitetit, ndërrimit dhe thyerjes së ‘fjalëkalimeve’ etj. Në këtë kuadër shkelësit më të mëdhenj janë sistemet e kontrolluesve të telekomunikacionit, të sistemit bankar, të sistemit të shëndetësisë etj. Edukimi dhe ngritja e njohurive të mdhp përmes sistemit edukativo-arsimor, forcimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit të mdhp dhe ngritja e masave administrative ndaj shkelësve të dhp e përmirëson situatën në favor të sigurisë dhe mdhp. AShMDhP në favor të këtij konstatimi e ka dërguar në riamndamentim ligjin e mdhp, shih draft propozimet e reja për riamndamentim në strategji ligjore të Qeverisë së Kosovës (tetor 2016). Pokështu në rishikimin e kurrikules së përgjithshme të arsimit në Kosovë, Agjencia i ka dhënë propozimet e veta për përfshirje në procesin arsimor, të leksioneve mësimore nga siguria dhe mdhp në kudër të programit të lënda “e drejta qytetare” dhe “teknologjia e informimit”.

Forcimi i besimit në strukturat shtetërore ndërlidhet me fuqizimin e shtetit ligjor, me luftimin e dukurive negative të strukturave shtetërore brenda institucioneve të pushtetit; të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Në kuadër të këtyre niveleve të pushtetit funksionojnë shumë institucione varëse si; ministri, agjenci, institute etj., të cilat

përpunojnë dhe operojnë me të dhp të qytetarëve dhe jo rrallë herë ato shkelen në “emër të rritjes së efikasitetit të shërbimeve apo sigurisë së qytetarëve”. P.sh. gjatë marsit 2016, komuna e Gjilanit, me instalimin e aparatit për nxjerrjen e çertifikatave personale të qytetarëve, me qëllim të shërbimeve efikase, kishte shkelur të dhënat e tyre, sepse ato mund të nxirreshin me shtypjen në aparat të numrit shtatë-shifror personal edhe për persona të panjohur. Përveç çertifikatave personale mund të nxirreshin edhe çertifikata të ndryshme për secilin qytetarë të vendit me rastin e shtypjes në aparat të një numri 7 shifror. Me një vendim (prill 2016), AShMDhP, shih vendimi i lëshuar i AShMhP (mars 2016) e kishte ndërpre një aktivitet të ktillë, ku veq tjerash cenohej siguria e qytetarëve, ku ishte e mundur qasja në dokumente të shumta të qytetarëve. Në vendim theksohet se ishte urdhëruar komuna e Gjilanit në sigurimin e masave mbrojtëse dhe të sigurisë, me rastin e aplikimit të këtyre pajisjeve kompjuterike. Një tjetër shkelje që kishte rezultuar në komunën e Prishtinës, me rastin e bartjes së ditarëve të nxënësve nga godina e gjimnazit “Sami Frashri” në godinën e arkivit komunal të Prishtinës, pa zbatimin e masave mbrojtëse dhe sigurisë së të dhp, nga ana e shkollës dhe komunes. Duke abuzuar kundërligjshëm me të dhënat e qytetarëve, portalet i kishin nxjerrë dhe publikuar notat dhe suksesin e shkollës së mesme, të kryetares Jahjaga, ku ajo kishte qenë nxënëse e këtij gjimnazi, në vitet ’90. Edhe në këte rast, agjencia kishte ndërpre këtë lloj aktiviteti, dhe kishte urdhëruar, komunën dhe shkollën në nxjerrjen e rregulloreve për masat mbrojtëse dhe të sigurisë së të dhp, shih vendimin e AShMDhP (prill 2016). Këta, dhe shembuj të tjer nxjerrin në pah ndikimin e mbrojtjes dhe sigurisë së të dhp në *forcimin, disiplinën, zbatimin e ligjit dhe efikasitetin e strukturave shtetërore dhe padyshim rritjen e besimit të qytetarëve në këto institucione*. Marrë parasysh shtetformimin e ri dhe brishtësinë e institucioneve të reja të Kosovës; “Sfida themeltare me të cilën përballen shtet e dobëta është ajo e arritjes së niveleve më të larta të shtetformimit dhe zhvendosjes drejt fuqisë reale shtetërore”(Collins 9, 2013:210). Ndërkaq, AShMDhP me instrumentet e veta ligjore synon ta jap kontributin e vet në këtë drejtim ku detajet më specifikisht jepen në kapitujt V dhe VI të punimit të disertacionit.

Fuqizimi e demokracisë në kohën e shpejtësisë së rritjes ekonomike, si dhe; “Raporti i fortë ndërmjet zhvillimit dhe demokracisë, pasqyron faktin që zhvillimi ekonomik është i favorshëm për demokracinë” (Rose & Tepperman, 2012:324). Mirëpo një ndër kushtet e

favorizimit të demokracisë theksohet fakti i sigurisë, që sigurojnë një ambient të qetë të mirëqenies e të lirive civile. Në përpjekje të sigurimit të kushteve në këtë kuadër, politikat europiane të sigurisë dhe mbrojtjes (PESM) në strategjinë europiane të sigurisë, në kuadër të aspektit civil të kapërcimit dhe “menaxhimit të krizave ka përcaktuar katër veprime:

- Veprimin policor,
- Forcimin e sundimit të ligjit,
- Forcimin e qeverisjes së lirë dhe
- Mbrojtjen civile” (Ferati 8, 2013:254).

Agjencitë e pavarura, në këtë kontekst, luajnë rol të rëndësishëm ku në qendër të veprimit të tyre i kan vendosur “liritë fundamentale të njeriut dhe sundimit të ligjit”. Kosova në këtë drejtim përmes, agjencive dhe institucione të saj, në bashkëpunim me shoqërinë civile ka hartuar strategji të ndryshme, që në secilën prej tyre liria e mdhp është e konsideruar:

- Strategjia për të drejtat e njeriut dhe plani i veprimit 2013-2017.
- Strategjia dhe plani nacional i veprimit për të drejtat e fëmijëve në RK-së 2009-2013.
- Strategjia për sigurinë kibernetike 2016-2019.
- Strategjia e mdhp 2014-2017 (AShMDhP).
- Strategjia e Kosovës për Teknologji Informative 2016-2021.
- Strategjia Shtetërore e RK-së kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit 2012-2017.
- Strategjia Kombëtare e RK-së për menaxhimin e integruar të kufirit, 2009.
- Strategjia kombëtare kundër korrupsionit dhe plani i veprimit 2013-2017.

Në këtë drejtim të dhënat flasin për orientim të mirë të Kosovës, por fakti qëndron aty se “thelbi i demokracisë qëndron në atë që i fuqizon qytetarët e thjeshtë. Një demokraci është e efektshme ose jo, kjo duket kur nuk mbështet vetëm me shkallën me të cilën të drejtat civile dhe politike ekzistojnë në letër, por gjithashtu edhe në masën me të cilën zyrtarët i respektojnë këto të drejta në realitet” (Rose & Tepperman, 2012:326). Por, në nivel nacional mungon ende një “strategji nacionale për mdhp” dhe e masave administrative ndaj abuzuesve me të dhp, padyshim, janë favorizuese për demokracinë. Analiza e shtruar

në punim, sipas shkollave të konceptimit të gjerë të sigurisë njerëzore, forcon faktin se “siguria njerëzore në vendet e pazhvilluara shkon përtej lirisë nga varfëria duke përfshirë vlera dhe liri të tjera individuale” (Collins 6, 2013:133) në forcim të demokracisë.

1.8 Impakti shkencor i studimit

Ky studim mbi bazën e vështirimit dhe argumentimit të problemit, mendoj se ka një rëndësi të veçantë, sepse trajton sfidat me të cilat ballafaqohet, individi dhe vendi ynë lidhur me mdhp, sigurinë dhe të drejtat e individit nga njëra anë dhe detyrimet e institucioneve në garantimin e këtyre standardeve nga ana tjetër. Përveç njohurive mbi këto sfida, studimi jep edhe rekomandime për tejkalimin me sukses të këtyre vështirësive në fuqizimin e sigurisë së institucioneve shtetërore.

Sfida e tanishme dhe parashikimi i sfidave në cenimin e privatësisë në të ardhmen, është element i rëndësishëm i orientimeve tona strategjike të Kosovës, në integrimet europiane e ndërkombëtare e veçmas, anëtarësimin në KE, integrimin në BE dhe integrimet në strukturat e ndryshme të sigurisë dhe sundimit të ligjit.

Studimi jep refleksione, në përmbushje të detyrimeve tona ndërkombëtare si shtet, duke qenë pjesë aktive në promovimin e sigurisë dhe standardeve të demokracisë, mbi bazën e lirisë dhe drejtësisë me fokus individin, si kërkesa dhe vlera të globalizmit.

Nga ana tjetër, evidentimi i problemeve përmes këtij studimi, në kontekstin historik të drejtave të njeriut, në mdhp, në secilën fushë veç e veç, është një ndihmesë mjaft e madhe që mund të shfrytëzohet nga grupet e interesit.

Studimi mund të shërbejë për Kosovën si qasje e re, në ngritje të studimeve akademike, në bazë të teorisë së mdhp.

Risia qëndron edhe në rrafshin teorik, sepse trajtimi në aspektin e sigurisë së të dhënave është ndërlidhja me aplikimin e Shkollës së Kopenhagës, ku “siguria njerëzore përbën qëllimin, ndërsa siguria e shtetit (siguria shtetocentrike) mjetin për ta arritur këtë objektiv” (Collins 2013:151).

Mendojmë se përfitime të dobishme do të shkojnë te vet qytetarët, përpunuesit dhe grumbulluesit e të dhë, ku përveç informatave, në studim gjejmë edhe udhëzime se si duhet vepruar për mdhp.

Studimi sjell impakte emancipuese në njohjen e sfidës së re që ka sjell revolucionarizimi i teknologjisë digjitale. “Si orientim politik, ai rrjedh nga synimi i forcimit të sigurisë nëpërmjet politikave emancipuese dhe rrjeteve të komunitetit në të gjitha nivelet, përfshirë bashkësinë potenciale të komuniteteve-racën e përbashkët njerëzore.” (Both 2005b:268), Collins (2013).

Punimi përmban të dhëna, lidhur me proceset integruese në strukturat e BE-së, të ndërlidhura me mdhp, dhe obligimet për përmbushjen e këtyre standardeve me interes për të gjithë sektorët e shoqërisë ku e dhë është e aksesueshme.

Si studim gjithë përfshirës, është i pari në këtë fushë në Kosovë dhe mund të shërbejë për studiues dhe individë të interesuar të kësaj fushe dhe fushave tjera, për t’u shërbyer me informacione të nevojshme lidhur me mdhp.

1.9 Limitet e studimit

Kjo temë e studimit nuk ka pasur paraprakisht model për t’u orientuar. Literatura e munguar më ka detyruar që të përcjell me kujdes zhvillimet në këtë fushë. Si studim i ri, kam menduar se me shumë interes do të ishte krijimi i një modeli bazik shumëdimensional i fushave ku është aktive dhe të pranishme me dinamikën e saj, të dhë dhe privatësia e individit. Kjo qasje më ka nxjerrë para vështirësive në punë, ngase më është dashur hulumtimi i shumë materialeve nga shumë lëmi, njohja e tyre, gjetja e lidhjes së privatësisë dhe të dhë, ndonëse disiplinat, prej nga aksesohen të dhë janë krejtësisht të kundërta, ku padyshim më është dashur mund i madh në këtë drejtim. Vështirësitë e studimit janë nxjerrë në pah edhe nga krahasimet shembujt e ndryshëm dhe pyetjet eksploruese.

Vendosja e studimit në shumë nën fusha dhe sektorë të jetës e punës në shoqëri, bëri që studimi të mos përkushtohet specifikisht nëpër sisteme të ndryshme. Kjo vështirësi u

tejkalua duke e analizuar problemin në kuadër tërësisë, pasi ky është punimi i parë i kësaj natyre, tek ne, dhe për studiuesit e ardhshëm ka hapësirë dhe mundësi kritike të kësaj nën ndarjeje.

Formati i studimit, i gjerë, ashtu si ç'është edhe gjerësia e shtrirjes së të dhp dhe mungesa e literaturës edhe në shkallë botërore, më ka detyruar, në hulumtimin e literaturës, në shumë drejtime, për ta mbledhur informacionin, për ta trajtuar atë, në përputhje me rregullat e reja ndërkombëtare, mbajtjen e drejtimit të hipotezës dhe pyetjeve kërkimore në fushën e mdhp; kjo mënyrë e shtruar për analizë bëri që puna të jetë mjaft sfiduese.

Vështirësitë rreth funksionalizimit institucional të autoriteteve të mdhp, bashkë me kornizat e tyre organizative llogaridhënëse dhe sfidat e reja të qasjes në informacione, sigurisë së informacionit, sigurisë kibernetike, sigurisë institucionale e kombëtare dhe një literature të munguar specifike të fushës; në këtë drejtim, punimi ishte mjaft sfidues. Për minimizim të këtyre sfidave kam shfrytëzuar të dhëna të shumta nga interneti, kornizat juridike ndërkombëtare, rajonale e vendore dhe aspektet praktike. Studimi ka pasur synim grumbullimin bazik të gjërave, në mungesë të një bazamenti teorik të veçantë të kësaj fushe dhe ruajtjes së balancës koherente të niveleve të shpjegimit me gjuhën e thjeshtë të ligjërit për auditorin; në këtë rast, mendoj se e kam arritur tejkalimin e sfidës.

Dinamika e zhvillimeve në këtë drejtim, kërkoi vazhdimisht prezencën time aktive, dhe secila risi më mbajti në përditësimin e studimit, rishikimin e materialit, freskimin, sistematizimin dhe vendosjen e parametrave empirike të studimit në hap me kohën.

1.10 Parathënie

Para se të hidhem një shpjegim të shkurtër parathënës të kësaj fushe, fillimisht do jap disa shpjegime lidhur me punimin e shtruar për studim. Mdhp është një fushë e re për BE-në, rajonin e Mesdheut e Ballkanin, natyrisht edhe për shoqërinë kosovare. Kjo fushë në rrafshin e mdhp në aspektin institucional, bazën e ka në Konventën 108 të KE-së dhe Direktivën e KE-së 95/46. Aplikimin direkt në praktikë të kësaj fushe, bazuar në Direktivë, shtetet anëtare të BE-së e filluan për herë të parë në vitin 1995, ndonëse para

këtij viti ishin nxjerrë nga KE një mori rekomandimesh dhe aktesh të ndryshme për shtetet anëtare të KE-së për mdhp në fusha dhe sektorë të ndryshëm të jetës dhe punës, veçmas të organeve publike. Shtetet jo-anëtare dhe shtetet e rajonit, në këtë kuadër edhe Kosova, ligjin për mdhp e kanë aprovuar shumë më vonë.

Në kohën e fillimit të aplikimit të Konventës 108/1981, shumica e shteteve të rajonit, në veçanti ato që sundoheshin/udhëhiqeshin nga komunizmi, as që i kishin gjasat e aplikimit në rregullat e tyre të kësaj natyre, gjë që ishte sistemuar në Direktivën e mdhp 95/46 e që buronte nga sistemi evropian i sundimit pluralist shumë partiak. Pas shembjes së Murit të Berlinit dhe aspiratave të shteteve të lindjes në drejtim të sistemit të vlerave të demokracisë, me përkushtim të theksuar të institucioneve të këtyre shteteve për integritet Europian, dallimet në këtë fushë themelore për të drejtat dhe liritë e njeriut, sigurinë dhe drejtësinë si dhe qarkullimin e lirë të individit dhe kapitalit (si parakushte esenciale të demokracisë) nuk janë më aq të dukshme.

Institucionet për mdhp në rajon kanë emërtime të ndryshme, si: Komisioner për mdhp, Agjenci Kombëtare-Shtetërore për mdhp, Drejtori Shtetërore për mdhp, Komisioner për informim etj. Në parim, këto institucione, bazë themelimi e kanë Direktivën Europiane për privatësinë dhe mdhp.

Në Kosovë, mbrojtja e privatësisë është e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Kjo e drejtë është gjithashtu e garantuar edhe me kushtetutat e vendeve të rajonit dhe të shumicës së vendeve tjera në nivel ndërkombëtar. Në shumicën e shteteve, përveç mdhp, institucionet që merren me mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e rregullave të dhp, mbikëqyrin edhe të Drejtën e Informimit dhe të drejtat e qytetarëve për Qasje në Dokumente Zyrtare. Këto institucione, për nga rëndësia e tyre që kanë, në shumicën e vendeve të BE-së, janë vendosur si kategori kushtetuese, si dhe kanë një pavarësi të plotë profesionale, financiare dhe vendimmarrëse.

Stabiliteti shtetëror, sundimi i ligjit dhe siguria e një vendi ndërlidhen dukshëm me fuqizimin, organizimin dhe forcimin e këtyre institucioneve, duke qenë kështu kontribuuese të drejtpërdrejta në të mirën e përgjithshme të qytetarëve në tërësi dhe institucioneve integruese të familjes Europiane në veçanti.

KAPITULLI II: HISTORIK I SHKURTËR I TË DREJTAVE TË NJERIUT TË DHËNAVE PERSONALE DHE SIGURISË NË KËTO TË DREJTA

2.1 Zanafilla e mbrojtjes së të drejtave të njeriut

Funksionalizimi i mekanizmave në shoqëri për mbrojtjen e të drejtave universale njerëzore, natyrisht edhe mekanizmave që mbrojnë qenien njerëzore nga cenimet e dinjitetit të njeriut për të respektuar nderin dhe privatësinë e individit, janë vlera të civilizimit dhe vlera europiane të demokracisë. Të dhp i përkasin vetëm individit, ato janë pronë personale vetëm e individit, dmth. kjo përbën privatësinë bashkë me veprat tona personale. Duke nënkuptuar privatësinë si një term pak më të gjerë se e dhp, në kuptim të një hapësire dhe ambienti ku subjekti i të dhënave e ka të drejtën ta ruajë vetëm për veten e tij. Këto të dhëna në parim janë themeli i lirive themelore të njeriut. Të drejtat e njeriut në shtetin e sundimit të normave juridike e marrin kuptimin, nëse goditet e padrejta dhe goditen shkeljet e lirisë së njeriut. Normat juridike mbi liritë dhe të drejtat e njeriut tani nuk janë vullnet fakultativ i avokatëve të popullit, këshillave apo zyrave joqeveritare për të drejtat dhe liritë e njeriut, fondacioneve humanitare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut etj. Tashmë, dimensionin e HUMANIZMIT NJERËZOR ngadalë po e merr rolin prijës, që reflekton shpresën për një paqe të qëndrueshme në nivel global, për të cilën, të gjithë ne, duhet të jemi kontribuues të devotshëm. Rruga për të ardhur deri këtu nuk ishte e lehtë. Shkeljet dhe mohimet mbi njëri-tjetrin, luftërat dhe dhunimet për dominim ishin aq të pamëshirshme, sa që domosdoshmërisht hapi madhor u hodh më 10 dhjetor 1948, kur Kombet e Bashkuara miratuan Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDLN, OKB: 1948)⁸, dokument dhe hap i dytë me rëndësi madhore i hedhur nga OKB, mbas Kartës së San Franciskos. Kombet e Bashkuara në hapin e hedhur drejt Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në vetë materien e saj u bazuan në historinë e gjatë me plot ulje-ngritje, dështime e suksese të të drejtave të njeriut në mbarë historinë e njerëzimit (Nikolla, 2011).

⁸ Universal Deklaration of Human Rights *Adapted and proclaimed by General Assambly resolution 217 A (III) of 10 Decembar 1948*

Besimi i natyrshëm njerëzor se çdo njeri meriton të gëzojë të drejtat njerëzore, të gëzojë liritë dhe të drejtat e tij që me lindjen e tij në mënyrë të ndershme, është një koncept filozofik-juridik, i natyrshëm dhe legjitim që reflekton siguri. Rruga deri te realizimi konkret i këtij koncepti ishte plot kataklizma njerëzore, ishte shtegu më i gjakosur i historisë njerëzore dhe vazhdon të jetë një ndër prioritetet kryesore të civilizimit në nivel global. Nga parahistoria përpjekjet për vendosjen e bazave teorike për demokracinë, sigurinë, drejtësinë dhe vendosjen e normave ligjore të sjelljes shoqërore dhe përgjegjësi në mes shteteve dhe botës si tërësi, nuk kanë ndaluar asnjëherë. Kështu, Perikliu, i cili jetoi në kohën e luftës në mes Spartës dhe Athinës (431-404, para Erës së Re), për demokracinë athinase thoshte:

“Ligjet u japin drejtësi të barabartë të gjithëve, por ne nuk mund të shpërfillim koncesionet që mund të ndodhin për raste të shkëlqyera . . . Na kanë mësuar të respektojmë gjykatësit dhe ligjet dhe të mos harrojmë kurrë se duhet të mbrojmë të dëmtuarit . . . Jemi të lirë të jetojmë ashtu si na pëlqen, megjithatë, jemi gjithmonë gati të përballojmë çdo rrezik” (Greay, 2005:17)

Këto konstatime e kanë mesazhin e qartë edhe për zhvillimet e sotme, që në parim e kanë konceptin e vendosjes dhe sjelljes sipas normave ligjore, pavarësisë gjyqësore, respektimit të lirisë dhe të drejtave të njeriut, mbrojtjes së jetës private etj. Shikuar pak më thellë, gjatë historisë njerëzore, popujt e ndryshëm, grupet e ndryshme njerëzore; sikundër përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre kryesisht i kanë kërkuar përmes organizimeve grupore: në grupe, në grupime fisesh, në grupime kastash, në grupe besimesh fetare, në grupe të klasave ekonomike-sociale, në grupe etnike, përmes organizimeve shtetërore e sindikale dhe përmes organizimeve lokale, rajonale, kontinentale e globale të organizatave me karakter humanitar dhe social.

Mbi këtë qasje filozofike, mbi këtë ide veprimi e organizimi, janë shtruar e zhvilluar edhe një mori kërkesash për të drejtat; janë ndërtuar e shkruar shumë programe lëvizjesh të të drejtave të njeriut, një sërë dokumentesh e kodesh të ndryshme zakonore me ngarkesa, politike e juridike në mbështetje të të drejtave të njeriut. Kjo qasje ka reflektuar dhe ka mbushur edhe shume faqe dokumentesh, vendimesh e arsyetimesh, që në emër të lirisë dhe humanizmit njerëzor, të aspekteve të sigurisë e të lirisë dhe humanizmit, goditen dhe

ndalohen asimilimet e popujve, gjenocidet mbi grupet e caktuara etnike etj, që tashmë janë të njohura, intervenimet e forcës së kolektivitetit njerëzor NATO-s në Kosovë (1999), Bosnje Hercegovinë (1995) etj. Të tilla dokumente, qysh nga kohërat e hershme janë: Kodi i Hinduve, Kodi Babilonas Hamurabi, Bibla, Kurani, Citatet e Konfucit (që përbëjnë pesë burimet më të vjetra, që adresojnë detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e njerëzve), Nikolla, B. Ligjërata të Autorizuara mbi të Drejtat e Njeriut, 2012. Ndërsa, tek ne, në Ballkan, njihet Kanuni i Lekë Dukagjinit. Sistemet e drejtësisë të popujve të ndryshëm dhe zakonet e tyre kishin bartje rregullash për të drejtat e njeriut, por në sasi dhe cilësi ishin shumë të kufizuara, duke shmangur kështu të drejtat themelore, si: të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e punës, të drejtat në barabarësi kundër diskriminimit, të drejtat sociale, të drejtat e arsimimit etj.

Ndërkaq, dokumentet që u paraprijnë akteve ndërkombëtare që pasqyrojnë të drejtat e njeriut të shekullit XX, janë: Magna Karta (Magna Karta:1215), Ligji Anglez i të Drejtave (English Bill of Rights:1689), Ligji Francez i të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit (FDRMC:1789), Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara, Ligji për të Drejtat etj. Mirëpo, shumica e këtyre akteve, kur janë adaptuar në politikë, në praktikë i kanë përjashtuar gratë, njerëzit me ngjyrë, grupet e caktuara të shtresave sociale, grupet e caktuara etnike, fetare, ekonomike, politike etj.

Kombet e Bashkuara, si tërsi, nuk i injoruan përpjekjet pozitive të njerëzimit për të drejtat dhe liritë e njeriut. Ky mekanizëm global i njerëzimit (OKB), edhe pse deri te vendimmarrja, ka burokraci të rëndë veprimi, reflektoi pozitivitetet në këtë drejtim. Përpjekjet e para kundër skllavërisë dhe kufizimit të tmerreve të luftës i përkasin shekullit XIX. Ndër aktet më të rëndësishme ishte themelimi i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO:1919), e cila u krijua si Agjenci e Lidhjes së Kombeve, e para organizatë ndërkombëtare universale që doli nga Traktati i Versajës, pas Luftës së Parë Botërore, duke pasuar më vonë me formimin e shumë mekanizmave e agjencive të ndryshme ndërkombëtare, deri te pas lufta e dytë botërore, duke vazhduar kështu në gjysmën e dytë të shekullit të shkuar (XX) e deri te themelimi i Komisariateve për të Drejtat e Njeriut, atij për Refugjat etj. Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Britania e Madhe, Franca, Belgjika dhe Italia, të cilët me tërësinë e tyre u përfshinë në përgatitjen e një organizate

ndërkombëtare të punës, me refleksione të fuqishme të përfundimit të diplomacisë sekrete, më 1918, Federata Amerikane e Punës u vu në mbështetje të krijimit të një organizate botërore për të drejtat e punëtorëve. Përfundimi i Luftës së Parë Botërore dhe fjalimi 14-pikësh i Presidentit Wilson të Shteteve të Bashkuara, i vunë vulën projektuese krijimit të Lidhjes së Kombeve, më 1919.

Pranë Lidhjes së Kombeve, u krijua edhe Organizata Ndërkombëtare e Punës, hap ky i rëndësishëm për mbikëqyrjen e traktateve për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, sigurisë së tyre, jetës, mirëqenies dhe kushteve të punës.

Lufta e Dytë Botërore mori miliona viktima dhe u shfarosen më tepër se gjashtë milion hebregj, rom dhe grupe të shumta. Kjo shfarosje e kryer nga nazizmi (i njerëzve të pafajshëm) tmerroi mbarë njerëzimin ku u sensibilizuan qytetërimin botëror, duke ndikuar në organizimin e gjykimeve (gjyqet e para ndërkombëtare kundër krimineleve të luftës): në Nurenberg kundër nazizmit gjerman, në Tokio kundër fashistëve japonezë, për të vazhduar edhe në ditët e sotme në TN-Den Hagë për krimet e luftës të bëra nga ish-Jugosllavia–Serbia (në vitet '90 të shekullit XX dhe fillimin e shekullit XXI). Mohimi i të drejtës së lirisë, të drejtës së shprehjes, të drejtës së mendimit, të drejtës politike, lirisë së besimit, lirisë së fjalës, lirisë kombëtare, të drejtës së strehimit, të drejtës së ushqimit; ishin arsye të mjaftueshme për themelimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me qëllim të vendosjes së paqes botërore dhe parandalimin e luftërave dhe konflikteve, në mënyrë që të sigurohej njerëzimi për mospërsëritje të ngjarjeve si ato të Luftës I Botërore, Luftës së II Botërore dhe konflikteve e luftërave civile, gjenocidit dhe shtypjes (si ato të shekullit XX në Ruandë, Etiopi, ish-Jugosllavi, të fillim shekullit XXI në Irak, Afganistan, Siri etj). Presidenti amerikan Franklin Delano Rusvelt, nën inercionin frymëzues të paqes botëror përshkon mbarë njerëzimin në proces për të drejta të standardizuara dhe për mbrojtje të qytetarëve nga abuzimet e qeverive të tyre që kërkonin mbrojtje edhe nga shtetet fqinje. OKB, për zhvillimin e të drejtave të njeriut në instrumente juridike, formuan Komisionin për të Drejta të Njeriut, i cili hartojë një draft-dokument me definicione gjeneralizuese të principeve mbi të Drejtat e Njeriut, në frymën e parimeve të Kartës së OKB-së. Komisioni i kryesuar nga Elonora Rusvelt, nxori draftin me dimensionin human

ndërkombëtar, i cili u miratua nga 56 shtete anëtare të OKB-së, më 10 dhjetor 1948, me votim unanim dhe me tetë shtete abstenuese (UDHR:1948).

DUDNJ e revolucionarizoi tërë “doktrinën” e akteve ndërkombëtare, i bëri të drejtat e njeriut si “Doktrinë e Universale” të mbarë njerëzimit. Pastaj këto të drejtat do të shndërrohen nga një çështje e brendshme dikur, në çështje ndërkombëtare legjitime, dhe principi i sovranitetit do të gjuhëzohet në raport me të drejtat humanitare të të drejtave dhe lirive të njeriut. Ky ambient favorizoi zhvillimin e doktrinës së re mbi sigurinë, ku Shkolla e Kopenhagës e zgjeroi konceptin e sigurisë. “Për rrjedhojë, Shkolla e zgjeron konceptin e sigurisë përtej shtetit, duke përfshirë objekte të reja referimi, të tilla si shoqëritë dhe mjedisi” (Collins, 2013:152), ku siguria njerëzore është objekt studimi me rastin e cenimit të dhp nga teknologjia digjitale dhe rrjetet sociale të komunikimit në këtë rast studimi. Rasti i intervenimit ndërkombëtar në Kosovë në frymën e Kreut Tetë të Kartës së OKB-së për të Drejta Humanitare, si Ligji Ndërkombëtar për të Drejta të Njeriut e kanë supermacinë e veprimit mbi çdo akt tjetër lokal apo shtetëror. DUDLNj, duke theksuar qartazi ndërvlerësinë e të gjitha të drejtave si tërësi të pandara, në preambulë ka vendosur lirinë, drejtësinë dhe paqen, ku dinjiteti i njeriut mbivendoset ndaj të gjitha koncepteve tjera për sigurinë dhe paqen e përgjithshme të njerëzimit, ku e “dhëna personale përfshihet tek dinjiteti i individit, si pjesë e pandarë. Njohja e dinjitetit qenësor dhe e të drejtave të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë” (DUDNJ, OKB:1948).

Nga ky themel u nis ndërtimi i “lokomotivës së madhe të akteve ndërkombëtare” për nxjerrjen e shumë konventave, traktateve, rregulloreve, direktivave, deklaratave dhe akteve tjera ligjore e nënligjore për të drejtat civile, politike, të drejtat e gruas, të drejtat e fëmijëve, ekonomike, kulturore, shoqërore, të drejtat dhe liritë sindikale, të drejtën e arsimimit, shëndetit, strehimit, të drejtën e ushqimit, si dhe konventat: Kundër Diskriminimit Racial, mbi Parandalimin e Krimit dhe të Gjenocidit, Kundër Torturës, Kundër Skllavërisë, Konventa për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut e KE-së (e hyrë në fuqi më1953), Konventa mbi Mbrojtjen e Individit gjatë Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale e KE-së (1981) etj, të cilat në tërësinë e tyre e ndalojnë diskriminimin e çdo lloji forme. Ligji Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut solli klimë të re në nxjerrjen e akteve

dhe dokumenteve të ndryshme në politikë, në marrëdhënie ndërkombëtare, në sisteme të sigurisë e të drejtësisë, në nivel global, pothuaj në të gjitha kontinentet në botë: Europë, Afrikë, Azi, Amerikë etj. Ky ligj ndërkombëtar, gjithashtu, solli ndryshime me rëndësi të veçantë në fushën e të drejtave të njeriut, të demokracisë, të lirisë dhe lëvizjes së lirë.

Ndryshimet dramatike në Europën Lindore, përfundimi i Luftës së Ftohtë, ndryshimet dhe hapjet demokratike në Kinë, Lindje të Mesme, si dhe proceset e pavarësisë së kombeve i kaluan kufijtë e “sovrانيتit të paprekur shtetëror” (Reka, 2007:55). Zhvillimet globale të shekullit XXI kanë vënë plotësisht rregulla të reja të ndërvarësisë në mes kombeve duke kaluar vijat ndarëse kufitare në mes tyre. “Ambienti, energjia, të drejtat dhe liritë e njeriut apo komunikimet elektronike, dolën nga guaca deri dje hermetike e pushteteve të brendshme të sovranitetit klasik shtetëror” (Reka, 2007:55). Mbrojtja e privatësisë në trendet e zhvillimeve globale po i tejkalon kufijtë nacionalë dhe vazhdimisht po kërkohen rrugë për unifikim të veprimeve në mes kombeve në këtë drejtim, për tejkalimin e kësaj sfide të epokës së internetit. Megjithatë, përkufizime filozofike mbi fushën e sundimit të ligjit, të demokracisë liberale dhe liberalizmit si doktrinë, individualizmit dhe respektimit të lirive të njeriut nën kujdesin e “sundimit ligjor” i gjejmë tek Hobsi që në kohën e mesjetës, i cili konstatonte:

“Përderisa fakti themelor dhe absolut moral është e drejtë dhe jo detyrë, funksionet dhe kufijtë e shoqërisë civile duhen të përkufizohen me anë të të drejtave natyrore të njeriut, dhe jo me detyrat e tij natyrore. Shteti nuk ka funksion të prodhojë apo të nxisë një jetë të virtytshme, por të ruajë të drejtën natyrore të secilit. Pushteti i shtetit e gjen kufirin e tij absolut tek e drejta natyrore dhe në asnjë fakt tjetër moral” (Greay, 2005:25).

Për kohën, këto ishin zhvillime tejet moderne, të cilat gradualisht do të vijnë në shprehje me zhvillimet e përgjithshme të shoqërisë njerëzore nga “shtet-kombet” deri te zhvillimet në fushën e sigurisë njerëzore, të së drejtës ndërkombëtare, veçmas në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut. Në zgjerimin ndërkombëtar të Drejtave dhe Lirive të Njeriut padyshim kanë dhënë kontribut shumë personalitete që kanë menaxhuar me çështjet me ndikim botëror. Personalitete që u sakrifikuan për të drejtat universale, dhe lanë gjurmat e tyre në këtë drejtim padyshim janë; Abraham Lincoln, Franklin Ruzvelt, Uindson Çerqill, Henry Kisingjer, Vili Brand, Xhimi Karter, Mihajl Gorbaqov, Vaclav Havel, Dalaj Lama,

Nelson Mandela, Bill Clinton, Les Valenca, Papa Gjon Pali II, Nënë Tereza, Saharov, Adem Demaqi etj. Studiuesi amerikan David Shiman (2007) në mes tjerash, duke analizuar të drejtat e njeriut në kontestin e zhvillimeve demokratike–politike, shkruan:

“Çdo ditë qeniet njerëzore në mbarë botën mobilizohen për t’u përballur me padrejtësitë dhe aktet çnjerëzore. Ashtu sikundër pika e ujit bie mbi shkëmb dhe me forcë e shpon atë, po ashtu edhe njerëzimi shkon gjithnjë e më pranë arritjes së parimeve të shprehura në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut” (f. 45).

Në mbështetje të instrumenteve ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut, duke marrë mësim nga fatkeqësitë e mëdha njerëzore, ku brenda një shekulli shpërthyen dy Luftëra Botërore, në përpjekje për konsolidim dhe fuqizim të paqes kontinentale, në përpjekje për progres ekonomik dhe forcim të demokracisë, të vendosur për të mos u përsëritur e kaluara, KE dhe BE, me përkushtim në mbështetje të parimeve themelore të Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, themeluan Gjykatën e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, nxorën, aprovuan dhe vunë në zbatim instrumente të shumta mbi të drejtat e njeriut, që në thelb i kanë LIRITË THEMELORE TË NJERIUT.

Veç të tjerash, KE, sipas Statutit të tij, konfirmon se “çdo shtet anëtar i Organizatës duhet të pranojë parimet e shtetit ligjor dhe të njohë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore për të gjithë personat brenda juridiksionit të tij” (Puto, 2010:217). Kështu, përcaktohet si objektiv kryesor realizimi i një bashkimi më të ngushtë midis shteteve anëtare, me qëllim që të ruhen dhe të qohen përpara idealet dhe parimet e tyre të përbashkëta, ku mirëqenia dhe vlerat e demokracisë janë gjithmonë busulla kryesore e këtij sistemi të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër, KE në vitin 1981 aprovoi Konventën 108, lidhur me mbrojtjen e individit gjatë përpunimit automatik të të dhp. Ndërkaq, për privatësinë dhe mdhp, nxitur nga Parimet e Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut të OKB-së, në preambulën e saj, duke vënë në spikamë dinjitetin e njeriut, thuhet:

“Duke pasur parasysh se njohja e dinjitetit dhe e të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme, që u përkasin të gjithë familjes njerëzore . . . , . . . duke pasur parasysh se popujt e Kombeve të Bashkuara në Kartë kanë rikonfirmuar besimin e tyre në të drejtat

themelore të njeriut në dinjitetin dhe vlerën e qenies njerëzore . . .”(New York Gjenevë, Kombet e Bashkuara 1994:5)

Në perceptim të drejtë, për të vënë në zbatim parimet e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, të miratuara dhe të hapura për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 2200 A (XXI), të datës 16 dhjetor 1966, të hyrë në fuqi më 3 janar 1976, në përputhje me nenin 27 në Preambulë, ndër të tjera, për liritë dhe të drejtat e njeriut, thuhet: “Këto të drejta burojnë nga dinjiteti i pandarë që i përket çdo njeriu“ (New York Gjenevë, Kombet e Bashkuara, 1994:4)

Në KNDNJ, mbajtur në Teheran (13 maj 1968), ishte vërejtur ndër të tjera se, zhvillimi i hovshëm tekniko-teknologjik mund të bartte rrezik dhe shkelje të të drejtave të njeriut, dhe ndër të tjera në preambulë të Deklaratës thuhej: “Duke pasur parasysh mundësitë e reja të disponueshme nga zhvillimi i shpejtë i shkencës dhe teknologjisë, publikim i OSBE-ODIR-it (New York Gjenevë, Kombet e Bashkuara, 1994:65).

Në pikën 18 në Deklaratën e Teheranit për të Drejtat e Njeriut është vendosur obligimi për shtetet dhe qeveritë që u dedikohen parimeve të përmbajtura në Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut.

“Përderisa zbulimet shkencore dhe përparimet teknologjike të kohëve të fundit kanë hapur mundësi të gjera për përparim ekonomik-social, megjithatë zhvillimet e tilla mund të rrezikojnë të drejtat dhe liritë e individëve, dhe për këtë ato kërkojnë një vëmendje të pandërprerë” publikim i OSBE-ODIRI-t (New York Gjenevë, Kombet e Bashkuara, 1994:68, 69)

Konform Konventës për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në përputhje të Konventës 108 për mbrojtjen e individit gjatë përpunimit automatik të të dhp, KE-së, më 1995, miratoi Direktivën specifike dhe të veçantë EC 95/46, e cila merr në mbrojtje segmentin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DHE TË PRIVATËSISË. Kështu u hodh hapi i parë në nivel botëror që në mënyrë specifike të bëhet mbrojtja institucionale e të dhp dhe privatësisë së individit, nga abuzimet dhe shkeljet nga ana e operatorëve dhe përpunuesve të të dhp, kushdo çofshin ata.

Tashmë, një rrezikim serioz për privatësinë, një rrezikim edhe i sigurisë së individit dhe institucioneve të shoqërisë, ku rrezikohet siguria kombëtare edhe ajo ndërkombëtare, po vjen pikërisht nga cenimi, abuzimi dhe kriminalizimi me të dhp, si pasojë e keqpërdorimit, keqmenaxhimit, abuzimit dhe ushtrimit të krimeve kibernetike nga makineria kërkuese (rrjetet sociale të internetit) dhe automatizimi i teknologjisë së tele-informimit dhe digjitalizimit.

2.2 Historik i shkurtër mbi mbrojtjen e të dhp dhe të privatësisë

Të dhp, privatësia e individit dhe të dhënat e ndjeshme (sensitive) e kanë zanafillën e hershme të kujdesit juridiko–ligjor. Në këtë kuadër, nëpër shumë ligje të fushave të ndryshme, janë vendosur dispozita dhe nene të caktuara si: në Ligjin e shërbimit civil, në ligjet që i kanë rregulluar aspektet e caktuara të fushave të sigurisë, kodin penal, kodin civil etj., të cilat kanë rregulluar çështje të caktuara lidhur me natyrën e të dhp. Për nderin dhe dinjitetin e individit, edhe kodet e hershme juridike të popujve të ndryshëm, qysh nga mesjeta dhe para saj i kanë rregulluar aspektet e kësaj natyre. Zhvillimet e shpejta të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit shtruan nevojën e domosdoshme që të dhp dhe privatësia e individit, të trajtuara në thelb si liri themelore të njeriut, të merren nën mbrojtje institucionale me një kuadër rregullash të veçanta.

Ndër shtyllat serioze të drejtësisë të BE-së, konsiderohen ajo e Bashkimit Ekonomik, ajo e Politikës së Jashtme të Përbashkët dhe e Sigurisë, ajo e sistemit të drejtësisë e BE-së (e konsideruar si shtylla e Tretë e Drejtësisë dhe e Çështjeve të Brendshme) (Bello, 2010:291), e cila në kuadër të vet e ka edhe materien e mdhp dhe të privatësisë, apo siç quhet ndryshe “intimitetit” ose “të dhënat individuale”. Për bashkimin monetar, sikurse edhe për atë doganor, që shpesh thuhet se kanë pasur ndikim pozitiv në përsheptimin e integritetit të BE-së, lirisht një konstatimi i këtillë mund të nxirret edhe për fushën e mdhp, ku në mënyrë akoma më të përsheptuar mund të sjellë integrimin e BE-së, me vetë faktin që të dhp të regjistrit civil European gradualisht po qendërzohen në një qendër kontrolli të sistemit biometrik të dokumenteve personale të qytetarëve në nivel europian. Neni 108 i Konventës për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, duke qenë një ndër çështjet bazë

të themelimit të UE, ku shprehimisht thuhet “Unioni është themeluar mbi bazën e demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore si dhe shtetit të së drejtës”, parime që janë të përbashkëta për shtetet anëtare, dhe “Unioni respekton të Drejtat Themelore të Lirive të Njeriut, ashtu siç janë garantuar me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ashtu siç është nënshkruar në Romë më 04 nëntor 1950” (Romë, KEDLNJ:1953), hyri në fuqi më 3 shtator të vitit 1953.

Ndërkaq, baza për sigurinë e mdhp dhe privatësisë së individit vjen nga neni 8 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, ku thuhet: “Gjithkush ka të drejtë në respektimin e jetës së tij private dhe familjare, shtëpisë së tij dhe korrespondencës së tij”. Kjo Konventë ishte bërë pikë referimi për më tepër se 40 vende Europiane, duke ndikuar në legjislacionin përtej kufijve European lidhur me mdhp, për më tepër se 30 vite rresht, deri te nxjerrja e Direktivës së Unionit European 95/46, si legjislacion sekondar i së drejtës komunitare europiane me fuqi vepruese. Konventa u shtri në legjislacionet e shteteve anëtare nënshkruese të Konventës, kurse në mënyrë detyruese u fut në zbatim te shtetet anëtare të BE-së. Duhet theksuar se Direktiva 95/46 mbështetjen direkte të bazës ligjore e vendosi në dy segmente kryesore: 1) në nevojën e përshpejtuar për të mbrojtur privatësinë e individit nga zhvillimi marramendës i teknologjisë digjitale të informimit dhe komunikimit (si nevojë e ngutshme), nga presioni i zhvillimit teknologjik, dhe 2) nga detyrimet e Konventës 108/1981, “të Këshillit të Europës, për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” (Konventa 108:1981).

Data 28 janar, tash festohet edhe si Dita Europiane e Privatësisë, nga të gjithë Komisionerët dhe Agjencitë apo Autoritet e mdhp, në nivel european dhe më gjerë. “Në vitin 2001 organet e BE-së e caktuan kontrollorin apo kontrolluesin European, në përputhje me nenin 46 dhe 47 të TKE-së për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (Bello, 2010:274), i cili do të merrej me mdhp dhe të privatësisë, që të sigurojë që institucionet dhe organizmat e BE-së respektojnë në mënyrë rigorozë të drejtën për privatësi, sa herë që ato përpunojnë të dhëna me karakter personal. Në të gjitha vendet e BE-së dhe ato përtej kufijve të BE-së, deri te nxjerrja dhe ratifikimi i Konventës 108 të KE-së për përpunimin automatik të dhp, dhe më vonë edhe Direktivës EC 95/46, çështjen e mdhp dhe të

privatësisë nuk e kishin të rregulluar në legjislacionin e tyre në mënyre unike, ndërkaq, pothuajse në të gjitha kushtetutat e vendeve të BE-së ishin vendosur dispozita që garantonin privatësinë e individit dhe fshehtësinë e korrespondencave të tij dhe të drejtën e pacenuar të banesës (banimit) të tij.

E drejta e privatësisë e garantuar me nenin 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe e drejta themelore për lirinë e shprehjes që është e garantuar me nenin 10, duke i “konkurruar” njëra-tjetrës, “reflektojnë diversitetin dhe kompleksitetin e shekullit XXI”. Sekretari Përgjithshëm i KE-së (shih Jagland.Th, fjalimin i mbajtur në Bruksel, 28 Janar 2011), me rastin e Ditës së Privatësisë. Gjithashtu, në nevojën e domosdoshme të përligjëse, duhet zënë vend në strukturë legjislative edhe e “drejta e harresës”, apo, “e drejta për të harruar”, ngase shpesh të dhënat në distanca të gjata kohore për individin janë edhe pengesa të pakapërcyeshme që sfidojnë përparimin dhe pozitën e tij synuese në shoqëri. Ekziston arsyeja e fortë dhe e “domosdoshme që në një dokument ndërkombëtar detyrues të përcaktohet e drejta e bilancit në mes të dy të drejtave themelore: të drejtës së privatësisë dhe të drejtës të lirisë së shprehjes”, deklaroi në fjalimin e tij Sekretari i Përgjithshëm i KE-së, (Jagland. Th., Bruksel, 28 janar 2011).

Prandaj, gjykuar në përgjithësi me realizëm, në bilancin veprues në fushën e sundimit të ligjit, pa e cenuar lirinë e lëvizjes, të drejtat themelore të njeriut, të drejtën e mendimit dhe të shprehjes në korpusin e vlerave të përgjithshme të demokracisë dalim në një përfundim të qartë se e vetmja rrugë e drejtë për të bërë balancimin në mes të lirisë së shprehjes dhe të drejtës së privatësisë dhe mdhp, është që të miratohet një TRAKTAT NDËRKOMBËTAR detyrues ose “rregullore” e karakterit veprues ndërkombëtar, që e ka rolin e ligjit ndërkombëtar primar (obligativ). Sidoqoftë, konkretizimet individuale të legjislacionit gjatë adaptimit ose përshtatjes së direktivës EC 95/46 respektivisht “rregullores së re”, në sferën juridike të shteteve veç e veç në kuadër të BE-së me ligjin për mdhp, do të marrin fund edhe “mospërputhje ligjore në fushën e sigurisë së privatësisë, kur të miratohet një rregullore e standardizuar”. Konferenca mbi Promovimin e të Drejtave të Privatësisë në Kosovë, organizuar nga LENS në mbështetje të Fondacionit për Shoqëri të Hapur, sipas artikullit, Promovimi i të Drejtave të Privatësisë në Kosovë, Prishtinë, Korrik, 2012:4, si akt primar në kuadër të së Drejtës Komunitare Europiane, do

ta zëvendësonte Direktivën e deritashme 95/46, që e ka rolin e aktit sekondar në të drejtën komunitare Europiane.

Këto iniciativa tashmë janë duke u zhvilluar dhe konkretizimi i modernizimit i rregullave për mdhp është në proces miratimi, dhe hyrja në fuqi në një periudhe 2-4 vjeçare. Deri te koha e nxjerrjes së këtyre rregullave “Shtëpia europiane” dhe shtetet në oborrin e kësaj “Shtëpie” kanë mjaft punë për të bërë në organizimin institucional, në draftimin, propozimin dhe përshtatjen me parimet e deritashme të Konventave dhe Direktivave në fushën e mdhp dhe të privatësisë. Fuqizimi i të drejtës ndërkombëtare sot e luan rolin kryesor në zhvillimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kështu e drejta ndërkombëtare dita-ditës është detyrimi kryesor në vendosjen e sistemit të brendshëm të drejtësisë. Ndërsa, “në ShBA njihet parimi, sipas të cilit e drejta ndërkombëtare është pjesë e së drejtës së vendit; edhe në Angli e drejta ndërkombëtare trajtohet si pjesë e së drejtës së brendshme dhe është e detyrueshme për zbatim” (Puto, 2010:29). Mbi bazën e të drejtave të njeriut, njerëzimi sot ka sisteme të shumta, si: Sistemi Amerikan i të Drejtave të Njeriut (OAS) me bazë Deklaratën Amerikane të të Drejtave dhe Detyrave të Njeriut, Karta e Organizatës së Shteteve Amerikane, Sistemi Afrikan i të Drejtave të Njeriut dhe i të Drejtave të Popujve, (KSBE-OSBE), organizata joqeveritare të të drejtave të njeriut etj. Sistemi European i Drejtësisë tash për tash është lideri kryesor botëror që me sukses po i zhvillon të drejtat e njeriut, me gjithë gamën e gjerë të tyre dhe zbatimin e realizimit praktik të këtyre instrumenteve përmes Gjykatës së Strasburgut.

Shkeljet e të drejtave të privatësisë mund të adresohen edhe në Gjykatën Europiane të Drejtësisë (GjED), nëse shkeljet e këtilla kanë përfunduar të “pasuksesshme për subjektin e të dhënave” te sistemi i drejtësisë të shtetit anëtar të BE-së.” GjEDNj është instrumenti kryesor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Europë, e cila ka një juridiksion të detyrueshëm për të gjitha shtetet anëtare të KE-së”, pohon Benedekand. W, (Daci, 2011:133). Numri i gjyqtarëve është i barabartë me numrin e vendeve që janë Palë të Larta Kontraktuese të Konventës dhe i ashtuquajturit Gjyqtar Kombëtar në shqyrtimin e një çështjeje kundër shtetit nga i cili ai vjen, përfshihet në proces vetëm për të lehtësuar të kuptuarit e legjislacionit kombëtar.” Meqenëse Komuniteti European nuk e ka një ndarje të prerë të gjykatave, GJDE kryen një sërë rolesh, duke vepruar edhe si Gjykatë Kushtetuese,

edhe si Gjykatë Administrative, edhe si Gjykatë Arbitrazhi, edhe si Gjykatë Këshilluese”, (Bashkimi European, “Kokollari International”, 2010: 307, 308). Prandaj, “lëvizja e lirë e mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitalit kërkon jo vetëm që të dhp duhet të qarkullojnë lirshëm nga një shtet anëtar tek shteti tjetër, por gjithashtu të drejtat themelore të individëve duhet të jenë të garantuara” (Direktiva 95/46, Tetor, 1995:1), duke kontribuar kështu në progresin ekonomik dhe social, në ekspansionin tregtar dhe në mirëqenien e individëve. Fuqizimi institucional-ligjor në fushën e të dhp, padyshim që do të sjellë përfitime të shumëfishta në tri shtylla për të gjitha shtetet dhe të gjithë qytetarët e shteteve të BE-së dhe përtej BE-së, ekzaktësisht në: DREJTËSI-SIGURI-LIRI THEMELORE TË NJERIUT.

2.3 Të drejtat personale, të drejta themelore të njeriut

Të dhp të njeriut dhe jeta e tij shpirtërore, materiale, intelektuale e kulturore, duke përfshirë edhe botën e tij të brendshme (sensitive), janë e vetmja pronë personale që lidhet drejtpërdrejt me individin dhe është në pronësinë e tij të përhjetshme. Këto të drejta qëndrojnë në themelet e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në gjuhën e përditshme, me këto të drejta nënkuptojmë sedrën e individit, nderin e individit etj. Thënë në gjuhën e terminologjisë juridike dhe në aspektin ndërkombëtar lirisht qëndron shprehja privatësi për individin. Dhe, nëse shkelet apo keqpërdoret nga kushdo qoftë, atëherë kemi të bëjmë me shkeljen e privatësisë, që herë-herë lidhet me të kuptuarit se “nderi ynë”, “dinjiteti ynë” është nëpërkëmbur apo shkelur. Shprehja e përdorur në ligjin për mdhp të Republikës së Kosovës, ***të dhëna personale*** nënkupton: “Çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave); person i identifikueshëm është personi i cili mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në veçanti në bazë të një numri të identifikueshëm ose të një e më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij ose saj fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqërorë”, shih (ligji për mdhp, Republika e Kosovës, Prishtinë, prill 2010).

Në përpjekje për të parë sigurinë dhe mdh në kuadër të normimit të të drejtave të subjekteve, shohim se e drejta civile, duke rregulluar normat shoqërore-juridike, në rendin

shoqëror, te shumë sisteme shtetërore politiko-juridike, ka rregulluar në mënyrë specifike të drejtën pasurore dhe jopasurore. Pra, normat e së drejtës civile i rregullojnë edhe disa të drejta jopasurore të cilat quhen: “të drejta personale jopasurore. Të drejtat personale jopasurore janë: e drejta e emrit, e pseudonimit, e banimit, e autorit, e nderit etj. Kuptimi i fjalës *personale* tregon lidhjen që ka kjo e drejtë me një person të caktuar” (Kondili, 2008:99). Në kornizat kushtetuese, si akte juridike më të larta të sistemeve të ndryshme politike shtetërore, e drejta e privatësisë zë vendin qendror. Ndërkaq, në legjislacionin sekondar, kjo e drejtë është e normuar juridikisht nëpër shumë të drejta, si: e drejta civile, e drejta familjare, e drejta penale, e drejta e trashëgimisë etj.

Që nga viti 1981, e drejta personale dhe e privatësisë rregullohen me ligje të veçanta, veçmas në Europë, ku detyrimet për rregullim ligjor në këtë fushë dalin nga Direktiva për mdhp dhe të Privatësisë 95/46. Në fakt këtu gjendet edhe burimi kryesor mbi sigurinë dhe mdhp dhe të privatësisë i fuzionuar në sistemet juridike të shteteve nënshkruese të Konventës mbi mdhp gjatë përpunimit automatik të të dhp, e ashtuquajtura Konventa 108. Termat: “privatësi” dhe “të dhp”, edhe pse në përgjithësi kushtetutat e vendeve të BE-së dhe të shumicës së vendeve tjera jashtë BE-së, duke përfshirë edhe legjislacionin e tyre primar dhe sekondarë, i trajtojnë të pandara dhe në një kuptim të pandarë. Të njëjtin trajtim e bën edhe legjislacioni i sistemit të drejtësisë në BE, edhe pse këto terma në thelb kanë kuptime të ndryshme dhe që të dy lidhen për individin/personin.

2.4 Të dhp dhe të dhënat identifikuese

Definicioni mbi “të dhënat personale” para së gjithash, është me interes parësor për t’u kuptuar saktësisht, veçmas kur kemi të bëjmë me materien, të cilën e kemi shtruar për studim dhe funksionin që kanë të dhp në tërësi në jetën e përditshme, pa përjashtim brenda BE-së, si dhe jashtë saj, duke përfshirë edhe vendin tonë. Kush trajtohet në fakt e dhp, përveç emrit dhe mbiemrit që konsiderohen të drejta personale, jopasurore? Ato janë të lidhura pazgjidhshmërisht me personin dhe nuk mund të tjetërsohen, “. . . edhe pseudonimi i përdorur nga personi fizik e gëzon të njëjtën mbrojtje” (Kondili, 2008:124-125).

Kur kemi të bëjmë me mbrojtjen dhe sigurinë e të dhp, rregullat vlejné vetëm atëherë kur informatat që i përpunojmë janë “të dhp”. Nëse informatat që i përpunojmë, nuk janë të dhp, atëherë ligji për mdhp nuk vlen dhe të dhënat mund të përpunohen pa fuqinë ligjore të ligjit përkatës (përpos nëse kemi të bëjmë me aplikimin e ligjeve tjera). Të dhënat të cilat e identifikojnë individin apo personin fizik dhe lidhen për të, quhen të dhp. Kjo do të thotë se informatat duhet të jenë personale për personin fizik. Mirëpo, edhe të dhënat mund të jenë të dhëna relevante të lidhura për personin dhe si të tilla trajtohen si të dhp, kështu që në Komentarin për mdhp të Republikës së Maqedonisë gjejmë, se: “. . . ajo çka është relevante është a janë të dhënat marrëse për atë person”, (DZLP, KOMENTAR na zakonot za Zaštita na ličnite podatoci, Skopje, 2010:10). Kështu, vijmë te përfundimi se, përveç të dhënave të fotografisë, emrit, vijave papilare, retinës së syrit, grupit të gjakut, ADN-së, datëlindjes, gjurmëve të gishtërinjve, zërit të personit, si të dhp, nga ky komentim ligjor profesional mund të konsiderohen edhe mendimi për individin, edhe përqindjet e theksuara në komentime (raportime) të ndryshme kur lidhen për individin, ndarja në grup apo e grupeve, komente e raporte të natyrave të ndryshme për personat (individët).

Sipas artikullit 8 (tetë) pika 1 (një) të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, për të drejtën e privatësisë dhe të drejtat personale, kemi edhe komentim, i cili parashikon jo thjesht vetëm të drejtën për t’u lënë vetëm, por edhe “integritetin moral dhe fizik të personit, identitetin e tij personal, hapësirën individuale, mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhp, aktivitet seksual dhe lidhjet shoqërore midis individëve” (Nano, 2010:142). Prandaj, individ mund të identifikohet direkt nga të dhënat direkte identifikuese, siç janë: emri dhe mbiemri i tij, adresa e tij, numri personal i tij, fotografia, ADN-ja, zëri i tij etj. Por, mund të identifikohet edhe në mënyrë indirekte, p.sh. nga aspekte dhe me rrugë tjera, si: përmes numrit të “telefonit” të tij, nga organizata ku e ka dhënë numrin e tij “telefonik”, ose të “regjistrave të telefonit”, përmes të dhënave të lëna në aeroport me rastin e fluturimeve, përmes të dhënave (adresës) ku ka mbaruar “studimet” kohë më parë, përmes të dhënave që ka lënë në “spital” kur “personi ka qenë pacient në ndonjë klinikë”, nga evidenca e sistemit “bankar” ku personi ka lënë numrin e tij “të telefonit” apo “adresën personale”.

Identifikimi i personit mund të bëhet edhe nga rrugë të tjera, si: zgjedhjes së ushqimit, pasioni, veprimtaria e tij (politike, fetare, publicistike, shkencore, profesionale etj), sëmundja e tij, nofka (emërtime dytësore lehtëuese apo përlënëse), si dhe të dhëna tjera që kanë fokus individin (që kanë të bëjnë me individin, që e identifikojnë individin), gjithashtu bëjnë pjesë në të dhe të personit fizik.

2.5 Zëri si e dhënë personale identifikuese

Zëri - si e dhe - është e dhënë e rëndësishme identifikuese për informacionet rreth individit. Si e dhënë e qëndrueshme, e lidhur direkt me personin fizik në aspektin fiziologjik-“simptomatik vokal”, që nga lindja deri te vdekja, ai pëson ndryshime në relacion me zhvillimin dhe rritjen e personit dhe asnjëherë, në asnjë rrethanë nuk lë mëdyshje për devijim apo shmangie nga personaliteti-personi fizik për të cilin është lidhur si e dhe direkte. Gjatë komunikimeve telefonike, gjatë dëgjimit të radios apo bisedave përmes pajisjeve audio-diktofone, edhe nëse personin nuk e shohim dhe nuk posedojmë të dhëna tjera personale të tij, ne me lehtësi do ta identifikojmë, p.sh. fjalimin e presidentit Obama, fjalimin e liderit universal të rezistencës për të drejtat dhe liritë e njeriut z. Demaqi, moderatorin apo spikerin e TV, interpretuesin e këngës “A vritet pafajësia” (Leonora Jakupi), apo fjalimin e Merkelit para deputetëve të Parlamentit Europian etj.

“Përpunimi, ruajtja ose njoftimi i të dhënave të zërit dhe figurës që i përkasin personit fizik lidhur me regjistrimin, zhvillimin, grumbullimin, transferimin dhe përdorimin në kuadër të rëndësisë që e ka në shoqërinë e informacionit, do të duhej të zbatohet Direktiva 95/46 për përfshirjen e të dhënave të tilla” (Direktiva 95/46, tetor 1995:4), sepse këto të dhëna me karakter specifik (thuhet në vazhdim të parimit nr. 15 të Direktivës 95/46), kanë të bëjnë me individin, dhe të dhënat në fjalë, janë me karakter personal.

Përpunimi i të dhënave të zërit dhe të imazhit të personave konform zhvillimeve të reja të teknologjisë së kësaj fushe do të nxisin propozime të reja të Komisionit të KE-së, duke marrë parasysh progresin shoqëror në sferën e teknologjisë së informacionit në nivel botëror dhe rregulloreve ligjore mbi të drejtën e informimit. Marrja e incizimeve të zërit nga kushdo qoftë, keqpërdorimit të zërit dhe komunikimit me të folmen e individit, pa

pëlqimin e vetë individit apo individëve që kanë zotësi juridike dhe ligjore, si dhe pa pëlqimin e kujdestarëve apo familjarëve të personave që kanë aftësi të kufizuara juridike (fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara), konsiderohet cenim i sigurisë personale apo shkelje ligjore e të dhp.

2.6 Karakteristikat biometrike

Avancimi i teknologjisë kompjuterike bëri që përsosja e metodave identifikuese (nga software) të jetë e shpejtë dhe akoma më e saktë përmes krahasimeve, klasifikimeve, zmadhimeve dhe pozitive projektuese aksonometrike të gjurmëve të gishtërinjve dhe vijave papilare. Përderisa karakteristikat tjera personale ndërrojnë përgjatë viteve, gjurmët e gishtërinjve janë të përhershme dhe të pandryshueshme përgjatë tërë jetës së një personi. “Studimet kanë treguar se gjurmët e gishtërinjve janë të përhershme dhe ato nuk ndërrojnë me kalimin e kohës“ (Ademaj 2008:14-16).

Për identifikimin e individualitetit të një personi në sistemin e tyre juridik, kinezët qysh herët në shekullin XIX kishin vënë në përdorim gjurmët e gishtërinjve dhe vijat papilare, ndërsa më vonë u nxorën edhe libra shkencorë në këtë drejtim, hartuar nga ekspertët Henry Fulds më 1879 dhe Francis Galton 1880, 1882, duke u pasuar edhe me shumë libra të tjerë nga ekspertë dhe studiues të ndryshëm. Përdorimi i gjurmëve të gishtërinjve ndihmoi shumë edhe në identifikimin e personave që nuk dinin shkrim-lexim, ngase analfabetizmi ishte gjerësisht i përhapur, sidomos në vendet që ishin koloni të pjesës më të madhe të shteteve të fuqishme europiane.

Në vitin 1901 komiteti i quajtur “Belper Committee” deklaroi se gjurmët e gishtërinjve do të jenë si mënyra primare e identifikimit personal. “Ndërsa, më 1902 në SHBA përdorimi sistematik i gjurmëve të gishtërinjve filloi në New York. Ndërkaq, pasi Teodor Ruzvelt kishte themeluar FBI në (1905), ishte themeluar edhe sektori identifikimit në vitin 1924, duke përdorur sistemin ‘Henry’ të gjurmëve të gishtërinjve”, (Ademaj 2008:14). Zhvillimi i shkencave mbi njeriun si; Antropologjia, Mjekësia Ligjore, Anatomia, Fiziologjia, Gjenetika, Ortopedia dhe shkenca tjera të mjekësisë mbi autopsinë e nxjerr ADN-në, llojin

dhe grupin e gjakut si të dhëna identifikuese ku gjithashtu janë të dhp që lidhen me individin dhe si të tilla e identifikojnë personin.

Por, nuk do të jetë e largët dita kur edhe qelizat e njeriut do të përfshihen si të dhp, ngase, si të tilla, e përcaktojnë specifikisht trashëgiminë dhe të ardhmen shëndetësore dhe personale të personit. Në përpjekje të qëndrimit, të sistemit dhe menaxhimit me të dhp, sot janë avancuar sisteme të veçanta të grumbullimit, evidentimit dhe të regjistrimit civil të të dhp, dhe në këtë drejtim Europa po bën përgatitjet finale të aplikimit të Sistemit Biometrik të të *Dhënave Personale* me qendër në Bruksel.

Fotografia e individit e standardit ISO, gjurmët e gishtërinjve, emri dhe mbiemri, vendi i lindjes dhe datëlindja të vendosura në një çip (disk), në një kartelë identiteti të kualitetit të lartë do të përbëjnë të dhp të individit në një sistem unik, të një programi unifikues civil në nivel evropian. Këto të dhëna janë personale dhe pronë individuale e lirive themelore të individit, ndërsa, mbrojtja e privatësisë dhe e të dhp në këtë drejtim janë në referencë me legjislacionin e Konventës Europiane për mdhp gjatë përpunimit automatit të të dhënave (Konventa 108 e 28.01.1981) dhe Direktivës EC 95/46 të KE-së.

Po çka në fakt është “biometria”? Biometria është shkenca e identifikimit të një personi në bazë të karakteristikave të tij fiziologjike apo të sjelljes, të cilat nuk i ka të përbashkëta me asnjë person tjetër dhe për këtë arsye ato janë unike dhe të qëndrueshme. Ato, gjithashtu, nuk janë të transmetueshme tek të tjerët apo nuk mund të humbasin, është e vështirë të riprodhohen apo falsifikohen, është e mundur të përdoren me ose pa pëlqimin e individit, si dhe është e vështirë të fshihen ose të ndryshohen. Sot në botë kryesisht përpunimi i karakteristikave biometrike bëhet për arsye të mbrojtjes, masave kufitare shtetërore, emërimeve në dokumentet personale të lejeve të njoftimeve dhe pasaportave, në banka dhe sisteme financiare, në sisteme të informacionit, në sisteme të sigurisë së lartë shtetërore etj “Si çdo teknologji tjetër biometria mund të përdoret në mënyrë ‘miqësore’ me privatësinë e individit, dhe nga ana tjetër mund të nënkuptohet edhe një ndërhyrje serioze në jetë në privatësinë e individit.” (Shih, Udhëzuesi i hartuar lidhur me përdorimin dhe përpunimin e të dhënave biometrike), marrë nga Komisioneri për MDhP, [www. kmdp](http://www.kmdp), shikuar 09, shkurt, 2014, ora 14.00h, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

Baza ligjore e përdorimit dhe përpunimit të të dhënave biometrike në RK-së është e rregulluar me ligjin mdhp në sektorin publik dhe atë privat në katër dispozita, (ligji për mdhp, i Republikës së Kosovës, prill, (2010:33-34), duke e konsideruar plotësisht bazën ligjore të Direktivës Europiane EC 95/46 të KE-së dhe Komisionit European për mdhp gjatë përpunimit automatik të të dhp. Kontrollori në rast se ka vendosur të përdorë të dhënat biometrike të subjekteve gjatë punës së tij, ai duhet të sigurohet se e ka pëlqimin paraprak të subjektit të të dhënave dhe e ka të siguruar ligjshmërinë e përdorimit.

Kur të dhënat biometrike, në llogari të kontrollorit, përpunohen nga një kontraktor i jashtëm, kontrollori duhet të ketë kontratë me shkrim me përpunuesin e të dhënave, si: arsyen e përdorimit, masat e sigurisë për këtë kategori të veçantë të të dhp, afatin e përdorimit (në rast se transferohen, duhet të sigurohen informata “kur?”, “kujt?”, “në ç’masë”?, “pse” ?) dhe arsyen e transferimit të këtyre të dhënave. Duke qenë se shenjat e gishtërinjve, retina, irisi, tiparet e fytyrës, vijat papilare dhe karakteristikat tjera të individit janë pjesë të veçanta përcaktuese e veçorive dhe tipareve të individit, ku kuptojmë arsyen e domosdoshme se pse biometria është objekt i monitorimit.

Ndërhyrja dhe keqpërdorimi i të dhënave biometrike nga ana e kontrollorëve apo kushdo qoftë është me pasoja të pariparueshme për individin, ngase në trendet e zhvillimit të madh të teknologjisë së informimit dhe të elektronikës rreziku është bërë akoma më i madh. Secili kontrollor, i cili ligjërisht nuk e ka të përcaktuar përdorimin e të dhënave biometrike, patjetër nga institucioni i ASHMDhP, duhet ta sigurojë pëlqimin paraprak të përdorimit të tyre, njëherazi duhet të ketë siguruar pëlqimin formal të subjektit të të dhënave.

Pas aplikimit për përdorimin dhe përpunimin e të dhënave biometrike në përputhje me pëlqimin e siguruar nga autoriteti i mdh dhe bazës ligjore, kontrolluesi i të dhënave është i obliguar që të vendosë, rregulla, standarde dhe masa të sigurisë, duke vepruar në mbrojtje të lokaleve, hapësirave të punës, duke rregulluar procedurat dhe format e qasjes, duke emëruar personelin përgjegjës, duke siguruar ruajtjen e tyre jashtë ambienteve të drejtpërdrejta të punës, duke rregulluar dhe siguruar fjalëkalimet në pajisjet softuerike dhe kompjuterike, duke vepruar dhe freskuar mbrojtjen e programeve nga sulmet e ndryshme virusale të jashtme dhe të brendshme etj.

Theksojmë se të dhënat biometrike kanë përdorim të gjerë sidomos në sektorin e sigurisë dhe përdoren kryesisht për identifikim dhe verifikim. Zhvillimi i pajisjeve teknologjike të biometrisë po shkon në drejtim të zhvillimit dhe avancimit të pajisjeve verifikuese dhe pajisjeve identifikuese biometrike. Pajisjet identifikuese përfshijnë vendosjen e gjurmëve të gishtërinjve në sistem (dhe këto gjurmë, p.sh. në Republikën e Kosovës, ruhen në sistemin softuerik të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht në ARC). Ndërsa, pajisjet verifikuese, në rast të gjurmimit dhe verifikimit të identitetit të individit nga ana e personaliteteve zbatuese të ligjit, në rastin kur i kërkohet subjektit të të dhënave, dhënia e gjurmëve të gishtërinjve, krahasojnë gjurmët e dhëna në depozitim të sistemit në ARC dhe në mikroprocesorin e dokumentit personal që lexohet me elektrovalë (çipi mikrovalor në dokumentin personal), dhe ky operacion quhet verifikim i subjekteve të të dhp. Gjithashtu, kërkohet që kontrollorët në rastet e përdorimit të të dhp për arsye verifikuese, duhet të shënojnë arsyen dhe kohën e këtij zbulimi të të dhënave biometrike, e dhënë kjo që hynë në grupin e të dhënave të ndjeshme (si kategori e veçantë e të dhënave).

Në përputhje me ndjeshmërinë e përdorimit të të dhënave biometrike, kontrolluesi asnjëherë nuk bën të përcaktohet lehtë në përdorimin e të dhënave biometrike, në rast se kanë mundësi që me mjete dhe metoda tjera mund të përmbushë obligimet e veta të punës në institucionin e tij, i çfarëdo niveli qoftë (publik dhe privat), përveç nëse është paraparë ndryshe me ligje specifike.

2.7 Siguria dhe dimensionin e saj të mbrojtja e të dhp

Koncepti i sigurisë për një kohë të gjatë është ndërlidh si siguri “territoriale e shteteve nga ndërhyrjet e jashtme” si “mbrojtje ndaj agresionit të jashtëm”, si “mbrojtje e interesave kombëtare” apo si “siguri globale”. Andaj, në periudhën e trendeve të globalizmit këto koncepte po relativizohen dhe duken të pa përshtatshme, ku teoricienët kritikë në avancim të sistemeve moderne të shteteve besojnë në krijimin e strukturave “kozopolite që do të nxisin më mirë lirinë, drejtësinë dhe barazinë nëpër botë . . . në përpjekje për të rivlerësuar rrënjësisht bazat normative të politikës botërore” (Burchill & Linklater, 2010:196). Konceptet e tilla të sigurisë nënkuptojnë zgjerimin e tyre, duke marrë në konsideratë

kërcënimet dhe rreziqet globale si: terrorizmin ndërkombëtar, problemet mjedisore, gjenocidin dhe spastrimet etnike, problemet shëndetësore, luftën kundër drogës, shtetet e dobëta dhe problematike për sigurinë botërore, varfërinë, ekstremizmin fetar, krimet kibernetike etj.

Mirëpo, në mbështetje të përfaqësuesve të Shkollës së Kopenhagës, sidomos në publikimin “Siguria: një kuadër i ri analize”, (anglisht “Security: A New Framework for Analysis”) (1998) gjejmë përkufizimin se “siguria ka të bëjë me mbijetesën. Siguri quhet momenti kur një çështje paraqitet si rrezik ekzistencial për një objekt të përcaktuar referues” (Collins, 2013:151). Nga këndvështrimi i kërcënimit të sigurisë së të dhp, dhe vetë individit në këtë drejtim, kemi të bëjmë me konceptin “antropocentrik”, ku problem i sigurisë është shumë shtresore dhe prek të gjitha nivelet e sistemeve të organizuara të jetës së njeriut ku e dhp shtrihet. Prandaj në këtë ndërlidhje dallojmë:

- Nivelin horizontal, duke marrë në konsideratë gamën e gjerë të sistemeve.
- Nivelin vertikal, duke marrë në konsideratë organizimin e sistemeve shtetërore në dy sektorët e tij (organet publike dhe organet private).
- Nivelin sistemor, duke marrë në konsideratë organizimet e sistemeve, si veçanti (organet publike dhe private).

Në implementim të këtij studimi janë të pashmangshme pyetjet?

Siguri për kë? Përgjigjja është për objektin referues-individin. Përveç objektit si përfitues anasjelltas përfiton sistemi (organi publik-privat), shteti, regjioni e më gjerë).

Siguria për cilat vlera? Për vlerat e humanizmit, të drejtësisë, të sundimit të ligjit, paqes dhe mirëqenies.

Nga cilat kërcënime? Nga abuzuesit e të dhënave, sistemet si përpunues dhe operues me të dhp (organet publike dhe shtetërore).

- Kërcënimet reale, nga sulmet kibernetike, ndërhyrjet në sisteme, faktori njeri etj.
- Kërcimet potenciale që vijnë nga brenda vetë sistemit, aty ku janë të grumbulluara dhe ku përpunohen të dhënat.
- Nga bindjet, perceptimet, njohuritë e dobëta të individit dhe institucioneve të shtetit.

Me cilat mjete dhe cili është çmimi i organizimit? Mjeti apo instrumenti kryesor për mdh është :

- Korniza e mirë ligjore-Kosova e ka dhe po kështu edhe rajoni.
- Institucioni mbikëqyrës i pavarur-Kosova dhe Rajoni i ka të ngritura këto struktura.
- Sistemi i mirë dhe i pavarur gjyqësor-që masat administrative të realizohen në rast të kërcënimeve të sigurisë së të dhënave ku masat e buta dhe edukuese nuk kanë dhënë efekt.
- Kostoja e shpenzimit organizativ të autoriteteve nuk është e madhe por rritja e shpenzimeve në këtë drejtim favorizon forcimin e sigurisë së të dhënave të të gjitha sistemeve, ku te siguria e përgjithshme kombëtare, rajonale dhe më gjerë, në qendër është individi.

Në sintetizim të këtij punimi, koncepti i sigurisë mund të përmblihet në:

- Individ, institucione (publike dhe private), shtet, rajon e më gjerë.
- Aplikohet në të gjithë sektorët e jetës dhe punës (Sektorin e Sigurisë, Ekonomik, Politik, Informimit e telekomunikacionit, Rrjetet sociale, Shëndetësor, Arsimor, Diplomantik ... etj).
- Aktorët janë shtetërorë dhe joshtetërorë.
- Aspekti teorik ka analizë bazë sigurinë/mbrojtjen e të dhp, realizuar përmes rregullave, institucioneve të mdhp si instrumente garantuese të sigurisë së të dhënave, duke pas në fokus sigurinë e individit.

Këto elemente do të zbatohen gjatë gjithë këtij studimi.

KAPITULLI III: KUPTIMET THEMELORE MBI PRIVATËSINË DHE PARIMET E MBROJTJES DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE PERSONALE

3.1 Kuptimi themelor mbi privatësinë?

Privatësia si term nënkupton një dimension shumë më të gjerë në krahasim me termin “të dhëna personale”, përderisa lirisht mund të konstatojmë se të dhënat janë vetëm pjesë e privatësisë së një individi. Lidhur me këtë, në shumicën e kushtetutave të shumë shteteve, privatësia është kategori e garantuar kushtetuese. Për shembull, Kushtetuta e Kosovës në nenin 36 (Kushtetuta, Republika e Kosovës, prill, 2008:11) garanton privatësinë e individit, ndërsa me paragrafin e katërt të këtij neni, si pjesë e kësaj dispozite, theksohet edhe mdhp, duke nënkuptuar kështu të dhënat si pjesë përbërëse të privatësisë së individit. Me të drejtë del konstatimi se dimension i kësaj të drejte në Kushtetutën e RK-së është “. . . jo vetëm një nga të drejtat më komplekse, por edhe një indikator i rëndësishëm në pasqyrimin e shkallës së përgjithshme të zbatueshmërisë të së drejtave kushtetuese” (Bajrami 2011:202).

Nëse shikojmë Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë vërejmë se edhe të dhënat, edhe privatësia për nga rëndësia janë trajtuar specifikisht me nene të veçanta, shih nenet 17, 18, 25, 26, ku thuhet “pacenueshmëria e letrave dhe të gjitha formave të komunikimit dhe paprekshmëria e banesës” (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë). Ligji europian për mdhp, i cili “pritet të marrë formën e legjislacionit primar në vitin 2016”⁹, privatësinë dhe të dhënat synon t’i trajtojë me “Rregulloren të Përgjithshme të Parlamentit të Këshillit të Europës dhe të Komisionit të Bashkimit Europian, duke i dhënë fuqinë e një akti legjislativ primar, si akt detyrues për zbatim nga të gjitha shtetet” (Banacsh & Osvald, 2012:2).

⁹ Në dhjetor 2015, të tre mekanizmat Europiane si, Komisioni Europian, Këshilli dhe Komisioni i Parlamentit Europian për të Drejtat e Njeriut janë pajtuar për futjen në procedurë aprovuese të Rregullores së re të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, e cila do të aprovohet gjatë vitit 2016, e cila brenda një afati të caktuar nga moment i hyrjes në fuqi do të përcaktojë edhe afatin kohor për të gjitha shtetet anëtare për transpozimin e saj në ligjet e tyre të brendshme shtetërore.

Ndërsa, sipas të Drejtës Penale Europiane, nocioni “jetë private” luan rol në shumë plane të drejtësisë penale, e cila ka për objekt penalizimin e sjelljeve që duhen cilësuar si jetë private. Këtu bëhet fjalë për bastisje, përgjime telefonike, interceptime formash të tjera të trafikut elektronik dhe metodat policore si infiltrimi, dhe “të gjitha këto akte mund të cenojnë jetën private jo vetëm të personave fajësia e të cilëve do të konstatohet në një stad të mëvonshëm, por edhe të të pafajshmëve” (Pradel & Corstens, 2010:402).

Prandaj, me privatësi nënkuptojmë të gjitha çështjet jetësore që nga lindja deri te vdekja, që lidhen me jetën, veprën, botëkuptimin politik, fetar, intelektual, filozofik, mendor, shpirtëror-emocional, sensitiv, seksual, kreativ, të korrespondencës, të komunikimit, të komunikimit elektronik, banesës (shtëpisë), duke nënkuptuar të metat, afinitetet, talentet, sëmundjet, kreativitetet, të kaluarën, gëzimet, hidhërimet, sukseset dhe dështimet e individit, gjatë gjithë jetës, si pronë e vetme e lidhur për personin, dhe që përbëjnë privatësinë e individit. Nga kjo pikëpamje shohim se të dhp, specifikisht janë të një kuptimi më të ngushtë dhe formësojnë dimensionin e privatësisë.

Termi privatësi mund të përkufizohet edhe si e drejtë e individit për të mbajtur marrëdhëniet personale të fshehta nga të tjerët, liria e veprimit apo qëndrimit pa qenë i vëzhguar nga të tjerët si dhe si e drejtë e individit për të zbuluar informatat e tij/saj personale; kur?, si?, sa? dhe me kë dëshiron t'i ndajë?. Privatësia mund të jetë fizike, informative, vendimmarrëse dhe psikologjike. Ndërkaq, në cenimin e privatësisë në shoqërinë njerëzore mund të çojnë edhe dukuritë tjera, si: puna, ambienti, incidentet, luftërat, marrëdhëniet ndërnjerëzore, dhuna fizike, dhuna psikologjike, zhurmat e mëdha etj. Sa për ilustrim po japim faktin e ankesës së 40 qytetarëve italianë më 18 tetor 1988 në GJEDNJ kundër Bashkisë së qytetit Monte Sant Angelo, pasi qytetarët ishin ankuar kundër lëshimit të sasive të mëdha të gazit të lëngshëm që shkaktonte reaksione kimike shpërthyes dhe në lëshimin e substancave helmuese nga fabrika e shoqërisë bujqësore “Enichem”. Qytetarët jetonin në afërsi të kësaj fabrike në qytetin Manfredonia, ku veç tjerash jeta e tyre familjare dhe banesore ishte çrregulluar tej mase. Kjo gjë, nga GJEDNJ, ishte konstatuar si “ndërrhyrje arbitrare e autoriteteve publike në jetën e njeriut, ku përveç detyrimit të nenit 8 (tetë) të KEDNJ, Gjykata kishte theksuar edhe detyrime pozitive të shtetit si qenësore për mbrojtjen dhe respektimin e jetës private ose familjare” (Pradel &

Corstens, 2010:210). Në vështrim të ligjeve ndërkombëtare, sikurse në ligjin e ashtuquajtur “legjislacion i butë” dhe atë të quajtur “legjislacion i fortë”, në themelet e tyre është e vendosur shprehja “dinjitet”, “dinjitet njerëzor”, “dinjitetit imanent” etj. Dhe nga kjo del se burim themelor i të drejtave të njeriut është dinjiteti i njeriut, i cili lidhet në referencë parësore me privatësinë dhe të dhp. Termi dinjitet njerëzor është prezent në një numër shumë të madh të deklaratave, pakteve, protokolleve dhe konventave ndërkombëtare. Po kështu, edhe e drejta humanitare ndërkombëtare në mënyrë eksplicite ndalon çfarëdo cenimi të dinjitetit njerëzor. Prandaj, “dinjiteti njerëzor njihet si shtyllë e të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut në instrumentet e së drejtës ndërkombëtare” (Hanski & Suksi, 2001:28)

3.2 Privatësia dhe të dhp në të drejtat e njeriut

Të drejtat e njeriut janë një fushë e gjerë në të gjitha segmentet e jetës dhe punës së njeriut. Në të gjitha sistemet shtetërore që nga parahistoria, të drejtat e njeriut janë inkorporuar në sistemet juridike-administrative, ku më shumë e ku më pak. Por zhvillimi i fuqishëm që përbën bazën referuese për zhvillimet e sistemeve juridiko-politike në botën e sotme, padyshim se është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB-së, e aprovuar më 1948, e cila në Preambulë ka të drejtat mbi dinjitetin e njeriut, i cili është i pacenueshëm (“Universal Declartion of Human Rights, Adapted and proclaimed by General Assambly resolution 217 A”, 1948), dhe shërben si bazë për të gjitha të drejtat universale të njeriut. Mbi këtë bazë buron edhe e drejta e privatësisë.

Shumë kushtetuta, shumë ligje civile dhe penale, në kuadër të dispozitave, e kanë edhe elementin e privatësisë dhe të dhp, të trajtuara për më tepër edhe si të drejta pasurore të individit. Por Deklarata e të Drejtave të Njeriut e vitit 1968, e miratuar nga KNDNJ, e mbajtur në Teheran, duke shikuar zhvillimin tekniko-teknologjik në nivel ndërkombëtar, në pikën 18 të saj adreson shqetësimin dhe rrezikun e cenimit të privatësisë për individin dhe kërkon nga të gjitha vendet që të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e privatësisë së individit. Kjo kërkesë përsëritet edhe në Deklaratën e Vjenës, të nxjerrë nga Konferenca Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, në vitin 1993. KE-së të drejtën për mbrojtjen e

privatësisë e ka sanksionuar në Konventën Europiane mbi të Drejtat Themelore të Njeriut në vitin 1950, e hyrë në fuqi më 1953. Adresimi i kërkesave për zgjidhje nga palët ankuese dhe zgjidhja e këtyre rasteve në Gjykatën Europiane të Drejtësisë në Strasburg, në fushën e përgjimit të telefonave dhe letërkëmbimit”, (Të Drejtat e Njeriut-Një sfidë e Përhershme për Këshillin e Europës, Botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, 1996:18), shikuar në sferën e privatësisë dhe të dhp, tashmë ka arritur në një shkallë ku mund të thuhet se ka kualitet dhe demokraci të përparuar në respektimin e vlerave dhe lirive themelore të njeriut në Europë. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (1996) thotë:

“Çdo njeri ka të drejtën e respektimit të jetës private, nuk mund të ndërhyhet në ushtrimin e kësaj të drejte, përveç se kur kjo parashikohet me ligj dhe kur përbën një masë, e cila, në një shoqëri demokratike, është e domosdoshme për disa qëllime të mirëpërcaktuara” (fq.79). Ndërkaq, përpunimi i automatizuar i të dhp e ka ngritur nevojën e ratifikimit të Konventës Europiane 108 për mbrojtjen e individit gjatë përpunimit automatik të të dhp (1981), e cila hyri në fuqi më 1 tetor 1985 dhe janë nxjerrë një varg rekomandimesh për mbrojtjen e të dhënave, si në: fushën e shëndetësisë (1981), kërkime shkencore dhe statistika (1983), marketing të drejtpërdrejtë (1985), sigurime shoqërore (1986), dosje të policisë (1987), komunikim të të dhp të tretë nga organizatat publike (1991) (Të Drejtat e Njeriut-Një sfidë e Përhershme për Këshillin e Europës, Botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, 1996:80) etj.

Përparime në cilësi për të drejtat e njeriut shënohen edhe në demokracinë liberale amerikane. Arritje të theksuara në këtë drejtim rrjedhin përmes aprovimit të KONVENTËS AMERIKANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT-“PAKTI I SAN HOZESË” 22 nëntor 1969, me ç`rast e drejta për jetë private (privacy) në paragrafin 3, neni 11, saktëson:

“1. Çdokush ka të drejtë t`i respektohet nderi dhe t`i njihet dinjiteti. 2. Askush nuk mund të jetë objekt i përzierjes arbitrare dhe fyese në jetën e tij private, në familjen e tij, në shtëpinë e tij ose në korrespondencën e tij, ose i sulmeve të paligjshme në nderin dhe reputacionin e tij. 3. Çdokush ka të drejtë në mbrojtje të ligjit kundër përzierjeve ose sulmeve të tilla” (Gruda 2001:107).

Tashmë, Direktiva EC 95/46 për mbdhdp e KE-së, dimensionin e mbrojtjes të drejtave të njeriut në të dhp dhe të privatësisë e avancojnë me ligj detyrues për shtetet anëtare. Në këtë drejtim janë kryer të gjitha përgatitjet për nxjerrjen e Rregullores së Parlamentit dhe Këshillit Europian mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me të dhp dhe mbi lëvizjen e lirë të të dhp (Rregullorja e përgjithshme mbi mdp e Komisionit të BE-së), si akt primar që i detyron me ligj të gjitha shtetet në mdh dhe privatësisë (Banacsh dhe Osvald, 2012:4, 5).

3.3 Parimet e mbrojtjes së të dhënave personale

Parimet nënkuptohen si rregulla kryesore për të dhp, të cilat mund të kategorizohen në:

- Parime për mbrojtjen e të dhp,
- Parime gjatë përpunimit të të dhp,
- Parime gjatë transferimit të të dhp.

Duke u referuar në mbrojtjen ligjore, të dhp sipas paragrafit 3 të nenit 3 të Ligjit 03/L-172 për mdhp të Republikës së Kosovës, të dhënat grumbullohen vetëm për qëllime të qarta dhe legjitime, dhe nuk mund të përdoren (përpunohen) më tutje në kundërshtim me këto qëllime, përveç se në rastin kur nuk është paraparë ndryshe me ligj. Të dhënat duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara. Para se të grumbullohen të dhënat, kontrolluesi (institucioni) i të dhënave e verifikon saktësinë e të dhënave, duke kontrolluar çdo dokument të identifikimit, apo çfarëdo dokumenti tjetër publik të përshtatshëm (të përdorshëm) të subjektit të të dhënave personale. Të dhënat e grumbulluara mund të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin janë grumbulluar. Me rastin e arritjes së qëllimit për të cilin janë grumbulluar dhe përmbushjes së qëllimit të përpunimit, të dhp duhet të asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç se në rastin kur është paraparë ndryshe me ligjin për lëndën arkivore dhe arkivat, ose me ndonjë ligj tjetër përkatës” (Paragrafët 4 dhe 5 të nenit 4 të ligjit për mdhp të Republikës së Kosovës, 2010:4).

Përpunimi i të dhp bëhet në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme, pa e cenuar dinjitetin e subjektit të të dhënave. “Të dhënat personale gjatë përpunimit të tyre duhet të jenë adekuate, relevante dhe nuk duhet ta tejkalojnë qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar, apo edhe janë përpunuar më tutje”, (ligji për mbrojtjen e të dhënave personale i Republikës së Kosovës, 2010 : 3, 4). Parimet e njëjta i saktëson edhe Direktiva EC 95/46 për mdhp dhe të privatësisë e KE-së në “kapitullin 2, në nenin 8 dhe në seksionin në nenin 6” (Direktiva 95/46 e KE-së e Parlamentit European dhe e Këshillit, 1995:19).

Ndërsa parimet bazë sipas Direktivës për vendet anëtare dhe natyrisht për të gjitha vendet që përshtaten me rregullat e KE-së dhe të BE-së për mdhp janë të specifikuar qartë dhe saktë për subjektet e të dhënave me karakter personal. Ndërkaq, me masa mbrojtëse të të dhënave nënkuptojmë “. . . shumën e masave për të mbrojtur të dhënat, përderisa ato janë duke u mbledhur ose duke u përpunuar dhe të cilat mund të përpunohen dhe përdoren më pastaj ose në vazhdimësi” (Lowrances & William2013:34). Të dhp të subjekteve dhe kategorive të ndryshme të tyre gjatë punës dhe përpunimit (operimit) me të dhëna mund të transferohen:

- brenda një organizate punuese, nga një njësi në njësinë tjetër punuese, e që mund të quhet transferim intern (brenda një organizate punuese),
- brenda korporatave të bashkuara, brenda një shteti të caktuar me seli në një shtet ku ekziston edhe autoriteti i mdhp (transferimi i këtillë mund të quhet i brendshëm),
- në mes të korporatave, organizatave dhe organeve private e shtetërore të shteteve të ndryshme, të cilat selitë e tyre i kanë në shtete të ndryshme (ky transferim quhet transferim ndërkombëtar i të dhp).

Gjatë bartjes dhe transferimit të të dhënave personale duhet pasur kujdes që të përcillet legjislacioni i BE-së dhe KE-së. Klauzolat bazë që e rregullojnë transferimin e të dhënave, rregulloret dhe direktivat që specifikojnë kontratat dhe kontraktorët për realizimin e transferimit dhe aspektin e mbrojtjes dhe të sigurisë për të dhp për shtetet e BE-së, shtetet e zonës ekonomike të BE-së dhe shtetet e treta me nivel adekuat të mdhp.

Gjithashtu, autoritet e mdhp me kujdes duhet të ndjekin listën e vendeve dhe organizatave me nivel adekuat për mdhp të BE-së dhe përditësimin e kësaj liste. Ndërkaq, transferimi ndërkombëtar i të dhp sipas rregullave të KE-së dhe BE-së, sipas kapitullit të katërt të Direktivës EC. 95/46, në dy artikuj, (Direktiva 95/46 e KE. Parlamentit Europian dhe e Këshillit, 1995:31), të hapësirës komunitare, aspektin e transferimit ndërkombëtar e ndan në:

- transferim ndërkombëtar i të dhp brenda hapësirës së UE-së dhe Zonës ekonomike të BE-së,
- transferimi i të dhp në vendet e treta me nivel adekuat të mdhp,
- transferimi i të dhp nga BE-ja dhe vendeve me nivel adekuat të mdhp, në drejtim të vendeve pa nivelin e duhur për mdhp.

Për transferimet e lartpërmendura ndërkombëtare ekziston një mori procedurash dhe kushtesh të kërkuara që duhen plotësuar për kryerjen e një transferimi adekuat të përshtatshëm dhe të ligjshëm që shkon në funksion të mbrojtjes dhe sigurisë së të dhp të subjektit të dhënave, përkatësisht të qytetarëve që jetojnë në hapësirën e UE-së dhe sigurisë së të dhënave në këtë drejtim. Ndërkaq, në perspektivë, privatësia mund të dizajnohet si informacion themelor. Andaj, shikuar nga ky prizëm, parimet themelore të privatësisë së dizajnuar në literaturën mbi privatësinë mund t'i hasim si 7 parime të ashtuquajtura (PbD-Privacy by Design):

- 1. Proaktive jo-reaktive, parandaluese, jo-përmirësuese;
- 2. Vendorsje e parazgjedhur e privatësisë;
- 3. Funksionalitet shumë të plotë, jo të përmbledhur;
- 4. Privatësi e ngulitur në dizajnim;
- 5. Fundi i fundit të sigurisë, mbrojtje e plotë e ciklit të jetës;
- 6. Shikim dhe transparencë për të mbajtur atë të hapur (për subjektin);

- 7. Respektim i privatësisë nga përdoruesi, Mbajeni atë Përdorues të Qendërsuar (OPERATIONALIZING PRIVACY BY DESIGN: “A Guide to Implementing Strong Privacy”, Information and Privacy Commissioner, Practices, Ontario, Canada, 2012:8).

3. 4 Përpunimi i të dhënave personale

Përpunimi i të dhp është një ndër çështjet më të rëndësishme në relacion të sigurimit të lirive themelore të njeriut. Për subjektin e të dhp, ruajtja, mbrojtja dhe përpunimi i të dhënave ndikon drejtpërdrejt që privatësia e tij të mos keqpërdoret dhe pa dijen apo pëlqimin e subjektit të të dhënave të mos jepen informacione që lidhen me të drejtpërdrejt, apo që e kanë fokus atë. “Përpunim i të dhp është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat kryhen mbi të dhp, me mjete automatike ose jo, duke përfshirë mbledhjen, regjistrimin, organizimin, ruajtjen, përshtatjen, ndryshimin, rikthimin, konsultimin, shfrytëzimin, transmetimin, bllokimin, shpërndarjen ose ndryshe duke vënë në dispozicion, kombinimin, fotografimin, pasqyrimin, hedhjen, plotësimin, seleksionimin, shkatërrimin. Çdoherë kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhp, përpunimi bëhet në përputhje me tetë parimet që përmban ligji i mdhp” (Data Protection, for voluntary organisations, published, Office; Directyro of Social Change, is a Registered Charity, no, 800517, British Library Cataloguing in Publication Data, Copyright Directory of social change, 2009:34). Këto parime janë shpjeguar më lart, gjatë shtjellimit të këtij punimi dhe vlejné për të gjithë sektorët ku bëhet përpunimi i të dhp, përveç se në rastin kur me ligj është specifikuar ndryshe.

Derisa nuk kishim një zhvillim të teknikës së përpunimit të të dhënave, krijimi i regjistrave, dosjeve dhe katalogëve në sisteme dhe fusha të ndryshme në shoqërinë njerëzore është bërë kryesisht me dorë, në mënyrë të thjeshtë dhe mekanike. Më vonë, zhvillimi tekniko-teknologjik dhe veçmas zhvillimi elektronik, avancoi shumë mënyrën e përpunimit të të dhp. Në këtë aspekt dallojmë dy lloje përpunimesh:

- përpunimin e thjeshtë apo manual të përpunimit të të dhp dhe
- përpunimin automatik të të dhp.

Në bazë të natyrës së punës dhe pajisjeve regjistruese, dallojmë përpunimin e të dhëp sipas këtyre fushave:

- fusha e librave hyrës-dalës të regjistrimit nëpër ndërtesa dhe librave publikë,
- të dhënat biometrike (në dokumente personale dhe gjatë përdorimit për nevoja tjera),
- të dhënat në fushën e telefonisë,
- të dhënat në fushën e internetit dhe portaleve të ndryshme,
- të dhënat në audioincizim,
- të dhënat në videoincizim,
- të dhënat në qeverisje (administratë),
- të dhënat në mjekësi (veçmas gjatë në diagnostikimit),
- të dhënat në media,
- të dhënat në sistemin financiar/bankar etj.¹⁰

3.4.1 Përpunimi i thjeshtë i të dhënat personale

Të dhëp që përpunohen me dorë, që sistemohen në regjistra dhe katalogje, nëpër dosje (të sistemuara nëpër regjistratorë) nëpër organizata të ndryshme private e shtetërore përbëjnë mënyrën e thjeshtë të përpunimit të të dhëp. Përpunim i thjeshtë i të dhëp llogaritet edhe mbajtja e evidencave, regjistrave të librave hyrës dhe dalës nëpër ndërtesa e institucione në organet publike dhe private. Librat amëz të shënimeve të të lindurve, vdekurve, kurorëzimeve, librave kadastralë, librat amëz të nxënësve, studentëve, librat (evidencave) e të punësuarve, librat evidentues të të sëmurëve, evidencat e udhëtarëve etj. mund të radhiten si përpunim në grupin e përpunimit të thjeshtë (manual) të të dhëp, duke

¹⁰ Detaje për këtë ndarje do të japim në kapitujt VI dhe VII të kësaj analize studimore.

përgjashtuar këtu sistemimin elektronik-kompjuterik të të dhënave. Ky lloj i përpunimit të të dhënave gjithsesi kryhet mbi bazën ligjore të përpunuesve, përkatësisht kontrollorëve të të dhënave, duke përdorur specifikisht bazën specifike ligjore të fushës relevante në të cilën kryhet përpunimi i të dhënave. Ligji mdhp është baza dhe të gjitha ligjet tjera duhet të jenë të harmonizuara me të. Në interes të mbrojtjes adekuate, sigurisë së ruajtjes dhe përpunimit të këtyre të dhënave, afatet e ruajtjes janë të precizuara në ligj apo të specifikuara edhe në aktet e brendshme të institucioneve që mbajnë dhe përpunojnë të dhp të punësuarve apo subjekteve (klientëve) të të dhënave. Gjithçka e tejkaluar në këtë drejtim është në kundërshtim me ligjin, sigurinë e të dhënave dhe e palejueshme.

3. 4.2 Përpunimi automatik i të dhp

Në kushtet e sotme të zhvillimit të komunikimit masiv, kompjuteri është bërë domosdoshmëri e përpunimit, operimit dhe e krijimit të bazave të të dhp, që nga lindja e njeriut e deri në vdekjen e tij. Kjo për faktin se qytetërimi me arritjet e tij me shpejtësi marramendëse dhe mundësive tejet të mëdha, përpunon miliarda të dhëna të subjekteve në fusha të ndryshme, si: telekomunikacion, audioincizim, videovëzhgim, përpunim automatik të dhp të dokumenteve personale, polici, gjyqësi, tregti, shëndetësi, arsim, administratë etj. Subjekti i të dhënave jo gjithçka nga informatat apo nga privatësia e tij dëshiron të japë apo të bëjë publike për opinion e gjerë, dhe kjo përbën kujdesin kryesor të mandatuar me ligjin për mdhp për autoritet e mdhp.

Konventa 108/1981 këtë shqetësim të përpunimit automatik të të dhënave e vuri nën mbikëqyrje dhe sigurinë detyruese ligjore për të gjitha shtetet e KE-së, përmes Direktivës EC 95/46 të Parlamentit European dhe KE-së. Pra, ky është një përpunim automatik i të dhp, duke përdorur mjetet e teknologjisë informative. Kështu, përpunimi automatik i të dhp mund të prodhojë efekte ligjore me ndikim për subjektet e të dhp dhe ky lloj i përpunimit të të dhënave sipas parimit të njëmbëdhjetë (Direktiva EC e Parlamentit European dhe e Këshillit, Strasburg, 1995:4) dhe artikullit 15 të saj të vendimit individual automatik (Direktiva EC e Parlamentit European dhe e Këshillit, Strasburg, 1995:4), nënkupton vendimmarrjen automatike gjatë përpunimit të të dhënave.

Pajisjet përpunuese harduerike dhe softuerike kërkojnë njohuri të reja për të të punësuarit, kërkojnë njohuri të njohjes së rregulloreve dhe kornizave ligjore respektive në fuqi. Siguria, gjatë përpunimit të të dhënave në kompjuter, kërkon kujdes të shtuar dhe rregullat e përdorimit të pajisjeve kërkojnë personel të arsimuar e të trajnuar me standarde ISO. Siguria e të dhënave do të jetë, në vazhdim, pjesë detyruese ligjore në kuadër të masave të sigurisë gjatë përpunimit të të dhp. Në artikujt në vazhdim të këtij studimi do të japim sqarime më të detajuara për këtë lëmë.

3.5 Subjekti i të dhënave personale

Para së të flitet për subjektin (qytetarin) e të dhënave, duhet të dimë se kush është subjekt i të dhënave? Subjekt i të dhënave është individ, personi apo qytetari, të cilit i përpunohen të dhënat e tij personale, dhe i cili me vullnetin e tij në bazë të përcaktimeve për të realizuar të drejtat e tij në punësim, administratë, shëndetësi apo fusha të tjera të jetës dhe punës i ka deklaruar te kontrolluesi apo punëdhënësi, në harmoni me kërkesat ligjore në fushat respektive. Sipas teorisë së përgjithshme të së drejtës sociale, me subjekt të së drejtës nënkuptojmë çdo person që gëzon të drejta dhe që ka detyrime.

Vetëm subjekti i së drejtës mund të hyjë në ato lloj marrëdhëniesh që rregullohen nga ligji dhe që quhen marrëdhënie juridike (Puto, 2010:89). Subjektit të të dhënave, me kërkesën e tij, kontrollori (përgjegjësi ligjor i organit publik apo privat) duhet t'i sigurojë informacionet në vijim: bazën rregulluese të përpunimit të të dhënave, ruajtjen, qëllimin e përpunimit, origjinën e të dhënave, kategoritë e të dhënave që janë duke u përpunuar, marrësit dhe kategoritë e marrësve të të dhënave, qëllimin dhe bazën ligjore të marrësve të të dhënave (për çfarë qëllimi janë duke u përpunuar, për çfarë qëllimi janë zbuluar të dhënat e subjektit, duke përfshirë edhe marrësin dhe zbulimin e të dhënave për shtetet tjera).

Subjekti i të dhënave e ka të drejtën të informohet dhe të dijë edhe për procedurat teknike të përpunimit dhe të përfshirjes në vendimmarrje të të dhp të tij. Për të forcuar interesimin për të dhp, në interes të subjektit të të dhënave të individit, Eric Schmidt thotë: “Për privatësinë tënde vlen të luftosh, përndryshe e humb atë” (Kalendari vjetor i AShMDhP në

Republikën e Kosovës, v. 2014). Subjektit, qasja në të dhënat e tij personale mund t'i lejohet me kërkesën e tij, që t'i kopjojë, transkriptojë dhe konsultojë informacionet në periudha të rregullta kohore, duke pasur të drejtën që t'i sigurohet një kopje apo ekstrakt i këtyre informacioneve. Subjekti mund të parashtrojë kërkesë me shkrim, në formë elektronike apo gojarisht, dhe përgjigjja nga kontrolluesi për subjektin e të dhënave duhet të kthehet brenda afatit ligjor.

Lidhur me pengesat eventuale dhe shkeljet e vërejtura në këtë drejtim që bëhen nga ana e kontrolluesit (institucionit apo organit), qoftë publik apo privat, subjekti i të dhënave shqetësimin e vet mund ta adresojë te autoriteti shtetëror për mdhp, përkatësisht në AMDhP, nëse bëhet fjalë për shkeljet ligjore në Republikën e Kosovës. Në rast të pakënaqësive të subjektit, ai/ajo shqetësimin e vet mund ta ngrejë në Gjykatën Europiane të Drejtësisë në Strasburg (të drejtat dhe detyrimet e Gjykatës në këtë rast shkojnë konform ratifikimit, nënshkrimit dhe pranimi të konventave, përkatësisht direktivave dhe rregulloreve për shtetet palë nënshkruese të këtyre akteve respektive). Gjithashtu, shpenzimet e subjektit të të dhënave lidhur me realizimin e këtyre të drejtave duhet të rregullohen me ligj, por rëndom janë të mbuluara nga kontrollori (institucioni publik ose privat) ndaj të cilit është ushtruar ankesa.

Sa herë që subjekti i të dhënave vëren parregullsi, ose nga përpunimi i mëtejshëm vëren se mund t'i dëmtohet interesi, imazhi apo personaliteti i tij, ai/ajo ka të drejtë dhe mund të kërkojë nga kontrolluesi; shtimin, korrigjimin, bllokimin, shkatërrimin, asgjësimin, fshirjen, anonimizimin dhe kundërshtimin e të dhp. Lidhur me masat e ndërmarra, kontrollori duhet ta njoftojë në afat ligjor subjektin e të dhënave, përveç se në rastin kur me ligj është përcaktuar ndryshe. Në rast të shkeljes së këtyre kërkesave nga ana e kontrollorit (organit publik dhe privat), subjekti (qytetari) i të dhënave, brenda një afati optimal ligjor, mund ta adresojë shqetësimin në autoritetin shtetëror për mdhp (në këtë rast në Kosovë në ASMDhP). Për aq kohë sa kërkesa është adresuar në agjenci, kontrolluesit i pezullohet puna e mëtejme e përpunimit të të dhënave të subjektit.

Shpenzimet për realizimin e kësaj të drejte të subjektit (qytetarit) të të dhënave në këtë rast mbulohen nga kontrolluesi (institucioni apo organi publik ose privat). Por, përveç personave që kanë zotësinë juridike dhe ligjore, subjekte të të dhënave janë edhe fëmijët,

që nga lindja, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e vdekur. Gjatë përdorimit apo përpunimit të të dhp të këtyre personave është e detyrueshme marrja e pëlqimit me shkrim nga prindërit, kujdestarët e tyre ligjorë apo të autorizuarit e tyre.

3.6 Kontrolluesi i të dhënave personale

Kush është kontrolluesi i të dhp? Cilat janë përgjegjësitë dhe detyrat e tij në procesin e përpunimit të të dhënave të subjektit?

“Kontrollues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik dhe privat, agjenci, institucion, korporate, asociacion, apo ndonjë organ tjetër, që; vetëm apo së bashku me të tjerët, grumbullon, përpunon, transferon si dhe përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhp në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës përkatëse, dhe është llogaridhënës dhe përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të tija të përcaktuara sipas ligjit. Kontrollues i të dhp në gjuhën e shumicës së legjislacioneve, që nga ligji Komunitar i KE-së dhe BE-së, quhet përgjegjësi, drejtori, shefi, kryetari apo personaliteti i parë i ngarkuar me ligj i institucionit, ndërmarrjes, korporatës, organit publik apo privat, i cili në institucionin e tij grumbullon, përpunon, administron, transferon apo ruan të dhp për realizimin e funksionit e të detyrave të përcaktuara dhe të parapara me ligj, të organit i cili bën përpunimin e dhp të subjekteve.

Veçmas, “kujdesi permanent i kontrolluesit duhet të jetë tek përdorimi i imazheve të identifikuara ose të identifikueshme dhe vlerësimi i çështjeve të intimitetit, duke përfshirë interesat e palëve” (COMMISSION DE LA PROTECTION DE LA VIE PRIVEE, RAPPORT ANNUEL, and Edituer Responsable: M. Debeuckelaere, vzm Atomium–SABAM, Belgium, Bruxelles, 2010:38) dhe subjekteve të të dhp. Besimi dhe fuqizimi i secilit kontrollor publik apo privat është në interes të vendosjes së besimit reciprok, me këtë edhe të vendosjes së parakushteve për një demokraci të shëndoshë. Në favor të kësaj, Hillary Clinton do të shprehej: “Unë besoj në një zonë privatësie”(marrë nga kalendari i AShMDhP në Republikën e Kosovës.)

Përgjegjësitë e kontrolluesit karshi përpunimit dhe operimit me të dhëp janë të rregulluara me ligjet specifike të kornizës ligjore të secilit shtet veç e veç. Rregullimin bazë për përgjegjësitë ligjore të kontrolluesve ndaj të dhëp e parasheh Korniza Ligjore Komunitare e Unionit European dhe KE-së në Konventën e të Drejtave Themelore të Njeriut (1950) dhe protokollet shtesë të saj, Konventën 108/1981 mbi përpunimin automatik të të dhënave personale, Direktiva EC 95/46 e vitit 1995 për mdhp dhe të privatësisë, Vendimi Kornizë i Komisionit European, KE-së dhe Parlamentit të BE-së. Bazën ligjore të detyrimeve karshi subjekteve të të dhëp, lidhur me atë se si duhet të sillen ligjërisht kontrolluesit gjatë përpunimit të të dhënave e kanë ligjet e mdhp të shteteve anëtare të KE-së dhe shteteve tjera që nuk janë anëtare por, në ligjet e tyre e kanë futur ligjin e harmonizuar me Direktivën 95/46 dhe i kanë krijuar autoritetet për mdhp.

Duhet pasur parasysh se subjekti i të dhëp “gjatë procesit gjyqësor civil apo procedimeve para një autoriteti publik (p.sh. para ASHMDhP v.a), për të vendosur nëse të dhënat janë të sakta apo jo, mund të kërkojë që në hyrje të dosjes së tij të të dhënave të vendoset shënim, duke theksuar që saktësia është e kontestuar dhe se vendimi zyrtar është në pritje” (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, 2010). Gjatë kësaj periudhe kontestimore, kontrolluesi i të dhëp nuk mund dhe as që duhet t'i paraqesë të dhënat si të finalizuara të kryera dhe përfundimtare, sidomos kur ato zbulohen, jepen apo hapen për palët marrëse dhe palët e treta.

Sipas rregullave në fuqi në përputhje me Direktivën për mdhp për të gjitha vendet, palë të kësaj Direktive, kontrolluesit në mënyrë që të ofrojnë përpunim të sigurt të të dhënave, janë të detyruar që të organizojnë të gjitha masat e duhura organizative, teknike, duke përfshirë këtu të gjitha procedurat për parandalimin e çfarëdo shkatërrimi të paqëllimshëm ose të qëllimshëm të paautorizuar, si: zbulimin, ndryshimin, qasjen ose përdorimin e të dhënave apo humbjen e papritur ose të qëllimshme të tyre, në ndërmarrjen e veprimeve të mëposhtme.

- duke mbrojtur lokalet, pajisjet dhe sistemet (softuerike), duke përfshirë edhe kontrollin e qasjes,

- duke i mbrojtur programet aplikative (softuerike) që përdoren për përpunimin e të dhënave,
- duke parandaluar qasje të paautorizuar në leximin e të dhp gjatë ruajtjes dhe transmetimit, përfshirë këtu edhe transmetimin e tyre nëpërmjet rrjeteve të telekomunikimit dhe rrjeteve të internetit,
- duke siguruar metodat efikase për bllokimin, shkatërrimin, fshirjen ose anonimizimin e të dhp.

Të dhënat që përpunohen përmes mjeteve të telekomunikimit duhen siguruar në përputhje me masat e kërkuara me ligj. Gjithashtu, pajisjet harduerike, programet softuerike dhe aplikative duhen siguruar, në mënyrë që të ofrojnë nivel të duhur të masave të sigurisë për mdhp.

Procedurat dhe masat mdhp duhet të jenë të përshtatshme dhe të përditësuara, duke pasur parasysh mbrojtjen dhe rrezikun që paraqitet gjatë procesit të përpunimit. “Sipas parimit të përgjegjshmërisë, kontrolluesi në çdo kohë duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se ka një bazë të shëndoshë ligjore për përpunimin e të dhënave të tij/saj, përndryshe përpunimi duhet të ndalet”, (Handbook on European data protection law, European Agency for Fundamental Rights, Council of Europe, Luxemburg Publikations Office of the European Union, 2014:111).

Zyrtarët, të punësuarit dhe kontrolluesit që merren me përpunimin e të dhp gjatë dhe pas kryerjes së punëve të përditshme, janë të obliguar që të mbrojnë fshehtësinë e të dhp, gjëra këto që i kanë parë gjatë procesit të përpunimit. Përpunuesit të të dhënave të kontraktuar me shkrim mund t'i besohet përpunimi i të dhënave, nëse kontraktuesi është i regjistruar në vendin ku mbikëqyrja e të dhënave bëhet nga një autoritet kombëtar i pavarur i mandatuar me ligj, në të cilin vend është edhe selia e kontrollorit, brenda kufijve të autorizimeve të kontrolluesit. Në këtë rast kontrolluesi bën mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave dhe masave ligjore, te autoriteti kontraktues duke përfshirë edhe vizitat e herëpashershme të lokaleve, pajisjeve dhe hapësirave ku bëhet përpunimi i të dhënave. Në rast të mospajtimeve, përpunuesi i të dhënave me kërkesën e kontrollorit duhet t'i kthejë të gjitha të dhënat që ai/ajo i posedon, duke mos i lejuar përpunuesit t'i mbajë kopjet e të

dhënave për përpunim të mëtejshëm. Ky veprim kryhet nëse përpunuesi i të dhp e ndërpret veprimtarinë punuese dhe të dhënat i kthen menjëherë te kontrollori. Kontrolluesi i të dhp, përpunuesi i të dhënave apo autoriteti kontraktues që në llogari të kontrolluesit përpunon të dhp, në çdo kohë duhet të sigurohet se të dhënat janë duke u mbrojtur.

Kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhp janë të obliguar që në aktet e tyre të brendshme të përshkruajnë me shkrim procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhp dhe duhet të emërojnë me shkrim personat që janë përgjegjës për sistemin e dosjes dhe personat përgjegjës, të cilët për shkak të natyrës së punës duhet të përpunojnë edhe të dhp.

Kontrollorët në organet publike, dhe së fundmi, edhe ato private janë të obliguara që ta emërojnë me shkrim zyrtarin për mdhp që në disa vende në rajon dhe më gjerë quhet pika e kontaktit. Kjo njëherazi është edhe detyruese sipas kornizës ligjore të KE-së të Komisionit dhe të Parlamentit të BE-së për mbrojtjen e të dhp (“Rregullorja e Re e KE-së, Parlamentit dhe Komisionit, në procedurë aprovuese”)¹¹

3.7 Përpunuesi i të dhënave personale

Kush është përpunuesi i të dhp dhe çfarë përgjegjësisë ka ai?

Secili person (zyrtar) që merret me evidentimin e të punësuarve, që kryen shërbime të ndryshme, duke evidentuar të dhp të qytetareve pa dallim të kategorisë sociale të tyre, si psh. pensionistët, nxënësit, studentët, udhëtarët, pacientët, klientët si përdorues të shërbimeve të telefonisë, shërbimeve të internetit, shërbimeve sociale, shërbimeve bankare, shërbimeve të sigurimeve, shërbimeve të mbrojtjes dhe sigurisë, shërbimeve të

¹¹ Rregullorja e Re e KE-së dhe e Parlamentit të Komisionit European në procedurë aprovuese. Aprovimi pritet të finalizohet gjatë vitit 2016. Procedurat aprovuese të tri (3) Komisioneve i ka kaluar, pritet vetëm Parlamenti European ta bëjë aprovimin formal. Rregullorja gjendet në strategji aprovuese, thuhet se kjo është një reformë dhe fitore e madhe në funksion të mdhp. Kjo Rregullore mbështetet në 173 parime. Ka 99 dispozita ligjore të shtrira në 11 kapituj. Është nënshkruar nga Parlamenti European dhe Këshilli më 27 prill 2016. Është publikuar në gazetën zyrtare të UE më 4 maj 2016 dhe ka fuqi vepruese 10 ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të EU. Ndërsa formën aplikuese do ta nisë nga 25 maji 2018, duke lënë kështu hapësirë dy vjeçare të transpozimit në ligjet kombëtare të shteteve anëtare të BE dhe shteteve që janë palë të Konventës 108, me ç'rast do të zëvendësohet Direktiva e Deritashme 95/46 EC e mbrojtjes së të dhënave personale.

taksave dhe atyre doganore, shërbimeve të tregtisë, shërbimeve të marketingut, shërbimeve administrative, qoftë në sektorin publik apo privat quhet përpunues i të dhp të subjektit/subjekteve. “Përpunues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhp në emër të kontrolluesit. Përpunuesi i të dhp është personi, i cili ngarkohet për këtë punë (i emëruar me shkrim) nga kontrolluesi ose i autorizuari i tij për përpunimin, sistemimin, organizimin e dosjeve dhe katalogëve, apo edhe të operacioneve tjera të çfarëdoshme me të dhp të subjekteve për qëllime të veprimtarive legjitime të vetë kontrolluesit, të organizatave punuese, institucioneve të ndryshme, shoqatave të ndryshme etj. në sektorin publik dhe atë privat, në përputhje me ligjin për mdhp.

Përpunuesi, gjatë punës dhe operimit me të dhp, dhe pas punës, duhet të mbajë fshehtësinë e punës dhe nuk guxon të nxjerrë jashtë mandatisë së tij informacionet që ka hasur gjatë përpunimit të të dhp dhe t’i bëjë publike ato, apo t’i komentojë me palët tjera. Përpunuesi i të dhp të subjekteve gjatë punës dhe operimit me të dhëna përpunon të dhëna të natyrave të ndryshme, si: të dhp (emri, mbiemri, data e lindjes, data e vdekjes, vendi i lindjes, vendi i vdekjes, data e kurorëzimit, etj.), që lidhen direkt me subjektin e të dhënave, si dhe të dhëna që kanë të bëjnë me subjektin apo fokusojnë atë. Përveç këtyre, përpunuesi i të dhënave mund të përpunojë edhe të dhëna sensitive për individin (subjektin), të dhëna biometrike, të dhëna të videoincizimit, të dhëna të fotoincizimeve, të dhëna që kanë pasur rol vendimtar dhe rëndësi jetike për jetën dhe të ardhmen e subjektit të dhp etj.

Përpunimi i të dhp, përfshirë këtu edhe të dhënat sensitive të subjektit të të dhënave, duhet të bëhet në përputhje të plotë me ligjin për mdhp në shtetin respektiv. Përpunuesi (operuesi) i të dhënave ka për detyrë që gjithnjë ta mbajë të njoftuar kontrolluesin lidhur me masat ligjore të punës me të dhp; gjithashtu, këtë obligim e ka, në bazë të kërkesave ligjore, edhe ndaj subjektit të të dhënave.

Përpunuesi në organet publike dhe private ka ndërvlerësinë profesionale dhe ligjore edhe me zyrtarin për mdhp apo pikën e kontaktit dhe operatorin e teknologjisë informative, me të cilët është i obliguar që të bashkëpunojë ngushtë. Respektimi i kërkesave ligjore në aspektin e masave të sigurisë gjithmonë është prioritet i punës për përpunuesin e të dhp. Përpunuesi i të dhp duhet të disponojë dhe shfrytëzojë edhe aktet e brendshme normative,

të cilat janë në fuqi në organizatën punuese. Lidhur me të dhp duhet të ketë të konsultuar gjithnjë ligjin për mdhp dhe hap pas hapi duhet të përcjellë prurjet e rregullave të reja të kësaj natyre dhe zhvillimet e reja teknologjike në fushën e të dhp. Në përpjekje të avancimit të sigurisë dhe mdhp, në rast të shkeljeve ligjore gjatë punës, përpunuesi, duke u ndeshur me ligjin, për pasojë shkakton shkelje që sanksionohen si vepra kundërvajtëse dhe penale, varësisht nga natyra e shkeljes. Gjithnjë është e domosdoshme që trajnimi i përpunuesve në lëmin e mbrojtjes së të dhp, i zyrtarëve të mdhp/pikave të kontaktit, i zyrtarëve të teknologjisë informative të jetë prioritet i përhershëm i kontrolluesit. Kontrolluesi i të dhp, përpunuesit e të dhp, personat përgjegjës të institucioneve relevante që merren me mdhp duhet të dinë se paditë e ngritura të subjekteve të të dhp kundër kontrolluesve me rastin e shkeljes së privatësisë së tyre, “hyjnë në grupin e padive që nuk parashkruhen, kur padia ka të bëjë me rivendosjen ose mbrojtjen e një të drejte vetjake jopasurore, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj” (Buna, 2012:42).

Njohuritë më të mira dhe informacionet me kompetencë profesionale, duke llogaritur këtu edhe asistencën seminarike në këtë drejtim, secili kontrollues mund t'i marrë në Autoritetet e mdhp të shteteve ku vepron kontrolluesi.

3.8 Mbrojtja e të dhp në organet publike/Zyrtarët e mdhp (Pikat e kontaktit)

Kush është zyrtari për mbrojtjen e të dhp? Cilat janë përgjegjësitë e tij?

Zyrtari për mdhp është personi/zyrtari i brendshëm, i emëruar me shkrim nga ana e kontrolluesit të organit publik (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, 2010:36) dhe organit privat (Rregulloren e Re e KE-së ¹²); (tani është futur si detyrë obligative në Kornizën e re rregullative të Komisionit të Këshillit dhe të Parlamentit European edhe për sektorin privat). Ky zyrtar, apo kjo pikë e kontaktit, është plotësisht në varësi të institucionit të organit publik ose privat dhe nuk guxon të pësojë asnjë dëm gjatë kryerjes së punës së tij/saj. Ai/ajo është person i besueshëm dhe me njohuri solide në fushën e të

¹² Rregullorja e re e KE-së dhe Komisionit të Parlamentit European në procedurë aprovuese; shpjegimi më i zgjeruar është dhënë me lart.

dhp, me një kod etik të mirëfilltë dhe është i/e detyruar të mbrojë fshehtësinë e të dhp të subjekteve të të dhp, me të cilat përballet gjatë procesit të punës.

Duke qenë një ndër personat kyç në hierarkinë zyrtare, ky person si pikë kontakti respektivisht ky zyrtar i cili është i lidhur direkt me kryesuesin e organit apo të autorizuarin e tij, ai e njofton organin-kryesuesin e organit me shkrim lidhur me gjendjen e përpunimit të të dhp dhe reciprokisht zyrtari duhet të jetë i ndihmuar nga kontrolluesi në kryerjen e detyrave të punës së tij. Zyrtari i mdhp gjatë ushtrimit të punës së tij duhet të ketë në dispozicion pajisje dhe kapacitete të mjaftueshme për kryerjen e punës. “Detyra kryesore e zyrtarit për mdhp” shih (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, 2010:36), sipas dispozitës 75, është që të sigurojë organin publik/privat se rregullat e mdhp janë duke u zbatuar dhe janë në mbikëqyrje të duhur, për të cilat qëllime ai/ajo mund ta konsultojë në çdo kohë agjencinë. Ky zyrtar rregullisht mbikëqyr përdorimin e duhur të programeve dhe masave e procedurave mbrojtëse të vendosura për garantim të përpunimit të sigurt të të dhënave. Në mënyrë të rregullt, zyrtari për mdhp i informon të gjithë personat e punësuar të organit publik për të drejtat, zhvillimet dhe detyrimet në fushën e mdh të tyre.

Gjithashtu zyrtari i ngarkuar me këtë detyrë, me vet iniciativë mund të kryejë inspektime respektivisht kontrole, brenda institucionit ku ai është i punësuar, i cili mund të heqë, të transkriptojë ose të kopjojë të dhp të cilat i ndesh gjatë kontrollit, duke respektuar fshehtësinë e të dhënave. Zyrtari për mdh duhet t'i raportojë me shkrim kryesuesit të organit publik apo privat për kontrollet e kryera.

Subjekti i të dhënave mund t'i zbulojë zyrtarit për mdhp informata shtesë që mund të jenë të nevojshme për kryerjen e kontrollit. Zyrtari për mdhp mund ta lajmërojë me shkrim subjektin e të dhp lidhur me kryerjen e detyrave të tij/saj, si dhe mund ta njoftojë atë (subjektin e të dhënave) se do t'i ofrojë organit publik/privat opinionin e vet lidhur me kontrollin e kryer. Gjatë punës së vet kjo pikë e kontaktit respektivisht ky zyrtar gjat përpunimit të të dhp mund të has dhe përpunoj veç tjerash edhe të dhëna të ndjeshme të subjektit të të dhënave, në këto raste zyrtari për mdhp është i obliguar që të mbajë një shënim zyrtar në dosjen e subjektit të të dhp. Aspektet e detyrave, të të drejtave dhe obligimet e zyrtarit për mdhp mund të rregullohen dhe sqarohen akoma më shumë me

hartimin e rregulloreve dhe udhëzimeve të brendshme të autoriteteve kombëtare të mdhp dhe privatësisë, shih faqen zyrtare të AShMDhP, RK-së “aktet nënligjore të agjencisë”, shikuar më 20.02.2013 (Udhëzimi Administrativ për Zyrtarin e MDhP).

Shtetet anëtare të BE-së, Këshilli dhe Komisioni European tashmë në propozim të Rregullores së Re kanë futur dispozita të reja për detyrime obliguese për caktimin e zyrtarit për mdhp në organe publike dhe private. Ky detyrim më parë nuk ishte i specifikuar për organet private. Kështu, boshti kurrizor në funksion të mdhp te kontrollorët (institucionet) dhe organet në sektorin publik dhe atë privat për mdhp dhe privatësisë së subjekteve (qytetareve) është zyrtari për mdhp. Në shumë institucione (në sektorin publik dhe privat) në Republikën e Kosovës (faqja zyrtare e AShMDHP, Republika e Kosovës, shikuar 20.02.2013), zyrtari për mdhp ka të vetmen detyrë pune.

3.9 Sistemet e dosjeve

Sistemi i dosjeve përmban një sërë aktiviteteve në sistemimin, grumbullimin, përshkrimin, procedurat, titullin dhe aktivitetin e organit, respektivisht organizatës punuese që grumbullon dhe përpunon të dhp. Gjithashtu, “përmban ndërlidhjen operative me sisteme, organe dhe organizata të tjera në kuadër të bashkëpunimit, respektivisht kooperimit, si dhe aspektet e bashkëpunimit me Agjencinë sipas dispozitave të rregulluara me ligji” (Ligji për MDhP i Republikës së Kosovës, 2010:16). Operacionet e këtilla nënkuptojnë formimin e:

- a)** katalogut të dosjeve për kontrolluesin e të dhënave,
- b)** njoftimin për autoritetin shtetëror për mdhp, regjistrimi dhe kontrolli paraprak,
- c)** ndërlidhjen e sistemit të dosjeve dhe zbulimin e të dhp.

3.9.1 Sistemi dhe katalogu i sistemit të dosjeve Secili kontrollues, për të siguruar mdhp me rrugë ligjore, është i obliguar të krijojë për secilin sistem të dosjeve një përshkrim të detajuar që quhet katalogu i sistemit të dosjeve. Përmbajtja e katalogut të sistemit të dosjeve ka zakonisht këto të dhëna dhe përshkrime:

- emrin apo titullin e sistemit të dosjes,
- identitetin e kontrolluesit të të dhp dhe përfaqësuesit të tij/saj.

Për personat fizikë shënohen këto të dhëna:

- emri (emrat) personal,
- adresa e përhershme ose e përkohshme, ku janë kryer veprimet ose adresa e përhershme ose e përkohshme e banimit,
- numri i telefonit dhe adresa elektronike (aty ku është e mundur), për tregtarët e pavarur:

emri (emrat) i tyre zyrtar,

- zyrat e regjistruara,
- selia dhe numri i regjistrimit, numri i telefonit dhe adresa elektronike (aty ku është e mundur),

Për personat juridikë:

- emri i themeluesit,
- titulli ose zyra e regjistruar,
- adresa ose selia,
- numri i regjistrimit, numri i telefonit dhe adresa elektronike (aty ku është e mundur),
- baza ligjore për përpunimin e të dhënave,
- kategoria e subjekteve të të dhënave,
- kategoria e të dhp në sistemin e dosjeve,
- qëllimi i përpunimit,
- kohëzgjatja e paraparë për ruajtjen e të dhp,
- kufizimet e të drejtave të subjekteve dhe baza ligjore për kufizimet e këtilla,

- marrësit e të dhënave-kategoritë e marrësve të të dhënave të përfshirë në sistemin e dosjeve.

Katalogu i dosjeve përmban edhe informacionet lidhur me atë se nëse të dhp janë ose do të transferohen në shtetin tjetër, duke specifikuar: ku, kur, dhe kujt i transferohen dhe duke nënvizuar edhe bazën ligjore për transferime të këtilla. Gjithashtu, përmban përshkrimin e përgjithshëm të procedurave dhe masave në përputhje me masat e sigurisë për përpunim të ligjshëm të të dhp, si dhe të dhënat ose sistemet e ndërlidhjeve të dosjeve nga evidencave zyrtare ose librat publikë.

Çdoherë, kontrolluesi i të dhp duhet të sigurohet që përmbajtja e katalogut të sistemit të dosjeve të jetë e saktë dhe të mbahet e freskuar me përditësimin e shënimeve të reja që futen në përpunim. Në disa shtete autoritet e mdhp pothuajse fare nuk e kanë konsideruar dhe as që e kanë aplikuar praktikisht regjistrin dhe sistemin e dosjes, duke e konsideruar si punë të tepërt për autoritetin e mdhp, sepse konsiderohet se kjo punë kryhet edhe nga vetë kontrolluesit e të dhp, “edhe pse Direktiva e KE-së 95/46 i obligon të gjitha autoritetet nacionale që merren me mdhp për zbatim të detyrimit për regjistrin dhe dosjen sipas përshkrimit të sipër thënë edhe me dispozitat e Direktivës“, shih Direktiva EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, Strasburg (tetor, 1995:28, 29, 30) për të gjithë kontrolluesit, madje edhe nxjerrjen e akteve të veçanta për vendosjen e tarifave për regjistrim.

3.9.2 Njoftimi për regjistrim dhe kontrolli paraprak është i paraparë sipas Direktives EC të PE dhe e Këshillit (Strasburg, tetor 1995:29, 30). Njoftimi apo lajmërimi i agjencisë lidhur me evidencat e kategorive dhe regjistrave të reja të të dhp paraprakisht para krijimit të një sistemi të ri të dosjeve, në vetë dhe për vetë institucionin, është detyrim i kontrolluesit që ta informojë paraprakisht agjencinë e mdhp (autoritetin kombëtar të mdhp). Koha e njoftimit (informimit) është e rregulluar me ligjet për mdhp të shteteve respektive konform legjislacionit komunitar të BE-së për mdhp. Njoftimi bëhet me shkrim apo në mënyrë elektronike me të gjitha njoftimet për procedurat, qëllimin, kategoritë, emrat, masat e sigurisë, bazën ligjore të përpunimit dhe shënimet tjera të nevojshme për subjektet e të dhp. Për secilin ndryshim, deri te krijimi i dosjeve të reja, në vazhdimësi, në afat të caktuar ligjor duhet të mbahet i njoftuar autoriteti kombëtar i mdhp. Regjistrin me

shënimet e të dhp e mbajnë përherë kontrolluesit, duke pasur parasysh përditësimin me të dhp.

Regjistri i të dhënave mbahet nga autoriteti shtetëror për mdhp-agjencia respektivisht komisioneri. Në pajtim me procedurat e brendshme të agjencisë (autoritetit kombëtar të mdhp) themelohet regjistri, i cili menaxhohet duke përdorur mjetet e teknologjisë informative nga njerëz të pajisur me njohuri juridike dhe njohuri të teknologjisë së informacionit. Evidencat dhe regjistri i dosjeve, menjëherë pas lajmërimit në agjenci nga ana e kontrolluesve, publikohen në faqen zyrtare të agjencisë. Përditësimi me shënime të reja të kategorive të reja të subjekteve të të dhënave, të cilat vijnë nga kontrolluesit e të dhënave mbetet punë e përhershme e agjencisë respektivisht e autoriteteve të mdhp.

Për punë efikase dhe të saktë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe zhvillimin e legjislacionit komunitar, autoriteti kombëtar për mdhp harton akt të brendshëm administrativ dhe mund të krijojë referat apo dikaster të veçantë për udhëheqjen e regjistrit dhe funksionimin e një regjistri elektronik modern me data bazë (bazë të të dhënave) me standarde bashkëkohore. Për secilin operacion të punës rreth krijimit të dosjeve të reja, pas pranimit të njoftimit, agjencia respektivisht autoriteti kombëtar i mdhp, kontrollon nëse operacioni i përpunimit mund të paraqes rrezik për liritë dhe të drejtat e subjektit të të dhënave, për shkak të natyrës së të dhënave që përpunohen dhe qëllimit ose fushëveprimit të përpunimit. Pas marrjes së njoftimit në afat ligjor, autoriteti kombëtar i mdhp e jep mendimin e vet. Periudha e dhënies së mendimit mund të zgjatet, nëse kërkohen informata të reja shtesë, të cilat konsiderohen të domosdoshme për agjencinë respektivisht autoritetin kombëtar për mdhp. Vendimi i zgjatjes së afatit duhet t'i komunikohet kontrolluesit të të dhënave. Këto afate duhet të jenë të rregulluara me ligjin për mdhp (ligji i Kosovës i mdhp, 2010:13), ku thuhet se pas marrjes së njoftimit brenda 3 javësh agjencia duhet të japë mendimin e saj.

Ndërsa, nëse ka ndërlikim që agjencia ka informacione të tilla, vendimi për njoftim mund të zgjatet deri në 3 muaj me vendim të agjencisë. Brenda afatit 3 mujor, kontrolluesi i të dhënave duhet të jetë i njoftuar për këtë vendim. Secili shtet e ka të rregulluar këtë afat në kornizën e vet ligjore respektive. Nëse nuk ka komunikim tjetër me kontrolluesin, pas afateve ligjore të vendosura sipas rregullit, konsiderohet se komunikimi është i kryer dhe

kontrolluesi vazhdon përpunimin ligjor të të dhp. Mirëpo, edhe në këtë rast, nëse agjencia konsideron se përpunimi mund të përmbajë shkelje të rregullave për mdhp, ajo e bën sugjerimin e duhur për shmangie të shkeljeve të këtilla. Kontrolluesi i të dhp gjithmonë duhet të respektojë çdo sugjerim, opinion, këshillë, rekomandim dhe vendim që është nxjerrë nga autoriteti shtetëror për mdhp, për të siguruar përpunimin e ligjshëm të të dhp të subjekteve.

3.9.3 Ndërlidhja e sistemit të dosjeve dhe zbulimi i të dhp Sistemet e dosjeve të dokumenteve zyrtare dhe librave publikë mund të bashkohen, nëse ky veprim është i paraparë dhe ka bazë ligjore për bashkim të tyre. Kontrolluesit e të dhënave, nëse synojnë të ndërlidhin dy ose më shumë sisteme të dosjeve që mbahen për qëllime të ndryshme, përpara se ta bëjnë këtë veprim, duhet ta njoftojnë me shkrim agjencinë për mdhp (ligji i mdhp i Republikës së Kosovës, 2010:35). Sipas rregullave në fuqi thuhet se “nëse të paktën njëra nga ndërlidhjet përmban të dhëna të ndjeshme ose ndërlidhja rezulton në zbulimin e të dhënave të ndjeshme, ose zbatimi i ndërlidhjes kërkon përdorim të kodit ndërlidhës, ndërlidhja nuk do të lejohet pa autorizimin paraprak të agjencisë e cila ka të drejtë të autorizojë me vendim ndërlidhjen, nëse përcakton se kontrollori i të dhënave siguron nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave”. Sipas ligjit për mdhp të RK-së, nuk lejohet ankesë në vendime të tilla të agjencisë, por mund të hapet konflikti administrativ në gjykatën kompetente. “Kodi ndërlidhës përjashtimisht mund të përdoret, nëse është i vetmi element i të dhënave në një rast të veçantë për të mbrojtur trupin dhe jetën e subjekteve të të dhënave” shih (ligji i mdhp i Republikës së Kosovës, 2010:9).

Pas përdorimit të kodeve lidhëse, kontrolluesi i të dhp (përdoruesi i kodit lidhës) duhet të bëjë një shënim zyrtar apo dokument të shkruar, i cili bashkëngjitet me të dhp. Nga fusha e shëndetësisë vetëm kodet lidhëse nuk duhet të përdoren për grumbullimin dhe përpunimin e të dhp, ngase e dimë se sektori i shëndetësisë përpunon të dhëna sensitive. Ndërsa të dhp në regjistrin kadastral dhe regjistrin afarist mund të grumbullohen dhe përpunohen duke përdorur kodin lidhës.

Të dhp dhe hapja e tyre nga regjistri qendror i shtetit dhe regjistri i të dhënave të banorëve të përhershëm dhe të përkohshëm mund të zbulohen për marrësit që shprehin interes legjitim. Këto të dhëna apo informacione, sipas kornizës ligjore të të dhp të Republikës së

Kosovës, përmbajnë: emrin personal dhe adresën e përhershme ose të përkohshme të subjektit të të dhënave. Kornizat ligjore edhe të shteteve tjera po kështu përmbajnë të njëjtat të dhëna dhe informacione. Marrësit e të dhp i bartin shpenzimet e shkaktuara lidhur me këtë proces, nëse me procedura ligjore nuk është paraparë ndryshe. Gjatë zbulimit të dhp, kontrolluesi (institucioni publik ose privat) dhe marrësi i të dhënave duhet të sigurohen që të evidentohen informacionet në vijim: cilat të dhp janë zbuluar, kujt i janë zbuluar, kur janë zbuluar, me çfarë baze ligjore janë zbuluar, sasia e zbulimit, qëllimi i zbulimit. Këto informacione duhet të mbahen bashkë me të dhp të subjekteve për atë kohë sa ruhen edhe të dhp të subjekteve (qytetarëve), deri tek arritja e qëllimit të zbulimit të ligjshëm të tyre.

3.10 Marrja e pëlqimit për përpunimin e të dhp dhe mdhp për personat e vdekur

Për përpunimin e të dhp, duke qenë element rrënjësor i të drejtave të njeriut e që lidhet direkt me dinjitetin e tij (njeriut), dhe si e drejtë e pacenueshme e subjektit të të dhp, është e detyrueshme që të kemi pëlqimin e vullnetshëm të subjektit të të dhp për t'i bërë të ditura informatat në llogari të kontrolluesit, dhe në përputhje me të drejtat e tij mund të grumbullohen informatat personale nga subjekti i dhp. Pëlqimi mund të jepet me shkrim, gojarisht apo në formë elektronike. Kur kemi të bëjmë me pëlqimin, kjo veç tjerash ka të bëjë më tepër me kategorinë e fëmijëve deri te mosha e tyre ligjore e zotësisë juridike personale. Në këtë kuptim, privatësia e fëmijëve si subjekt i të dhp po kështu është e drejtë ligjore e mdhp pa dallim moshe. Edhe Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve me nenin 16 të saj e specifikon mbrojtjen e privatësisë së fëmijëve. Pëlqimi është i obliguar sidomos në rast se të dhënat e subjektit kërkohen ose u jepen marrësve të tjerë për përpunim të mëtejshëm për të njëjtat qëllime ose qëllime të tjera.

Kurë përpunohen të dhëna të ndjeshme, pëlqimi sigurohet nga ana e subjektit të dhënave në formë të shkruar. Subjekti i të dhënave për realizimin e interesit të tij të punësimit, shkollimit, shëndetësor, financiar etj., mund të deponojë të dhënat e tij te kontrolluesi (institucioni apo organi publik dhe privat), por assesi këto të dhëna nuk duhet të përdoren për qëllime të tjera dhe nuk duhet të tejkalojnë qëllimin për të cilin janë grumbulluar.

“Pëlqimi i subjektit të të dhënave” është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë, duke qenë në dijeni të plotë për arsyen e përpunimit të të dhënave, me ç’gjë nënkuptohet që subjekti i të dhënave pranon që të dhënat e tij të përpunohen. “Autonomia e vullnetit të subjektit të të dhp është doktrina, sipas së cilës forca detyruese e akteve juridike varet kryesisht nga vullneti i palëve: akti ka forcë detyruese, sepse ky ka qenë vullneti i palëve” (Lègier & Marsielle, 2009:24).

Për të dhp të personave të mitur, të fëmijëve dhe personave të mbajtur pa zotësi personale-juridike të kontrollimit të aftësive psiko-fizike të dhp kanë mundësi që të jepen në përdorim në llogari të kontrolluesit për nevoja të realizimit të interesave të ligjshme të subjektit të të dhënave, nga ana e prindit ose e kujdestarëve të autorizuar, të cilësuar si mbajtës kujdestar të kësaj kategorie. Në rast të përdorimit të këtyre të dhënave, kujdestari duhet të informohet saktë për efektet, eventualisht për pasojat e zbulimit të të dhp, për të ardhmen e personit në fjalë, të cilit iu kanë zbuluar të dhp. Kur bëhet fjalë për personat e vdekur, lënia e pasurisë së tyre mund të bartet, apo të drejtën mbi të mund ta gëzojnë vetëm të autorizuarit përmes një testamenti të vlefshëm të lënë nga ana e personit të vdekur, përmes marrëveshjes së vlefshme të bërë paraprakisht për trashëgimi, apo sipas së drejtës trashëgimore për personat që trashëgojnë pasurinë e personit të vdekur.

Për mbrojtje efikase të të dhp të personave të vdekur, (ligji për mdhp i RK-së, 2010:9,10), mund t’u zbulohet vetëm marrësve të autorizuar me ligj. Të dhp të personave të vdekur mund t’u zbulohen trashëgimtarëve ligjorë të tyre, nëse ata (trashëgimtarët) janë të interesuar ta bëjnë një gjë të tillë në interes legjitim dhe nëse personat e vdekur nuk e kanë ndaluar me shkrim zbulimin e të dhp të tyre. Të dhp të personave të vdekur mund të zbulohen për qëllime statistikore, historike, shkencore, publicistike vetëm nëse personi i vdekur e ka lejuar me shkrim paraprakisht zbulimin e të dhënave të veta personale dhe në rast se me ligj nuk është paraparë ndryshe. Mbrojtja dhe siguria e të dhp të personave të vdekur është e rëndësishme në aspektin e sigurisë së përgjithshme, për shkak të evidentimit të pretendimeve të natyrave abuzive nga trashëgimtarët. Trashëgimtarët ligjorë mund ta lejojnë me shkrim zbulimin e të dhp të personit të vdekur, nëse personi i vdekur paraprakisht nuk e ka ndaluar me shkrim zbulimin e të dhënave të tij (të saj), përveç se në rastet kur në ligj është parashikuar ndryshe.

KAPITULLI IV: KRONOLOGJI E AKTEVE NDËRKOMBËTARE DHE NDIKIMI I TYRE TE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

4.1 Njohuritë themelore mbi kronologjinë e zhvillimit të drejtave themelore të njeriut.

Deklarata Universale e Kombeve të Bashkuara për liritë dhe të drejtat e njeriut shënon hapin e parë në nivel ndërkombëtar, mbi të cilin fillojnë bazat e para për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut në nivel global. Në nenin 1 (një) të deklaratës thuhet:

“Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave. Ato janë të pajisura me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të veprojnë njëra ndaj tjetrës në një frymë vëllazërie.” (Gruda 2001:21)

Ndërkaq, në aspektin regjional e kontinental, duke avancuar në pikëpamje kualitative në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Konventa Evropiane e vitit 1950, e hyrë në fuqi në vitin 1953, në artikullin 8 të saj specifikon qartë të drejtën e privatësisë:

“1. Çdo person ka të drejtë që t’i respektohen jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe letërkëmbimi i tij. 2. Nuk mund të ketë ndërhyrje të ndonjë autoriteti publik në ushtrimin e kësaj të drejte, përveç kur kjo ndërhyrje parashikohet nga ligji dhe kur në një shoqëri demokratike kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, ose për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e shkeljeve penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për ruajtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve” (Gruda 2001:64)

Për të pasur efekte detyruese për zbatimin e të drejtave të njeriut të miratuara me Deklaratën e përgjithshme të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Asambleja i kishte dhënë detyrë Komisionit për të Drejta të Njeriut, menjëherë pas miratimit të Deklaratës, që të përgatisë një projekt të Paktit për të Drejtat e Njeriut, dhenë mënyrë të padiskutueshme rregullat e renditura në

Pakt të respektohen përmes detyrimeve të marra nga shtetet nënshkruese të këtyre Pakteve.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (1966), miratoi dhe hapi për nënshkrim, ratifikim dhe aderim, pa asnjë kundërshtim dhe asnjë votë kundër 3 (tri) Pakte. Konsiderojmë se në aspektin detyrues në nivel ndërkombëtar ky mund të jetë Pakti i Parë, që detyrimet e marra nga shtetet nënshkruese të jetësohen apo zbatohen praktikisht në sferën e privatësisë dhe të dhp. Kështu që, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike në nenin 7 saktëson:

“Se askujt nuk mund t’i përziehet askush në mënyrë arbitrare dhe të paligjshme në jetën e tij private, në familje, banesë ose korrespondencë, e as t’u ekspozohet sulmeve të paligjshme kundër nderit dhe autoritetit” (Gruda 2001:45)

Pakti lidhur me zbatimin e tij ka paraparë edhe masat për moszbatimin nga palët nënshkruese dhe ka formuar Komitetin për të Drejtat e Njeriut, në përbërje prej 11 (njëmbëdhjetë) anëtarësh, të zgjedhur nga konferenca e palëve nënshkruese, me kompetenca të zgjeruara lidhur me zbatimin e pikave të Paktit. Pavarësisht se në esencë termi “*dinjitet njerëzor*” ka karakteristika dalluese nga të drejtat e njeriut, ato së bashku me të drejtat tjera të njeriut përbëjnë bazën moderne të botës së sotme që i përket çdo qenie njerëzore në rruzullin tokësor.

Ky term, sikurse në shumë deklarata e konventa ndërkombëtare e rajonale, ”është edhe në *Preambulën e Deklaratës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve të vitit 1981, e cila ofron zgjidhje të cilat përfundojnë me një katalog dhe koncept tradicional për të drejtat e njeriut*”, *ART-HOUSE, Prishtinë (HANSKI & SUKSI 2001:27)*, me ç’rast janë dhënë edhe referenca të privatësisë për individin. Shumë shtete dhe organizata rajonale e ndërkombëtare, pas këtyre themeleve, vunë në drafte të organizimeve të tyre ligjore e themeltare-konstitucionale, edhe të drejtën e privatësisë dhe të dhp. Në shumicën e shteteve me sisteme të ndryshme politike e juridike sidomos të shteteve të fuqishme me të drejta të avancuara të njeriut dhe demokraci të përparuar, veçmas në SHBA, Francë, Angli etj., psh. në Deklaratën Amerikane për të Drejtat dhe Detyrat e Njeriut të 2 majit të vitit 1948, në nenin 9 dhe 10 vërejmë se:

“Çdo person ka të drejtë në paprekshmërinë e shtëpisë së tij (neni 9) dhe çdo person ka të drejtë në paprekshmërinë dhe dërgimin e korrespondencës së tij (neni 10)” (Gruda 2001:98).

Në frymën e kësaj Deklarate të ShBA-ve për të drejtat e njeriut dhe në mbështetje të DUDNj të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, Deklarata Amerikane për të Drejtat e Njeriut ”Pakti i SANHOZESE” i nëntorit të vitit 1969, nënshkruesit e paktit i detyron me zbatim të ligjit në aspektin e privatësisë dhe të dhp, ku për të DREJTAT NË LIRI PERSONALE dhe për TË DREJTAT NË JETËN PRIVATE shkruhet:

“1. Çdo person ka të drejtë për liri dhe siguri personale (neni1.Çdokush ka të drejtë t’i respektohet nderi dhe t’i njihet dinjiteti.

2. Askush nuk mund të jetë objekt i përzierjes arbitrare dhe fyese në jetën e tij private, në familjen e tij, në shtëpinë e tij ose në korrespondencën e tij, ose i sulmeve të paligjshme në nderin ose reputacionin e tij.

3. Çdokush ka të drejtë në mbrojtje të ligjit kundër përzierjeve ose sulmeve të tilla. (Neni11).”

Kështu, vërehen nismat ligjore në funksion të mbrojtjes së privatësisë dhe të dhp edhe në sistemin francez të drejtësisë. Që në shekullin XVIII, përkatësisht në fillimet e sistemit ligjor të shoqërisë franceze, në “Deklaratën për të drejtat e njeriut dhe qytetarit”, të vitit 1789, pasqyrohen 35 parime. Ndërsa për të parë aspektet e mbrojtjes së privatësisë, të drejtave personale dhe të dinjitetit të njeriut po veçojmë pikat në të cilat kemi fokusime të përafërta të Deklaratës, si:

“2. Këto të drejta janë barazia, liria, siguria dhe pronësia....., 6. Liria është forcë që i përket njeriut për të bërë çfarëdo që nuk i cenon të drejtat e të tjerëve, ajo për parim ka natyrën; për rregull drejtësinë; për mbrojtje ligjin; kufiri i saj moral përmbahet në fjalën e urtë: Mos i bëj tjetrit atë që nuk e dëshiron të ta bëjnë të tjerët,....8. Siguria konsiston në mbrojtjen që shoqëria i ofron çdonjërit nga anëtarëve e saj për të mbrojtur personalitetin e tij, të drejtat dhe të mirat e tij,....9. Ligji detyrohet të mbrojë lirinë publike dhe personale kundër shtypjes nga ana e atyre që qeverisin....” (Gruda 2001:13)

Fryma e të drejtave dhe lirive të njeriut, asnjëherë nuk do të ndalojë. Organizma e organizata të ndryshme të karakterit humanitar, të sigurisë e të karakterit fetar me dimension rajonal e ndërkombëtar, duke përqafuar parimet bazë të lirive themelore të njeriut, kanë përfshirë në aktet e tyre themeluese, për funksionimin e interesave të tyre të përbashkëta, edhe aspektin e humanizmit e të lirive të njeriut dhe të privatësisë.

Kështu, shtetet anëtare të Organizatës së Konferencës Islamike, në kohën e miratimit të “Deklaratës së Kajros mbi të drejtat e njeriut në islam” më 5 gusht të vitit 1990, aspektin e së drejtës së emrit, si e drejtë e të dhp dhe privatësisë, e fusin në deklaratë në nenin 4 dhe japin dimensionin e së drejtës së mbrojtjes në këtë mënyrë: *“Çdo qenie njerëzore ka të drejtë në pacenueshmëri dhe në mbrojtje të emrit të tij të mirë dhe nderit gjatë jetës dhe pas vdekjes së tij. Shteti dhe shoqëria do të mbrojnë mbetjet e tij dhe vendin e varrimit të tij.”*

Edhe OSBE, e themeluar në Helsinki në vitin 1975, fillimisht e quajtur si KEBS dhe më vonë si (OSCE), në themelet e saj, përveç aspekteve të sigurisë, bashkëpunimit ekonomik dhe sovranitetit, ka edhe shtyllën kryesore të saj, atë të lirive themelore të njeriut; lëvizjen e lirë të njeriut dhe kapitalit, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për lirinë e lëvizjes dhe mdhp. Kjo ishte edhe organizata më e fuqishme në nivel ndërkombëtar, që kishte thyer kufijtë dhe muret izoluese të dy kampeve dominuese të rruzullit tokësor, atij të Lindjes dhe atij të Perëndimit. Zhvillimet e të drejtave të njeriut konform DUDLNj, në zbatim direkt përmes konventave, shkojnë duke shënuar rritje në numër. Një risi në këtë drejtim e sjell Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, e cila u miratua më 20 nëntor 1989, nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me Rezolutën 44/25, e cila u hap për nënshkrim për shtetet aderuese dhe hyri në fuqi më 2 shtator të vitit 1990.

Privatësia në të drejtat e fëmijës është po kështu e sanksionuar sipas kësaj Konvente me nenin16, ku thuhet:

“1. Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjishme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij, as cenimeve të kundërligjshme të nderit dhe të reputacionit të tij. 2. Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve ose cenimeve të tilla” botimi i OSBE-së (Kombet e Bashkuara, Vëllimi i parë,

pjesa e parë, Liritë dhe te drejtat e njeriut, financuar nga programi mbështetës për Kosovë, Nju Jork Gjenevë (1994:228).

Konferenca Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, e mbajtur në Teheran (1968), në mbështetje të Parimeve Themelore të Deklaratës Universale për të Drejtat Themelore të Njeriut dhe akteve tjera ndërkombëtare në këtë fushë, nxiti të gjithë popujt dhe qeveritë të shtojnë përpjekjet e tyre, duke iu referuar parimeve të Deklaratës së Përgjithshme, në mënyrë që për të gjitha qenjet njerëzore të sigurojë një nivel jetësor me liri dhe dinjitet, dhe të përshtatshëm për mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore, shpirtërore, personale e private.

Duke shqyrtuar përparimet e bëra në fushën e shkencës dhe teknologjisë, si dhe progresin e përgjithshëm në teknologji, njëzet vjet pas miratimit të Deklaratës Universale të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, përmes kësaj Konference Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (Teheran 1968) u bënë formulimet e një programi prej 19 pikash për të ardhmen në këtë fushë.

Pika e 18 e kësaj Rezolute ka përafërsisht ngjashmëri me Konventën 108 të KE-së, e cila nuk ka specifikime në këtë drejtim sikur Konventa 108 e KE-së, por u bën thirrje të gjitha shteteve dhe shoqërisë njerëzore në interesimin dhe vigjilencën e shtuar në këtë drejtim:

“Përderisa zbulimet shkencore dhe përparimet teknologjike të kohëve të fundit kanë hapur mundësi të gjera për përparim ekonomik social dhe kulturor, megjithatë zhvillimet e tilla mund të rrezikojnë të drejtat dhe liritë e individit dhe për këtë ato kërkojnë një vëmendje të pandërprerë.” Botim i OSBE-së, Kombet e Bashkuara, Vëllimi i parë, pjesa e parë, Liritë dhe te drejtat e njeriut, financuar nga programi mbështetës për Kosovë, New York, Gjenevë (1994:68).

Privatësia, nderi dhe dinjiteti i individit, nëpër shumë zhvillime të kodeve të të drejtave dhe kornizave juridike të shteteve të ndryshme, ishin trajtuar dhe mbrojtur në frymën e të drejtave zakonore dhe të trashëgimisë tradicionale të popujve veç e veç.

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit, që për kohën, njihej si një kod që rregullonte raportet dhe marrëdhëniet shoqërore në shoqërinë patriarkale shqiptare në nivel të lakmueshëm, për

privatësinë, dinjitetin dhe të drejtën personale (që sipas Kanunit quhej “Ndera vetjake”), ndryshe si të drejta detyruese, në kreun shtatëmbëdhjetë, pika 596, 597 dhe 598 thuhet:

“Nderin secili e ka për veten e nuk mund t’i përzihet kush, as me e rrethue me pegje e me pleq. Dy gisht nderë në lule të ballit; nga i njëjti Zot i Madh. Ndera e marrun glob nuk ka. Ndera e marrun s’falet kurr. Ndera e marrun nuk shpërblehet me gja, por a` me të derdhun të gjakut, a me të falun fisnikish” (Shtypur nga Botimet “Kuvendi”, shtypshkronja “GER” (2001:68)¹³.

Edhe e drejta Romake, edhe kodet mesjetare të të drejtave zakonore të popujve të ndryshëm, secila e drejtë dhe kodifikim në mënyrën e vet rregullonte të drejtat, dinjitetin dhe nderin e individit. Këto të drejta tradicionale, duke konsideruar kështu mbrojtjen e “privatësisë dhe të dhënave të individit”, rregulloheshin përmes normave dhe rregullave tradicionale të shoqërisë njerëzore ndër popuj të ndryshëm, nëpër shumë etapa zhvillimesh në sisteme të ndryshme shoqërore dhe shtetërore. Nisur nga kjo që u tha deri më tani mbi themelet e mbrojtjes së privatësisë dhe të dhp për individin, vijmë në përfundim se ato janë aq të thella dhe aq të largëta historikisht sa edhe vetë lashtësia e shoqërisë njerëzore.

4.2 Rregullat e sigurisë dhe mdhp në BE dhe proceset e integruese europiane

Bota e të dhp dhe privatësisë, për nga aspekti i trajtimit, në parim ka dinjitetin njerëzor, që është vlerë thelbësore me të njëjtën nevojë dhe ndjesi për secilin individ pa dallime në të folur, në besim fetar, në besim politik, në gjendje sociale, në përgatitje shkollore dhe intelektuale, në racë dhe gjini. Prandaj, kjo pikëpamje është vlerë unike që nuk ka kufij dallues dhe ky koncept është mjeti më i përsosur në vendosjen e urave integruese në mes kombeve dhe popujve. Një pohim i tillë saktësohet përmes objektivave të BE-së:

¹³ Shtjefën Gjeqovi O.F.M, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shtëpia Botuese Kuvendi, Shtypur në “GER”, Gusht 2001, F..64. Gjithashtu në pikën 600 të kësaj faqeje thuhet se: Aj, të cilit iu muer ndera, xehet i dekun kah Kanuja. Kanuni zbatohej në shumicën e viseve shqiptare sidomos të pjesës veriore dhe zbatimi i tij filloi që nga shekulli 15, nga koha e sundimit të Lekë Dukagjinit; se Kanuni zbatohej edhe gjatë gjithë kohës së Sundimit Otoman, në faqen XXVII, Atë Gjergj Fishta, njëri ndër shkrimtarët dhe poetët me të zgjuar të Trollit Ballkanik, shkruan : “Nuk ka dyshim pra se Kanuni i Lekë Dukagjinit, në kohën e pushtimit otoman në Shqypni, ka pasur vlerë juridike e asht njëfë për ligje civile detyrues ndër male të Mbishkodrës e në Dukagjin”.

“Për krijimin e një bashkimi më të ngushtë midis popujve të Evropës, duke ndërtuar marrëdhënie më të ngushta ndërmjet shteteve që i përkasin komunitetit, të sigurojë progres ekonomik dhe social nëpërmjet veprimit të përbashkët për të eliminuar barrierat që e ndajnë Europën, të inkurajojë përmirësim të vazhdueshëm të jetesës së njerëzve, të ruajë dhe forcojë paqen dhe lirinë dhe të promovojë demokracinë mbi bazën e të drejtave themelore të njohura në kushtetutë dhe në ligjet e shteteve anëtare dhe në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Bazë të Njeriut” thuhet në Direktivën 95/46 të KE, Parlamentit European dhe Këshillit (tetorit 1995:1).

Ligji European për mdhp, i cili tashmë është i draftuar si një ligj i “fortë” nga konventa në direktiva dhe rregullore, ka vendosur baza të forta integruese në BE. Për këtë arsye bota e të dhp, si vlerë e mbrojtur ligjore, po e shton vlerën e demokracisë, lirisë së lëvizjes së individit, lëvizjes së kapitalit, qarkullimit të lirë të mendimit, lirisë dhe sigurisë së përgjithshme të njerëzimit. Institucionet e ngritura për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtyre legjislacioneve me pavarësitë e tyre vepruese dhe bashkëpunim të ndërsjellë janë ofruar deri në atë shkallë sa çë rastet studimore dhe zgjidhjet e rasteve të ankesave të qytetarëve i aplikojnë me qasje gati pothuajse identike. Kështu, një rast i zgjidhur i një fushe të caktuar në Mal të Zi, njëkohësisht do të zgjidhet në mënyrë identike në fushën respektive edhe në Kosovë apo Shqipëri dhe anasjelltas. Një shembull i zgjidhur në Slloveni apo Gjermani do të kishte të njëjtën zgjidhje identike edhe në Kosovë e Maqedoni. Kjo qasje e zgjidhjeve të problemeve që solli teknologjia e re e komunikimit njerëzor, qytetarëve; pa marrë parasysh dallimet shtetërore, u ka shtuar vëmendjen e bashkimit dhe integritetit të tyre në unifikimin e qasjeve për të mbijetuar këtë sfidë të re të globalizimit.

Aplikimet e shpikjeve të reja të teknikës së komunikimit, sa janë në funksion të modernizimit dhe të dobishme për njerëzimin, aq bartin rreziqe në ndërhyrje të privatësisë së individit. Ndërkohë që gradualisht po evitohen premisat e nacionalizmave njerëzorë, nga të cilat Europa pati humbje të mëdha në të kaluarën, dhe Ballkani ende po i vuan këto pasoja të rënda të nacionalizmave dhe shovinizmave mesjetarë. Me qëllim të bashkimit të përvojave dhe dijeve në kapërcimin e kësaj sfide të re, tehu i aksionit njerëzor po orientohet duke u bashkuar në tejkalimin e kësaj sfide “sfida e re për njerëzimin”.

Gradualisht po lëshohet terreni dezintegrues edhe për shumë arsye të tjera dhe Europa po integrohet edhe nën mbrojtjet ligjore të përqendruar të të dhp në një qendër të mbikëqyrur nga Brukseli. Ky është një kontribut jashtëzakonisht i madh nga prizmi i mdhp në proceset e përgjithshme integruese europiane.

“Marrëveshja *Modus Vivendi* e 20 dhjetorit të vitit 1994 midis Parlamentit European, KE-së dhe Komisionit European" Direktiva 95/46 e KE dhe e Parlamentit European dhe e Këshillit (tetor 1995:15), mbështetur në Direktivën e Parlamentit Evropian bashkon të gjitha potencialet për të vepruar bashkërisht në fushën e mdhp.

Kështu, me Direktivën EC 95/46 rreth mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individëve dhe sidomos të jetës private, vendeve anëtare të KE-së iu dha afat, “që nuk ka mundësi të kalojë tri vjet” shih Direktivën 95/46 e KE të Parlamentit European dhe të Këshillit (tetor 1995:15) nga fillimi i hyrjes në fuqi të Direktivës, për hyrjen dhe transportimin e saj në ligjet kombëtare. Në përcaktimin e afatit e kohor thuhet:

“...se vendet anëtare mund të parashikojnë një periudhë plotësuese, që do të skadojë 12 vjet pas ditës së nxjerrjes së Direktivës aktuale, me qëllim të përshtatjes së disa dispozitave të Direktivës lidhur me arkivat e shkruara që do të gjenden në këtë kohë,...që përfshin të dhënat personale..” Shih Direktiva 95/46 e KE dhe e Parlamentit European dhe e Këshillit (tetor 1995:16)

Në kuadër të harmonizimit të gjithë masës legislative me këtë kërkesë të Direktivës për unifikim ligjor, për të gjitha vendet anëtare të KE-së dhe BE-së, natyrisht edhe shtetet anëtare me aspiratë integruese, rrjedhimisht tashmë vijat ndarëse kufitare të shteteve anëtare po fshihën nga harta gjeografike e Europës.

Rolin e Direktivës (95/46) në proceset integruese europiane e saktëson më së miri dispozita e nenit 28 e Kapitullit VI të Direktivës EC 95/46, e cila i jep detyrë çdo shteti që të konsultojë autoritetin e mdhp në shtetin përkatës sa herë që harton masat legislative, të cilat në çfarëdo mënyre prekin në natyrën e të dhp të individëve. Ky detyrim është i vazhdueshëm dhe permanent dhe për shtetin e Kosovës. Edhe aktet tjera juridike (të legjislacionit dytësor) të KE-së dhe BE-së, si: rregullore, direktiva, akte tjera (vendime, rekomandime dhe opinione), aspekte të teknikës legislative, sanksione dhe ekzekutim;

shih botimi i dhjetë, 'Universiteti i Tiranës', Tiranë (Zajmi 2010:210), përfshinë në vete një gamë të gjerë të masës legislative që bie në fushën e mdhp.

Më poshtë do të ndalemi për të sqaruar dokumentet dhe aktet kryesore, duke filluar nga deklaratat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

4.3 Akte të rëndësishme ndërkombëtare që derivuan mdhp dhe të privatësisë

Të drejtat dhe liritë e njeriut gjeneruan gjallëri hap pas hapi, duke shfrytëzuar mbështetjen dhe duke marrë frymëzimet bazë nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB-së. Rruga ishte e gjatë, por objektivi ishte i arritshëm (viti i largët 1948). Deri tani janë nxjerrë shumë konventa, protokolle, memorandume e marrëveshje për të drejtat dhe liritë njerëzore në të gjithë botën. Andaj konstatojmë se “Bota e shekullit të Ri” e ka ndryshuar jetën e njeriut dhe zhvillimet e përgjithshme në shoqërinë njerëzore. Vetëm në Kontinentin e vjetër European, nga Konventa e Parë për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut e vitit 1949 e deri më sot, janë aprovuar e ratifikuar mbi 100 konventa, gati që të gjitha bazë kryesore kanë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut: liritë politike, ekonomike, sociale, të punës, sindikale, etnike, të grave, të fëmijëve, kundër dhunës, kundër gjenocidit, liritë kulturore, gjuhësore, të pronës, të besimit fetar, të arsimit etj.

Por, në thelb të të gjithave është respektimi i dinjitetit njerëzor në të cilin, si parim pashmangshëm bën pjesë edhe privatësia, të drejtat personale dhe pacenueshmëria e së drejtës së korrespondencës për secilin individ. Deri te nxjerrja e Konventës 108, protokolli shtesë i saj, Direktiva 95/46, në shumë fusha të jetës dhe punës, nga KE u nxorën shumë rekomandime për mdhp dhe të privatësisë. Rekomandimet në këtë fushë nxirreshin dhe vazhdojnë të nxirren në presion të kërkesave dhe domosdoshmërisë së kohës, për të mbuluar vakumin juridik të kornizës ligjore në lëmin e mdhp.

Duke parë mundësinë e cenimit të drejtës së privatësisë dhe të dhp nga zhvillimet marramendëse të teknologjisë së komunikimit njerëzor, në Europë doli në pah domosdoshmëria e mbrojtjes ligjore të individëve. Kështu që në vazhdim, do të japim disa nga aktet më të rëndësishme juridike europiane sipas kronologjisë, të cilat kanë si

specifikë apo janë bazike për privatësinë dhe mdhp, duke marrë në konsideratë DUDNj të OKB-së. Në vazhdim po japim sqarime më të zgjeruara mbi disa akte juridike. Ndonëse akte të tilla janë të shumta, ne do të shqyrtojmë vetëm disa prej tyre, që mendojmë se janë më të rëndësishme për këtë studim pa e nënvlerësuar ndikimin dhe rëndësinë e akteve tjera juridike.

4.4 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB-së (DUDNj)

DUDNj ka gjithsej 30 nene me dispozita të qarta dhe me bazë universale mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Pararendëse të DUDNj të OKB-së janë: Karta e Madhe e Lirive (Magna Carta Libertatum) e vitit 1213, Ligji për të Drejtat (Bill of Rights) i vitit 1689, Deklarata për Pavarësinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e vitit 1770 dhe Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit 1789 (Gruda 2001:8).

Dokumenti i Deklaratës së Përgjithshme të të drejtave të njeriut, për herë të parë në historinë e njerëzimit, është dokumenti më gjithëpërfshirës që konsideron dhe merr në mbrojtje liritë themelore të njeriut: liritë sociale, liritë ekonomike dhe ato kulturore. Dokumenti është aprovuar tri vite pas Kartës së San Franciskos të Kombeve të Bashkuara, (10 qershor 1948), me votim të 48 shteteve asnjë votë kundër dhe dhjetë abstenime (BRSS, Polonia, Jugosllavia, Afrika e Jugut, Ukraina, Çekosllovakia, Bjellorusia dhe Arabia Saudite).

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut për mbarë njerëzimin mund të konsiderohet si një nga aktet dhe instrumentet më me meritë, që ndikoi në sigurinë e përgjithshme si dhe në forcimin e paqes në planet. Pas miratimit të Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, në nivel global do të fillojë epoka e re e të drejtave dhe lirive të njeriut, ndoshta, sepse këto të drejta do të dalin nga fusha e kompetencës kombëtare (shtetërore) dhe do të kalojnë në fushën e kompetencës ndërkombëtare. Mekanizmi që do të mbikëqyrë të drejtat e njeriut në nivel ndërkombëtar u themelua nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut, mbajtur në Vjenë me 23-25 Qershor 1993, që do të quhet Komisariati i Lartë për të Drejtat e Njeriut, do të emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm i

OKB-së dhe do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së. Selia e Komisarariatit është në Gjenevë.

4.5 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i OKB-së (PNDCP)

PNDCP, duke qenë se Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut është një akt ndërkombëtar, pa masa detyruese juridike. Ky akt ishte nxitja kryesore për nxjerrjen e një traktati ndërkombëtar me masa kontrolluese juridike dhe për zbatimin praktik të tij në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Kështu, rreth njëzet vjet pas miratimit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (19 dhjetor 1966) Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi njëzëri pa asnjë kundërshtim dhe hapi për nënshkrim, aderim dhe ratifikim dy Pakte: Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (hyrë në fuqi më 23 mars 1976); Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (hyrë në fuqi më 3 janar 1976) dhe dy Protokolle Opsionale në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (hyrë në fuqi më 1976 dhe 1989).

Paktet përmbajnë dispozita për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të drejtave për vetëvendosje të popujve, të drejta për mbrojtjen e pakicave, të drejta për mbrojtjen kulturore e të trashëgimisë etj. dhe janë në mbështetje të Kartës së OKB-së dhe parimeve themelore të Deklaratës së OKB-së për të Drejtat e Njeriut.

Ne do të fokusohemi në Paktin e të Drejtave Civile dhe Politike, për arsye se në këtë Pakt janë trajtuar të dhp dhe të privatësisë së individit. Ndërkaq Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i OKB-së përfshin të drejtën për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhp të individit (subjektit të të dhënave), në dallim nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. DUDNj të drejtën e privatësisë dhe të dhp si normë juridike vetëm e deklaroi, dhe në dispozitën e nenit 12 shkruan: “Asnjëri nuk duhet t’i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal. Gjithkush ka të drejtën të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla”, (Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut e OKB-së 1948).

Ndërsa Pakti i të Drejtave Civile dhe Politike këtë të drejtë të normuar juridike e fuqizon, dhe në dispozitat e nenit 17 shkruan: “Askush nuk mund të jetë objekt i ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, banesë ose letërkëmbim, ose i cënimeve të paligjshme të nderit dhe reputacionit të tij. Çdo person ka të drejtë të ketë mbrojtjen e ligjit kundër ndërhyrjeve dhe shkeljeve të tilla” (Shih Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike i OKB-së), (dhjetor 1966, hyrë në fuqi në mars 1976).

Pakti rekomandon përfshirjen e instrumenteve ligjore në ligjet kombëtare për të marrë nën mbrojtje të drejtat e njeriut. Dispozitat e Paktit për të Drejta Civile dhe Politike shtrihen në 53 nene. Tekstet e Paktit në gjuhën angleze, franceze, kineze, ruse dhe spanjolle janë autentike dhe të depozituara në arkivat e Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u dërgonë nga një kopje të njëjtë të vërtetuar të këtij Pakti të gjitha shteteve që përmenden në nenin 48 të Paktit. Pakti më vonë, deri në vitet nëntëdhjeta (1994), u pasurua edhe me protokollet shtesë:

1. Protokollin Opsional të Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike, i miratuar dhe i hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor, 1966. Protokollin ka hyrë në fuqi, më 23 mars, 1976, në përputhje me nenin 9. / 2. Protokollin Opsional i Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike, i miratuar dhe i shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 44/128, të datës 15 dhjetor, 1989, (Rights Support Programme-Kosovo, Prishtinë, Kombet e Bashkuara, New York-Gjeneva, 1994:54, 60)

4.6 Deklarata e Teheranit e 13 majit 1968

Kjo Deklaratë është shpallur në KNDNJ, mbajtur në Teheran, më datën 13 maj 1968. Përfaqësuesit e konferencës ishin mbledhur në Teheran (22 prilli-13 maj 1968), me qëllim të shqyrtimit të përparimit të bërë gjatë njëzet viteve (që nga miratimi i Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut) dhe të formulimit të një programi për të ardhmen.

Pas shqyrtimit të problemeve në lidhje me aktivitetet e Kombeve të Bashkuara në promovimin dhe nxitjen e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, duke

pasur parasysh rezolutat e miratuara në Konferencë; duke vënë në pah se shënimi i Vitit Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut ndodh në kohën kur bota është duke kaluar nëpër një proces të ndryshimeve të paprecedentë; duke pasur parasysh mundësitë e reja të disponueshme nga zhvillimi i shpejtë i shkencës dhe i teknologjisë, me besimin se në kohën kur konfliktet dhe dhuna mbizotërojnë në shumë pjesë të botës; faktet e ndërvarshmërisë njerëzore dhe nevoja për solidaritet njerëzor janë më evidente se kurrë më parë, duke pranuar se paqja është një aspiratë e përgjithshme e njerëzimit dhe se paqja e drejtësia janë më esenciale për realizimin e plotë të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Konferenca solemnisht shpalli Deklaratën prej 19 pikash.

Veçojmë pikën e 18-të të Deklaratës për rëndësinë që do të ketë në të ardhmen në reflektimin e mdhp dhe privatësisë, parë kjo në prizmin e zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë, ku thuhet: “Përderisa zbulimet shkencore dhe përparimet teknologjike të kohëve të fundit kanë hapur mundësi të gjera për përparim ekonomik, social dhe kulturor, megjithatë zhvillimet e tilla mund të rrezikojnë të drejtat dhe liritë e individëve dhe për këtë ato kërkojnë një vëmendje të pandërprerë” (pika 18)

Prandaj, KNDNJ, duke shpallur besimin në parimet e Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe instrumentet tjera ndërkombëtare në këtë fushë nxit të gjithë popujt dhe qeveritë që t’iu dedikohen parimeve të pasqyruara në Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe të shtojnë përpjekjet e tyre për të siguruar për të gjitha qeniet njerëzore një nivel jetësor në liri, me dinjitet dhe të përshtatshëm për mirëqenien e tyre fizike, mendore, sociale dhe shpirtërore.¹⁴

4.7 Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

Në mbështetje të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut të shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, duke pasur parasysh se kjo Deklaratë ka për qëllim të sigurojë njohjen dhe zbatimin universal dhe efektiv të të drejtave të shpallura në të; duke pasur

¹⁴Rights Support Programme-Kosovo, Prishtinë, Kombet e Bashkuara, New York-Gjenev (1994:54, 69).

parasysh se qëllimi i KE-së është që të realizojë një bashkim më të ngushtë midis anëtarëve të tij dhe se një nga mjetet për të arritur këtë qëllim është mbrojtja dhe zhvillimi i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore; duke ripohuar përkushtimin e tyre të thellë ndaj këtyre lirive themelore, që përbëjnë vetë themelet e drejtësisë dhe të paqes në botë dhe ruajtja e të cilave mbështetet kryesisht mbi një regjim politik dhe me të vërtetë demokratik nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, mbi një koncept dhe respekt të përbashkët të të drejtave të njeriut që ato kanë marrë përsipër të mbrojnë, të vendosura si qeveri të shteteve evropiane që shtyhen nga e njëjta frymë dhe që kanë një pasuri të përbashkët të idealeve dhe të traditave politike, të respektimit të lirisë dhe të epërsisë të së drejtës, të marrin masat e para të përshtatshme për të siguruar garancitë kolektive të disa prej të drejtave të shpallura në Deklaratën Universale. Shtetet anëtare janë dakorduar për miratimin, nënshkrimin dhe aderimin në këtë Konventë, e cila tërë materien dhe dispozitat e veta i ka shtrirë në 59 nene.

Kjo Konventë u është paraqitur për nënshkrim anëtarëve të KE-së. Ratifikimet dorëzohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të KE-së. Kjo Konventë hyn në fuqi pas dorëzimit të dhjetë instrumenteve të ratifikimit (që nënkupton dorëzimin e instrumenteve të ratifikimit të dhjetë shteteve). Për çdo nënshkrues që do ta ratifikojë më vonë këtë dokument, Konventa do të hyjë në fuqi me dorëzimin e instrumentit të ratifikimit. Konventa është miratuar në Romë, më 4 nëntor 1950, në frëngjisht dhe anglisht (të dy tekstet janë të barasvlershme), në një ekzemplar të vetëm, i cili është depozituar në arkivat e KE-së. Sekretari i Përgjithshëm i KE-së e komunikon një kopje të vërtetuar konform të gjithë nënshkruesve.

Deri më tani (2012) kësaj Konvente i janë shtuar katër protokolle shtesë, të cilat janë pjesë e kësaj Konvente dhe kanë hyrë në fuqi: nr.3 (STE nr.45, hyrë në fuqi më 21 shtator 1970; nr.5 (STE nr.55), hyrë në fuqi më 20 dhjetor 1971; nr.8 (STE nr.118), hyrë në fuqi më 1 janar 1990; nr.11 (STE nr.155), hyrë në fuqi më 1 nëntor 1998. Duke filluar nga kjo datë është shfuqizuar Protokolli nr.9 (STEnr140), shfuqizim i hyrë në fuqi më 1 tetor 1994. Shfuqizimi është vërtetuar nga Sekretari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nëntor 1998, dhe qeveritë nënshkruese që janë anëtare të Këshillit të Europës.

(Përmbledhëse ligjore e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Republika e Shqipërisë, Tiranë, 2012:12)¹⁵.

Neni 8 i kësaj Konvente garanton të drejtën në respektimin e jetës private dhe familjare, ku thuhet:

“1. Çdo person ka të drejtë që t’i respektohet jeta e tij private dhe familjare, vendbanimi dhe korespondenca e tij. Autoriteti publik mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte vetëm në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur, në një shoqëri demokratike, kjo masë është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurimin publik, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”

Duke e çuar më tej interpretimin dinamik të Konventës, “Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut konsideron se ka ardhur koha që në disa rrethana të pranohet se të drejtat e garantuara sipas nenit 8 të Konventës mund të përfshijnë, në rastin e shoqërisë, të drejtën për respektimin e selisë së saj, agjencisë apo ambienteve të saj profesionale”(Pradel & Corstens 2010:401), dhe këto të drejtat u njihen edhe personave juridikë.

4.8 Konventa për Mbrojtjen e Individit në lidhje me përpunimin automatik të të dhp

Konventa për mbrojtjen e individit në lidhje me përpunimin automatik të të dhp është bërë në Strasburg më 28 Janar 1981, dhe në preambulë të saj thuhet se: Shtetet nënshkruese anëtare të Këshillit të Evropës, duke pasur parasysh se KE është për të arritur një unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, bazuar sidomos në respektimin e shtetit ligjor, si dhe të drejtave të njeriut dhe lirive themelore; duke pasur parasysh se është e dëshirueshme të zgjerohen garancitë për të drejtat e të gjithëve dhe liritë themelore dhe sidomos të drejtat për të siguruar jetën private; duke marrë parasysh fluksin ndërkufitar në rritje të të dhp që i

¹⁵PËRMBLEDHËSE LIGJORE E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, (përkthimet e Konvetës janë bërë nga ekspert të siguruar nga botuesi).

nënshtrohen përpunimit automatik; duke riafirmuar në të njëjtën kohë përkushtimin e tyre për lirinë e informacionit, pavarësisht nga kufijtë; duke ditur që është e nevojshme të përshtaten vlerat themelore për respektimin e jetës private dhe fluksin e lirë të informacionit ndërmjet njerëzve, kanë rënë dakord për tekstin në dispozitat e Konventës e cila përmban 27 nene. Sipas përkufizimeve të kësaj Konvente “Të dhëna personale” janë të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm. ”Dosje e të dhënave të autorizuar” janë të gjitha kompletet e të dhënave që i nënshtrohen përpunimit automatik. ”Përpunimi automatik” përfshin operacionet e mëposhtme, nëse kryhen plotësisht ose pjesërisht, me anë të mjeteve automatike: ruajtja e të dhënave, kryerja e veprimeve logjike dhe/ose aritmetike mbi këto të dhëna, ndryshimi, fshirja, marrja ose shpërndarja e tyre. ”Kontrollori i dosjes” është çdo person fizik ose juridik, organ publik, agjenci ose ndonjë autoritet tjetër që është kompetent në bazë të ligjit vendas për të vendosur se cili duhet të jetë qëllimi i dosjes së të dhënave të automatizuara, cilat kategori të të dhënave duhet të ruhen dhe cilat veprime duhet të zbatohen mbi to. Në lidhje me fuqizimin e kësaj konvente dhe një justifikimi të domosdoshëm të vendosjes së normave universale të njerëzimit mbi privatësinë, në epokën tonë gjejmë fraza të ndryshme.

Kështu, Katherine Neville shprehet: *“Privatësia–si ushqimi e frymëmarrja–është nga kërkesat themelore të jetës” (Kalendari vjetor i AShMDhP në Republikën e Kosovës, 2014)*

Sekretari i Përgjithshëm i KE-së i njofton shtetet anëtare të KE-së dhe çdo shtet që është i anëtarësuar në këtë Konventë për çdo nënshkrim të kësaj Konvente; për depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose anëtarësimit; për çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në pajtim me nenet 22, 23 dhe 24 të saj; dhe për çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër që ka të bëjë me Konventën. Konventa është hartuar në anglisht dhe frëngjisht (të dy tekstet janë njësoj autentike), në një kopje të vetme, e cila mbetet e depozituar në arkivat e KE-së. “Sekretari i Përgjithshëm i KE-së u transmeton kopje të gjitha shteteve anëtare të KE-së, Komunitetit Europian dhe çdo shteti tjetër të ftuar për t’u anëtarësuar në Konventë” *Përmbledhëse Ligjore e Komisionerit Për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale, Republika e Shqipërisë, Tiranë, (2012:61).*

Të gjitha autoritetet kombëtare pjesë të kësaj Konvente, përfshirë edhe Komisionerin e KE-së, zyrtarisht e festojnë si “Ditën Europiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale” çdo 28 Janar.

Konventes 108 më 8.11.2001 i është shtuar edhe protokoll i shtesë, i cili merret me rregullimin e mbrojtjes së individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhp, duke dhënë kështu mandate për këtë qëllim tek organet mbikëqyrëse, si autoritete të shteteve anëtare, palë të kësaj Konvente dhe duke marrë në konsiderim rritjen e fluksit ndërkufitar të të dhënave. Ky Protokoll shtesë është i përbërë prej tre (3) neneve. Protokoll i është hapur për nënshkrim nga shtetet palë të Konventës. Pas anëtarësimit në Konventë, sipas kushteve të përcaktuara në të, Komuniteti European mund të nënshkruajë këtë protokoll. Ky protokoll i nënshtrohet ratifikimit, aprovimit ose pranimi. Një palë e këtij protokoll nuk mund ta ratifikojë, pranojë ose aprovojë atë, përveç kur ai e ka ratifikuar, pranuar ose aprovuar më parë ose njëkohësisht Konventën, ose është anëtarësuar në të. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose aprovimit të këtij protokoll depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i KE-së. Protokoll i hyn në fuqi ditën e parë të muajit, pas përfundimit të periudhës tre mujore, pas datës në të cilën pesë shtete palë të tij të kenë shprehur pëlqimin për t’iu nënshtruar protokollit në pajtim me dispozitat e nenit 3. Në lidhje me çdo shtet palë të këtij protokoll, i cili e shpreh pëlqimin e tij më vonë për t’iu nënshtruar atij, protokoll i hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimi ose aprovimit. Pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll, çdo shtet që është anëtarësuar në Konventë mund të anëtarësohet në Protokoll. Anëtarësimi kryhet nëpërmjet depozitimit te Sekretari i Përgjithshëm i KE-së të instrumentit të anëtarësimit, i cili bëhet i efektshëm në ditën e parë të muajit, pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit.

Çdo palë mund ta denoncojë në çdo kohë këtë protokoll nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të KE-së. Një denoncim i tillë bëhet i efektshëm në ditën e parë të muajit, pas kalimit të një periudhe tre mujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Sekretari i Përgjithshëm i KE-së njofton shtetet anëtare të KE-së, Komunitetin European dhe çdo shtet tjetër anëtar që është anëtarësuar në këtë protokoll për çdo nënshkrim, për

depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit ose aprovimit; për çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij protokoll në pajtim me nenin 3; për çdo akt, denoncim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Protokoll. Si dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, ligjërisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll, të hartuar në Strasburg (8 nëntor 2001) në anglisht dhe frëngjisht (të dyja tekstet njëloj autentike), në një kopje të vetme e cila depozitohet në arkivat e KE-së. “Sekretari i Përgjithshëm i KE-së u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha shteteve anëtare të KE-së, Komunitetit Europian dhe çdo shteti të ftuar për t’u anëtarësuar në Konventë”.¹⁶

4.9 Direktiva EC 95/46 për MDhP e vitit 1995

Parlamenti Europian dhe Këshilli i UE-së duke marrë parasysh Traktatin e themelimit të Komunitetit Europian dhe veçanërisht nenin 100/a prej ku, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit, opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social, duke vepruar në përputhje me procedurat e referuara sipas nenit 189/b të Traktatit, ka nxjerrë Direktivën EC 95/46 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të të dhënave të tilla, të mbështetur në 72 paragrafë, si parime me një bazë të gjerë sqarimesh.

Direktiva ka gjithsej VII kapituj dhe dispozitat e saj shtrihen në 34 nene. Në Direktivë është e vendosur e tërë masa ligjore e cila i vendos bazat themelore të përpunimit të ligjshëm të të dhp, parimet e përpunimit të të dhp, të drejtat e subjektit të të dhënave, detyrimet e kontrollorëve që përpunojnë të dhp në sektorin publik dhe privat, transferimin e të dhp, institucionet apo autoritetet e mdhp dhe masat administrative për shkelësit e të drejtave të subjekteve të të dhp. Gjithashtu, me Direktivë janë specifikuar fushat e të dhënave si: librat e regjistrat të hyrje-daljeve, librat publik, përpunimi i të dhënave biometrike, vëzhgimi i hapësirave me videovëzhgim me kamerë, masat e sigurisë dhe fshehtësisë gjatë përpunimit të të dhënave, përpunimi i të dhënave të zërit dhe fotografisë, përpunimi automatik i të dhënave etj. Një rregullim përmes masave mbrojtëse dhe të

¹⁶*Përmbledhëse Ligjore e Komisionerit Për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale, Republika e Shqipërisë, Tiranë, (2012:64, 65)*

sigurisë ligjore është dhënë edhe te transferimi ndërkombëtar i të dhp. Direktiva specifikon edhe ndërlidhjen e dosjeve, mbajtjen e tyre dhe mbajtjen e regjistrit të dosjes me të dhp. Përpunimi i të dhënave të ndjeshme apo sensitive merret në konsideratë nga Direktiva me seriozitetin më të madh dhe keqpërdorimi apo shkeljet e kësaj natyre konsiderohen vepra penale.

Në përputhje me kërkesat dhe normat e Direktivës kërkohet që të gjitha autoritetet kombëtare të hartojnë kodet e tyre të etikës. Me rëndësi është të përmendet që “Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni më 20 dhjetor të vitit 1994 nënshkruan bashkërisht marrëveshje për “modus vivendi” në lidhje me masat ekzekutive të veprimeve që nxirren në përputhje me nenin 189/b të Direktivës së Parlamentit Europian” (Direktiva 95/46 e KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, (tetor 1995:15). Sipas Direktivës (95/46) të gjitha vendeve anëtare iu është thënë që nuk kanë mundësi të kalojnë tre vjet nga fillimi hyrjes në fuqi të masave kombëtare për transportim të drejtave të direktivës aktuale në masat e së drejtës kombëtare, me qëllim të zbatimit hap pas hapi të dispozitave të vendosura të kësaj direktive në ligjet kombëtare. (Direktiva 95/46 shfuqizohet nga rregullorja 679/2016 e Parlamentit Europian me aplikimin e saj më 25 maj 2018).

Vendet anëtare sipas direktivës parashikonin një periudhë plotësuese, e cila skadon 12 vjet pas nxjerrjes së Direktivës, me qëllim të përshtatjes së disa dispozitave të Direktivës, arkivat e shkruara me dorë të cilat do të ekzistojnë në këtë datë, kur të dhënat që përfshihen në këto arkiva përbëjnë objekt të përpunuara me dorë brenda periudhës plotësuese kalimtare, përshtatja me dispozitat e lartpërmendura duhet të realizohet gjatë realizimit të përpunimit.

“Transpozimi i një Direktive `ishte` një detyrim për të gjitha vendet e BE-së, që janë të anëtarësuar (në BE) si shtete anëtare, do të thotë se kjo është kërkesë e Direktivës, ato nuk zbatohen vetvetiu, ato janë të zbatueshme vetëm kur vendosen në të drejtën kombëtare“ (Lowrance 2013:41).

Direktiva u jep detyrë të gjitha shteteve anëtare që kur të hartojnë masat legislative dhe rregulloret e tyre për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të individëve lidhur me të dhënat e tyre personale, të konsultojnë autoritetet e mbrojtjes së të dhp. Autoritet e kanë pavarësinë

e plotë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Direktiva 95/46 me nenin 29 të saj themelon grupin punues për mbrojtjen e individëve lidhur me përpunimin e të dhp, i cili do të quhet “Grupi i Punës” me status këshillimi, me veprim të pavarur dhe me përbërje nga një anëtar nga secili autoritet kombëtar i të dhp i shtetit anëtar.

Vendimmarrja e grupit punues është me shumicën (mazhorancën) e thjeshtë të përfaqësuesve të tij të autoriteteve mbikëqyrëse. Grupi punues e zgjedh kryetarin me mandat dy vjeçar, me të drejtë edhe të një rizgjedhje. Sekretari i grupit punues vendoset nga Komisioni i KE-së. Grupi i punës harton një raport vjetor, i cili përmbledh gjendjen e mdhp në shtetet anëtare, në shtetet e treta dhe në komunitete, raport ky që u dërgohet Komisionit, Parlamentit European dhe Këshillit. Raporti bëhet publik dhe shtetet anëtare janë të obliguara sipas Direktivës t’i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave të ligjeve të brendshme, të cilat ata i kanë adoptuar në çështjet e mbuluara nga kjo Direktivë. Direktiva është aprovuar me 24 tetor 1995 në Luksemburg.

4.10 Deklarata e Vjenës për të Drejtat e Njeriut dhe Plani i Veprimit i 25 i qershorit 1993

Pas shumë aktiviteteve dhe shumë konferencave rajonale në botë, rreth njëzet vjet pas mbajtjes së KNDNj të Teheranit u mbajt Konferenca Ndërkombëtare e Vjenës nga data 23-25 qershor 1993, e cila konsiderohet si më e madhja dhe më gjithëpërfshirëse në aspektin e rekomandimeve për komunitetin ndërkombëtar. Mbështetur në parimet universale të të drejtave të njeriut që nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut të OKB-së, në këtë konferencë ndërkombëtare, në Deklaratën e Adaptuar të të Drejtave të Njeriut të Vjenës, janë aprovuar njëqind (100) rekomandime për komunitetin ndërkombëtar. Me këto rekomandime u bëhet thirrje të gjithë aktorëve vendimmarrës (publik dhe privat), duke filluar nga niveli i OKB-së, niveleve rajonale dhe të gjitha shteteve, agjencive, shoqatave, shoqërisë civile pa përjashtim për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut të proklamuar në Deklaratë. Gjithashtu, edhe respektimin e privatësisë dhe të drejtave të dinjitetit të individit në relacion të zhvillimit shkencor dhe teknologjik, duke pohuar se:

“Gjithkush ka të drejtë të gëzojë përfitimet edhe aplikimet e këtij progresi shkencor. KNDNJ vë në dukje se përparimet e caktuara të këtij progresi, sidomos në shkencat e jetës dhe biomjekësore, si dhe në teknologjinë e informacionit, mund të ketë pasoja për të drejtat e individit në dinjitetin dhe integritetin njerëzor të njerëzve, dhe bën thirrje për bashkëpunim ndërkombëtar për të siguruar që të drejtat e njeriut dhe dinjiteti janë shqetësim universal dhe duhet të respektohen plotësisht mbi këtë bazë shqetësimi” Vienna Declaration and Programme of Action, Adopted by the World Conference on Human Rights in Vienna (June 1993), The World Conference on Human Right, (Rekomandimi, nr.11). Me qëllim të përforcimit të drejtave dhe lirive të njeriut në funksion të pages, dhe me qëllim të afirmimit dhe nxitjes së vlerave themelore të lirive dhe të drejtave të njeriut, Konferenca ka futur në deklaratë këtë rekomandim, ku thuhet:

“Marrëveshjet rajonale luajnë një rol thelbësor në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ato duhet të përforcojnë standardet universale të të drejtave të njeriut, të përfshira në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e tyre. Konferenca ndërkombëtare për të drejtat e njeriut miraton këto përpjekje që të forcohen këto marrëveshje dhe në të njëjtën kohë riafirmon dhe thekson rëndësinë e tyre, Vienna Declaration and Programme of Action, Adopted by the World Conference on Human Rights in Vienna (June 1993), The World Conference on Human Right, (Rekomandimi, nr.37)

Marrëveshjet dypalëshe dhe ato shumëpalëshe në fushën e të drejtave të njeriut midis shteteve rrisin nivelin e mirëbesimit dhe të fqinjësisë së mirë në relacionet ndërshtetërore dhe ndikojnë drejtpërdrejt në interes të qytetarëve dhe vlerave të humanizmit, duke forcuar kështu luftën kundër diskriminimeve çfarëdo qofshin ato.

Këso lloj marrëveshjesh në këtë kohë janë të shumta në rajonin tonë dhe janë aplikuar me vullnetin më të madh nga autoritetet e mdhp. AShMDhP e Republikës e Kosovës në këtë drejtim ka nënshkruar marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me të gjitha shtetet e rajonit, me përjashtim të Serbisë. Pokështu ka shënuar suksese në vendosjen e marrëdhënieve bilaterale me shumë autoritete të mdhp të shteteve në Ballkan dhe Europë. Shkeljet e dinjitetit njerëzor konsiderohen shkelje të tmerrshme të të drejtave të individit. Ato janë të njëjta me torturën fizike dhe si të tilla radhiten si një ndër torturat më të rënda

që i bëhen njeriut. Në këtë aspekt, duke riafirmuar privatësinë e individit dhe të drejtat e tij personale Konferenca ka theksuar, se: “. . . një nga shkeljet më të tmerrshme të dinjitetit është akti i torturës, rezultat i cili shkatërron dinjitetin dhe dëmton aftësinë e viktimave që të vazhdojnë jetën dhe aktivitetin e tyre”, Vienna Declaration and Programme of Action, Adopted by the World Conference on Human Rights in Vienna (June 1993), The World Conference on Human Right, (Rekomandimi, nr.55).

Sa të rëndësishme janë të drejtat e njeriut në nivel ndërkombëtar, më së miri flet fakti se vetëm në pjesën e dytë të vitit 2013 janë parashikuar 23 aktivitete të drejtave të njeriut; në kalendarin e takimeve, sesioneve, konferencave, grupeve të punës dhe aktiviteteve të fushës së të drejtave dhe lirive të njeriut në fusha të ndryshme, si: “Kundër torturës dhe diskriminimit, lirive dhe të drejtave ekonomike, të drejtave sociale, të drejtave të fëmijëve, të drejtave të grave, zhvillimit ekonomik, edukimit, komunikimit, kooperimit dhe bashkëpunimit” etj.¹⁷ Prandaj, këtë epokë mund ta quajmë si “Epoka e Rilindjes së Demokracisë dhe Lirive e të Drejtave Themelore të Njeriut”.

¹⁷[www.ohcr.org/EN/News Events/Pages/Meetings.aspx](http://www.ohcr.org/EN/News%20Events/Pages/Meetings.aspx) shikuar më 10.10.2013, 17.00h,

KAPITULLI V: ZHVILLIMI I TI DHE KOMUNIKIMIT, DOKUMENTET PERSONALE, MEDIUMET INFORMATIVE DHE MBROJTJA E TE DHËNAVE PERSONALE

5.1 Roli dhe efektet e teknologjisë në fushën e të dhp dhe të privatësisë

Në kapitullin, paraparak, te përpunimi i të dhënave, u tha se të dhp përpunohen, regjistrohen dhe transmetohen përmes pajisjeve të ndryshme të teknologjisë së informimit dhe komunikimit. Në këtë kapitull është bërë ndarja, janë dhënë shpjegimet relevante dhe efektet ndikuese të këtyre pajisjeve në të dhp dhe privatësinë e individit. Mundësitë teknologjike kanë hapur rrugë për mundësi të shumta të shkeljes mbi privatësinë, prandaj studiues të ndryshëm japin vlerësime të ndryshme.

Katharine Fulelton Gerould jep këtë vlerësim: “Të gjitha shkeljet e privatësisë thelbësore janë brutale” (Kalendari i ASHMDhP në Republikën e Kosovës, 2014). Për nocionin “jetë private” mund të jepen shumë interpretime. Por, në kuadrin e drejtësisë penale ky nocion nënkupton lirinë (të drejtën e secilit, sqarim i autorit) për ta jetuar jetën sipas dëshirës së vet, si dhe mbrojtjen kundër masave për ndërhyrje nga ana e autoriteteve publike (Pradel & Corstens 2010:403). Vlerësimet e rrezikimit të privatësisë shihen të arsyetuara mirë në vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ku shkeljet e nenit 8 dhe nenit 6 të Konventës Europiane dominojnë në vendimet e kësaj gjykate. “Gjatë vlerësimit të rreziqeve të privatësisë ne gjithmonë duhet të vlerësojmë shkallën e dëmeve të mundshme dhe përpjekjet për t'i peshuar individët, shoqërinë dhe vendin, si dhe ndërmarrjen e hulumtimit mbi dëmet e imagjinueshme” (Pradel & Corstens 2010:403).

5. 2 Telefonia

Shpikja e telefonit dhe zhvillimi i telefonisë relativisht është diçka e re në kohë. Zhvillimi i këtij komunikimi i përket periudhës kohore rreth dy shekuj. Por, zhvillimi dhe përsosja e telefonisë ka ofruar mundësi të jashtëzakonshme. Shpikja e parë e telefonit fiks është

tashmë në kujtesë muzeale. Tani në “tokën e përbashkët të komunikimit”, hapësirë kjo të cilën e shfrytëzojmë gjatë komunikimit, që ndryshe njihet me emrin “common land”¹⁸, të shekullit XX dhe XXI po përdoren gjeneratat e telefonave që dërgojnë dhe pranojnë në çfarëdo distance imazhe fotografish, tekste të shkruara, videoinçizime, filma, porosi përmes inçizimit të zërit me shpejtësi tepër të mëdha, me ndihmën e pajisjeve satelitore. Këto pajisje ofrojnë mundësi që komunikuesit të dinë dhe të identifikojnë saktë vendëndodhjen (adresat) e tyre gjatë komunikimit. Mundësia për të ditur vendëndodhjen gjatë komunikimit, përmes sistemit të internetit (Google, dhe faqeve tjera ku harta botërore e dixhitalizuar është futur në sistemin GPS) ka mundësuar që përmes satelitit të identifikohet pozicioni dhe adresa e bashkëbiseduesit (mundësia e ndërtuar në klasat “ifon”, “galaksia”, “nokia” etj).

Kjo mundësi komunikimi zhvilloi kualitetin e zhvillimeve demokratike dhe lehtësoi jetën e njeriut në njërin anë, por në anën tjetër, padyshim krijoi mundësi të mëdha të ndërhyrjes në jetën private të njeriut, sepse pranuesi dhe dërguesi në të dy anët e receptorit padyshim regjistrojnë të dhp të individit dhe pajisje të tilla posedojnë mundësi të deponimit të këtyre shënimeve në serverët transmetues. Operatorët e pajisjeve telekomunikuese, përmes rregullimeve ligjore, ligjeve të telekomunikimit të standardizuara sipas Direktivës së KE-së, e kanë për detyrë që t’i mbikëqyrin rregullat, të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve gjatë telekomunikimit dhe njëkohësisht të zbatojnë edhe dispozitat ligjore të mdhp dhe privatësisë konform kërkesave të sigurisë së të dhënave dhe rregullave që dalin nga ligjet për mdhp të vendeve respektive të hapësirës së BE-së, dhe atyre që e aspirojnë anëtarësimin në BE.

5.3 Videoincizimi

Depërtimi i kamerës si mjet me fuqi të mëdha në procesin e incizimit, vëzhgimit dhe transmetimit të imazheve statike dhe dinamike ka lehtësuar në masë të konsiderueshme

¹⁸Mediat dhe Komunikimi, Kolegji Universitar i Gazetarisë, “Faik Konica”, Prishtinë, 2006/2007, f.59 (Duke shpjeguar artikullin Multimedia, Mediat online, Interneti dhe e Ardhmja, hasim te emërtimi i termit “Cyberspace “ ndryshe njihet me emrin “Common land”, ku William Gibson (1984) e emërtoi hapësirën virtuale që e shfrytëzojnë njerëzit kur komunikojnë online).

rritjen e mbikëqyrjes në favor të sigurisë dhe zvogëlimit të fuqisë punëtore, të cilët do të detyroheshin që me prezencën e tyre fizike të sigurojnë hapësira të caktuara, duke ruajtur dhe u kujdesur për sigurinë e pronës, njerëzve dhe kapitalit në sektorët e ndryshëm të jetës. Depërtimi i syrit të kamerës në rast se do të përdorej kundërligjshëm, si në: repartet e maternitetit, repartet e psikiatrisë, repartet e neurologjisë, nyje sanitare (sektorë të ndryshëm), dhomat e zhveshjeve (ku bëhet përgatitja dhe veshja e uniformave të punës), kabina të provave të rrobave (në tregti), dhoma gjumi (ambiente private) etj, do të konsiderohej skandal, dhe ky lloj i vëzhgimit me kamera, padyshim do të përbënte shkelje të rëndë të rregullave të mdhp dhe të privatësisë. Në këtë rast dhe në shumë raste të tjera të ngjashme të vëzhgimit me kamera cenohet thellë privatësia e individit dhe dinjiteti i tij. Dallojmë dy forma të vëzhgimit me kamera:

- incizimi me video dhe
- regjistrimi momental pa video (pa regjistrim të imazheve me shirit).

Një mundësi tjetër gjatë incizimit me kamerë është ajo e teletransmetimit direkt në rrjete televizive dhe të internetit. Ligjet e mdhp në funksion të mdh të qytetareve dhe privatësisë së tyre e konsiderojnë këtë fushë mjaft serioze, sidomos në aspektin e ndërhyrjeve agresive të marketingut në sektorin e tregtisë, në sektorin e sigurisë, në sektorin e shëndetësisë, në jetën private dhe sensitive të njeriut.

Në aspektin e rregullimeve ligjore, sipas Ligjit të Kosovës 03/L-172, i cili konsiderohet ndër ligjet më të avancuara në rajon në fushën e mdhp kemi rregullimin ligjor të veçuar në¹⁹:

- dispozita të përgjithshme,
- vëzhgimi i ndërtesave zyrtare dhe bizneseve,
- mbikëqyrja e ndërtesave dhe apartamenteve,

¹⁹Vlerësim i Raportit të Progresit nga Komisioni i KE-së dhe BE-së për Kosovë në bllokun: Drejtësia-Siguria-të drejtat e njeriut -liria, (shkurt, 2013, pika 3.3)

- vëzhgimi me kamera në sektorin e punësimit (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, prill 2010:30,31,32). Në këtë fushë, duke prodhuar efekte sigurie për individin, pothuajse njësoj, janë rregulluar edhe aspektet ligjore të shteteve tjera, ndërkohë që Direktiva EC 95/46 e KE-së nuk e specifikon fushën e videoincizimit. Të gjitha organet e sektorit publik dhe privat që e përdorin sistemin e vëzhgimit kanë obligime ligjore që:

- të regjistrojnë hyrjen: kur, kush dhe autorizimin e atyre që e kanë marrë apo parë serverin, kasetën ose monitorin e video/regjistrimit,
- që të caktojnë afatin e ruajtjes së videovëzhgimit dhe,
- që të nxjerrin shenjë standarde të njoftimit të qytetarëve të cilët vëzhgohen gjatë përdorimit të vëzhgimit me kamerë.

Gjatë zbatimit në praktikë të ligjeve të mdh hasen edhe shumë aspekte të tjera dhe dilema që cenojnë integritetin personal dhe privatësinë e qytetarëve gjatë vëzhgimit me kamera, e për të cilat ligjet nuk kanë përshkrime të hollësishme. Por, zgjedhja dhe interpretimi ligjor gjithmonë duhet t'i japë prioritet të drejtave themelore të njeriut, lirisë së individit dhe së drejtës mbi dinjitetin e njeriut. Përdorimi i madh i kamerës edhe në jetën individuale, përdorimi i dronëve-fluturakeve vëzhguese dhe pajisjeve moderne vëzhguese, në shumë fusha të jetës dhe punës, ka bërë që shumë shtete të nxjerrin ligje të veçanta rreth përdorimit të vëzhgimit me kamera dhe rregulla të përdorimit të dronëve; në mënyrë që të rritet sa më shumë siguria të subjektet e të dhp.

5.4 Audioincizimi

Aparatura audioincizuese u zhvillua në masë të madhe në forma, dizajne e fuqi të ndryshme, që nga zbulimi i transmetuesit radiofonik në fund të shekullit VIII dhe fillim të shekullit IX. Radiofonia ka mundësuar zhvillimin e degës së rëndësishme të informimit “Radio-gazetarisë”. Përmes këtij zhanri informativ përpunohen dhe transmetohen në eter të dhëna të shumta personale me interes për publikun dhe zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë. Përveç kësaj forme të përpunimit, janë të mundshme edhe përpunimet përmes diktofonëve, si incizime të zërit dhe bisedave të ndryshme të subjekteve të cilat mund të

përdoren për transmetim apo mund të ruhen për nevoja të dëshmime, qofshin ato historike, arkivore, gjyqësore, kulturore, të sigurisë, etj. Në interes të privatësisë dhe mdhp, zëri bën pjesë në korpusin e të dhp. Prandaj, operimi dhe përpunimi i të dhënave të subjekteve (qytetarëve) në këtë fushë duhet të bëhet me pëlqimin paraprak të deklaruar në formë të shkruar, apo incizuar nga ana e tyre (subjekteve të dhp), nëse me ligjet bazike të fushave specifike nuk e kanë parashikuar ndryshe. Komisioni i KE-së dhe Parlamentit të BE-së do të kontrollojë, në veçanti, “zbatimin e kësaj Direktive (Direktiva EC 95/46 e 24 Tetorit 1995, përderisa kjo ndodhet në fuqi) për përpunimin e të dhënave të zërit dhe imazhit, për paraqitjen e propozimeve të përshtatshme“, ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, (prill 2010:30, 31, 32).

Duke marrë parasysh zhvillimet e teknologjisë në këtë fushë, zhvillimi i rregullave për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhp në nivel europian dhe ndërkombëtar, është ende në zhvillim e sipër, ndërkohë që siguria dhe mbrojtja ligjore e subjekteve të të dhp përparon shumë më ngadalë se sa avancimet dhe zbulimet teknologjike, në këtë rast të pajisjeve audioincizuese.

5. 5 Dokumentet personale

Qytetarët që nga lindja deri në vdekje, në bazë të nevojave personale për identifikim, për qarkullim të lirë, për realizim të ligjshëm të të drejtave të tyre etj, pajisen me dokumente që quhen “dokumente personale”. Në një numër të madh të këtyre dokumenteve kërkohet të jepen të dhp të individëve/subjekteve, si: viti i lindjes, vendi i lindjes, emri e mbiemri, fotografia, shenjat e gishtave (gjurmët e gishtërinjve). Gjithnjë duhet pasur parasysh që në asnjë dokument nuk kërkohet që të jepen të dhëna të tepërta që tejkalojnë qëllimin e regjistrimit/grumbullimit të tyre. Në bazë të cilësisë, sigurisë së dokumentit, qëllimit të përdorimit etj, dokumentet mund t'i ndajmë në:

- letërnjoftime,
- pasaporta,
- certifikata (të lindjes, të vdekjes, martesore, të vendbanimit, të shtetësisë etj.),

- kartat e identifikimit (ID-kartat),
- librezat e lejeve të dëshmisë së shoferëve (drejtuesve të automjeteve),
- librezat (çertifikatat e automobilave) e dëshmisë së veturave,
- librezat e nxënësve dhe indekset e studentëve,
- diplomat, dëftesat, çertifikatat e nxënësve, studentëve dhe qytetarëve,
- librezat e shëndetit,
- historitë e pacientëve në spitale dhe shtëpi të shëndetit në sektorin publik dhe privat,
- kontratat e kredive, dëshmitë e pagesave, faturat e pagesave dhe dokumentet e ngjashme me të dhp,
- faturat e tatimeve,
- librat e regjistrimit dhe librat publik,
- interneti dhe intraneti,
- mediumet informative,
- fotografitë (galeritë me fotografi)
- kartelat bankare, të bankomatëve, star kartelat, kartelat e telefonave, kartelat e kompjuterëve, kartelat e programeve softuerike etj.

Në mbështetje të ndjeshmërisë së tyre, të gjitha dokumentet personale mund t'i ndajmë në:

- dokumente personale që kanë të dhëna biometrike,
- dokumente personale pa të dhëna biometrike, dhe që së fundi kanë filluar të aplikohen,
- dokumente personale me kartelë të sigurisë së lartë, përkatësisht “çipa”.

Nga institucionet që merren me prodhimin dhe përdorimin e tyre e që veçohen për nga aspekti i sigurisë dhe i së drejtës së garantimit të masave të sigurisë së dokumenteve

personale, janë organet shtetërore të sigurisë, ku hyjnë: policia, qendrat e regjistrimit civil, ministria e punëve të brendshme, konsullatat, doganat etj.

Në këto institucione dokumentet me të dhëna biometrike, siç janë: fotografia, të dhënat e gishtit dhe kartelat (përkatësisht çipat) në vetvete bartin të gjitha të dhënat sensitive të jetës së individit, konkretisht poseduesit të dokumentit. Dokumentet e këtilla janë të domosdoshme për masat e sigurisë së përgjithshme dhe punohen nga letra shumë cilësore, vula të sigurisë së lartë, me numra të serive të kombinuara dhe të zgjedhura sipas prodhuesit. Në nivel të BE-së po standardizohet prodhimi i dokumenteve personale dhe rregullimi i përdorimit të tyre po bëhet përmes ligjeve për letërnjoftime, ligjeve për amzat e të lindurve (çertifikatave) etj, konform kërkesave rregullative të legjislacionit të BE-së.

Në drejtim të unifikimit të përgjithshëm të centralizimit të dokumentacionit të të dhp në Bruksel, Europa ka bërë përparime të dukshme, duke hedhur hapat e parë në nivel botëror. Dokumentet e tilla me kartela integrale ndryshe quhen dokumente “biometrike”, për vet faktin se në to ka të dhëna biometrike të qytetarëve, dhe siguria e mbrojtja e tyre kërkon angazhime serioze. Vëmendja kryesore e mbikëqyrjes ligjore është koncentruar në ligjet e mdhp, të harmonizuara me konventat dhe direktivat respektive të KE-së dhe BE-së për ligjshmërinë e përpunimit të të dhp, për masat e sigurisë së përpunimit të të dhp, për parimet e përpunimit të të tyre, për të drejtat e subjekteve në qasje në të dhënat përkatëse, për të drejtat në transferimin e të dhp, për të drejtat për ndërlidhjen e sistemeve të dosjeve dhe regjistrimit të të të dhp etj.

Pronari që posedon pronën private e ka të ligjshme të drejtën mbi të dhënat dhe mjetet (letrat) ku janë të vendosura këto të dhëna. I vetmi person që ka të drejtën ligjore është subjekti (individi), përkatësisht kujdestari apo i autorizuari ligjor ose trashëgimtari ligjor (për fëmijët, personat me pengesa shëndetësore dhe personat e vdekur).

Zhvillimi i teknologjisë së prodhimit të letrave dhe dokumenteve me vlerë, i teknologjisë së telekomunikimit dhe dixhitalizimit të qeverisjes elektronike, njeriut ia ka lehtësuar operimin me gjithë këtë dokumentacion. Kështu, gati të gjitha operacionet, qofshin financiare, të qarkullimit të lirë, tregtare, administrative, turistike etj. kryhen përmes telefonave të “zgjuar”, duke shfrytëzuar lidhjen përmes rrjeteve të internetit.

5.6 Librat e regjistrit dhe librat publikë

Të gjitha institucionet e administratës shtetërore, institucionet shkollore, institucionet shëndetësore, në kadastër dhe gjeodezi, institucionet e sigurisë, institucionet e regjistrit civil, agjencitë e ndryshme të zhvillimit ekonomik, agjencitë e shërbimeve të ndryshme, institucionet e drejtësisë, institucionet fiskale etj, organet e sektorit privat, si: institucionet financiare, bizneset, shërbimet e avokaturave etj, mbajnë shënime të evidencave të ndryshme të punëtorëve, të klientëve që kanë marrë shërbimet nga institucionet, të debitorëve tatimorë, të studentëve, të nxënësve, të pacientëve, evidenca statistikore për qytetarët e lindur e për qytetarët e vdekur, evidenca për të kurorëzuarit, evidenca të shtetësisë, evidenca për të huajt, statistika për pasurinë individuale, evidenca të patentave për shoferët, evidenca të posedueseve të pronave të paluajtshme, evidenca nga doganat etj. Të gjitha këto shënime/regjistrime mbahen në libra që quhen libra publike dhe të regjistrit.

Nga ajo që u theksua, vetvetiu del se grupimin e të gjitha shënimeve evidentuese të qytetarëve në fushën e mdhp, për çfarëdo shërbimi qoftë, i grupojmë në dy lloje:

- librat e regjistrit,
- librat publikë.

Sot, në kohën e mundësive të mëdha të pajisjeve teknologjike, pothuajse të gjitha këto shërbime janë kompjuterizuar, janë dixhitalizuar dhe me to operohet përmes sistemeve të teknologjisë informative. Në kuptim të këtij aplikimi të teknologjisë automatike të përpunimit të të dhënave që sistemohen në regjistra e libra elektronikë të sistemeve të ndryshme të punës dhe të jetës së njeriut, mdhp sipas Konventës 108/1981, shih Konventa 108, Strasburg, (Janar 1981), dhe Direktivës EC 95/46, (1995) ka vendosur mbrojtje detyruese për shtetet anëtare të KE-së dhe BE-së, si dhe për të gjitha shtetet që aspirojnë anëtarësimin në këto mekanizma.

Librat e regjistrit edhe librat publikë tashmë, përmes pajisjeve kompjuterike janë duke u dixhitalizuar, dhe kjo formë e punës në administratë po e zëvendëson administratën klasike, duke e shtuar efikasitetin në cilësi dhe shpejtësi të kryerjes së shërbimeve, e që sot

njihet me emrin “E-qeverisja”. Në aspektin e mdhp kërkohen masat organizative dhe të sigurisë, të njohjes së teknologjisë dhe të procedurave të punës konform kërkesave të standardeve të sigurisë për mdh “ISO 27001, ISO 27002, duke siguruar ruajtjen, besimin, integritetin dhe aksesin në informata” (Bilić & B 2012:6).

5.6.1 Librat e regjistrimit, kryesisht janë libra të regjistrave, regjistrimeve, të hyrjes dhe daljes nga ndërtesat, regjistrimeve të shërbimeve të përkohshme për kryerje të një pune operationale etj, p.sh. regjistri i poseduesve të telefonave të punëtorëve, të ndërmarrjes për nevoja të brendshme të institucionit, regjistri i nxënësve të klasës që shërben për punën me nxënës (ditari), regjistri i policëve të një stacioni policor që shërben për nevoja të brendshme të institucionit, regjistri i të gjithë klientëve në hotel që shërben për nevoja të hotelierisë dhe shërbimit në interes të klientit dhe interesit të vetë ndërmarrjes hoteliere, regjistri i të gjithë vizitorëve që kanë hyrë në ndërtesë të një institucioni publik për shërbime të caktuara që institucionit i shërben për nevoja të sigurisë, regjistri i të gjithë klientëve që kanë marrë shërbimet e fluturimit në linja të ndryshme nga aeroporti etj.

Këto shërbime që vendosen nëpër evidenca të ndryshme të regjistrimit, përmbajnë të ashtuquajturin “libër të regjistrimit”, i cili mund të jetë edhe në formë elektronike.

Në përputhje me mdhp, të gjithë këta regjistra që shërbejnë si regjistra të hyrje-daljeve nëpër ndërtesa në sektorin publik dhe privat ndryshe quhen “Regjistrime të hyrje-daljeve në ndërtesa”. Afati i ruajtjes së këtyre shënimeve është i rregulluar me ligj nga çdo shtet në përputhje me rregullat e mdh dhe privatësisë. Ligji i Kosovës këtë afat e ka të rregulluar deri në 3 vjet, dhe pas këtij afati të gjitha shënimet duhet të fshihen ose shkatërrohen, nëse me ligj nuk është parashikuar ndryshe, ligji për mdhp i Republikës së Kosovës (prill 2010:34).

Formati i përmbajtjes së shënimeve të këtyre regjistrave është i rregulluar me ligjet respektive të shteteve, që rregullojnë sasinë e shënimeve që mund të kërkohen nga personat për aksesin e tyre në rastin e hyrje-daljes nga ndërtesat. Kjo dispozitë ka për qëllim mdh, duke synuar që të hidhen sa më pak të dhë nëpër regjistra.

5.6.2 Librat publikë janë të gjithë libra të institucioneve të cilat janë themeluar për ushtrimin e veprimtarisë publike në sektorë të ndryshëm dhe funksionin e tyre e kryejnë

në përputhje me ligjin në fuqi dhe kushtetutën, në interes të publikut dhe jetës së qytetarëve.

Ata janë pjesë e punës së këtyre institucioneve, si p.sh. Libri i Regjistrimit Civil të Shtetit është libër publik; forma, ruajtja, përmbajtja e të dhp etj, janë të rregulluara me ligjin organik të Regjistrimit Civil. Gjithashtu, fushat e ndryshme, si: arsimi, shëndetësia, gjeodezia, sistemi fiskal, administrata, telekomunikacioni, sistemi i adresave, sistemi bankar etj, me ligjet e tyre specifike e kanë të rregulluar fushën e të dhp në atë mënyrë që ato (të dhp në këto fusha) mund të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë grumbulluar ose janë përpunuar, nëse qëllimi ligjor i grumbullimit dhe përpunimit të tyre është i përcaktueshëm, pa u përdorur për qëllime tjera.

Librat publikë si dokumente bazike shërbejnë për nxjerrjen e dokumenteve për nevoja të ndryshme të qytetarëve, si në rast të humbjes së dokumenteve të lëshuara origjinale, në rast të nevojave për verifikim të vërtetësisë së dokumenteve dhe kryerjes së veprimtarive me interes për subjektin (individin), sipas kërkesës ligjore nga organet e sigurisë, gjyqësisë etj.

Me arritjet e reja teknologjike librat publike në shumë sisteme e sektorë publikë dhe privatë janë dixhitalizuar, dhe si të tilla mund të ruhen me mjaft siguri në periudha afatgjata, të rregulluara me ligjet mbi arkivat për lëndën arkivore dhe ligjet respektive specifike të institucioneve poseduese të librave publikë, në të dy sektorët (publik dhe privat).

5.7 Interneti dhe intraneti

Mundësia jashtëzakonisht e madhe e komunikimit përmes teknologjisë komunikuese ka hapur një kapitull të ri të zhvillimeve të reja për të mirën e njerëzimit në të gjitha fushat e jetës, duke i dhënë botës një qasje krejtësisht të re, me nevojën e perceptimeve të reja në funksion të zhvillimeve shkencore, socio-teorike në nivel global.

Kjo periudhë me të drejtë quhet “epoka e kompjuterizimit dhe internetit”. Interneti është një lidhje nacionale, rajonale dhe më gjerë e rrjetëzuar e shfrytëzuesve të internetit

(shfrytëzues-shfrytëzues) që lidhen në gjithë botën. Përmes lidhjeve-rrjeteve të këtilla mund të barten të gjitha të dhënat që ndodhen në një kompjuter. Përmes internetit mund të kryhen një mori shërbimesh, si posta elektronike. Që nga viti 1991 shërbime të tilla u mundësua të ofrohen përmes një faqe të quajtur “world wide web (www), e cila për herë të parë u paraqit në një konferencë të hulumtimeve nukleare në Gjenevë në vitin 1989, sipas të cilës përmbledhjet e dokumenteve mund të përktheheshin përmes një serveri të internetit në gjuhën e HTML, e cila paraqet një metodë të rrjetëzimit të informatave“, botimi i Kolegjit Universitar, “Mediat dhe komunikimi“, “Faik Konica, Prishtinë, (2006-2007:60).

Se sa rëndësi ka ndihp në fushën e internetit e kuptojmë më së miri kur flasim për rrezikun e thyerjes së fjalëkalimeve dhe ndërhyrjet e paligjshme në web faqe të ndryshme përmes hakerëve dhe dërgesave virusale. Në referim të artikullit: “Hakerët rusë vjedhin të dhënat e gjysmës së përdoruesve të internetit në botë” thuhet: ”Një grup hakerash nga Rusia kanë vjedhur më shumë se 1.2 miliard të dhëna të profileve të ndryshme në internet. Sipas llogarive janë prekur pothuajse gjysma e përdoruesve të internetit në botë,... Kjo u bë e mundur pas një problemi në sigurinë e serverëve të të dhënave. Të dhënat e vjedhura janë nga 420.000 website.”²⁰

Nga sa u tha më lart, kuptojmë se veç të mirave që në fakt ofron rrjetëzimi i komunikimit në internet, kur kemi të bëjmë me sigurinë e të dhp dhe dëmet që mund të shkaktohen, ne ballafaqohemi edhe me vjedhjet e të dhënave tona nga ndërhyrjet e paligjshme ku ne duhet të mësojmë se si të mbrohemi. Në vazhdim do të flasim për masat e sigurisë në internet. Kjo mundësi e vendosjes së informatave në nivel global në të ashtuquajtura “toka e përbashkët” dhe “re kompjuterike” mundësoi që çdo e dhënë e individit të jetë e arritshme në secilin cep të rruzullit tokësor, nëse nuk do të kishte rregulla të sakta të sigurisë në teknologji informative dhe përpunim të ligjshëm, të mbrojtur dhe të kontrolluar për të dhp dhe privatësinë e individit gjatë përpunimit kompjuterik dhe të automatizuar të të dhënave.

²⁰<http://www.dw.de/hakerat-rusët-vjedhin-të-dhënat-e-gjysmës-së-përdoruesve-të-internetit-në>

botë, Rubrika e web faqes së Dojce Weles, FOKUS/SHKENCE dhe EDUKIM, (shikuar, 7, gusht, 2014

Ndërsa, një përdorim i rrjetëzuar i brendshëm për nevoja të brendshme të një institucioni, të një ndërmarrjeje, të një sistemi operativ e që është i kontrolluar nga Host–Server, që ka një produkt të caktuar dhe standard pune dhe që është vendosur për nevoja të brendshme të institucionit quhet ndryshe intranet.

Edhe këtu vlejnë të gjitha masat dhe nevojat e domosdoshme të aplikimit të rregullave të ligjshmërisë së përpunimit dhe operimit me të dhp konform standardeve ligjore të KE-së dhe BE-së për mdhp dhe privatësisë. Një lidhje telefonike, hapja e një adrese elektronike, një kompjuter dhe një klikim në një web faqe sot i mundëson njeriut që të ketë komunikime direkte, apo të gjejë dhe të shpërndajë informata të pakufishme (të shkruara, foto, audio, video incizuese e filmime) me fuqi prej miliona giga bajt-ëve, në secilën pikë të globit, dhe pikërisht ky është fokusi kryesor i interesit global. Bashkimi i njerëzimit për mbrojtjen e individit nga ndërhyrjet e mundshme në jetën e tij private, i cenuar nga ky zhvillim marramendës i teknologjisë së komunikimit njerëzor.

5.8 Mediumet informative

Pashmangshëm rrjedhave dhe progresit të përgjithshëm teknologjik mund të shihet në ndërvlerësi edhe zhvillimi i mediave në nivel global. Në referim të këtij konstatimi qëndron mendimi se: “Shoqëritë mund të përparojnë shpejt ose ngadalë, por drejtimi i progresit nuk është në pikëpyetje. Kështu progresi teknologjik është një rrjedhë e pashmangshme e ngjarjeve” (Memia 2010:134)

Duke mos qenë prioritet aspekti i konsiderimit të privatësisë, por vetëm shpejtësia e komunikimit dhe marketingut agresiv, në shumicën e kompanive të mëdha është krijuar “marrëdhënie e vështirë midis praktikave të privatësisë dhe komunikimit të privatësisë dhe kjo bëhet e qartë kur shihen kompanitë që kanë kaluar nëpër skandale të privatësisë”, (Gutwirth 2012:240), si psh. British Telekom Britani, faqet sociale në Spanjë, Francë, Itali, Holandë, Gjermani, Belgjikë etj, ku gjobat ishin me shuma prej disa milion eurosh.

Shumë kompani, në përpjekje për të përmirësuar imazhin e tyre, kanë kontraktuar dhe ngritur “departamente të tëra që të pastrojnë reputacionin, pavarësisht efikasitetit të këtyre

masave” (Gutwirth 2012:240), veçmas për ruajtjen e besimit mbi klientelën e subjekteve të të dhp, që është me interes jetik për vetë afarizmin dhe suksesin financiar të kompanive.

Rol të rëndësishëm në këtë drejtim, sidomos në raportet mes praktikave të privatësisë dhe komunikimit të privatësisë, luajnë padyshim ndërtimi i raporteve të informimit dhe marketingut të mdhp në të gjitha zhanret e masmediave.

Në kohën tonë të postmodernizmit dhe në kushtet e zhvillimit të globalizmit, përfaqësuesi eminent i shkollës së Çikagos, Wirth, në mes viteve të 50` dhe 60` të shekullit 20, lidhur me diversitetin kulturor të zhvillimit njerëzor; shtron pyetjen se cili vektor do t`i bashkojë njerëzit lidhur me këtë çështje? Përgjigjja del se “vetëm nëpërmjet të komunikimit masiv” (Dhima 2010:390, 391).

Wirth kishte dalluar 5 karakteristika të masës njerëzore për ta “përçar vlerën emblematike”, respektivisht idenë rreth të cilës mund të bashkoheshin masat nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv. Mediumet informative janë dritare apo mjete pune, përmes të cilave mund të jepet apo merret një informacion dhe në varësi të mjetit të përdorur për vendosjen e informacionit, ato mund të ndahen në:

- medime të shkruara “Gazetaria e shkruar”,
- medime radiofonike “Radio gazetaria”,
- medime radiovizuele “Radio televizionet”,
- komunikim elektronik “Multimediat dhe mediat online”.

5.8.1 Mediumet e shkruara “Gazetaria e shkruar”Medime të shkruara quhen të gjitha ato media informative të cilat informacionin, komentin, raportin apo mesazhin për opinionin publik e japin në formë të shkruar apo përmes gazetës ose revistës, portaleve apo mesazheve të pajisjeve të telekomunikacionit. Çdoherë, hedhja e mesazhit në media të shkruara ka për qëllim që të informojë qytetarin dhe të ushtrojë ndikim të lexuesi për të vënë në fokus qëllimin ose dukurinë përmes ngjarjes së zhvilluar, e cila shtjellohet në faqet e shtypit nga autorët e shkrimeve.

Respektimi i rregullave të shkrimit (raportimit) në gazeta përcillet përmes autoriteteve të ndryshme të themeluara nga institucionet që kanë emërtime të ndryshme, si: komisione të pavarura për media, komisione të shoqërisë së informacionit, komisioner për informim etj. Të gjitha këto grupe, qofshin të ngritura nga institucionet shtetërore, apo edhe nga grupime të shoqatave të gazetarëve dhe shoqërisë civile, kanë për qëllim që të shtrijnë aktivitetin e vet në përputhje me ligjet e shkruara për informimin dhe kodin e gazetarisë.

Duke nxituar për nxjerrjen e lajmit shpesh ndodh që të shkelen rregullat dhe, sa i përket privatësisë së individit dhe sigurisë së të dhënave të tij personale, lëndohet seriozisht dinjiteti i subjektit të të dhënave (qytetarit), si; p.sh. në përpjekje për të vënë në pah dukurinë sociale si të rëndë, nxirren foto të fëmijëve, duke shtrirë dorën si lypës, pa e mbuluar fytyrën e tyre, shfaqen foto të personave të arrestuar, foto duke u lidhur në pranga nga policia, foto të personave në forma të ndryshme pa paralajmërimin dhe pëlqimin e tyre, emra e mbiemra të personave të akuzuar (ende pa përfunduar procesi gjyqësor), emra e mbiemra të personave me sëmundje ngjitëse, me sëmundje të rënda etj. Të gjitha këto dukuri dhe shkelje të privatësisë së individit dhe të dhp të tij janë të dënueshme me ligjin përkatës, të dënueshme me Direktivën Evropiane për mdhp dhe privatësisë, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut.

Në respektim të interesit publik mund të ketë përjashtime, por specifikimi është shumë i qartë: kur dhe në çfarë rastesh mund të lejohen raportimet e tilla që e tejkalojnë ligjin dhe përdorimin e të dhp, që është i rregulluar edhe me dispozitat e ligjeve të mdhp. Por, kufizimet janë shumë strikte. Ligji i Kosovës për MDhP03/L-172, nga gjithsej 96 dispozita ligjore dhe tetë kapituj, ka përjashtime për mediat vetëm në katër nene (16,17,18 dhe 20), ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, (prill 2010 2010:4) dhe në kapitullin V, ku bëhet fjalë për transferimin e të dhp, ligji për mdhp i Republikës së Kosovës (prill 2010:4), ndërkajq të gjitha dispozitat tjera janë obligim për t'u zbatuar nga sektori medias.

Përveç interesit thelbësor të informimit dhe zhvillimit të industrisë së informacionit modern në shoqërinë njerëzore, të lirë dhe demokratike, “Mediat si segment i rëndësishëm i formësimit të qëndrimeve të qytetarëve, duhet të tregojnë shkallë të lartë të përgjegjësisë për fjalën e shkruar dhe të thënë, e cila duhet t'i nënshtrohet kritikës publike, por edhe sanksioneve, në rast se i tejkalojnë kufijtë e informimit të lirë dhe bëjnë thirrje për dhunë

dhe urrejtje”, botimi i Kolegjit Universitar, “Mediat dhe Komunikimi“, “Faik Konica, Prishtinë (2006-2007:42), dhe shkelje të etikës së punës me rastin e cenimit të dinjitetit të njeriut, privatësisë së individit dhe të dhp.

5.8.2 Mediumet radiofonike“Radio gazetaria”Shtëpitë informative radiotransmetuese janë në funksion të përçimit të informacionit në drejtim të qytetarëve dhe subjekteve të tërësishme të shoqërisë, dhe mesazhi i tyre për pranuesin drejtohet nga qendrat (stacionet) radiotransmetuese në formë radiofonike (përmes zërit).

Prodhimi i informacionit bëhet nga gazetarët dhe ekipet profesionale të lidhura në mënyrë specifike (duke qenë njohës) me fushën e radio-gazetarisë. Zhvillimi i përgjithshëm i mundësive komunikuese ka rritur jashtëzakonisht mundësitë e kësaj fushe, e cila përmes internetit me shpejtësi marramendëse në kuptimin e informimit online, radio-internetit, telekomunikacionit etj, jep dhe merr informacione radiofonike nga secili skaj i globit, duke dhënë kështu kontributin për të informuar për ngjarje, aktivitete dhe zhvillime të përgjithshme të njerëzimit dhe dukurive të ndryshme. Informacioni dhe lajmi në radio-gazetari ka hapësirë të kufizuar, si: opinionin, komentin apo kronikën në gazetarinë e shkruar dhe “që në momentin kur lajmi dyzohet, d.m.th vendoset a kërkohet një mundësi tjetër, kur dihet se lajmi është lloji më i shkurtër i gazetarisë” (Memia 2010:169), në këtë pikëpamje njohja e normave dhe respektimi i sjelljeve në frymën e etikës profesionale, duke respektuar dinjitetin e individit, janë obligim për kujdesin ndaj privatësisë së subjektit të të dhënave, në rast se të dhënat e tij janë pjesë e përpunimit gjatë krijimit dhe transmetimit të informacionit.

Mirëpo, si në gazetarinë e shkruar, edhe këtu, shpeshherë, në përpjekje të prodhimit të “superlajmit”, “lajmit sensacional”, gazetarët shpesh e shkelin etikën e gazetarisë, duke bërë shkelje në rregullat që i mbrojnë të dhp dhe sigurinë e tyre të privatësinë, me publikimin e informacioneve të ndjeshme dhe të tepërta për individin (subjektin) gjatë transmetimit të informatës së tyre, duke tejkaluar kështu edhe qëllimin e grumbullimit dhe aspektin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhp.

Teknika transmetuese në radio-gazetari nuk nxjerr pamje të imazheve të individit dhe ngjarjeve në formë të fotografisë së transmetuar. Gjithçka që jepet përmes këtij zhanri informativ shkon vetëm përmes zërit.

Zëri është e dhp që specifikisht lidhet me individin dhe duke qenë unik, hyn në grupin e të dhënave të ndjeshme. Para realizimit të intervistimit ose vërtetësisë së informacionit të cituar përmes zërit të subjektit, gazetarët duhet të marrin pëlqimin nga të intervistuarit për përdorimin e diksionit akustik të transmetimit të informacionit të incizuar. Shpjegimet më të hollësishme rreth zërit si e dhp janë dhënë në kapitullin e tretë të Direktivës 95/46 të KE-së.

5.8.3 Mediumet radiovizuale “Radio televizionet” Zbulimi i teknologjisë për transmetimin e fotografisë bashkë me zërin i dha njerëzimit impuls të madh në zhvillimin e epokës, duke pasur parasysh se shoqëria njerëzore moderne e industrializuar sot është e paimagjinueshme pa zhvillimin dhe zbulimin e televizionit.

”Që nga transmetimi i parë televiziv” (25 prill 1925), “nga skocezi Xhon Lordz Berdi”, (Bicaj 2000:114), për një periudhë të shkurtër kohore (ende pa e kapërcyer një shekull), me zhvillimin e internetit, televizionit i mundësohet përcjellja e fotografisë dhe e zërit dhe shikimi, ruajtja e informacionit dhe riciklimi i saj mund të bëhet 24 orë “online”. Racionalizimi i shpenzimeve në investime, cilësia e përmirësuar, sistemi kabllor i shpërndarjes së rrjetit televiziv bashkë me internetin, mundësia e kontrollit të të gjitha “hosteve”, apo “aparateve të ekraneve transmetuese”, kudo që ndodhen ato, nga qendrat transmetuese të radio televizioneve, lidhur me shikueshmërinë, lidhur me anketimet dhe arsyeshmërinë e prodhimeve televizive, mundësia që të dihet saktësisht se sa aparate televizive janë të ndezura, ku janë ato dhe cilin program e shikon qytetari. Kjo mundësi e ndërhyrjes kaq thellë deri te “dhoma e gjumit”, ka ngritur shqetësimin e komunitetit njerëzor se privatësia e individit është tej mase e rrezikuar, me këtë edhe e drejta thelbësore e dinjitetit dhe e personalitetit të tij, e cila cenohet në mënyrë të vrazhdë dhe arbitrare.

“Publikimi i fotove apo artikujve në fjalë, qëllimi i vetëm i të cilëve është të kënaqin kuriozitetin e një kategorie të caktuar lexuesish në lidhje me jetën private” (Pradel &

Corstens 2010:229), të subjektit të të dhp që shtypi e ka atakuar, konsiderohet shkelje e nenit 8 (tetë) të KEDNj. Prandaj, përgjigjen në mdhp dhe privatësisë së individit e jep Konventa 108/1981 mbi mdhp gjatë përpunimit automatik të dhënave. Konventa (108) gjen zbatimin direkt në Direktivën 95/46 të vitit 1995, e cila aktualisht zbatohet në ligjet detyruese për mdhp në shtetet e BE-së dhe shtetet që pretendojnë anëtarësimin në këtë mekanizëm. Në këtë pikëpamje, duke rregulluar përpunimin e ligjshëm të të dhp, të drejtën e subjekteve të të dhp, detyrimet e kontrollueseve të të dhp, të drejtën e qasjes në të dhp, të pamundësohet dhe të minimizohet mundësia e keqpërdorimit të të dhp. Në këtë rast duhet të shmangen edhe keqpërdorimet e të dhënave nga gazetaria televizive.

Transmetimi i fotografive të personave në proceset gjyqësore dhe në fazat e hetuesisë gjatë arrestimeve të fëmijëve me kushte të rënda sociale, të qytetarëve me sëmundje të ndjeshme mund të përbëjë “lajm” komercial për shtëpinë informative, por, në asnjë rrethanë nuk përkojnë me etikën e gazetarisë dhe nëse me ligje specifike nuk janë parashikuar format e nxjerrjes së këtyre fotove, atëherë konsiderohet se është cenuar siguria e të dhp dhe janë shkelur dispozitat ligjore të mdhp të parashikuara në ligj. Në këtë rast subjekti ka të drejtë të kërkojë mbrojtje ligjore për shkeljen dhe abuzimin me të dhp.

5.8.4 Komunikimi elektronik “Multimediat dhe mediat online” Mundësia e komunikimit bashkëbisedues në faqe të ashtuquajtura “facebook”, “messenger”, “google”, “hotmail”, “twitter“, “instagram“ etj, transmetimi vizual, audiovizual, i formës së shkruar nga një kompjuter qendror në shumë kompjuterë të rrjetëzuar, nga një telefon celular në tjetrin, në gjithë hapësirën botërore e ka ndryshuar formën klasike të informimit. Kështu kufijtë në mes të komunikimit individual dhe atij masiv kanë filluar të zhduken, dhe mundësia e komunikimit të “dixhitalizuar” dhe formave të informimit nga “online” në format “offline” po japin mundësi të re komunikimi dhe informimi që quhet “komunikimi elektronik ose multimediat”.

Prandaj, multimedia është nocioni kryesor për shumë produkte dhe shërbime të reja kompjuterike dhe të telekomunikacionit që përdoren në media. Këto shërbime të këtyre produkteve të përbashkëta kanë si veçori në vete përdorimin interaktiv, përdorimin integruar dhe përdorimin dixhital, botimi i Kolegjit Universitar, “Mediat dhe Komunikimi”, “Faik Konica, Prishtinë (2006-2007:59)

Portalet e hapësirave të shfrytëzuara në këtë komunikim për botën e të dhp dhe privatësinë paraqesin një sfidë të re në aspektin e mbikëqyrjes ligjore të përpunimit dhe përdorimit të të dhënave të qytetarëve. Por, një fakt është gjithnjë në anën e mundësisë së kontrollimit dhe menaxhimit, kundër abuzimit dhe keqpërdorimit, duke ditur se gjithmonë zotërues i këtyre shpikjeve është vet njeriu. Po kështu, vet njeriu është në epiqendër të funksionalizimit të sigurisë dhe rregullave për mdhp dhe të privatësisë, e cila bazën e ka thellësisht në legjislacionin e të drejtave të njeriut që nga DUDNJ e OKB-së e deri te aktet e tanishme ligjore të KE-së dhe BE-së që i përkasin kësaj fushe të ndërlidhur ngushtë me internetin. Kjo formë moderne e informimit masiv në kohën e zhvillimit marramendës të internetit, sipas Gëzim Mekulit (2006) mund të përkufizohet kështu: “Mediat masive janë organizata dhe teknologji të cilat prodhojnë dhe shpërndajnë porosi, në mënyrë që sa më shumë pranues të mbulohen në mënyrë të njëjtë, mundësisht edhe në kohë të njëjtë” (fq.13).

Prandaj viti 2018 do të sjellë akoma më shumë fuqi ligjore dhe siguri për mdhp, veçanërisht në internet dhe kundër abuzimeve dhe keqpërdorimit të të dhënave në internet. Në vitin 2013 është themeluar Autoriteti nga Komisioni i Këshillit dhe BE-së me seli në Bruksel, i cili ka marrë mandatin për hartimin dhe sjelljen për aprovim para Komisionit dhe Parlamentit, të kornizës ligjore kundër krimit dhe abuzimit në internet në vitin 2018, marrë nga web faqja e KE-së, Parlamentit dhe Komisionit të të BE-së, (26 gusht 2013). Tashmë të gjithë komisionerët dhe autoritetet e mdhp në web faqet e tyre zyrtare kanë publikuar format e këshillave dhe rekomandimeve për mbrojtjen e fëmijëve dhe përdoruesve të internetit nga mundësia e keqpërdorimit dhe abuzimit nga keqpërdoruesit e ndryshëm gjatë komunikimit, gjatë vjedhjeve të identitetit, ndryshimit të identitetit dhe publikimit të imazheve abuzuese të individëve. Të gjithë kanë ofruar mundësitë për orientim të të rrezikuarve drejt këtyre organeve të autorizuara dhe të mandatuara me kushtetutat dhe ligjet e mdhp në shtetet respektive, nënshkruese të Konventës 108/1981, adaptuese të Direktivës 95/46, të vitit 1995 dhe të gjitha shteteve aspiruese për anëtarësim në BE.

KAPITULLI VI: FUSHËVEPRIMTARIA E ORGANEVE QË PËRPUNOJNË TË DHËNA PERSONALE DHE ASPEKTE KRAHASUESE NË RAJON

6.1 Njohuritë bazike mbi fushë e veprimtarisë së organeve që përpunojnë të dhp

Përdorimi i të dhp shtrihet në secilën fushë të punës dhe jetës së njeriut. Përdorimin e të dhp e hasim edhe në sektorin publik, edhe në atë privat. Të dhp i përdorim edhe në jetën politike, sindikale, fetare, publicistike, shkencore, në statistika, në veprimtaritë shërbyese, për nevoja shëndetësore, arsimore, personale etj. Secila fushë i ka specifikat e veta, ka qëllimin e grumbullimit, bazën ligjore të përdorimit të të dhënave, sigurinë gjatë përpunimit, rregullat e operimit me të dhp, afatet e përcaktuara për ruajtjen e tyre, marrëdhëniet kontraktuale me kontraktorët dhe nënkontraktorët për kryerje të shërbimeve në interes të kontrollorit etj. Secili kontrollor është i detyruar që ta mbajë të njoftuar subjektin e të dhp për përpunimin e të dhënave të tij, me të drejtat ligjore që i ka, për; përditësimin, shtimin, korrigjimin, fshirjen, bllokimin, shkatërrimin, ndërprerjen e përkohshme të përpunimit dhe ndërprerjen e përhershme të përpunimit. Kujdesin kushtetues-ligjor lidhur me mbikëqyrjen e ligjshmërisë dhe sigurisë së përpunimit të të dhp, mbi bazën e kornizës juridike të KE-së dhe të BE në Europë, e kanë autoritetet e mdhp të emërtuara si: komisioner, drejtor, mbikëqyrës kryesor shtetëror për mdh, kryetarë, avokat i popullit, inspektor për mdhp dhe të privatësisë etj, të cilët udhëheqin dhe menaxhojnë institucionet e mdh në shtetet respektive.

Në nivel European është themeluar Komisioneri European për MDhP dhe Grupi i Punës, sipas Artikullit, 29 shih Direktiva 95/46 e KE-së, e Parlamentit European dhe Këshillit, (1995:36), e përbërë nga përfaqësuesit e autoriteteve të mdhp të shteteve anëtare të Këshillit të Europës. Ka edhe autoritete të mdh në Europë që kanë ngjashmëri në mes tyre në ushtrimin e rolit që ato luajnë, por, gjithashtu, demonstrojnë edhe diferenca të caktuara. Dallimi kryesor është se; disa nga këta autoritete veprojnë sipas modelit “ombudsmen”, ndërsa shumica e të tjerëve veprojnë sipas modelit “regulation” (autoritetet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit të mdhp), (Kunere 2012:14).

Me këtë qasje të KE-së në lidhje me ndërtimin e institucioneve të mdhp, mungesa e interesit të klientit (subjektit të të dhp) lidhur me mbrojtjen e privatësisë dhe të dhp, që quhej “macja dhe miu në atmosferë” (Gutwirth & Leens 2012:240), ka filluar të përmirësohet, dhe adresimi i shqetësimeve dhe shkeljeve ligjore tashmë bëhet përmes Gjykatës së Strasburgut për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut. Mbrojtja e lirisë së të dhp po vijon në binarë të sigurt, për faktin se siguria e të dhënave dhe privatësisë po e dominon debatin në ShBA, Europë dhe rajon. Jemi dëshmitarë se gjatë vitit 2015-2016 një debat i fuqishëm lidhur me përgjimet ndodhi në Maqedoni, ndërsa me javë të tëra opozita organizoi protesta të fuqishme ku qeveria u detyrua të çojë vendin në zgjedhje, kurse aspektet e cenimit të sigurisë u shtrinë në; sigurinë ekonomike, sociale, shoqërore e shtetërore.

Ky fenomen e atakoi edhe Shqipërinë ku publikisht shpërthyen informacione në portale lidhur me përgjimet e paligjshme të bëra nga shërbimet e jashtme, sipas Tv klanit “Merkel pyetet për përgjimet në Shqipëri”. “Der Spiegel” në një artikull në variantin online citoi të dhëna konfidenciale të BND-së, ku konstatohej se; “Shqipëria ishte nën përgjim që prej vitit 2009, para dhe pas anëtarësimit në NATO”, thuhet në këtë artikull.²¹ Ndërkaq në artikullin “Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar” nga “Zëri i Amerikës” shohim se nga presioni i opinionit publik në Kuvendin e Shqipërisë, “Komisioni parlamentar i sigurisë zhvilloi sot një seancë dëgjimore me drejtues të institucioneve kryesore mbi dyshimet nëse janë kryer apo jo nga policia përgjime të paligjshme telefonatash të politikanëve në kryeqytet”²². Faktet flasin për rëndësinë e aktit të sigurisë dhe aktorëve për sigurizimin dhe mdhp, duke ndërmarrë aktin e ligjërimit, si masë parandaluese. Në vazhdim do të flasim për njohuritë bazike të institucioneve që merren me mdhp.

6. 2 Institucionet e mdhp (Aspekte krahasuese)

²⁰ <http://tvklan.al/merkel-pyetet-per-pergjimet-ne-shqiperi/>, shikuar më 20.05.2016, ora 20.00 h .

²² <http://www.zeriamerikes.com/a/visho-ajazi-saimir-tahiri-pergjimet/3335627.html>, 20.05.2016, ora 20.00h.

Institucionet e mdhp janë institucione administrative që mbikëqyrin zbatimin e ligjit për mdhp, janë të pavarura dhe burimin konstitucional të ndërtimit të tyre e kanë në kushtetutat e shteteve ku veprojnë ato. Dispozitat kushtetuese të shteteve anëtare të BE-së dhe KE-së si dhe ato jashtë kësaj hapësire, por që e aspirojnë anëtarësimin në BE, kanë adaptuar dispozita të veçanta për mbrojtje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Gjithashtu, janë vendosur edhe dispozita të veçanta për mbrojtjen e privatësisë dhe sigurinë e të dhp, veçmas me Direktivën 95/46 dhe Konventën 108 të mdhp gjatë përpunimit automatik të dhp. Për autoritetet kombëtare (shtetërore) të mdhp kërkohet respektimi i pavarësisë së plotë institucionale dhe mosndërhyrje në pavarësinë dhe punën e këtyre organeve, gjithnjë në interes të forcimit të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të privatësisë së subjekteve të të dhp. Prandaj, sipas GJEDN, “ . . kuptimi ‘pavarësi të plotë’ duhet interpretuar në dritën e pavarësisë së EDPS (European Data Protection Supervisor), siç përcaktohet në Rregulloren e institucioneve të BE-së të mdhp” European data protection law, botimi i European Agency for Fundamental Rights, Council of Europe in Belgium (2014:116)²³

Institucionet e mdhp janë autoritete mbikëqyrëse kombëtare (shtetërore), dhe me “Mbikëqyrje” nënkuptohet ndjekja me kujdes e përpunimit të të dhp nga të gjithë kontrolluesit dhe përpunuesit nëpërmjet bashkëpunimit, kontrollit, hetimit administrativ dhe inspektimit, për parandalimin e shkeljeve dhe, kur ka vend, edhe vendosja e sanksioneve administrative për të siguruar zbatimin e urdhrave, të udhëzimeve dhe rekomandimeve të autoritetit mbikëqyrës, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në këtë rast, privatësinë dhe të drejtat personale të individit.

Në funksion të respektimit të privatësisë, më së miri do të qëndronte konstatimi i mendimtarit Richard Perle: “Qytetarët që i binden ligjit e çmojnë privatësinë.....” ²⁴ [https://www.google.com/search? Sourceid =navclient&ie=UTF-](https://www.google.com/search?Sourceid=navclient&ie=UTF-)

²³ Handbook on European data protection law, European Agency for Fundamental Rights, 2014.Council of Europe, 2014; Luxemburg Publikations Office of the European Union, Printed in Belgium, 2014, faqe 116.

²⁴ Studiuesi i Shquar Amerikan i ditëve të sotme i të drejtave të njeriut, i luftës kundër terrorizmit dhe studiues i denjë i funksionimit të administratës, Perle, me rastin e shpjegimeve të tija në respektim të ligjit dhe luftës kundër terrorizmit, thot se: qytetarët që i binden ligjit e respektojnë privatësinë; kurse terroristët kërkojnë padukshmëri ndërsa, këta nuk janë të njëjtë dhe nuk duhet të ngatërrohen.

8&rlz=1T4ADFA_en__487__488&q, aksesuar, 19 prill 2016, 18.00 h. Të gjitha shtetet që kanë autoritete të ngritura për mdhp i kanë edhe ligjet e veçanta dhe zbatimi i tyre mbikëqyret nga autoritetet respektive. Ligjet e mdhp janë të përshtatura në përputhje të plotë me Direktivën, aktuale, EC 95/46 të KE-së të vitit 1995 dhe hap pas hapi, duke ndjekur zhvillimin e legjislacionit Europian, bëhet edhe plotësimi i legjislacionit vendor. Në vazhdim po e japim një pasqyrë tabelare të nxjerrjes së kuadrit ligjor dhe ngritjes së autoriteteve kombëtare të mdhp me nuancat e tyre organizative dhe numrin e të punësuarve në tet shtete të rajonit.²⁵

/Shteti / Autoriteti /Tipi i organiz. /Ligji i Aprov. /Nr.i të punës./

Kosova	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Agjenci me Organ kolektiv të udhëheqjes Viti i ngr. 2011	Në vitin 20110	23
Shqipëria	Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Komisioner me Organ individual Viti i ngr.2008	Në vitin 2008	33
Mali i Zi	Agjencia	Agjenci me	Në vitin 2008	26

²⁵**Vërejtje sqaruese:** Autoriteti i Sllovenisë dhe Serbisë menaxhojnë edhe me Ligjin mbi Informacionin, ndërsa autoriteti i Malit të Zi dhe ai i Shqipërisë (nga v.2015) tani menaxhojnë edhe me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike (zyrtare). Ndërsa të gjitha autoritetet tjera të renditura në këtë tabelë menaxhojnë vetëm me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Para se të vijmë te shpjegimi i fushave dhe kompetencave të organeve të cilat merren me përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale, paraprakisht po japim një pasqyrë krahasuese të kuadrit kushtetues dhe ligjor të disa shteteve të rajonit dhe më gjerë, për t'u orientuar më lehtë te fusha e veprimtarisë së mdhp të autoriteteve kompetente për mbrojtjen e të dhënave.

	Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave	organ kolektiv Viti i ngr.2007		
Maqedonia	Drejtoria Shtetërore e Mbrojtjes së të Dhënave Personale	Autoritet me udhëheqje individ Viti i ngr. 2005	Në vitin 2005	27
Kroacia	Agjencia e Mbrojtjes së të Dhënave Personale	Autoriteti me udhëheqje individuale Viti i ngr. 2003	Në vitin 2003	37
Bullgaria	Komisioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Autoriteti ka dy shkallë të organizimit, është organ i udhëheqjes kolektive Viti i ngr. 2002	Në vitin 2002	86
Serbia	Komisioner për Informim dhe Mbrojtjen e të	Autoriteti është organ me udhëheqje	Në vitin 2007	76

	Dhënave Personale	individuale Viti i ngr. 2007		
Bosnja - Hercegovina	Agjencia Shtetërore e Mbrotjtjes së të Dhënave Personale	Autoriteti është organ me udhëheqje individuale Viti i ngr. 2008	Në vitin 2008	40
Sllovenia	Komisioneri për Informim	Autoriteti është organ me udhëheqje individuale Viti i ngr.1997	Në vitin 1997	30

6.3 Krahasset kushtetuese

Gjatë analizës dhe krahasimit të kushtetutave të ndryshme të shteteve të dispozitat e privatësisë dhe mdhp, duke shikuar të dhp dhe autoritet që merren me mdhp në prizmin e kategorizimit kushtetues, vërejmë se:

Kushtetuta e Kosovës në nenin 36 e garanton të drejtën e privatësisë në 4 paragrafë:

“Çdokush e gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe e fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera. Kontrollat e

cilësdo banesë ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen, vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyes për një kontroll i cili është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasurinë, në mënyrën e përcaktuar me ligj, gjykata duhet që të miratojë veprimet e tilla në mënyrë retroaktive. Fshtësia e komunikimit, korrespondencës dhe telefonisë, dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale, ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj. Secili person e gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhp. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj” theksohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (qershor 2008:11)

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë:

Në kapitullin e dytë të Kushtetutës së Maqedonisë, në kuadër të të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit, gjejmë:

“Neni 17. Garantohet liria dhe fshtësia e letrave dhe e të gjitha formave të tjera të kumtimit. Vetëm në bazë të vendimit gjyqësor, mund të shmanget nga pengimi i pacenueshmërisë së fshtësisë së letrave, nëse ajo është e domosdoshme për mbajtjen e procedurës penale ose kur atë e kërkojnë interesat e mbrojtjes së Republikës.

Neni 18. Garantohen siguria dhe fshtësia e të dhp. Qytetarëve u garantohet mbrojtja nga cenimi i integritetit personal, që buron nga regjistrimi i informatave për ta nëpërmjet të përpunimit të të dhp.”

Ndërsa më poshtë në nenin në vijim thuhet:

Neni 25. Çdo qytetari i garantohet respektimi i privatësisë së jetës së tij personale dhe familjare, e dinjitetit dhe autoritetit.

Neni 26. Garantohet paprekshmëria e shtëpisë. E drejta e paprekshmërisë së shtëpisë mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor, kur është në pyetje zbulimi ose pengimi i veprave penale ose mbrojtja e shëndetit të njerëzve.”²⁶

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

Në bazë të Kushtetues së Republikës së Shqipërisë, në Kreun e dytë, te liritë dhe të drejtat vetjake, në nenet në vazhdim gjejmë:

“Neni 35. Pika1. Askush nuk mund të detyrohet, përveç kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij. Pika 2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet publike me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të lejuara me ligj. Pika 3. Kushdo ka drejtë të njihet me të dhënat që mblidhen rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Pika 4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të papara të mbledhura në kundërshtim me ligjin.”

Ndërsa, në dispozitat në vazhdim thuhet:

“Neni 36. Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara. Ndërkaq, me dispozitën në vazhdim rregullohet fshehtësia e banesës:Nenit 37. Pika1. Paprekshmëria e banesës është e garantuar. Pika 2. Kontrolllet e banesës, si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj. Pika 3. Askujt nuk mund t’i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij, ose për të mënjeluar një rrezik që i kanoset sigurimit publik.”²⁷

Kushtetuta e Malit të Zi:

Kushtetuta e Malit të zi, në dispozitën në vazhdim garanton:

“Neni 40 (dyzet). Çdokush ka të drejtë në respektimin e privatësisë dhe jetës familjare.

²⁶http://www.sobranie.mk/al/default.asp?ItemID=254A796A2FD5034_A430BEEDE9FD6AB, e shikuar, 10. mars, 2013, 18.00h

²⁷<http://www.parlament.al/web>, e shikuar, (10 qershor, 2013, 19.00h

Neni 41(dyzet e një). Banesa është e pacenueshme. Askush nuk mund të hyjë në banesë ose hapësirat tjera, pa vendimin e gjyqit, në kundërshtim me dëshirën e poseduesit të banesës, dhe në to të bëhet bastisje. Bastisja bëhet në prani të dy dëshmitarëve. Personi zyrtar mund të hyjë në banesë të huaj, ose lokale tjera edhe pa vendimin e gjyqit, dhe të bëjë bastisje pa praninë e dëshmitarëve, nëse kjo është e domosdoshme për arsye të pengimit të veprës kriminale, me rastin e drejtpërdrejtë të kapjes së kryerësit të veprës kundërvajtëse ose me rastin e shpëtimit të jetës së njerëzve dhe pasurisë.

Neni 42 (dyzet e dy). Fshehtësia e letrave është e pacenueshme, e bisedave telefonike dhe të mjeteve tjera të komunikimit. Nga parimi i pacenueshmërisë së fshehtësisë së letrave, të bisedave telefonike dhe mjeteve tjera të komunikimit mund të ketë përjashtime në bazë të vendimeve gjyqësore, nëse kjo është e domosdoshme për kryerjen e procesit të kundërvajtjes ose për arsye të sigurisë së Malit të Zi. Neni 43 (dyzetë e tre). Garantohet mdhp. Ndalohet përdorimi i të dhp jashtë qëllimit për çka janë grumbulluar. Çdokush ka të drejtë të jetë i njoftuar me të dhënat që janë grumbulluar për të (atë) dhe të drejtë në mbrojtje gjyqësore në rast të keqpërdorimit.”²⁸

Kushtetuta e Kroacisë:

“Neni 34 (tridhjetë e katër). Shtëpia është e pacenueshme. Vetëm gjyqi mundet në bazë të ligjit të urdhërojë që shtëpia apo hapësirat tjera të bastisen. E drejtë e banuesit ose të autorizuarit të banesës është që me rastin e bastisjes së banesës apo hapësirave tjera të jenë prezent edhe dy dëshmitarë. Në përputhje me ligjin, organet e rendit mundën edhe pa vendimin e gjyqit dhe pa praninë e dëshmitarëve të hyjnë në banesë dhe të bëjnë bastisjen, nëse kjo është e domosdoshme për kryerjen e hetimeve ose kapjen e kryerësit të veprës kundërvajtëse, gjegjësisht evitimin e rrezikshmërisë për jetën e njerëzve ose të pasurisë të përmasave të gjera. Bastisja me rastin e gjetjes ose sigurimit të provave për të cilat ekziston dyshim i bazuar që gjenden në shtëpinë e kryerësit të veprës së dënueshme, mund të merren vetëm në prezencën e dëshmitarit.

Neni 35 (tridhjetë e pesë). Çdokujt i garantohet e drejta e tij dhe e jetës së tij, e familjes së tij,

²⁸SU-SK Broj 01-514/21 Podgorica, 19. oktobra, 2007. godine USTAVOTVORNA SKUPŠTINA CRNE GORE, Ueb faqja, http://wikisource.org/wiki/Ustav_Crne_Gore, shikuar, (10, mars, 2013, 20.00 h.

dinjitetit dhe nderit të tij.

Neni 36 (tridhjetë e gjashtë). E drejta e fshehtësisë së korrespondencës dhe të gjitha formave të komunikimit janë të pacenueshme. Vetëm me ligj mund të përshkruhen kufizime nëse është e domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë së shtetit ose me rastin e procesit të veprës (vër.e aut.) kundërvajtëse (procesit të dënueshëm gjyqësor.vër.e aut.)

Neni 37 (tridhjetë e shtatë). Çdokujt i garantohet siguria e fshehtësisë së të dhp. Pa dëshirën e individit, të dhp mund të grumbullohen, të përpunohen dhe shfrytëzohen vetëm me kushte të përcaktuara me ligj. Me ligj rregullohet mdhp mbi veprimtarinë e bashkësisë (shoqërisë së informacionit në shtet) në nivel vendi. Është i ndaluar përdorimi i të dhp në kundërshtim me qëllimin e përcaktuar të grumbullimit.²⁹

6.4 Krahasset ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhp

Ligji i Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në maj të vitit 2010, ka 96 dispozita ligjore të sistemuara në tet kapituj. Kapitulli i parë ka në përmbajtje dispozita, ku përfshihet qëllimi i ligjit, përkufizimet, parimet e përpunimit të dhp dhe fusha e veprimtarisë, të cilën e mbulon ligji. Kapitulli i dytë rregullon legjitimitetin e përpunimit të të dhënave të sistemuara në tre nën kapituj me 16 dispozita ligjore: në nën kreun e parë janë vendosur bazat ligjore dhe qëllimet e përpunimit; në nënkreun e dytë ligji rregullon detyrimet e përpunuesve dhe kontrolluesve të të dhënave; në nën kreun e tretë është rregulluar aspekti ligjor i sistemit të dosjeve. Kapitulli tre i ligjit në tetë dispozita ligjore rregullon të drejtat e subjektit të të dhënave.

Ndërkaq, në kapitullin e katërt janë sistemuar dispozitat e mbrojtjes institucionale të të dhp në katër nën kapituj dhe 22 nene, duke përfshirë këtu themelimin e AShMDhP, si: statusin e saj, organizimin, emërimin e mbikëqyrësit kryesor, emërimin e mbikëqyrësve shtetëror, zv. e mbikëqyrësit kryesor shtetëror, shkarkimin e mbikëqyrësve, pavarësinë e mbikëqyrësve,

²⁹ USTAV REPUBLIKE HRVATSKE, Pročišćen tekst.

<https://www.google.com/search?q=ustav+republike+hrvatske+2012>, Shikuar, (10, mars, 2013, 22.30h)

organizimin e brendshëm të agjencisë, fondet për punë të institucionit. Nënkreu i dytë rregullon detyrat e agjencisë.

Nën kreu tre (3) rregullon punët dhe publicitetin e agjencisë, duke përfshirë këtu edhe raportin dhe raportimin vjetor. Në nënkreun katër janë vendosur dispozitat e inspektimit dhe kontrollit. Transferimi i të dhp është sistemuar në kapitullin e pestë në tetë (8) nene.

Ndërkaq, të drejtat dhe mbikëqyrja sipas ligjit janë rregulluar në shtatë (7) nënkapituj. Në këtë kapitull nënkapitulli i parë rregullon marketingun e drejtpërdrejtë, nënkapitulli i dytë rregullon vëzhgimin me kamerë, nënkapitulli tre ka të trajtuar përdorimin e karakteristikave biometrike, nënkapitulli i katërt merr në trajtim librat dhe regjistrimet e hyrje-daljes nga ndërtesat, ndërkohë që në vazhdim të nënkreut të pestë janë dhënë dispozita të mdhp në librat publikë.

Ndërlidhja e sistemit të dosjeve është rregulluar në nënkreun e gjashtë. Nënkreu i shtatë rregullon detyrimet për zyrtarin e mdhp. Dispozitat ndëshkuese me masat e dhëna janë vendosur në kreun shtatë të ligjit, duke përfunduar kështu me masat kalimtare të vendosura në kreun e tetë dhe të fundit të ligjit.

Ligji i Shqipërisë për mdhp është nxjerrë për herë të parë më 10. 03. 2008, ndërsa është amenduar më 26.04.2012, në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të neneve 78 (shtatëdhjetë e tetë) dhe 83 (tetëdhjetë e tre) pika1 (një). Ligji përmban dhjetë kapituj me 44 (dyzetë e katër) nene. Kapitulli i parë (I) përfshin në katër (4) nene, dispozitat e përgjithshme. Kreu i dytë përmban përpunimin e të dhp në pesë nene, përderisa përpunimi i veçantë i të dhp ose përjashtimet e caktuara të këtij ligji te përpunimi i të dhp në fusha të caktuara është rregulluar në dy nene.

Të drejtat e subjektit të të dhp, ky ligj i rregullon me 6 nene në kapitullin e katërt (IV). Kapitulli i pestë (V) merret me detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave në tri nene. Ndërkaq, kapitulli i gjashtë rregullon mënyrën e njoftimit apo lajmërimit të komisionerit për përpunimin e të dhp në gjashtë nene. Kreu i shtatë me dy nene i rregullon aspektet e sigurisë së të dhp. Kreu i tetë (VIII) i vendos bazat ligjore të institucionit të komisionerit me të drejtat detyrimet dhe përgjegjësitë e tij në njëmbëdhjetë nene. Sanksionet administrative janë dhënë në kapitullin e nëntë (IX) në tri (3) nene, ndërsa në

kapitullin e fundit në tri (3) nene janë dhënë dispozitat kalimtare. Ky ligj ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2012.

Dallimet

1. Në ligjin e Republikës së Kosovës 03/L-172 ka specifikim të fushave të caktuara të përpunimit të të dhp, si:

- librat e regjistrimeve të hyrjeve dhe daljeve nëpër ndërtesa,
- librat publik,
- përpunimi i të dhp në fushën e vëzhgimit me kamerë në sektorin publik dhe privat,
- përpunimi i të dhënave biometrike në sektorin publik dhe privat,
- zyrtari i mdhp.

Këto specifikime të lartpërmendura nuk janë të specifikuara në ligjin e mdhp të Republikës së Shqipërisë.

2. Në Ligjin e dekretuar me nr. 7451, datë 08.05.2012 të Republikës së Shqipërisë ekzistojnë këto dallime:

- Në nenin 2 (dy), dispozita ligjore përveç “përpunimit të ligjshëm të të dhp” garanton edhe “të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private”; me çka në ligjin e Kosovës për mdhp termi “Privatësi” askund nuk është specifikuar në asnjë nen të ligjit.
- Në nenin 42 (dyzetë e dy) ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore të rastet: e të dhënave sensitive (te përpunimi i të dhp të ndjeshme), e transferimit ndërkombëtar të dhp dhe e detyrimit të kontrolluesve për njoftimet të komisioneri për përpunimin e të dhp.
- Në ligjin e Kosovës askund nuk ka detyrim që Qeveria e Kosovës të nxjerrë akte nënligjore, përveç një udhëzimi administrativ për nxjerrjen e kartelave zyrtare të

mbikëqyrësve shtetëror me propozimin e Këshillit Mbikëqyrës të AShMDhP të Republikës së Kosovës.

- Në nenin 20 (njëzetë) të detyrimet e kontrolluesve ndaj komisionerit nuk e gjejmë të specifikuar detyrimin për konsultim me rastin e hartimit të masave legislative nga Qeveria (Këshilli i Ministrave) dhe Kuvendi (organi me i lartë i legjislativit) detyrimin për konsultim siç është specifikuar në ligjin e Republikës së Kosovës në nenet 37, 38 dhe 39 të mdhp.

- Përderisa komisioneri është organ i pavarur dhe person juridik e publik në ushtrimin e funksionit të tij, në ligjin e Kosovës është ndërtuar një Këshill i Agjencisë që ka kompetenca edhe ekzekutive edhe vendimmarrëse. Agjencia me ligj ka edhe Mbikëqyrësin Kryesor Shtetëror, që përfaqëson Agjencinë, nxjerr akte për themelimin e Agjencisë dhe e propozon buxhetin e agjencisë para Kuvendit të Kosovës.

- Përderisa në Shqipëri vendimmarrja është më e shpejtë, këtu vendimmarrja për shumicën e çështjeve është më e ngadalshme, nga se kërkohet vendimi i Këshillit të Agjencisë, si në rastet:

- e transferimit të të dhp (transferimit ndërkombëtar),
- e lejimit të përdorimit të të dhënave biometrike,
- e nxjerrjes së opinioneve ligjore,
- e aprovimit të raportit të punës së Agjencisë,
- e aprovimit të planit të punës së Agjencisë.

Për këto çështje autoritetet kombëtare të udhëhequra me një person janë më efikase në fushën e mdhp, ndërkaj vendimmarrja të autoritetet kolektive është më e ngadalshme (burokratike), por është më e qëndrueshme dhe konsensuale në kuptimin gjithëpërfshirës.

Përparësitë e ligjit të Republikës së Kosovës

Ligji i Republikës së Kosovës është shumë më i avancuar, sepse është shumë më specifik në fushën e: vëzhgimit me kamera, biometrisë, librave të regjistrimit të hyrje-daljeve në

ndërtesa, librave publikë. Ky Ligj është i veshur me kompetenca të detyrimit për konsultim të Qeverisë dhe të Kuvendit, ka pavarësi më të theksuar të nxjerrja e akteve normative nënligjore, ngase asnjë akt nënligjor nuk e nxjerr qeveria. Masat administrative janë më të specifikuara nëpër fusha të caktuara dhe janë më të larta. Detyrimi ligjor për vendosjen e zyrtarit për mdhp te kontrolluesit publik (organet publike) dhe masat e inspektimit janë saktësisht të specifikuara.

Përparësitë e ligjit të Republikës së Shqipërisë

Ligji i Republikës së Shqipërisë e ka të shprehur vendimmarrjen më të shpejtë dhe më efektive ngase: e ka një Komisioner si autoritet të veshur me kompetenca edhe vendimmarrëse edhe ekzekutive, e ka në kuptimin më të gjerë të vendosur edhe termin e shprehjes “privatësi” (kjo në ligjin e Republikës së Kosovës mungon), e ka mundësinë që komisioneri të merret me mësimdhënie gjë që ndihmon shumë në shtrirjen e ndikimit të ligjit dhe sensibilizimit përmes arsimimit në ngritjen e vetëdijes për mdhp.

Tani në ligjin e Republikës së Shqipërisë në kuadër të komisionerit për mdhp është edhe mbikëqyrja e të drejtave të qytetarëve për qasje në dokumente publike.

Të metat e ligjit të Republikës së Kosovës:

- vendimmarrja është më e ngadalshme,
- mungon e drejta për mësimdhënie të mbikëqyrësit,
- mungon shprehja e termit “privatësi”,
- veshja e mbikëqyrësve me rolin edhe të ekzekutimit (si inspektor në këtë rast), edhe në rolin e vendimmarrësit në organin e Këshillit Mbikëqyrës.
- tani në ligjin e Republikës së Shqipërisë në kuadër të Komisionerit për mdhp është edhe mbikëqyrja e të drejtave të qytetarëve për qasje në dokumente publike ku ligji i Kosovës një gjë të këtillë e ka të munguar.

Të metat e ligjit të Republikës së Shqipërisë:

- Ligji nuk përmban specifikime ligjore të fushave të biometrisë, librave të regjistrit, librave publikë etj.,
- pavarësinë e ka më të ngushtuar, ngase shumë akte nënligjore për mdhp janë në kompetenca të Këshillit të Ministrave,
- nuk ka detyrime specifike Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për të marrë konsultimin paraprak të Komisioneri për hartimin e masave legislative në të cilat ka të dhp,
- nuk janë të specifikuara detyrimet e kontrolluesve për vendosjen e zyrtarit për mdhp, përderisa me rastin e amendimit në vitin 2012 janë kërkuar dispozita për zyrtarin e mdhp (sigurisht këto kompetenca janë mundësuar përmes hartimit të akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave në fushën e mdhp në nenet e caktuara 7, 8 dhe 21 të ligjit të Republikës së Shqipërisë për mdhp).
- Në krahasim me ligjin e Republikës së Shqipërisë i cili tashmë e ka në kuadër të Komisionerit për mdhp, edhe mbikëqyrjen e të drejtave të qytetarëve për qasje në dokumenta publike, AShMDhP në RK-së këtë përparësi apo sfidë, e ka të munguar.

Ligji për mdhp i Republikës së Malit të Zi është aprovuar dhe ka hyrë në fuqi në fund të dhjetorit të vitit 2008. Në përmbajtje ligji ka nëntë kapituj me gjithsej 79 (shtatëdhjetë e nëntë) dispozita. Kapitulli i parë (I) ka 9 (nëntë) nene, të cilat përmbajnë materien e parimeve të përgjithshme. Kapitulli i 2 (dytë) shtjellon përpunimin e të dhp në 20 (njëzetë) nene, ku përfshihen kushtet e përpunimit, fshehtësia (besueshmëria) e përpunimit, dhënia në shfrytëzim, obligimi për njoftimin e subjektit për përpunimin dhe fshirjen e të dhp, masat për mdhp me rastin e përpunimit, evidencimi dhe regjistri i grumbullimit të dhp.

Aspektet e posaçme të përpunimit të të dhp ky Ligj i trajton në kapitullin e 3 (tretë), në 10 (dhjetë) nene, ku përfshihen: të dhënat biometrike, evidenca me rastin e hyrjes dhe daljes nga ndërtesat e punës ose zyrtare, mbikëqyrja me kamera. Transmetimi jashtë shtetit i të dhp në ligjin e Malit të Zi rregullohet në kapitullin e 4 (katërt) me 2 (dy) dispozita ligjore. Ndërkaq, të drejtat e subjektit të të dhp rregullohen me këtë ligj në kapitullin e 5 (pestë) me 6 (gjashtë) nene.

Kapitulli i 6 (gjashtë) rregullon të drejtat, obligimet dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, të autoritetit, përkatësisht të agjencisë për mdhp të Republikës së Malit të Zi, në 16 (gjashtëmbëdhjetë) nene. Në kapitullin e 7 (shtatë) rregullohet mbikëqyrja, përkatësisht detyrat dhe të drejtat e inspektimit të kontrollorëve (inspektorëve) të agjencisë.

Masat ndëshkuese janë rregulluar në kapitullin 8 (tetë) me një dispozitë, ndërsa masat kalimtare dhe përfundimtare janë dhënë në kapitullin e 9 (nëntë) në 5 (pesë) nene.

Dallimet

Për dallim me ligjin e Republikës së Shqipërisë për mdhp, në ligjin e Republikës së Malit të Zi janë specifikuar aspektet e përpunimit të të dhp biometrike, të librave të regjistrit të hyrje-daljeve në ndërtesa të punës dhe ndërtesa zyrtare si dhe vëzhgimi dhe mbikëqyrja me kamera. Këto dispozita i përmban edhe ligji i Republikës së Kosovës për mdhp. Për dallim me ligjin e Shqipërisë, në të cilin thuhet se institucioni (autoriteti) i mdhp udhëhiqet nga një person (komisioneri), në Mal të Zi Agjencia udhëhiqet nga Këshilli i Agjencisë, i përbërë prej tre personave të emëruar nga Kuvendi i Malit të Zi, me propozimin e trupit punues të Kuvendit dhe Qeverisë.

Agjencia e ka edhe drejtorin që zgjidhet me konkurs dhe detyrat e tij janë të përshkruara në ligj. Ndërkohë, po kështu mbikëqyrja, përkatësisht kontrollorët që kryejnë inspektimin, punët e tyre i anë të specifikuara po kështu me ligj, për dallim nga ligji i Shqipërisë.

Dallimet me ligjin e Kosovës ekzistojnë te institucioni. Kështu, në Mal të Zi kemi një këshill të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Malit të Zi. Gjithashtu, edhe në Republikën e Kosovës emërimi i këshillit nga ana e Kuvendit, i përbërë prej pesë mbikëqyrësve, dhe njëri prej tyre është i emëruar mbikëqyrës kryesor shtetëror nga ana e Kuvendit, i cili është i veshur edhe me kompetenca ekzekutive dhe me udhëheqjen e Këshillit të Agjencisë. Në këtë rast drejtori në Mal të Zi është i veshur me kompetencat ekzekutive.

Ndërsa, kompetencat e inspektorëve (kontrollorëve) të Malit të Zi janë dhënë të përshkruara te mbikëqyrësit e Agjencisë për mdhp në Republikën e Kosovës. Ligji i Kosovës për mdhp, gjithashtu përmban edhe dallime të tjera që janë më të avancuara se sa

ligji i Republikës së Malit të Zi për mdhp. AShMDhP nuk menaxhon me ligjin për qasje në dokumente publike.

Përparësitë e ligjit të RK-së për mdhp në krahasim me ligjin e mdhp të Republikës së Malit të Zi ligji i Kosovës i mdhp ka dispozita detyruese për qeverinë, kuvendin dhe organet publike e private për ta konsultuar Agjencinë, kur ato nxjerrin akte ligjore e nënligjore në fushën e të dhp. Një detyrim të tillë nuk e përmban ligji i Republikës së Malit të Zi, e as ai i Republikës së Shqipërisë. Ky është një kualitet që përmbush kërkesat e Direktivës 95/46 të BE-së për mdhp dhe të privatësisë.

Ligji i Kosovës e ka të paraparë edhe zyrtarin për mdhp, obligim detyrues ligjor për të gjitha organet publike dhe në amendimin të ligjit në vitin 2013 është futur si detyrim ligjor edhe për organet private, me çka i jep akoma më shumë zbatim detyrues brenda përbrenda secilit përpunues të të dhënave për zbatimin e ligjit të mdhp. Një mungesë e këtillë është në të dy ligjet, në atë të Shqipërisë dhe në atë të Malit të Zi, në amendimet e tyre të bëra gjatë vitit 2012 për aprovim në kuvendet e këtyre dy shteteve.

Përparësitë e ligjit për mdhp të Republikës së Malit të Zi në krahasim me ligjin e Republikës së Kosovës

- Ekziston mundësia e dyshkallshmërisë për ushtrimin e ankesës, ngase ekziston pozita e drejtorit të agjencisë e specifikuar me ligj.
- Ka të specifikuar dhe të rregulluar mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit përmes kontrolloreve me detyra specifike sipas ligjit.
- Kjo trupë (kontrollorët) i ka të specifikuara dhe të qartësuar kompetencat e inspektimit.
- Kompetenca të inspektimit nuk ka Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë në Mal të Zi.
- Ky Këshill e luan rolin e mandatimit të të emëruarit nga Kuvendi i Republikës dhe merret vetëm me vendimmarrje dhe nxjerrje të akteve nënligjore e ligjore të agjencisë.
- Ky Këshill e luan rolin edhe të kontrollit të punës së drejtorit të agjencisë.

- Është siguruar ikja nga konflikti i interesit gjatë punës së Këshillit të Agjencisë dhe zbatimit të ligjit gjatë mbikëqyrjes.

- Tani organizimi i agjencisë përfshinë edhe të drejtën e qytetarëve për çasjes në dokumente publike.

Të metat e ligjit të Republikës së Kosovës për mdhp në krahasim me ligjin e Republikës së Malit të Zi për mdhp:

- nuk ka pjesë të ndarë dhe të siguruar të dyshkallshmërisë,

- Këshilli mbikëqyrës bën inspektive dhe ka kompetenca për vendimmarrje,

- nuk është e garantuar ikja nga konflikti i interesit,

- efikasiteti mund të jete pak më i ngadalshëm në vendimmarrje,

- Nuk ka dispozita kalimtare sikurse të ligji i Malit të Zi për harmonizim të detyruar të evidencave të sektorit publik dhe atij privat për librat e hyrje-daljeve dhe mbikëqyrjes dhe vëzhgimit me kamerë në afat prej 18 ditësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

- Gjithashtu, detyrimi ekziston në dispozita kalimtare edhe për njoftimin detyrues në afat prej 9, përkatësisht 15 muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhp dhe detyrimin që udhëheqësit e organeve private e publike të njoftojnë agjencinë. Këtë detyrim nuk e ka ligji i Kosovës.

- Në ligjin e Kosovës për mdhp nuk është e përfshirë në organizimin e agjencisë edhe mbikëqyrja e të drejtës së qytetarëve në dokumente zyrtare.

Të metat e ligjit të Malit të Zi në krahasim me ligjin e Kosovës për mdhp:

- Ky ligj nuk e përfshin në përmbajtjen e tij detyrimin për organet publike për zyrtarin e mdhp.

- Nuk ka dispozita detyruese për marrjen e konsultimeve detyruese, të nevojshme për të dhënat personale, gjatë hartimit, draftimit dhe aprovimit të masave legjislative, sikurse të ligji i Kosovës.

- Nuk ka dispozita të caktuara që shprehimisht flasin për të drejtat e ndërlidhjes së dosjeve me të dhp.
- Nuk ka dispozita që e rregullojnë të drejtën e të dhp për personat e vdekur.

Ligji për mdhp i Republikës së Kroacisë është aprovuar dhe ka hyrë në fuqi në tetor të vitit 2003. Në përmbajtje ky ligj është ndërtuar prej 11 (njëmbëdhjetë) kapitujve dhe 40 (dyzetë) dispozitave ligjore. Deri në vitin 2013 ligji është pastruar katër herë (2006, 2008, 2011, 2012). Kapitulli i (parë) rregullon parimet e përgjithshme të përpunimit në 4 (katër) nene.

Kapitulli i II (dytë) përmban përpunimin e të dhp me 3 (tri) dispozita ligjore. Ndërsa, me 2 (dy) nene janë rregulluar aspektet e kategorive të veçanta të përpunimit të të dhp në kapitullin e 3 (tretë). Ndërkohë që kapitulli i IV (katërt) me një dispozitë e rregullon kontraktimin dhe autorizuesit për përpunimin e të dhp.

Në kapitullin e V (pestë) rregullohet aspekti i të dhënave personale me 2 (dy) nene për marrësit e të dhp. Transferimi i të dhënave nga Republika e Kroacisë rregullohet me 2 (dy) dispozita ligjore në kapitullin e VI (gjashtë). Ndërkaq regjistri qendror, evidentimi dhe grumbullimi i të dhënave personale rregullohet në kapitullin e VII (shtatë) me 7 (shtatë) nene.

Kapitulli i VIII (tetë) i trajton të drejtat e subjektit dhe mdhp me 9 (nëntë) nene.

Në kapitullin e IX (nëntë) me 9 (nëntë) nene është rregulluar puna, themelimi dhe të drejtat e autoritetit kroat për mdhp, i titulluar si Agjencia për MDhP e Republikës së Kroacisë.

Masat administrative (ndëshkuese) janë dhënë në kapitullin e X (dhjetë) me një dispozitë ligjore. Ndërkaq në 4 (katër) nene në kapitullin XI (njëmbëdhjetë) janë dhënë dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Dallimet

Dallimet e ligjit të Kroacisë për mdhp me ligjin e Kosovës janë të mëdha. ligji i Kosovës specifikon shumë aspekte, si psh:

- Të dhënat biometrike, të dhënat në librat e regjistrit të hyrje-daljeve nëpër ndërtesa në sektorin publik dhe atë privat, librat publikë, vëzhgimi me kamerë në të dy sektorët (publik dhe privat), obligimi për konsultim të qeverisë dhe kuvendit, mënyra e mbikëqyrjes etj. Ky ligj për nga përmbajtja është i ngjashëm me ligjin e Shqipërisë për mdhp dhe me ligjin e Maqedonisë.
- Ligji, gjithashtu, nuk e parasheh si obligim për organet publike zyrtarin për mdhp, ashtu si nuk e parashohin as ligjet në Shqipëri, Maqedoni e Mal të Zi.
- Mbikëqyrësi i Agjencisë dhe zëvendësi i tij emërohen me mandat 4 vjeçar.

Përparësitë e ligjit të Republikës së Kosovës në krahasim me ligjin e Republikës së Kroacisë për mdhp.

- Në Kroaci, Kuvendi i Kroacisë e emëron me propozim të qeverisë mbikëqyrësin e agjencisë dhe zëvendësin e tij. Në Kosovë zëvendësi emërohet drejtpërdrejt nga mbikëqyrësi i agjencisë dhe atë në mungesë të tij, kur ai mungon për arsye zyrtare apo arsye të pushimit.
- Ligji i Kosovës është shumë më i specifikuar, ndërsa ligji kroat për nga vëllimi është me i shkurtër dhe i gjithanshëm dhe len të hapura të gjitha mundësitë që shumë çështje të rregullohen me akte nënligjore.
- Ligji i Kosovës ka dispozita detyruese për konsultim me Qeverinë, Kuvendin dhe organet publike dhe private që merren me draftimin dhe aprovimin e masave legislative që përmbajnë të dhp.
- Në Kosovë, në ligj janë specifikuar aspektet e përpunimit të të dhënave biometrike, të dhënave të vëzhgimit me kamerë, të librave të regjistrit të hyrje-daljeve nëpër ndërtesa të sektorit publik dhe privat, librave publikë.
- Vendimmarrja është më gjithëpërfshirëse dhe me bazë më të gjerë.
- Afati i kohës së emërimit të mbikëqyrësve është më i gjatë (periudhë kohore pesë vjeçare).

Përparësitë e ligjit Kroat për mdhp në krahasim me ligjin e Kosovës për mdhp

- Specifikat e njoftimit për kontrollorët që të lajmërojnë agjencinë për regjistrin dhe kategoritë e përpunimit i janë lënë qeverisë në kompetencë. Këtë aspekt të rregullimit të njoftimit me përmbajtjen e kanë në mënyrë të ngjashme edhe Shqipëria edhe Mali i Zi.
- Statutin e themelimit të agjencisë e ratifikon Kuvendi i Kroacisë.
- Te dispozitat kalimtare kontrollorët dhe përpunuesit e të dhp obligohen me ligj që në afate të caktuara kohore nga data e hyrjes në fuqi të ligjit detyrimisht ta njoftojnë Agjencinë për kategoritë e përpunimit të të dhp.
- Formalisht e rregullon çështjen e emërimit të zëvendësit të shefit të agjencisë (këtë e bën Kuvendi i Republikës së Kroacisë).

Të metat e ligjit të Republikës së Kosovës në krahasim me ligjin e Republikës së Kroacisë për mdhp.

- Ligji i Kosovës nuk përmban dispozita detyruese të dispozitat përfundimtare dhe kalimtare për njoftimin për regjistrin qendror nga kontrolluesit dhe afate të detyruara me ligj.
- Vendim marrja për shumë vendime bëhet me Këshillin e Agjencisë, gjë që shkakton procedura dhe humbje kohe, do të thotë vendimmarrja është më e ngadalshme.
- Nuk ka statut mbi themelimin e agjencisë që do të aprovohej nga Kuvendi i Kosovës, si në rastin e Agjencisë së Republikës së Kroacisë për mdhp.
- Specifikimet dhe formati i njoftimit nuk aprovohen nga qeveria për njoftimin e kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave për agjencinë, siç është e rregulluar me ligjin kroat.

Të metat e ligjit të Kroacisë për mdhp në krahasim me ligjin e Kosovës për mdhp

- Në ligj nuk është përfshirë zyrtari për mbrojtjen e të dhp.

- Nuk janë përfshirë në ligj fushat e mdhp te biometria, te librat e regjistrit të hyrje-daljeve nëpër ndërtesa publike dhe private, te video-vëzhgimi.
- Nuk janë dhënë dispozita për ndërlidhjen e sistemit të dosjeve. Nuk janë dhënë dispozita për përpunimin e të dhp të personave të vdekur.
- Vendimmarrje është me bazë më të ngushtë.
- Afati i kohës së emërimit të mbikëqyrësit dhe zëvendësit të tij është më i shkurtër (me afat katër vjeçar).

Ligji për mdhp i Republikës së Maqedonisë në bazë të Kushtetutës: nenit 75 (shtatëdhjetë e pesë) dhe pikave 1 (një) dhe 2 (dy) të saj është nxjerrë dhe aprovuar nga Kuvendi i kësaj Republike, më 25 Janar të vitit 2005, me nr.07-378/1, shih, Zakon za Zaštita na Ličnite Podatoci, Sobranieto na Republika Makedonija, Skopje (januari, 2005)³⁰.

Ky ligj në përmbajtje ngërthen 54 (pesëdhjetë e katër) nene që shtrihen në njëmbëdhjetë (XI) kapituj. Me ligj është paraparë organizimi dhe sistemimi i lëndës dhe materies ligjore sipas kapitujve në këtë formë:

Kapitulli i (par) shtjellon parimet e përgjithshme në 4 (katër) nene,

Kapitulli i dyt (II) përmban materien e përpunimit të të dhp në tre (3) nene,

Kapitulli i tret (III) shtjellon materien e përpunimit të të dhp për kategoritë e posaqme (të veçanta) me dy (2) nene,

Kapitulli i IV (i katërt) në materien e vet përmban të drejtat e subjektit të të dhp, të cilat janë rregulluar me 13 (trembëdhjetë) nene,

Kapitulli i V (i pestë) organizon në materien e vet ligjore në katër (4) nene fshetësinë dhe mdhp gjatë përpunimit të tyre,

³⁰ Zakon za Zaštita na Ličnite Podatoci. Se proglasuva zakonot za zaštita na ličnite podatoci, što Sobranieto na Republika Makedonija go donese na sednicata održana na 25 januari 2005 godina. Br. 07-378/1, Skopje Predsedatel na Republika Makedonija, Branko Crvenkovski, Predsedatel na Sobranieto na Republika Makedonija, D-p Ljupčo Jordanovski, s.r.

Kapitulli i gjashtë (VI) merret me organizimin e evidentimit dhe grumbullimit të të dhp dhe regjistrit qendror në 4 (katër) nene,

Kapitulli i shtat (VII) merret me tri dispozita ligjore, përkatësisht në tri (3) nene rregullon aspektet e transferimit të dhp në vendet tjera,

Kapitulli i tetë (VIII) me tre (3) nenet e veta, merret me rregullimin e materies së dhënies në shfrytëzim të të dhp,

Kapitulli i nëntë (IX) rregullon themelimin e institucionit dhe kompetencat (në këtë rast të Drejtorisë për mdhp të Republikës së Maqedonisë), me ç'rast lënda është shtrirë në 12 (dymbëdhjetë) nene,

Kapitulli i dhjetë (X) trajton masat administrative (gjobat) në dy (2) nene, dhe

Kapitulli i njëmbëdhjetë (XI) përmban në katër (4) nene dispozitat përfundimtare dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Dallimet

Dallimet janë të konsiderueshme me ligjin e Kosovës për mdhp, ngase në ligjin e Maqedonisë mungojnë specifikimet direkte të rregulluara me ligj, si:

- Përdorimi i të dhënave biometrike,
- Librat e regjistrit dhe librat publikë,
- Përdorimi i të dhp në videovëzhgim me kamera,
- Të drejtat e subjekteve të të dhp të personave të vdekur, dhe
- Kodet dhe nënkodet lidhëse të kategorive të ndryshme të të dhp.

Specifikat që i përmendëm më lart në ligjin kosovar janë trajtuar detajisht me dispozita dhe nene të veçanta dhe me inkorporim njëqind për qind të masës legislative të kërkuar dhe specifikuar me Direktivën 95/46 të mdhp të KE-së dhe BE-së. Pra, dallimet në shtjellimin e materies janë shumë të mëdha.

Dallimi esencial është te zyrtari i mdhp, gjë që ligji i Kosovës e ka rregulluar me I (një) kapitull të veçantë. Gjithashtu, dallimet ndodhen edhe në mënyrën e ndërtimit të institucionit–autoritetit për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit të mdhp.

Përparësitë e ligjit për mdhp të Republikë së Kosovës në krahasim me ligjin për mdhp të Republikës së Maqedonisë

Ligji i Republikës së Kosovës për mdhp ka këto përparësi:

- Në përmbajtjen e vet parasheh zyrtarin e mdhp,
- Ka kapitull të veçantë sikurse te ZMDhP te vëzhgimi me kamera,
- Në materien e vet gjithashtu përfshin përdorimin e të dhënave biometrike,
- Ka specifikim të veçantë lidhur me librat e regjistrat të hyrje-daljeve nëpër ndërtesa dhe librat publikë,
- Mbikëqyrësit i kanë kompetencat dhe masat e inspektimit të shkruara në ligj, ata nuk janë shërbyes civil, por zgjidhen dhe emërohen direkt nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në periudhë të caktuar kohore pesëvjeçare, me mundësi kandidimi edhe për një mandat, duke qenë kështu më të konsoliduar për nga fuqia vepruese.
- Vendimmarrja për çështjet kryesore merret nga Këshilli i Agjencisë, duke përjashtuar masat që mund t'i ndërmarrë mbikëqyrësi drejtpërdrejt me rastin e inspektimit në terren. Do të thotë kemi vendimmarrje kolektive, kur bëhet fjalë për dhënien e opinionëve, transferimit, lejimit të përdorimit të të dhënave biometrike, aprovimit të listës së shteteve me nivelin e duhur të mdhp, aprovimit të akteve të brendshme ligjore, raportit të punës.
- Prania e dispozitave ligjore që e detyrojnë Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës për marrje detyruese të konsulencës dhe mendimit me rastin e hartimit të masës ligjislative, e cila në përmbajtje ka të dhëna të qytetarëve.

Përparësitë e ligjit për mdhp të Republikës së Maqedonisë në krahasim me ligjin për mdhp të Republikës së Kosovës

Përparësia kryesore qëndron te organizimi i autoritetit, ku:

- Drejtori është autoriteti i vetëm vendimmarrës kompetent sipas ligjit për organizimin dhe vendimmarrjen për institucionin.
- Vendimmarrja është më efikase dhe zvarritjet janë të shmangura, meqë drejtori nuk ka nevojë për aprovime nëpër organe siç është Këshilli i Agjencisë te autoriteti kosovar me kompetenca ligjore për një numër të caktuar të vendimeve.
- Ka përparësi edhe te organizimi i inspektoratit, i cili direkt mund të kryejë inspektime për zbatimin e ligjit për mdhp në terren dhe kjo kompetencë te AShMP në Republikën e Kosovës është te mbikëqyrësit e agjencisë.
- Vendimet nga ana e drejtorit nuk paraqesin ndonjë konflikt interesi, gjë që në AShMDHP të Kosovës kjo nuk është e evitueshme gjithherë, pasi që mbikëqyrësit e luajnë edhe rolin vendimmarrës.

Të metat e ligjit për mdhp të Republikës së Kosovës në krahasim me ligjin e mdhp të Republikës së Maqedonisë

- Efikasiteti është më i ngadalshëm,
- Mundësia e konfliktit të interesit në vendimmarrje,
- Pamundësia ligjore e ushtrimit të profesionit të mësimdhënies për mbikëqyrësit, dhe me këtë privohet një mundësi e favorshme e përhapjes së njohurive dhe dijes me kompetencë profesionale në interes të qytetarëve.

Të metat e ligjit për mdhp të Republikës së Maqedonisë në krahasim me ligji e mdhp të Republikës së Kosovës

- Ligji nuk ka specifikime për fusha specifike,
- Është e domosdoshme nxjerrja e shumë akteve nënligjore për funksionimin e institucionit dhe zbatimin e mbikëqyrjen e ligjit nëpër kontrollor,
- Nuk janë dhënë dispozita për shumë fusha, kështu që kërkohet shumë punë për akte dytësore normative me fuqi më të vogël se sa ligji,

- Mungojnë dispozitat detyruese për Kuvendin dhe Qeverinë për marrje detyruese të mendimit dhe këshillimit me rastin e hartimit dhe nxjerrjes së masës legislative, e cila përmban të dhë të qytetarëve.

Marrë në tërësi, nga ky krahasim i ligjeve të autoriteteve për mbrojtjen e të dhë, te cenimi i privatësisë nuk janë të vendosura në këto ligje detyrime për dëmet e shkaktuara me rastin e shkeljes së të dhë, ndonëse subjekteve u shkaktajnë dëme të pariparueshme jomateriale, të quajtura si dëme morale. Këto dëme të shumica e shteteve gjenden të drejta civile, por në interes të fuqizimit të të drejtave universale të njeriut, me interes do të ishte vendosja e dispozitave me përmbajtje të detyrimeve të dëmeve në ligjet e mdhp, ku në grupin e dëmeve të subjekteve të të dhënave do të trajtoheshin kategoria e dëmeve **jomateriale** dhe kategoria e dëmeve **morale**. Me dëme jomateriale kryesisht do të nënkuptojmë: “Dëmet e lidhura me dhembjen fizike, dëmi estetik dhe dëmi i ushtrimit, pamundësia për të shijuar një gëzim” (Lègier2009:132), ndërsa me dëme morale do të nënkuptojmë cenimin e nderit, të jetës private ose të një të drejte tjetër të personalitetit dhe dëmet afektive që shkaktohen nga dhembjet si që janë vdekja apo degradimet” (Lègier 2009:132).

6.5 Të drejtat e subjektit të të dhë

Nocioni “subjekt” ka kuptim pak më të gjerë dhe në marrëdhëniet kushtetuese juridike si subjekt kryesor na paraqiten shteti dhe qytetari (Bajrami 2011:500). Mirëpo, për ne si subjekt i të dhë do të jetë qytetari. Çdo subjekt duhet të ketë të drejtën e aksesit tek të dhë që i përkasin atij dhe janë objekt i përpunimit, me kusht që të sigurohet saktësia e përpunimit dhe karakteri ligjor, duke pasur mundësinë e njohjes së logjikës e cila dikton përpunimin automatik të të dhënave që i përkasin me rastin e vendimmarrjeve automatike, duke u siguruar që kjo e drejtë të mos cenohet sekretin e biznesit as kapitalin shpirtëror, thuhet në parimet bazë të Direktivës Europiane për mdhp dhe të privatësisë (në parimin 41 të saj). Ndërkaq, subjektit të të dhënave me ligj, dhe në përputhje me Konventën 108/1981 të KE-së dhe Direktivës 95/46 të KE-së duhet t’i lejohet mundësia që të konsultojë, pa pagesë, regjistrin e sistemit të dosjes që mbahet nga autoritet kombëtare për mdhp.

Çdo subjekt i të dhënave e ka mundësinë që të konsultojë katalogun e sistemit të dosjeve të të dhp që mbahet nga kontrolluesi (institucioni që i përpunon dhe operon me të dhp, në të dy sektorët publik/privat), të informohet për ruajtjen e të dhënave të tij (saj), qëllimin dhe kategoritë e të dhënave të tij (saj) që janë duke u përpunuar, bazën ligjore të përpunimit, origjinën e të dhënave, marrësit e të dhënave, kategoritë e marrësve të të dhënave, kur i kanë përdorur ose marrë të dhënat e tij, me çfarë baze dhe për çfarë qëllimi i kanë përdorur, përfshirë edhe transferimin jashtë shtetit.

Subjektit të të dhënave me kërkesën e tij (saj), pa shpenzime, duhet t'i lejohet e drejta për shtim, korrigjim, bllokim, shkatërrim, asgjësim, fshirje, kopjim dhe kundërshtim. Natyrisht, secili autoritet kombëtar i mdh me ligj duhet të rregullojë procedurat e qasjes në të dhp për subjektet e të dhënave, sikurse edhe procedurat e shtimit, korrigjimit, fshirjes, shkatërrimit, asgjësimit, bllokimit dhe kundërshtimit. Me ligje të mdhp, konform Direktivës EC 95/46 të KE-së të drejtat e subjekteve mund të kufizohen në masë të caktuar, për arsye të sigurisë kombëtare, mbrojtjes kombëtare, sigurisë publike, parandalimit dhe ndjekjes së veprave penale, mbrojtjes së subjektit të të dhp dhe të drejtave dhe lirive të të tjerëve, interesit të rëndësishëm ekonomik dhe financiar të vendit.

6.6 Përpunimi i të dhp në fushën e arsimit

Sistemi i arsimit konsiderohet njëri ndër përpunuesit dhe operuesit më të mëdhenj me të dhp të individit. Në Kosovë, sistemi i arsimit zhvillohet në sektorin shtetëror dhe atë privat në të gjitha nivelet. Mbikëqyrja dhe rregullat mbi kornizën ligjore mbi arsimin janë në kompetencë të Ministrisë së Arsimit, ndërkaq në nivelin lokal (komunal) kontrolli mbi plotësimin e kushteve teknike të funksionimit të sistemit të arsimit parauniversitar (parashkollor/parafillor, arsimimit dhe edukimit të nxënësve me nevoja të veçanta, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë) bie mbi komunat. Edhe agjencitë, autoritetet, institutet, entet e ndryshme etj., që punën e tyre e kanë të ndërlidhur me prioritet me të gjitha nivelet e arsimit, i takojnë sistemit të arsimit dhe në një mënyrë janë përpunues të të dhp.

Tani, kur përdorimi i teknologjisë ka vërsuar të gjitha nivelet e arsimit në nivel global, veçmas në aspektin e komunikimit modern dhe efikas, duke mundësuar ndjekjen e studimeve në distanca të mëdha gjeografike, bota është afruar tej mase në kuptimin e komunikimit, marrjes dhe dhënies së informatës, mësimnxënies, dhe për pak minuta, secila e arritur shkencore apo njohuri arsimore është e mundur të jetë pjesë e dijeve të secilit nxënës, studiues apo punonjës të arsimit, pa marrë parasysh të folmen e tij apo përkatësinë nacionale.

Kështu, janë të përfshira të gjitha aspektet përmbajtjesore të Direktivës Europiane 95/46, duke filluar nga librat e regjistrit të hyrje-daljeve, librave publikë, vëzhgimi me kamera, përpunimi biometrik i të dhënave, instalimi i programeve të mësimin me internetin, organizimi i të gjitha njësive akademike, duke përfshirë këtu përpunimin e të dhënave përmes SIS-it, databazat e të dhënave të subjekteve (nxënësve, studentëve), databazat e të punësuarve, përpunimi i të dhënave të ndjeshme, transferimi i të dhënave etj., dhënia dhe marrja e të dhp në zinxhirin komunikues: subjekt-kontrollues-shfrytëzues-kontraktues.

Në këtë fushë të dhp shënojnë shkallë të lartë transferimi jashtë vendit, duke marrë parasysh nivelin dhe fluksin e madh të shkollimit dhe studimit jashtë vendit.

Ligji për mdhp në Republikën e Kosovës, i aprovuar në prill 2010, merret me administrimin e mdhp në sistemin e arsimit në nivel vendi. Prurjet efektive janë sidomos në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut: privatësia, përpunimi i ligjshëm dhe i dinjitetshëm i të dhp, siguria e të dhp, sundimi efikas i ligjit në këtë sektor dhe ngritja e nivelit të besueshmërisë dhe stabilitetit të përgjithshëm në relacionet: subjekt-kontrollues-përpunues/kontraktues. Për arritjet e këtyre objektivave ligjërisht është e obligueshme që niveli qendror, në këtë rast MASHT, të vendosë me prioritet zyrtarin e mdhp dhe të përpilojë akte nënligjore të procedurave dhe detyrave specifike në përputhje me ligjin dhe detyrimet kushtetuese në nivel vendi, në bashkëpunim të ngushtë me AShMDhP nga njëra anë dhe MASHT në anën tjetër, duke qenë në koherencë të vazhdueshme me përvojat dhe të arriturat e reja në këtë fushë në nivel European dhe ndërkombëtar. Për nga rëndësia dhe serioziteti i punës së kësaj fushe flet vetvetiu fakti se secili organ publik dhe privat duhet të ketë zyrtarin ligjor të emëruar me shkrim për mdhp (këtë e parasheh si obligim edhe për organet private Rregullorja e KE-së, BE-së dhe Komisionit, e cila tani është në aprovim

para Parlamentit dhe Komisionit të KE-së dhe ka kaluar procedurat aprovuese më 27 prill 2016). Secila njësi akademike, secili institucion shkollor, secili institucion që lidhet me sistemin arsimor, pa përjashtim e ka këtë detyrim ligjor zyrtarin për mdhp.

6.7 Përpunimi i të dhp në fushën e shëndetësisë

Sistemi shëndetësor i një vendi organizohet në bazë të specifikave dhe traditës shëndetësore të secilit vend (shtet), duke pasur për bazë ligjin mbi shëndetësinë dhe shëndetin publik të qytetarëve të atij vendi. Korniza ligjore në përgjithësi mbi shëndetin publik është bukur e gjerë dhe si e kompletuar, e harmonizuar dhe e koordinuar mirë me legjislacionin e përgjithshëm në nivel vendi luan rol kyç në organizimin efikas dhe kualitativ të shërbimit shëndetësor në secilin shtet. Kosova, që nga lufta deri më tani, ende nuk ka arritur që kornizës legjislative shëndetësore t’ia vejë në funksion ligjin mbi sigurimet shëndetësore (deri në këtë kohë të përgatitjes së këtij materiali, 30.4.2016)

Ligji mbi sigurimet shëndetësore do ta lehtësonte funksionimin e sistemit shëndetësor në tërësi, do të rregullonte zbrazëtirën e deritashme të shoqëritë e sigurimeve, të sigurimit shëndetësor të qytetarëve dhe do të rregullonte sistemin e pagesave të klientëve gjatë marrjes dhe shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore në sistemin shëndetësor, duke nënkuptuar këtu edhe shërbimet shëndetësore në sektorin privat. Natyrisht, në këtë ligj do të specifikoheshin edhe rregullat e mdhp dhe privatësisë, kur dihet mirëfilli se në këtë sektor kemi të bëjmë me të dhënat sensitive të subjekteve të të dhp. Për këtë qëllim, Komiteti i Ministrave, më 13 shkurt 1997 në mbledhjen e 58-të Ministrave Deputet të Këshillit të Europës adapton “Rekomandimin Nr. (97) 5 mbi mdhp për qëllime shëndetësore” DATA PROTECTION, Compilation of Council of Europe texts, Directorate General of Human Rights and Legal Affairs Council Europe Strasbourg Cedex, F-67075, 2011:64).³¹ Nga sqarimet e sipërme është e qartë se ndërlidhja me ligjin e mdhp është e pashmangshme, duke qenë se shëndetësia përbën njërin nga të drejtat themelore të njeriut, për të pasur të drejta në trajtim shëndetësor, trajtim të barabartë e human, duke marrë

³¹ www.coe.int/justike Council of Europe 2010

parasysh gjininë, përkatësinë nacionale, fetare e sociale të qytetarëve në shoqërinë e atij vendi, ngase ligji mbi mdhp ka për bazë të drejtat themelore të njeriut.

Duke qenë i organizuar në pikëpamje të sistemit të teknologjisë informative me programe softuerike me databazë, me të dhëna të përgjithshme për të gjithë qytetarët e një vendi, me të dhp sensitive, te sistemi shëndetësor kërkohet detyrimisht respektimi i ligjit për mdhp. Nënkuptohe se në bazë të ligjit duhet të rregullohet me akte të brendshme organizimi, siguria, operimi, kategoritë e përpunimit të të dhp, duke marrë në konsideratë kohën e ruajtjes, të drejtat e subjektit të të dhënave, detyrimet e kontrolluesit ndaj subjektit të të dhp, përpunimin e kontraktuar dhe transferimin e të dhp jashtë vendit.

Sistemi shëndetësor në RK-së, i organizuar si sistem primar dhe sekondar, me shtatë qendrat spitalore dhe qendrat e mjekësisë familjare në të gjitha komunat e Kosovës, duke përfshirë të gjitha shërbimet shëndetësore edhe në sektorin privat, është njëri ndër përpunuesit kryesor të të dhënave të ndjeshme të qytetarëve të vendit tonë. Sëmundja e qytetarit, analizat çfarëdo qofshin ato, grupi i gjakut, struktura gjenetike qelizore e individit, ADN-ja, historia e sëmundjes etj., janë të dhëna të ndjeshme të qytetarëve, dhe përpunimi e operimi me këto të dhëna është i rregulluar dhe i mbrojtur me ligjin specifik të shëndetësisë dhe ligjin për mdhp. Kështu, në baza ditore kryhen me qindra e miliona operime me të dhp në sistemin shëndetësor të Kosovës. Sistemi shëndetësor duhet të garantojë siguri të lartë të mbrojtjes së të dhënave të programeve “softuerëve” dhe pajisjeve fizike “harduerëve”. Operatorët dhe ekspertët e teknologjisë informative që mbikëqyrin bazën e të dhënave të sistemit shëndetësor, domosdoshmërisht duhet të respektojnë kodin e ruajtjes së fshehtësisë profesionale dhe duhet të jenë nënshkrues të deklaratës së kofidencialitetit, të kërkuar sipas ligjit për mdhp. Korniza ligjore për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor e konsideron fshehtësinë profesionale ndër përkufizimet bazë “për ruajtjen e të dhënave për gjendjen shëndetësore të qytetarit, nga personat e paautorizuar”, ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, i Republikës së Kosovës, Nr.2004/38, aprovuar (shtator 2004:2). Kjo klauzolë është bartur në vazhdimësi edhe më vonë gjatë ridraftimit dhe riamendimit të këtij ligji.

Duke pas parasysh përpunimin e ndjeshëm të dhp në këtë sektor, në shtete të ndryshme të botës, përveç mbikëqyrjes ligjore të mdhp ku në ligje kërkohet të ketë vendosje të zyrtarëve të mdhp, diku në mënyrë detyruese e diku ata mund të jen vetëm operacionalë. Në shtet e BE-së tashmë për të gjithë kontrolluesit, pa marrë parasysh sektorin e punës, po vazhdon trendi ligjor që ky zyrtari të jetë i detyruar me ligj. Por, për shembull në ShBA, ndonëse nuk është ndonjë detyrim në sferat tjera të jetës, ky detyrim, vendosja e zyrtarit të mdhp, është obligativ në këtë sektor gjatë përpunimit të dhënave sensitive (Strle, 2015:4). Me vetë faktin se të gjitha sëmundjet dhe kurimet bien në grupin e të dhënave sensitive, ligjërisht e drejta e dinjitetit njerëzor, “gjatë trajtimit mjekësor duhet të respektohen: dinjiteti, jeta private, integriteti personal dhe bindjet religjioze të qytetarit” (Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor i Republikës së Kosovës, Nr. 2004/38, shtator, 2004:4).

Ndërkaq, e drejta për t'u informuar, e drejta për qasje në të dhënat e tij dhe dokumentacionin shëndetësor përmbajnë njëërën ndër të drejtat themelore të dinjitetit personal të garantuara me të dy ligjet: atë të kujdesit shëndetësor dhe atë të mdhp. Specifikisht, qysh me fillimet e veta legislative, korniza ligjore e sistemit të shëndetësisë në Kosovë me dispozita të veçanta, të drejtën e ruajtjes së konfidencialitetit dhe aspektit të privatësisë të të dhënave shëndetësore e ka rregulluar duke i garantuar qytetarit të drejtat e tij në ruajtjen e konfidencialitetit dhe përmasës private të të dhp, “të informatave që janë të lidhura me gjendjen e tij shëndetësore, trajtimin mjekësor si dhe çdo informatë tjetër, që përmban dokumentacioni i tij shëndetësor” (Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor, i Republikës së Kosovës, Nr. 2004/38, shtator, 2004:4).

Por, problemi qëndron tek zbatueshmëria dhe tek efikasiteti i sundimit të ligjit, i cili në “orkestrën simfonike të sundimit të ligjit”, ku secili instrument ligjor duhet të funksionojë në mënyrë efikase, në mënyrë që “orkestra dhe simfonia të interpretohet plotësisht me sukses të plotë”. Kështu, sundimi (zbatimi) i ligjit në tërë vendin do të jetësohet me lehtësi. Përdorimi shtypit në mënyrë të gabuar kur është fjala te të dhënat e ndjeshme nga sektori i shëndetësisë përbën vepër penale dhe veprohet sipas legjislacionit të kodifikuar me kodin penal dhe kodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës. Përmbajtjet në

shtyp (në të gjitha zhanret e shtypit dhe në internet) të fotografive, të historive të sëmundjeve, të jetës private shëndetësore etj, të individit, pa pëlqimin e tij, vetëm me ligj nëse është përcaktuar ndryshe, janë të ndaluara dhe ndëshkohen me legjislacionin në fuqi. Përmbajtjet e tilla shkaktojnë dëme të pariparueshme për jetën dhe të ardhmen e individit, ndërkohë që “tek një kategori e lexuesve mund të krijojnë në vetëdijen e tyre një pasqyrë të shtrembër për vlerat në botën që i rrethon. Të tillë mund të bien lehtë në grackat që i ka jeta dhe kështu mund të arrihet gjer te konfliktet dhe te kryerja e sjelljeve negative dhe kriminale” (Kajtazi, B. 2007:112) në shoqëri.

Zyrtari për mdhp, deklarata e konfidencialitetit e nënshkruar nga përpunuesit dhe zyrtarët që punojnë me të dhënat e qytetarëve në sistemin e shëndetësisë, fshehtësia profesionale, nxjerrja e aktit të brendshëm në organet shëndetësore që rregullon dhe përshkruan masat e sigurisë gjatë operimit me të dhp dhe masat mbrojtëse, njohuritë e punës të ekspertëve të teknologjisë informative, siguria e programeve “softuerverve” dhe pajisjeve “harduerverve” te sistemi i organizuar i bazës së të dhënave në shëndetësinë e Kosovës janë parakushte të domosdoshme për mdhp të kërkuara sipas Konventës Europiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, Konventës 108 të KE-së, Direktivës 95/46 të KE-së dhe rrugëtim i drejtë dhe i sigurt për përmbushje të suksesshme të standardeve për mdhp dhe të privatësisë, të drejta këto të garantuara edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

6.8 Përpunimi i të dhp në administratë publike

Administrata publike e secilit shtet është përpunuese kryesisht e të dhp. Duke qenë e ndërtuar në funksion të qytetarit dhe për të mirën e tij, e ngritur prej vet qytetarit në baza reciproke merr dhe jep të dhp (merr nga qytetari të dhënat e tij dhe jep të dhp në drejtimin të tij për nevojat e tij, si dhe transferon të dhënat e tij). Teknologjia e ditëve tona është mjeti që sot qytetarit po i mundëson qasje të pakufizuar në informata. Vrap i secilit shtet për të disponuar teknologji të përkryer informative dhe komunikuese për nevoja të administratës nuk ka të ndalur. Kështu, cilësia e shërbimeve administrative është avancuar dukshëm në të mirë të qytetarëve, për kryerje të punëve pa humbur kohë në distanca të ndryshme, pa marrë parasysh vendndodhjen e tij (në punë, në banesë apo jashtë shtetit).

Nga njëra anë janë përmirësuar shërbimet administrative në aspektin kualitativ, por nga ana tjetër është hapur mundësia tej mase e cenimit të privatësisë së individit, duke pasur qasje të lehtë në jetën e individit dhe duke përcjellë jetën e tij private. ”Në këtë drejtim, në funksion të mdhp në organet publike, është adaptuar edhe Rekomandimi Nr. (91) 10 mbi mdhp në organe publike nga Komiteti i Ministrave, në mbledhjen e 461 të vitit 1991 të Ministrave Deputet”³²

“E-qeverisja”, në aspektin global, dita e ditës po ia zë vendin administratës së deritashme burokratike. Rruga e përdorimit të internetit, pajisjet e avancuara që dita e ditës po futen në shërbimet administrative, po e lehtësojnë komunikimin e qytetarit me shërbimet e administratës shtetërore. Ky, është një provokim i ri për fushën e mdhp dhe privatësisë së individit. Rruga e transmetimit p.sh. të çertifikatës së lindjes së qytetarit nga kompjuteri i zyrtarit deri te kompjuteri dhe shtypësi (në këtë rast te përdoruesi i kësaj çertifikate) kalon nëpër një mori “instrumentesh dhe pajisjesh”, duke rrugëtuar kështu përmes ajrit deri në banesën e subjektit të të dhënave (në këtë rast si kërkues i shërbimit administrativ).

Raporti i punës statistikore për hulumtuesit e nevojave jetësore të popullsisë dhe shëndetit publik për eliminimin e sëmundjes së TBC-së të një rajoni të caktuar të Kosovës, nënkupton nxjerrjen e shumë të dhënave të ndjeshme: përcjellja, përpunimi i këtyre të dhënave në formë elektronike dhe përcjellja dhe transferimi i tyre përmes kompjuterëve nga një lokacion lokal në lokacionin qendror të përpunimit për nxjerrjen e raportit final, për nevojat e planifikimit shtetëror, i cili kalon nëpër shumë pajisje kompjuterike dhe provokon nxjerrjen e shumë të dhënash sensitive. Hulumtimi për luftën kundër analfabetizmit për nevojat e politikës arsimore të një vendi–rajoni kërkon shumë informata, si të dhëna: të moshës, fetare, sociale, nacionale etj, ku përpunimi dhe operimi kalon nëpër shumë faza dhe pajisje deri te qendra e nxjerrjes së raportit final. Të gjitha këto ngjallin dilema të shtruara për individin, të cilat në rast të identifikimit të subjektit të të dhënave shkaktojnë shkelje ligjore.

³²DATA PROTECTION, Compilation of Council of Europe texts, Directorate General of Human Rights and Legal Affairs Council Europe Strasbourg Cedex, F-67075 www.coe.int/jstike Council of Europe 2010, Reprinted with corrections, (September 2011:71)

Përgjigjja e këtyre dilemave që na paraqiten në këtë shekull, më së miri është e paraqitur në kornizën ligjore për sigurinë dhe mdhp, e cila duhet pasuruar dhe harmonizuar me tërë masën ligjore që është në fuqi dhe e cila në vazhdimësi mund të pasurohet nga ngacmimet e reja teknologjike për t'i shërbyer njerëzimit.

Përdorimi i “E-qeverisjes”, përdorimi i portaleve qeveritare e jo qeveritare, përdorimi i arkivave elektronike çdo ditë nxjerr në pah nevojën e krijimit të rregullave dhe udhëzimeve ligjore si instrumente të sigurisë dhe mbrojtjes së domosdoshme juridike lidhur me përdorimin e këtyre aplikimeve të reja në administratën shtetërore, duke mbrojtur kështu dinjitetin dhe duke aplikuar standardet e të drejtave themelore të njeriut sipas dispozitave të Kushtetutës së Kosovës, në përputhje me kornizën juridike ndërkombëtare dhe europiane të drejtave të të njeriut.

“Ligji mbi Administratën Shtetërore”, shih ligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, Nr.03/L-189, (shtator 2010) “Ligji mbi Shërbimin Civil”, shih ligjin e Shërbimit Civil të RK-së (maj 2010), Kodi i Etikës i nëpunësit civil, një mori ligjesh për fushat specifike të agjencive të sundimit të ligjit dhe të agjencive të sigurisë dhe autoriteteve të lidhura me ekzekutivin, ligjet që rregullojnë fushën e gjyqësorit dhe të sistemit politik në tërësi si dhe një mori ligjesh që rregullojnë fushat specifike të agjencive dhe autoriteteve të pavarura rregullojnë marrëdhëniet e punës së të punësuarve në shumicën e institucioneve, duke aplikuar rregulla unike të organizimit të punës në administratë. Andaj, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë “Rregulloren e brendshme të punës lidhur me funksionimin dhe organizimin e qeverisë, ministrive, si dhe agjencive të ndryshme në kuadër të ministrive” (Rregullorja e Qeverisë Nr.02/2011, Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, mars, 2011). Ka praktika të ndryshme nëpër shtete të ndryshme lidhur me organizimin ligjor të punës dhe funksionimit të qeverisë, ku bazën e kane nga Kushtetutat e tyre.

Administrata shtetërore është shumë e gjerë dhe përmban fusha të ndryshme specifike të jetës e punës (të cilat do të shpjegohen veç e veç), në interes të subjektit të të dhp dhe si kontrollues të mëdhenj të përpunimit dhe të përdorimit të të dhp, si p.sh. policia, doganat, konsullatat, qendrat e regjistrimit civil, komunat, etj. Detyrimisht, sikurse edhe të gjitha organet publike e private, sipas ligjit të mdhp “duhet ta vendosin zyrtarin e mbrojtjes së të

dhënave personale” (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, prill, 2010:36, 37), i cili i ka të përshkruara detyrat e tij të punës në ligj dhe është boshti kurrizor i organit publik për mdhp te kontrolluesi. Ai, gjithashtu, vazhdimisht do të informojë kontrolluesin dhe agjencinë lidhur me gjendjen e të dhp të organit publik.

Organet publike–kontrolluesit e të dhp të administratës publike për nevojat e tyre të brendshme duhet të nxjerrin akte administrative, me të cilat i përshkruajnë masat mbrojtëse dhe të sigurisë për të dhp. Gjithashtu, duhet të nënshkruhet deklarata e kofidencialitetit nga gjithë ata të cilët merren me përpunimin, ruajtjen dhe operimin me të dhp. Koha e ruajtjes së të dhp duhet të mos e kalojë afatin i cili është specifikuar në ligjin e mdhp. Të gjitha organet publike të administratës janë të obliguara, që në përputhje me ligjin, subjektit të të dhp t’i sigurojnë qasje pa kompensim në të dhp, duke i mundësuar atij të drejtën e shtimit, korrigjimit, asgjësimit, bllokimit, fshirjes së të dhp të tij.

Rëndësia e mdhp e specifikuar me Direktivën Europiane të mdhp 95/46 është bartur edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në ligjin e mdhp. Dispozitat e “nenit 38 dhe 39 i detyrojnë të gjitha organet publike dhe private, duke filluar nga Qeveria dhe Kuvendi, që të konsultojnë AShMDhP”, ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, (prill 2010:20, 21), kur ato hartojnë masa legjislative lidhur me harmonizimin e tyre me ligjin e mdhp. Administrata publike, duke qenë hartuesi më i madh i rregullave ligjore, këtë detyrim e ka me prioritet karshi kërkesave ligjore të mdhp.

Konsultimin gjatë hartimit të masave legjislative e kanë të specifikuar gati të gjitha vendet e rajonit, por kjo sipas ligjit të RK-së është detyrim ligjor, ashtu siç e kërkon aktualisht edhe Direktiva 95/46 e mdhp dhe privatësisë e KE-së.

Me qëllim të informimit dhe për qëllime tjera të hartimit të politikave të punës në administratën publike punohet shumë në aspektin e ndërlidhjes në sistemin e dosjeve dhe të regjistrit, fushë kjo e rregulluar me ligjin e mdhp. Grumbullimi i të dhënave nuk guxon të tejkalojë qëllimet për të cilat janë grumbulluar ato. Në fund të prillit 2015 AShMDhP, pas një diskutimi publikë me aktorët shtetërorë, kontrolluesit e fuqishëm publikë e privatë dhe shoqërinë civile, nxori dhe aprovoi rregulloren e masave të sigurisë për mdhp, e cila do të zbatohet në nivel vendi.

6.9 Përpunimi i të dhp për qëllime sociale dhe të punës

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është kontrollues publik, i cili përpunon, ruan dhe operon në masë të madhe me të dhënat e qytetarëve, bazuar në “Ligjin për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Rregulloret e Qeverisë për organizim të ministrive dhe institucioneve, autoriteteve dhe agjencive që veprojnë nën organizimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës”, shih Ligji Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës si dhe Rregullorja Nr. 02.2012 (Mars 2012), për Fushat e Përgjegjësi Administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe Rregullorja e Punës e Republikës së Kosovës (Nr.09/2011). Këtu përfshihen sektorë të shumtë, si;

- Asistenca sociale,
- Agjencia e inspektoratit,
- Shërbimet e punësimit/entet e punësimit në nivel vendi,
- Sistemi pensional,
- Sistemi invalidor,
- Strehimoret për fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje/jetimore,
- Qendrat sociale nëpër komuna,
- Shtëpitë e përkujdesjes për personat e pa strehë dhe personat me të meta,
- Qendrat për rehabilitim dhe përkujdesje të personave me të meta,
- Qendrat e aftësimit dhe riaftësimit për punë etj.

Nga ky këndvështrim, del se me të dhp, në baza ditore kryhen qindra e mijëra operacione, ndërsa, në baza mujore e vjetore kalon shifra në miliona operacione me të dhp të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Operimi, përdorimi dhe përpunimi i të dhëp në qendrat e birësimit, në qendrat për punë sociale dhe në qendrat e rehabilitimit rezulton, se në dosjet e subjekteve të të dhëp të grumbullohen të dhëna shumë të ndjeshme për jetën e individit, andaj “kujdesi i kontrolluesit duhet të jetë i shtuar, ku gjatë çdo përpunimi të këtyre të dhënave, kur ato zbulohen gjatë punës, duhet të mbahen shënime që përmbajnë datën e zbulimit dhe qëllimin e përpunimit, si dhe datën e transferimit, nëse ato u janë dhënë marrësve të tjerë, apo janë transferuar te kontraktuesit tjerë” Direktiva 95/46 e KE-së, e Parlamentit Europian dhe Këshillit (tetor 1995:20,27,31). Qëllimi i grumbullimit të këtyre të dhënave nga subjektet e të dhënave të kësaj kategorie, por edhe të kategorive tjera, nuk guxon të tejkalojë qëllimin e grumbullimit të tyre. Pas arritjes së qëllimit për çfarë ato janë grumbulluar, duhet të bëhet shkatërrimi i tyre, nëse ruajtja nuk është paraparë ndryshe me ligjin mbi ruajtjen e tyre, ose ligjin për arkivat.

Në sektorin e punës grumbullohen dhe ruhen dosje të shumta me të dhënat e subjekteve, në lëndët e të cilave ka të dhëna të ndryshme, si: shënime personale të profilin individual të të punësuarve, CV-të e punëtorëve, pushimet mjekësore, diagnoza të sëmundjeve, karakteristika dhe deklarata të ndryshme me përmbajtje qoftë pozitive apo negative që ndërlidhën me individin (të punësuarin) si subjekt i të dhënave. Andaj, zbatimi i ligjit dhe qasja në dosjet e të dhënave të të punësuarve ka trajtim të veçantë dhe me ligjin mbi Shërbimin Civil është e ndaluar qasja në dosjet e të punësuarve, përveç nëse me ligj është e rregulluar ndryshe. Te sektori i punësimit mdhp parashihet edhe me “Rekomandimin Nr.(89) mbi mdhp për qëllime punësimi, adaptuar nga Komiteti i Ministrave më 18 janar 1989, në mbledhjen e 423 të Ministrave Deputet”³³ dhe me “Rekomandimin No.R(86) mbi mdhp në sektorin social të vitit 1986, i adaptuar nga Komiteti i Ministrave në mbledhjen e 392 të Deputetëve Ministra të KE-së”³⁴.

Qasjet në dosjet e të punësuarve mund të bëhen vetëm në rast se kjo kërkohet nga prokuroria me vendim të gjykatës paraprake, dhe për secilën qasje zyrtari i personelit është

³³DATA PROTECTION, Compilation of Council of Europe texts, Directorate General of Human Rights and Legal Affairs Council Europe Strasbourg Cedex, F-67075 www.coe.int/justike Council of Europe 2010, Reprinted with corrections, September, 2011:77).

³⁴DATA PROTECTION, Compilation of Council of Europe texts, Directorate General of Human Rights and Legal Affairs Council Europe Strasbourg Cedex, F-67075 www.coe.int/justike Council of Europe 2010, Reprinted with corrections, September, 2011:77).

i obliguar të mbajë evidenca (shënime zyrtare) se nga kush është kërkuar qasja, emrin e mbiemrin e personit, autorizimin ligjor mbi të drejtën për qasje, pozitën zyrtare, kohën dhe datën e qasjes, me ç'rast mbahet i informuar kontrolluesi (udhëheqësi i organit publik apo privat) ku subjekti i të dhënave e ushtron veprimtarinë e vet respektivisht të drejtat e veta ligjore.

Të drejtën për qasje në çdo kohë në të dhënat e dosjes së tij e ka subjekti i të dhënave, në të gjitha të dhënat të cilat vet i ka deponuar në dosjen e tij, me ç'rast pa kompensim e ka të drejtën e shtimit, të korigjimit, të bllokimit, të asgjësimit, të fshirjes, kopjimit dhe të kufizimit të të dhp të tij. Kjo vlen për të gjitha subjektet e të dhënave të cilët të dhënat e tyre i kanë në sistemin e dosjeve të MPMS, duke përfshirë dosjet e pensionistëve, asistencës sociale, invalidëve të punës, invalidëve të personave me aftësi të kufizuara, invalidëve të luftës, pensione të pleqërisë, pensione të punës, dosjet e fëmijëve pa prindër, dosjet e birësimit etj.

Duke qenë se historitë e dosjeve të pensioneve kanë afate të ruajtjes së gjatë kohore në përputhje me ligjin mbi pensionet dhe ligjin mbi arkivat, në Gjermani në ligjin e mdhp janë nxjerrë dispozita të veçanta për dosjet dhe arkivat e trashëguara nga koha e komunizmit, dhe dispozita të këtilla janë propozuar në draftin e riamendimit edhe në ligjin e mdhp të Republikës së Kosovës.

Shumë sisteme të jetës e punës kanë specifika të ngjashme sa i përket aspektit të mbrojtjes dhe ruajtjes së të dhp, mbi këtë bazë mëton edhe trajtimi i kësaj materie sa i përket mbrojtjes së të dhp. Fokusi ynë është zgjerimi i njohurive në sektorët më të mëdhenj të përpunimit të të dhënave që ligji i njeh aktualisht si kontrollues që përpunojnë të dhp të subjekteve. Përqendrimi ynë do të ketë më tepër fokusim te këta kontrollues, pa marrë parasysh se cilës ministri i përkasin.

6.10 Përpunimi i të dhp në qendrat e regjistrimit civil

Qendrat e regjistrimit civil janë të mandatuara me kompetenca dhe detyra të punës që t'u shërbejnë qytetarëve në pajisjen e tyre me dokumentacion personal. Këto qendra, në

shumicën e shteteve të BE-së, janë organe shtetërore në cilësinë e kontrolluesit sipas ligjit të mdhp dhe janë pothuajse me kompetenca të ngjashme të punës.

Duke ditur se ARC, Policia dhe Prokuroria me bazë ligjore mund të grumbullojnë dhe përpunojnë të dhëna biometrike (ADN, qelizat e gjakut etj), me qëllim të përmbushjes së ndonjë detyrimi ligjor, ruajtja e tyre në afat të pacaktuar dhe pa bazë ligjore përbën shkelje të privatësisë së individit. “Në vitin 2001, dy qytetarëve britanikë të arrestuar për vjedhje u ishin marrë mostrat qelizore dhe AND-në; pastaj ishin marrë vesh me ankuesin dhe çështja kishte pushuar po të njëjtin vit, por policia nuk i kishte asgjësuar të dhënat e tyre. Subjekti i të dhënave ishte ankuar në GjEDNJ në Strasburg. GjEDNJ kishte konstatuar shkelje të privatësisë sipas nenit 8 të KEDNJ”. (Sadushi & Kumbaro, 2012:177)

Duke qenë në linjën e njëjtë të kërkesave nga BE-ja, për qendërzimin e sistemit lidhur me dokumentet personale të qytetareve të Bashkimit European, në shtetet e BE-së të Zonës së Shengenit dhe në vendet të cilat synojnë integrimin në BE, zakonisht po punohet në aplikimin e standardeve unike lidhur me prodhimin e dokumentacioneve personale të qytetarëve.

Kosova ka nivel të lakmueshëm të aplikimit të këtyre standardeve, sa i përket sigurisë së dokumentacionit, bazës ligjore të punës dhe prodhimit të dokumenteve personale të qytetarëve, duke nënkuptuar përgatitjen profesionale, masat e sigurisë, masat e mdhp etj.

Me vet faktin e ndjeshmërisë së punës, aty ku punohet dokumentacioni i të gjithë qytetarëve, duke filluar nga letërnjoftimet, pasaportat, çertifikatat e lindjes, çertifikatat e vdekjes, çertifikatat martesore, fletë udhëtimet, çertifikatat e shtetësisë, çertifikatat e vendbanimit etj., qendrat e regjistrimit civil në nivel vendi llogariten ndër përpunuesit më të mëdhenj të të dhp të qytetarëve të RK-së.

Duke e konsideruar peshën e drejtë të përgjegjësisë si kontrollues me ndjeshmëri të përpunimit të të dhp, MPB me të drejtë, duke marrë hapin e para në nivel vendi, e ka përmbushur Rekomandimin e AShMDhP, që të ketë zyrtarin e mdhp në ARC, me të vetmin vend pune.

ARC të Kosovës në strukturën e vet përmban të gjitha qendrat e regjistrimit civil nëpër tërë komunat e Kosovës dhe prodhimin e dokumenteve e bën në drejtorinë e prodhimit të dokumenteve personale, e cila është e organizuar në nivel qendror të Agjencisë. Gjithashtu, Agjencia, në nivel qendror, në kuadër të vet, e ka edhe drejtorinë e prodhimit të patentës–shoferëve dhe librezave të regjistrimit të automjeteve. Kështu, aplikimi praktik i punës deri te nxjerrja e dokumenteve kërkon njohje të rregullave ligjore të shumë fushave, disiplinë pune, përkushtim, siguri dhe besueshmëri në kryerje të detyrave të punës.

Deri te finalizimi i një dokumenti nevojitet paraprakisht baza ligjore e punës së Agjencisë për gati të gjitha llojet e dokumenteve që lëshohen nga ARC, si:

- Ligji mbi Letërnjoftimet,
- Ligji për Pasaportat,
- Ligji mbi Komunikacionin (baza ligjore e patentave të shoferëve dhe librezave të regjistrimit të automjeteve),
- Ligji mbi Numrin Personal (baza ligjore e nxjerrjes së numrit personal të qytetarëve),
- Ligji (rregullore ligjore për dokumentet e shtetësisë, të lindjes, martesës, vdekjes, kurorëzimit etj),
- Ligji i mdhp,
- Kodi i Etikës i të punësuarve në ARC,
- Ligji mbi Qasjen në Dokumente Zyrtare etj.

Dhe një mori ligjesh, rregulloresh dhe udhëzimesh administrative që rregullojnë këtë fushë të punës në ARC dhe fushat tjera të ndërlidhura me punën e dokumenteve personale të qytetarëve.

Në kryerje të punëve, në këto institucione, që kanë qasje në të dhë të qytetarëve, zyrtarët e regjistrimit civil duhet t'a nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit, ndërsa kontrolluesi i të dhënave, në këtë rast ARC-ja, duhet të hartojë aktin e brendshëm ligjor me të cilin i

rregullon masat mbrojtëse dhe të sigurisë për mdhp, duke nënvizuar të drejtat dhe detyrimet ndaj subjektit të të dhp.

Përveç të dhp të lidhura me personin, si: emri, mbiemri, data e lindjes, vendi i lindjes, fotografia standarde sipas ISO standardeve për prodhimin e letër njoftimit apo pasaportës kërkohen edhe shenjat e gishtërinjve apo gjurmët e gishtit, të cilat janë të dhëna biometrike dhe në vete bartin të dhëna të shumta që lidhen për jetën dhe veprimtarinë e individit dhe si të tilla bien në grupin e të dhënave të ndjeshme (sensitive), prandaj përdorimi i tyre është i ndaluar me ligj.

Të drejtën e përdorimit të të dhënave biometrike për prodhimin e dokumenteve biometrike ARC e ka të lejuar me ligj, me ç'rast kërkohen kritere të veçanta të sigurisë për përdoruesit e pajisjeve për të dhënat e sigurisë.

Ndërkohë, përdorimi i të dhënave biometrike nga organet publike dhe private nuk preferohet që të përdoret, nëse ka mundësi që siguria dhe efekti i punës mund të arrihet me mjete tjera më të lehta.

Në RK-së përdorimi i karakteristikave biometrike është i rregulluar me “ligjin e mdhp me dispozita të veçanta“, ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, (prill 2010:33, 34)

I vetmi institucion në nivel vendi i autorizuar me ligj për lejimin e përdorimit të të dhënave biometrike në sektorin privat dhe atë shtetëror është AShMDhP, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe. Kur kontrolluesi vendos që, për arsye të sigurisë, të përdorë të dhënat biometrike, paraprakisht duhet t'i bëhet kërkesë me shkrim AShMDh për dhënien e autorizimit të përdorimit të të dhënave biometrike.

“Kodet lidhëse dhe ndërlidhja e sistemit të dosjeve me kontrolluesit tjerë bëhet në përputhje të kërkesave ligjore të ligjit mbi mdhp“ thekson ligji për mdhp i Republikës së Kosovës (prill 2010:9)

“ARC është e obliguar me ligjin e mdhp të Republikës së Kosovës, standard ky i kërkuar edhe me Direktivën Europiane EC 95/46 të mdhp dhe të privatësisë, që të krijojë sistemin e dosjes sipas ligjit”, (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, 2010:9) dhe të njoftojë agjencinë lidhur me të.

6.11 Përpunimi i të dhp në ambasada dhe konsullata

“Fusha e veprimtarisë së punës së ASHMDhP sipas dispozitave ligjore të ligjit për mdhp është e shtrirë dhe zbatohet edhe në zyrat diplomatike dhe konsullore, si dhe në të gjitha përfaqësitë e tjera zyrtare të RK-së jashtë shtetit” (Kajtazi, 2004) dhe ligjit për mdhp i Republikës së Kosovës, (prill 2010:99, 100)³⁵.

Ndërlidhja e veprimtarisë administrative rreth përgatitjes, nxjerrjes dhe pajisjes së diasporës me dokumente personale të të gjitha shtetet është në kompetenca të konsullatave, gjegjësisht përfaqësive zyrtare të shteteve respektive. Kjo kompetencë shtetërore për pajisje me dokumentacione personale në RK-së për qytetarët tanë jashtë vendit, është e konsullatave dhe dikastereve të caktuara të shërbimit të jashtëm të vendit tonë. Por ekzekutimi i punës, në këtë drejtim, bëhet në bashkëpunim me MPB, përkatësisht ARC.

“Ligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës (përfshirë ambasadat, konsullatat dhe përfaqësitë tona zyrtare jashtë shtetit, si organe të MPJ)” rregullohet sipas ligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës (dhjetor 2008) ku me rregullore të veçanta me dispozita të caktuara rregullohen përgjegjësitë dhe detyrimet ligjore karshi mdhp, për nëpunësit e shërbimit të jashtëm, për nëpunësit në administratë dhe personelin ndihmës. Ligji ka 39 dispozita që rregullojnë aspektet organizative të shërbimit të jashtëm dhe detyrimet karshi RK-së, përkatësisht MPJ.

Të gjitha detyrimet ligjore lidhur me mdhp dhe të privatësisë që kanë Qendrat e Regjistrimit Civil në nivel vendi, po kështu janë detyrime ligjore edhe për shërbimin konsullor të Republikës së Kosovës nëpër botë. Kujdesi kërkohet te masat e sigurisë dhe te transferimi i të dhp, ngase shërbimet e kësaj natyre për shërbimin konsullor janë specifike, kur merret parasysh fakti se të dhp të qytetarëve kërkohen për t’u përpunuar dhe prodhuar

³⁵ Besim M.Kajtazi, PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR TË DREJTËN E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE, Drejtoria Ligjore e Zyrës së Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe (GIZ) GmbH, Prishtinë, qershor 2004. Dispozitat e nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, i aprovuar në prill 2010, i hyrë në fuqi në maj 2010, faqe 99 dhe 100.

dokumentacionet e tyre personale nga vendi ku aktualisht e bën kërkesën qytetari deri në Qendrën e Regjistrimit Civil në Kosovë dhe anasjelltas, nga Kosova deri te vendi (shteti) nga është nisur kërkesa e qytetarit. Rugëtimi i kësaj natyre i dokumentacionit qoftë përmes “çantës diplomatike”, qoftë përmes ajrit, kërkon masa të shtuara të kujdesit dhe të sigurisë së mbrojtjes ligjore të të dhp, konform ligjit dhe konform Direktivës 95/46 të KE/së, si pajisje të inkriptimit dhe të dekriptimit që plotësojnë standardet e sigurisë të parapara nga BE.

Në përputhje të kërkesave ligjore, në konsiderim të kujdesit të shtuar dhe punës specifike që bëhet jashtë vendit nëpër konsullatat dhe ambasadat tona, të cilat njëherazi përfaqësojnë edhe shtetin tonë, është e detyrueshme që kontrolluesi (MPJ) të nxjerrë akte të brendshme lidhur me masat organizative, teknike-logjistike, dhe masat e sigurisë për përpunimin dhe mdhp të qytetarëve tanë, kur merret parasysh e dhëna se gjatë këtij përpunimi lidhur me pajisjen e qytetarëve me dokumente personale, përpunohen edhe të dhënat biometrike që, në të njëjtën kohë, janë edhe të dhëna sensitive.

Si çështje e dytë, që gjithashtu kërkon kujdes të shtuar, është edhe transferimi i të dhp, që po ashtu e trajton si fushë të veçantë edhe Direktiva Europiane e mdhp dhe të privatësisë, duke vendosur rregulla unike për shtetet anëtare të BE-së. Vendimmarrjet e transferimit të të dhp të kërkuara jashtë Bashkimit European dhe Zonës Ekonomike të BE-së, mbeten kompetenca të autoriteteve të mdhp të secilit shtet veç e veç. Nga fakti që kërkesat e transferimit mund të jenë të shumta, ngase qytetarët tanë mund të ndodhen me detyra të ndryshme nëpër shtete të ndryshme edhe jashtë BE-së, edhe trajtimi i tyre duhet të jetë i kujdesshëm. Baza ligjore e grumbullimit dhe përpunimit të dhp të qytetarëve tanë jashtë shtetit ekziston në ligjin e Organizimit të Shërbimit të Jashtëm, ligjin e Shërbimit Civil, ligjin mbi Regjistrin Civil të RK-së dhe në ligjet tjera specifike.

6.12 Përpunimi i të dhp në telekomunikacion

Zhvillimet e shpejta në telekomunikacion, përkatësisht në telefonin mobile dhe internet kanë mundësuar komunikim të shpejtë e cilësor dhe me kosto shumë të ulët në mes të njerëzve, pa marrë parasysh distancat e tyre gjeografike në nivel global. Secila pikë e rruzullit tokësor

shumë shpejt është e arritshme, brenda minutave dhe sekondave, kështu që njeriu i shekullit modern “epokës së internetit” kërkon hapësira të reja dhe qasje më të avancuara në univers.

Grumbullimi, përpunimi dhe transmetimi i të dhëp përmes komunikimit elektronik në nivel Europian rregullohet përmes direktivës së veçantë që rregullon aspektet e komunikimit elektronik që zakonisht thirren të “Direktiva Europiane e Privatësisë në Komunikimet Elektronike”, shkurtimisht të ashtuquajtura “E-Direktiva” të teknologjisë së telekomunikacionit: Direktivat “E-Privacy 2002, 2006, 2009”. Edhe “Rekomandimi No.R(95) mbi mdhp në fushën e shërbimeve të telekomunikimit dhe shërbimeve të telefonisë, i adaptuar nga Komiteti i Ministrave më 07 shkurt të vitit 1995, në mbledhjen e Ministrave Deputet të Këshillit të Europës”³⁶ flet mbi të drejtat e subjektit, principet, grumbullimin, respektimin e privatësisë, sistemimin, sigurinë e të dhënave dhe komunikimin me të dhëp në këtë fushë.

Në Kosovë baza ligjore në rrafshin e “komunikimeve elektronike është e rregulluar me Ligjin 04/L-109, i amandamentuar në vitin 2012 dhe i hyrë në fuqi nga muaji tetor 2012”, (Autoritetit Rregullues të Komunikimeve Elektronike dhe Postare-ARKEP në Republikën e Kosovës). Zhvillimi i kësaj fushe është mjaft kompleks me ç’rast edhe qasja e rregullimit juridik po kështu kërkon qasje komplekse dhe natyra e rregullimit ligjor afekton shumë sfera ligjore, si: “Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Privatësisë, Ligjin për Shërbimet Postare 03/L-173, i hyrë në fuqi më 15 Prill 2010” (shih ligjin postar të Republikë së Kosovës, si dhe ligje të sferave tjera si; ligji për Shërbimet e Shoqërisë Informative, ligji mbi të Drejtat e Konsumatorit etj).

Brenda një periudhe kohore katër vjeçare (2010-2014) ARKEP në Kosovë, ka evidencuar njëqind operatorë të internetit, telefonisë mobile dhe operatorë transmetues të televizioneve e radiove elektronike përmes internetit dhe sistemit kabllor në sektorin publik dhe atë privat.

Kjo e dhënë tregon për kujdesin e shtuar që duhet të ketë autoriteti kombëtar i mdhp në Republikën e Kosovës lidhur me përfshirjen e dhjetëra milionave operacioneve ditore të të dhëp në telekomunikim-përmes telefonisë mobile kabllore të qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë SMS, thirrjet telefonike dhe komunikimet tjera përmes postës

³⁶DATA PROTECTION, Compilation of Council of Europe texts, Directorate General of Human Rights and Legal Affairs Council Europe Strasbourg Cedex, F-67075
www.coe.int/justice/Council_of_Europe_2010, Reprinted with corrections, (September 2011:68),

elektronike. Grumbullimi dhe përpunimi i të dhp të zërit, fotografisë dhe SMS në telefoni nga subjektet e të dhp dhe komunikimi i qytetareve duke shfrytëzuar shërbimet e telefonisë; mobile, fikse dhe të internetit bëhet duke rregulluar detyrimet, obligimet dhe marrëdhëniet e kontraktuara të qytetarëve me kontrolluesin (operatorët e telefonisë), të cilat janë të rregulluara me ligjin mbi komunikimet elektronike, ndërsa zëri, si e dhp, është trajtuar më lart dhe po kështu Direktiva EC 95/46 e përpunimit të të dhp e ka trajtuar në mënyrë të veçantë.

Aspektet e qasjes në të dhp në sistemet e serverëve të telefonisë, përgjimet e telefonave, leximet e SMS-ve, siguria e të dhp, masat e sigurisë, baza ligjore e përpunimit dhe transferimit të këtyre të dhënave janë shqetësim i veçantë për AShMDHP, dhe me ngulm kërkohen rregulla të sakta të aspekteve të definuara ligjore të përgjimeve, të përgjimeve “ligjore” e “jo ligjore” (të ashtuquajtura përgjime në rreth), me ç’rast subjektet e të dhënave duhet të mbahen të njoftuara nga hetuesia për kohën kur janë përgjuar dhe përgjimet e këtilla, pas përfundimit ligjor të përgjimit, duhet të shkatërrohen në prezencën e subjektit të të dhp. Bashkëpunimi në mes të autoritetit rregullues të komunikimeve elektronike dhe autoritetit për mdhp duhet të jetë i atij niveli që subjektit të të dhënave t’i garantojë siguri se; të dhënat e tij çdo herë janë të sigurta; dhe janë duke u mbrojtur dhe përpunuar në mënyrë të ligjshme.

Me akte të brendshme duhet të rregullohen procedurat, masat organizative dhe masat e sigurisë lidhur me mdhp te secili operator i telefonisë.

Dokumentacioni i KE-së dhe i BE-së në legjislacionin juridik ka ndërmarrë seriozisht Rekomandimet nr. 2.3 i KE R(15)87 që nga viti 1987, i cili parasheh që “2.3. Mbledhja e të dhënave me anë të mbikëqyrjes teknike ose mjeteve të tjera të automatizuara duhet të parashikohet në dispozitat e veçanta.” Dokumenti i TAIEX-it, Analiza e Ligjit për Policinë nr. 04/L-76 dhe Kodin e Procedurës Penale duke përfshirë sugjerimet për ndryshime. Projekt i ekspertëve të TAIEX-it 48700, KOS IND/EXP 47109 (TAIEX ndihmë për agjencinë kombëtare për mdhp të Kosovës), (shtator 2012).

Kështu është e siguarur që ndërhyrja e rëndë në të drejtat themelore të njeriut, dinjitetin dhe integritetin e tij duhet të rregullohen me dispozita të veçanta dhe të qarta ligjore dhe

me akte nënligjore, veçmas kur janë të mundshme cenime të të drejtave të njeriut në fushën e telefonisë.

Ndërkaq, aspektet e mdhp të kësaj fushe (telefonisë) në relacion me policinë, prokurorinë, gjyqësinë dhe agjencitë e sigurisë do të trajtohen në artikujt specifikë të natyrës së mdhp në sektorët respektiv (polici, gjyqësi, prokurori dhe agjenci të sigurisë).

6.13 Përpunimi i të dhp në sistemin bankar

Grumbullimi dhe përpunimi i të dhp të qytetarëve në sistemin bankar bëhet në bazë të ligjit mbi sistemin bankar-financiar të vendit. Deponimi i të dhp të qytetarëve në banka bëhet me qëllim të realizimit të të drejtave të tyre për hapje të xhirollogarive të qarkullimit, për marrje të kredive, për hapje të xhirollogarive të kursimeve, për pagesa të transaksioneve, për pagesa të detyrimeve financiare etj. Përveç qytetarëve, xhirollogari hapin dhe posedojnë edhe personat juridikë (institucionet) publike dhe private.

Keqpërdorimi, vjedhja e kartelave të bankomatëve, të kartelave master dhe visa-kartelave është abuzim i rëndë me të dhp të subjekteve kreditore të bankave të ndryshme, andaj, abuzimet dhe vjedhjet e këtilla janë të shumta anekënd rruzullit tokësor. Lidhur me vjedhjet nëpërmjet bankomatëve, vetëm në fillim të vitit 2014, policia spanjolle kishte raportuar se ka arrestuar 8 (tetë) persona të përfshirë në një rrjet botëror, me ç'rast janë vjedhur miliona dollar nga bankat, përmes tërheqjeve nga bankomatët.” Lidhur me këtë skemë mashtrimi arrestimet ishin kryer edhe nga policia amerikane dhe ajo gjermane, në të cilën ishin përfshirë Banka Mucat në Oman si dhe Banka RAKBANK (nga të cilat janë vjedhur 45 Milion\$)”.³⁷ Qytetarët të dhënat e tyre i deponojnë në këtë sistem vetëm për realizimin e të drejtave financiare dhe këto të dhëna nuk mund të përdoren për qëllime tjera. Gjithmonë, subjekti i të dhënave duhet të mbahet i njoftuar dhe të merret pëlqimi i tij për ndryshimin, korrigjimin, freskimin apo çfarëdo veprimi me të dhënat e tij.” Më 13 shtator të vitit 1990 KE përmes Komitetit të Ministrave në Mbledhjen e

³⁷[http:// www.pcworld.al/](http://www.pcworld.al/) Artikulli; Arrestohen 8 persona në Spanjë të dyshuar për vjedhjen e 45 milionë \$ nëpërmjet bankomatëve, kërkimi është bërë më, 08. 01.2014, në ora 15.30h.

443 të Ministrave Deputet, ka adaptuar Rekomandimin No.R(90)19 mbi mdhp në sistemin e pagesave dhe realizimin e operacioneve tjera në këtë sistem”³⁸

Ndërkaq, në rast të transferimit të të dhënave nga ky sistem, nëse ato transferohen jashtë BE-së dhe zonës ekonomike të BE-së, pëlqimi duhet të merret në AShMDHP, i vetmi autoritet në nivel vendi i autorizuar me ligj për këtë qëllim. Të dhënat që përdor sistemi bankar, janë të dhp të privatësisë financiare të individit dhe ato ruhen deri sa të arrihet qëllimi i përpunimit.

Shpesh ndodh që të dhënat e qytetarëve të ruhen edhe 7-10 vite, edhe pas arritjes së qëllimit. Kjo ndodh në rastin e shlyerjes së kredive apo futjes së kredimarrësve të këqij në “lista të zeza”, gjë që për subjektin e të dhënave përbën shkelje të privatësisë së tyre.

Synimet e mdhp shkojnë në atë drejtim që ky afat të jetë sa më i shkurtër, shënimet e këtilla të jenë të bllokuara, qasja të jetë e kufizuar dhe të mund të realizohet vetëm nëse me ligj është paraparë ndryshe.

Në sistemin bankar mund të përpunohen edhe të dhënat biometrike (shenjat e gishtërinjve, videovëzhgimi etj.), por domosdoshmërisht përpunimi duhet të jetë në përputhje me ligjin, veçanërisht, duke pasur kujdes të përpunimi i të dhënave të ndjeshme.

Sistemi bankar, si përpunues i madh i të dhp dhe duke marrë parasysh punën specifike, llogaritet ndër sistemet me masat më të sofistikuara të sigurisë në nivel vendi. Andaj, edhe aspekti i mdhp dhe privatësisë në organet e këtij sistemi konsiderohet i mirë. Kujdesi institucional i mdhp lidhet kryesisht me zyrtarin e mdhp, gjë që sistemi bankar qendror e ka me të vetmin vend pune, dhe normalisht edhe organet tjera (bankat çfarëdo qofshin ato) e kanë caktuar me shkrim këtë zyrtar.

³⁸DATA PROTECTION, Compilation of Council of Europe texts, Directorate General of Human Rights and Legal Affairs Council Europe Strasbourg Cedex, F-67075 www.coe.int/justice/Council_of_Europe_2010, Reprinted with corrections, (September, 2011:74).

Të dhënat biometrike në sistemin bankar mund të përdoren në rast se është e domosdoshme për shkaqe sigurie të sistemeve të softuerëve dhe harduerëve si dhe pajisjeve, pronës dhe personelit. Përdorimi i të dhënave biometrike mund të bëhet vetëm nëse paraprakisht është marrë pëlqimi nga ana e përdoruesit të AShMDhP, i vetmi autoritet me ligj i mandatuar për këtë qëllim.

Hyrje-daljet, hollet, sportelet dhe bakomatet në sistemin bankar tashmë në të gjitha nivelet dhe në të gjitha vendet në nivel ndërkombëtar janë pothuajse nën vëzhgimin e sistemit të videovëzhgimit. ”Gjithmonë, gjatë aplikimit të këtij sistemi të mbikëqyrjes dhe vëzhgimit, detyrimisht duhet pasur kujdes në privatësinë e individit dhe dinjitetin e tij personal, në mënyrë që ky sistem të jetë i instaluar plotësisht, i mbikëqyrur, i siguruar, i ruajtur dhe i mbrojtur në përputhje me kërkesat e ligjit për mdhp, konform rregullave dhe dispozitave të vëzhgimit me kamerë”, shih Ligji 03/L-172 f.29 në përputhje me ligjshmërinë e përpunimit të të dhp Direktiven 95/46 e KE-së, e Parlamentit Europian dhe Këshillit (24 tetorit 1995) seksioni 2 neni 7, Direktiva EC 95/46 e Këshillit dhe Komisionit të BE-së. Perimetri i vëzhgimit gjatë mbikëqyrjes së sigurisë me sistem të videovëzhgimit nuk guxon të kalojë përtej hapësirës së pronës që e disponon kontrolluesi për këtë qëllim, njëkohësisht duhet përmbajtur rreptësisht rregullave të vendosjes së kamerave vetëm në hapësirat e lejuara me ligj.

Mbikëqyrja efikase e profesionale kërkon përkushtim dhe auditim të gjithanshëm përmes inspektimeve të rregullta që mund të zgjasin me ditë të tëra dhe me ekipe të përgatitura³⁹ nga agjencia e të dhënave. Ky lloj i inspektimeve dhe kontrolleve ndahet në fusha dhe sektorë të veçantë që do të përcillet specifikisht, si psh: sistemi financiar, sistemi arsimor, sistemi shëndetësor, sistemi gjyqësor-prokurori-polici, sistemi i telekomunikacionit etj. Kështu rekomandojnë ekspertët dhe njohësit e fushës së mdhp.

6.14 Përpunimi i të dhp në polici dhe prokurori

³⁹ Bernard Banasch, autor, TAIEX 48 700, shtator 2012 Ndhimë për Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Kosovës, Analizimi i Ligjit 04/L-76 për Policinë dhe Kodin e Procedurës Penale duke përfshirë edhe sygjerimet me shkrim për ndryshime.

Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave nga policia, prokuroria dhe sistemi gjyqësor përbëhet kryesisht nga përpunimi i të dhënave të personave problematikë, ankuesve, dëshmitarëve, të akuzuarve, personave të papërfshirë drejtpërdrejt në konteste, viktimave, abuzuesve të ndryshëm, personave të përfshirë në vepra kriminale e korruptive, personave të veprave kundërvajtëse, personave të veprave penale, personave të dyshuar, personave (qytetarëve) gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare me rastin e kontrolleve të rregullta ose rutinore etj. Policia dhe prokuroria me kompetencat e tyre konsiderohen përpunues jashtëzakonisht të mëdhenj të të dhp, janë sektor të shtetit që direkt dhe thellësisht ndërhyjnë në të drejtat themelore dhe privatësinë e subjekteve të përmendura më lart andaj domosdoshmërisht duhet të sigurohen kushtet mbrojtëse mbi bazën ligjore:

“...ku parakushtet dhe mbrojtja proceduarale duhet të përshkruhen në vetë ligjin për Policinë” shih Dokumentin e TAIEX-it, Analiza e Ligjit nr. 04/L-76 për Policinë dhe Kodin e Procedurës Penale duke përfshirë sugjerimet me shkrim për ndryshime, TAIEX 48700 KOS IND/EXP 47109, (Banash & Osvald shtator 2012:8).

Pajtueshmëria e Ligjit të Policisë, Kodit Penal, Ligjit të Procedurës Penale, Ligjit të Inteligjencës, Ligjit të Procedurës Civile (Kodit Civil) me ligjin e mdhp është detyrim ligjor lidhur me marrjen e mendimit për fushën e të dhp gjatë hartimit të ligjeve në fjalë dhe gjatë nxjerrjes së masës tjetër legjislative, e cila derivohet nga këto ligje dhe nga ligjet tjera në vend.

“Mosparashikimi në mënyrë të qartë nga ligji i brendshëm i hapësirave dhe mënyrës së ushtrimit të diskrecionit që u është dhënë autoriteve publike për të mbledhur dhe ruajtur informacionin në lidhje me jetën private të një personi”, (Sadushi & Kumbaro 2012:198), si dhe afatet, mbajtja e të dhp në mënyrë të panevojshme dhe mbajtja dhe grumbullimi i të dhp të tretë është në kundërshtim me nenin tetë (8) të KEDNJ.

Duke qenë se: ”Mbrojtja e të dhënave është një e drejtë themelore (Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut {ECHR}), Neni 8 i Traktatit të Bashkimit European, neni 16 i Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European {TFEU} dhe rendit kushtetues të Kosovës {neni 36 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e drejta e privatësisë) dhe dokumentet e ndryshme të KE-së dhe BE-së për mbrojtjen e të dhënave ”, marrë nga

dokumenti i TAIEX-it, Analiza e Ligjit nr.04/L-76 për Policinë dhe Kodin e Procedurës Penale, duke përfshirë sugjerimet për ndryshime nga Programi TAIEX-ndihmë për agjencinë kombëtare për mdhp të Kosovës, KOS IND/EXP 47109, shtator, (B, B.2012:2), del detyrimi që: shteti, institucionet shtetërore, duke përfshirë edhe ato private, dhe përgjithësisht shoqëria kosovare kanë detyrim ndaj respektimit me masa ligjore të së drejtës personale dhe privatësisë së subjekteve të të dhp.

Pajtueshmëria e këtyre ligjeve me standardet e BE-së për mdhp dhe të privatësisë është çështje kyçe në *acquis communautaire* dhe gjithashtu, ishte ndër çështjet më të rëndësishme të shteteve të cilat aderuan në Zonën e Shengenit dhe kaluan procesin e liberalizimit të vizave si dhe atë të stabilizim asociimit. Kjo pajtueshmëri ligjore me ligjin e mdhp është me interes të veçantë në rrugëtimin e Kosovës drejt proceseve integruese, konkretisht drejt UE-së. Për këtë arsye dhe për shkak të të drejtave themelore të subjekteve të të dhp, kompetencat e policisë dhe prokurorisë në ndërhyrjet në të dhp duhet rregulluar hollësisht, saktësisht dhe qartësisht me ligj.

Policia, duke qenë ndërhyrësit më të mëdhenj në të dhp, gjithmonë pas kryerjes së detyrimeve ligjore të parapara me ligj, duhet të sigurojnë subjektin e të dhënave se të dhënat e tij janë përpunuar ose ende janë duke u përpunuar në përputhje të plotë me ligjin për qëllimin që ato janë grumbulluar.

Në rastet e hetuesisë, gjithashtu subjektet e të dhënave të përfshira në procedurat e hetuesisë, në të cilat nuk janë shkaktarë të veprave kundërvajtëse apo penale, duhet të jenë të informuar për kohën, sasinë dhe llojin e të dhënave të tyre të grumbulluara (kur kanë përfunduar dhe janë mbyllur të gjitha proceset e hapura) dhe lidhur me këtë, në prezencën e subjektit të të dhënave, duke bërë konstatimin me anë të procesverbalit, hetuesia e bën shkatërrimin e të gjitha të dhënave që janë grumbulluar dhe janë shfrytëzuar nga hetuesia konform ligjit. Qysh në vitin 1987 KE-së, veç tjerash, “nxjerr Rekomandimin No.R(87)15 mbi rregullimin e mdhp në

sektorin e policisë, të adaptuar nga Komiteti i Ministrave, në mbledhjen e 410-të të Ministrave Deputet”.⁴⁰

Efektet e legjislacionit sekondar të BE-së dhe KE-së, veçmas direktivave si akte dytësore apo të derivuara të së drejtës së BE-së, duke qenë të detyrueshme për nga përmbajtja me transpozimin e tyre në legjislacionin nacional (shtetëror), ju mundësohet qytetarëve që të mbështetën në të drejtën e BE-së kundër shteteve, anëtare të BE-së të cilat dështojnë në implementimin e këtij legjislacioni. Nënkuptoheq që mundësia e individëve për t’iu referuar të drejtave që u jep Direktiva rrjedhin pikërisht nga veprimet apo mosveprimet e shteteve anëtare për transpozimin (inkorporimin) e një direktive (Ujkani, E 2012:272).

Në rastet e shkeljeve të të drejtave të subjekteve të dhp, në këtë relacion qytetarët, ekziston baza juridike që ankimitin e tyre, në rast të mos konsiderimit nga sistemi i drejtësisë së vendit anëtar, ta ngrenë në GJED (Gjykatën Europiane të Drejtësisë).

Kështu, ky mund të njihet si efekt i drejtpërdrejtë vertikal i së drejtës së BE-së.

6.15 Përpunimi i të dhp në turizëm dhe hotelieri

Komunikimi elektronik ka ndikuar në zhvillimin e hovshëm të turizmit dhe hotelierisë. “Makineria kërkuese” e quajtur internet ka avancuar dhe ka krijuar mundësi të shkëlqyera për qytetarët, të cilët me ndihmën e kompjuterit apo telefonit të mençur nga banesa e tyre mund të informohen për kushtet, çmimet dhe gjithçka tjetër që është në interesin e tyre lidhur me pushimet, rekreacionin, vizitat, ekskursionet etj. qofshin ato të karakterit personal, institucional apo të interesit grupor institucional.

Sa ka përparësi te ky lloj komunikimi, aq edhe krijohen mundësi të keqpërdorimit dhe shkeljes së privatësisë dhe të dhp të qytetarëve.

⁴⁰Shih, DATA PROTECTION, Compilation of Council of Europe texts, Directorate General of Human Rights and Legal Affairs Council Europe Strasbourg Cedex, F-67075 www.coe.int/justike Council of Europe 2010, Reprinted with corrections, (September, 2011:80).

Sot pushimoret, hotelet, ambientet e rehabilitimit dhe rekreacionit, për shkaqe sigurie të pasurisë dhe njerëzve, i kanë instaluar sistemet e vëzhgimit me kamera pothuajse në çdo skutë, si dhe sistemet biometrike të hyrje-daljes në punë për të punësuarit në këtë sektor. Janë avancuar edhe evidencat e hyrje-daljeve nëpër këto ndërtesa dhe ambiente, duke kaluar nga evidencat e thjeshta të regjistrave të shkruar me dorë në ato elektronike.

Për të siguruar qasje për të gjithë pasagjerët që i shfrytëzojnë këto shërbime në sektorin e turizmit përmes internetit gati çdo shërbyes turistik, pa dallim të llojit të shërbimit dhe madhësisë së tij, ka hapur web faqet e veta.psh. një pasagjer nëse kontakton në faqen e internetit “Booking.com” për të siguruar informata për udhëtimet dhe çmimet e shpenzimeve të qëndrimit në Tokio të Japonisë ose në Varshavë të Polonisë.⁴¹ Ai mund të japë informatat e veta personale për qasje dhe mund të marrë informacionin e nevojshëm të kërkuar nga banesa e vet përmes telefonit të mençur personal. Mirëpo, ne duhet të dimë se tashmë “Booking” është aktiv dhe shumë i zhvilluar. Çfarë informacioni personal përdor “Booking-u”, kur ju kërkon të bëni një rezervim? Prej jush kërkohet: emri e mbiemri, adresa, nr. i tel., email adresa, informatat e pagesës, emrat e mysafirëve që udhëtojnë me ju, preferencat tuaja për qëndrimin. Secili shfrytëzues i “Booking” duhet të informohet se kur vizitohen faqet e tyre të internetit, “Booking” mund të mbledhë informata të caktuar për ju, si: IP adresën tuaj, shfletuesit që ju jeni duke përdorur, informacionet lidhur me sistemin operativ të kompjuterit tuaj, faqet që kanë shënime për ju, të dhënat identifikuese për pajisjen tuaj të lëvizshme që ju e keni në përdorim, të dhënat për pajisjen tuaj mobile, parametrat e pajisjeve tuaja specifike etj.⁴²

Qytetarët i japin të dhp apo u nënshtrohen këtyre formave të ekspozimit të privatësisë së tyre, por gjithmonë e drejta e tyre për qasje dhe për t’u informuar lidhur me këto të drejta ekziston me bazë të plotë ligjore në të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe në shumicën e shteteve në nivel ndërkombëtar. Kështu, janë të detyrueshme edhe njoftimet për të drejtën e privatësisë për të gjithë kontrollorët e këtij sektori në mbrojtje të interesave të qetarëve. Tashmë, shumica e ofruesve të këtyre shërbimeve të turizmit në web faqet e tyre përmes “servisit për konsumator” ofrojnë të drejtën e privatësisë.

⁴¹Booking.com; marr nga Booking.com, shikuar më datë 10.10.2013, ora 16.00h

⁴²[www.http://Booking.com](http://www.booking.com), shikuar më 13.08.2014, ora 15.00h

KAPITULLI VII: TË DHËNAT SENSITIVE PERSONALE DHE KUFIZIMET GJATË PËRPUNIMIT TË TYRE

7.1 Aspekte vështruese mbi të dhënat sensitive

Të dhënat sensitive janë të dhpa të individit që në aspektin ligjor përkufizojnë origjinën etnike, racën, pikëpamjet politike dhe filozofike, besimin fetar, anëtarësinë sindikale. Gjithashtu, çdo e dhënë mbi gjendjen shëndetësore të individit dhe mbi jetën seksuale të tij është e dhënë sensitive. Po kështu, çdo përfshirje në evidencat penale ose të kundërvajtjeve, duke konsideruar edhe heqjen nga këto evidenca, konsiderohet e dhënë sensitive e individit.

Në grupin e të dhpa të ndjeshme (sensitive) bëjnë pjesë edhe karakteristikat biometrike, në rast se këto të fundit mundësojnë identifikimin e një subjekti të të dhënave në lidhje me cilëndo nga rrethanat e lartpërmendura në këtë vështrim.

Duke konsideruar se përpunimi i të dhpa të ndjeshme (sensitive) në shumë fusha të jetës dhe punës nga shumë kontrollues si brenda vendit dhe jashtë vendit ka efekte ndikuese në shumë aspekte në jetën dhe të ardhmen e individit, kërkohet kujdes i veçantë në mbrojtjen dhe sigurinë efektive-ligjore të këtyre të dhënave.

Të dhënat e ndjeshme lidhen direkt me dinjitetin e individit dhe integritetin e tij të privatësisë personale, dhe në këtë kuptim “Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut e OKB-së” dinjitetin e individëve ka fokusuar si vlerë universale të lirive dhe të drejtave të njeriut, duke e përfshirë në preambulë të Deklaratës në fjalinë e parë dhe si një dispozitë tepër të rëndësishme për jetën e njeriut dhe të ardhmen e tij, nenin numër 1 (një) Deklaratës (Gruda 2001:19).

Edhe Karta e Kombeve të Bashkuara e San Franciskos (1945), në preambulë, mes të tjerash, përmes konfirmimit të shteteve nënshkruese të ratifikimit të kësaj Karte, specifikon: “. . . shpallim përsëri besimin tonë në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e

personalitetit të tij, në barazinë e të drejtave midis burrit dhe gruas, si dhe midis kombeve të mëdha e të vogla . . .”(Gruda 2001:20, 21).

7.2 Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave sensitive personale

Të dhënat e ndjeshme personale përpunohen vetëm në rastet kur subjekti (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, Prill 2010:5, 6) i të dhënave e ka dhënë pëlqimin e vet dhe nëse përpunimi është i domosdoshëm për arritjen e qëllimeve dhe realizimit të detyrimeve dhe të drejtave specifike të kontrollorit në fushën e punësimit, në pajtim me ligjet respektive në fuqi, të cilat po ashtu ofrojnë masa mbrojtëse të përshtatshme për të drejtat e subjektit të të dhënave.

Përpunimi është i lejuar në rast se është i domosdoshëm për mbrojtjen jetike të interesave të subjektit (qytetarit) të të dhënave, kur subjekti i të dhënave ligjërisht ose fizikisht është i pa aftë për të dhënë pëlqimin e tij/saj.

Gjithashtu, të dhënat e ndjeshme përpunohen nëse përdoren për qëllimin e përpunimit të veprimtarive legjitime nga institucionet, shoqatat, asociacionet, bashkësitë fetare, sindikatat ose organizatat jofitimprurëse për qëllime politike, filozofike, fetare, sindikaliste, humanitare, në rast se përpunimi ka të bëjë vetëm me anëtarësimin e tyre ose subjektet e të dhënave që janë në kontakt dhe lidhje të vazhdueshëm me këto veprimtari, me qëllim që këto të dhëna të subjekteve të mos u zbulohen të tjerëve, pa pëlqimin e tyre me shkrim. Për vendimin mbi lejimin ose pëlqimin për përpunimin e të dhënave sensitive apo të ndjeshme ekzistojnë të njëjtat rregulla si më lart.

Lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së të dhp në progresin shoqëror dhe qytetërimin në nivel global, mendimtari Ayn Rand thotë: “Qytetërimi është progresi kah një shoqërie me privatësi” (Kalendari vjetor i AShMDhP në Republikën e Kosovës, 2014)

Në rast se subjekti (individi) i të dhënave ka bërë publike të dhënat e veta të ndjeshme, pa e kufizuar përdorimin e tyre, në mënyrë të dëshmuar dhe të çartë, ato mund të përpunohen nga ana e kontrolluesit (institucionit publik dhe privat) të të dhënave. Dhe, në raste të tilla nuk ka nevojë për ndonjë pëlqim apo leje paraprake për përpunimin e të dhp të subjektit të të dhënave, nëse ato përpunohen nga punonjësit e shëndetësisë ose

personeli shëndetësor, në pajtim me ligjet që kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit të shoqërisë, individëve dhe menaxhimit e funksionimit të shërbimeve shëndetësore dhe interesit të përgjithshëm publik.

Për të gjithë ata që udhëheqin dhe operojnë me të dhë, veçmas me të dhënat sensitive, është me rëndësi të dinë se vendimet për lejimin ose lirimin, apo pëlqimin ndahen në tri grupe:

- me akses të pakufizuar,
- me akses të kufizuar në përdorimin e internetit të sigurt ose të përdorimi i të dhënave në media,
- me akses shumë të kufizuar te përdorimi i pamjeve fizike apo të dhënave virtuale.

(William, 2013:19)

7.3 Përpunimi i të dhënave nga partitë politike dhe organizatat sindikale

7. 3.1 Partitë politike, duke qenë pjesë integrale e shoqërisë në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e saj, në kuptimin e nxjerrjes së alternativave qeverisëse për udhëheqjen

shtetërore të pushteteve politike dhe ekzekutive në shoqërinë njerëzore, kanë të drejtën e tyre të organizimit politik, duke nënkuptuar organizimin politiko-partiak dhe përfshirjen në anëtarësime të subjekteve aderuese nëpër partitë e ndryshme që kanë programe dhe vizione të ndryshme, përmes të cilave identifikohen dhe dallohen nga njëra-tjetra. “Partitë e formulojnë politikën e tyre për të fituar zgjedhjet dhe jo të fitojnë zgjedhjet për të formuluar një politikë” (Rajno 2007:354).

Prandaj, subjektet e ndryshme politike, përmes programeve politike, rekrutojnë anëtarë të partive dhe përpunojnë të dhënat e tyre personale, si dhe të dhënat e tyre të ndjeshme kur anëtarët e partive politike vullnetarisht me shkrim i deklarojnë ato për realizimin e interesave personale.

Secili përpunim që ndërlidhet me të dhë të individit, anëtar i një partie politike, nënkupton edhe mbajtjen e shënimeve me rastin e këtyre përpunimeve: kohën e zbulimit, llojin e tyre dhe qëllimin e përpunimit.

Në RK-së, partitë politike, si kontrolluese të të dhë për qëllime të përpunimit të të dhë për nevojat e anëtarësisë së tyre, nuk kanë detyrime ligjore për të mbajtur Katalogun e sistemit të dosjeve, nuk kanë detyrime ligjore për lajmërimin me shkrim të ASHMDhP dhe në këtë kuptim, Agjencia, “po kështu, nuk është e detyruar ligjërisht për të mbajtur në regjistër të sistemit të dosjeve partitë politike” (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, prill 2010:12, 13), si kontrollues të të dhë të anëtarësisë së vet.

Kështu, partitë politike në të gjitha dispozitat tjera, përveç këtyre të cekura më lart, i nënshtrohen me të gjitha detyrimet tjera në fushën e mdhp ligjit për mdhp në RK-së.

7.3.2 Organizatat sindikale përmes anëtarësisë së vet organizohen për mbrojtjen e të drejtave të tyre në fushën e punës në të gjithë sektorët e jetës shoqërore. Gjatë këtyre organizimeve bëhen edhe anëtarësime sindikale nëpër sindikata të ndryshme, si: sindikata të punëtorëve të arsimit, shëndetësisë, ndërtimtarisë, elektro-ekonomisë, administratës publike etj. Qëllim i tyre është mbrojtja e të drejtave të punës dhe interesave të tyre. Dhënia e të dhë nëpër sindikata dhe përpunimi i tyre bëhet konform realizimit të interesave të anëtarësisë sindikale dhe me pëlqimin e subjekteve të të dhë. Gjithashtu, përpunimi ligjor i të dhënave të ndjeshme obligon kontrolluesin, gjegjësisht organizatat sindikale, që të mbajnë shënime me shkrim për rastet kur zbulohen ose përpunohen të dhënat e ndjeshme.

Në RK-së, gjithashtu, sindikatat nuk kanë detyrime ligjore për mbajtjen e katalogut të sistemit të dosjeve, nuk kanë detyrim për njoftimin e agjencisë për regjistrin dhe katalogun e sistemit të dosjes së përpunimit të të dhë dhe agjencia nuk ka obligime ligjore për mbajtjen e regjistrin të katalogut dhe sistemit të dosjes për organizatat sindikale.

Të gjitha dispozitat tjera ligjore për mdhp janë të obligueshme, sikurse për të gjithë kontrolluesit tjerë. Edhe përpunimi i të dhë, kur jepen apo kërkohen të dhënat për racën e individit, bien në grupin e të dhënave të ndjeshme dhe gjithashtu si kategori mbrohen me ligjin e mdhp.

7.4 Përpunimi i të dhp nga shoqatat humanitare dhe bashkësitë fetare

Shoqatat dhe bashkësitë fetare po ashtu janë përpunues të të dhp të anëtarësisë së vet dhe të qytetarëve, të cilëve ua marrin të dhp me qëllimet që t'u shërbejnë atyre. Të dhp të anëtarësisë së shoqatave humanitare dhe anëtarëve të bashkësive fetare po kështu konsiderohen të dhëna të ndjeshme.

Të gjitha dispozitat ligjore të ligjit për mdhp të Republikës së Kosovës, te këto kategori të kontrolluesve, janë detyrim ligjor për t'u zbatuar, përveç sistemit të dosjes, lajmërimit të agjencisë dhe mbajtjes së regjistrit.

“Bashkësitë fetare, shoqatat dhe sindikatat nuk obligohen me ligj për mbajtjen e sistemit të dosjeve dhe katalogut të dosjeve” (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, Prill, 2010:4). Këtë kategori të përpunuesve të të dhp ligji nuk e detyron që ta njoftojë agjencinë për mbajtjen e sistemit dhe katalogut të dosjes. Gjithashtu, agjencia nuk ka detyrim ligjor për mbajtjen në evidencat zyrtare të regjistrit (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, prill, 2010:4) te këta kontrollues të të dhp.

Çdo tejkalim ligjor nga qëllimi për çfarë të dhënat e qytetarëve janë marrë në posedim për t'u përpunuar konsiderohet shkelje ligjore. Edhe Direktiva e KE-së 95/46 për mdhp dhe privatësisë këto të dhëna te anëtarësia e këtyre kategorive i konsideron në grupin e të dhënave të ndjeshme; sikurse edhe ligji i mdhp.

7.5 Përpunimi i të dhp të dënuarve dhe pacientëve të sëmurë

Subjektet e ndryshme, me qëllim të marrjes së shërbimeve gjyqësore apo veprimeve të pushtetit gjyqësor, me qëllim të sundimit të ligjit (që mund të jenë gjykuar për vepra penale apo kundërvajtëse), për çfarë kjo kategori e subjekteve edhe në legjislacionin e hapësirës juridike të BE-së, edhe në legjislacionin e shteteve të rajonit, edhe në legjislacionin e Kosovës hyn në kategorinë e të dhënave të ndjeshme, kërkohen rregulla dhe akte të veçanta

të masave mbrojtëse dhe të sigurisë nga autoritetet shtetërore që përpunojnë të dhënat e këtyre subjekteve.

7.5.1 Të dënuarit, për mdhp të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësisë, në mbështetje të Traktatit të BE-së, (Aktet e miratuara sipas titullit VI të Traktatit të BE-së, Vendimi Korniz i Këshillit i 2008/977/JHA, faqe 1, Parimet 2 dhe 3, faqe 1, Vendimi Kornizë i 27 nëntorit 2008, Bruksel, 27 nëntor 2008), nënshkruar për Këshillin nga Presidenti M.Alliot-Marie, specifikon se të drejtat e tyre në mbrojtjen e të dhp për shtetet anëtare detyrimisht i kanë të rekomanduara që të rregullohen dhe harmonizohen me Vendimin Kornizë të Këshillit 2008/977/JHA të 27 nëntorit 2008, me ç'rast shtetet anëtare (ishin obliguar) obligohen t'i raportojnë Komisionit deri më 27 nëntor 2013 për masat që i kanë ndërmarrë për të garantuar pajtim të plotë me këtë Vendim Kornizë, shih; Vendimi Kornizë i Këshillit të Europës (nëntor, 2008) për mdhp të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësisë në çështjet penale, neni 27, Bruksel, (nëntor, 2008:19).

Korniza Juridike e BE-së për mdhp në sektorin e gjyqësisë e specifikon ruajtjen dhe publikimin e të dhp për veprat penale dhe kundërvajtëse në Direktivën 95/46 të mdhp, ku saktëson se “respektimi i plotë i amzës penale lejohet vetëm nën kontrollin e autoritetit shtetëror dhe se vendet anëtare duhet të parashikojnë që përpunimet e të dhënave që kanë lidhje të ngushtë me vendim gjyqësor duhet të realizohen nën kontrollin e autoritetit shtetëror.” (Direktiva 95/46 e KE, e Parlamentit European dhe e Këshillit, tetor, 1995:22). Çdo devijim ose shmangie nga paragrafi i mësipërm, që nuk parashikon siguri për mdhp të subjekteve të kësaj fushe, duke ditur se e ardhmja e tyre denigrohet pikërisht nga publikimi i vendimeve të tilla, publikimet bëhen me komision enkas për këto qëllime.

7.5.2 Pacientët dhe subjektet e të dhënave i japin të dhënat e tyre në sektorin e shëndetësisë. Duke qenë se bëhet fjalë për të dhëna sensitive, të cilat nuk do të duhet të jenë të qasshme për publikun, sa herë që personat e autorizuar të kontrolluesit në aspektin profesional gjatë operimit me të dhëna të këtilla personale hasin në këto të dhëna, duhet të shënohet data, koha, qëllimi i zbulimit të të dhënave të këtilla dhe emri i zyrtarit. Kodet lidhëse dhe qasja në dosjen dhe regjistrin e sistemit shëndetësor, pikërisht për këtë arsye, janë të ndaluara nga opinioni publik dhe kontrolluesit tjerë, përveç rasteve të veçanta të lejuara me ligj. Psh qasja

ose vëzhgimi me sistemin e kamerave me videoincizim do të ishte me pasoja të pariparueshme për subjektin e të dhënave, nëse një sistem i këtillë do vendosej në repartet e neuropsikiatrisë, repartet e maternitetit apo repartet tjera shëndetësore. Dosjet, historitë e sëmundjeve dhe të gjitha të dhënat tjera që lidhen për pacientin, janë të dhëna sensitive dhe zbulimi i tyre është i ndaluar për publikun. Siguria dhe masat mbrojtëse të kësaj kategorie rregullohen me akte të veçanta të kontrolluesve që përpunojnë të dhëna të këtilla. Secili zyrtar shëndetësor që punon në sistemin e shëndetësisë, është i obliguar që t'i nënshtrohet kodit të fshehtësisë, që për të dhënat që i has gjatë punës, të mos i tregojë, në mënyrë që nesër të bëhen të dëmshme për subjektin e të dhp. Po kështu, subjektet e të dhënave, për shkak të sëmundjeve të tyre të ndjeshme, kanë të drejtë që të dhp t'i bëjnë anonime.

7.6 Përpunimi i të dhp për qëllime shkencore, statistikore dhe veprimtari botuese

Pothuajse është e pamundur të mendohet zhvillimi i shoqërisë, planifikimet e qëndrueshme të fushave të ndryshme të zhvillimit njerëzor, pa ndihmën e shkencës dhe të dhënave statistikore. Përdorimi i të dhp për qëllime shkencore dhe statistikore, sipas legjislacionit European, subjektit të të dhp i garantohet e drejta e mbrojtjes ligjore të të dhënave të tij. Një përpunim i këtillë imponon nevojën e mbrojtjes dhe ruajtjes së identitetit të subjektit të të dhp. Mdhp dhe procesimi i tyre në fushën e statistikave, gjithashtu, adresohet edhe përmes “Rekomandimit No R(97)18 të KE-së të 30 shtatorit 1997, adaptuar nga Komiteti i Ministrave, në mbledhjen e 602 të Ministrave Deputet”.⁴³

Shtetet anëtare të BE-së, me qasje unike do të parashikojnë mbrojtje të përshtatshme (Direktiva 95/46, e Këshillit Europian, tetor, 1995:23,25) dhe kanë parashikuar mbrojtje adekuate përmes themelimit të Agjencisë Statistikore Europiane të quajtur EUROSTAT, me ç'rast, duke përdorur standardet e kësaj agjencie, sot grumbullohen shumë të dhëna statistikore, si të dhënat për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare, demografisë, shkollimit etj, duke qenë në harmoni dhe duke respektuar kërkesat ligjore të ligjeve të

⁴³ DATA PROTECTION, Compilation of Council of Europe texts, Directorate General of Human Rights and Legal Affairs Council Europe Strasbourg Cedex, F-67075 www.coe.int/justike
[Council of Europe 2010](#), Reprinted with corrections, (September 2011 : 60)

mbrojtjes së të dhp dhe privatësisë së subjekteve të dhp të shteteve anëtare të BE-së dhe të gjithë atyre shteteve që e aspirojnë anëtarësimin në BE.

Kontrolluesit, me rastin e përpunimit të të dhp të këtilla, nuk obligohen për mbajtjen e sistemit dhe katalogut të dosjes për subjektet e të dhënave, nuk kanë detyrime për njoftimin e Agjencisë për përpunime të këtilla dhe po kështu Agjencia nuk ka detyrime për mbajtjen në evidenca të veta të regjistrit të të dhp.

E njëjta vlen edhe për të dhp, të cilat mediat i përpunojnë për qëllime të informimit. Por, mediat nuk obligohen që me aktet e tyre të brendshme të përshkruajnë procedurat dhe masat e tyre të brendshme të vendosura që të sigurojnë të dhp, duke emëruar persona që janë kompetent për sistemin e dosjeve dhe të cilët merren me përpunimin e të dhp (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, i aprovuar në prill, 2010:11).

Ndërkaq, “Rekomandimi No.R(63) 10, i 23 shtatorit të vitit 1983 e adreson mdhp në fushën e shkencës, kërkimeve dhe statistikave, adaptuar nga Komiteti i Ministrave në mbledhjen e 362 të Deputetëve Ministra të KE-së”.⁴⁴

7.7 Kufizimet e mdhp për arsye të mbrojtjes kombëtare dhe të sigurisë nacionale

Me kornizën ligjore të BE-së, dhe në veçanti me Direktivën 95/46 të mdhp, me Vendimin Kornizë të KE-së 2008/977/JHA të datës 27 nëntor 2008 për përpunimin dhe mdhp në sektorin e gjyqësisë, prokurorisë dhe policisë, me Direktivat e ashtuquajtura “E-Direktivat” mbi komunikimin elektronik të subjekteve të të dhp dhe me shumë akte tjera ligjore, për shkaqe të specifikuara edhe në ligjet e shteteve veç e veç, janë përcaktuar dispozita ligjore që rregullojnë se kur ka përjashtime dhe kufizime gjatë përpunimit të të dhp, dhe në cilat raste.

Nocioni “jetë private” është i gjerë dhe i pakufizueshëm në përcaktim. Në varësi të rrethanave, ai mund të prekë integritetin moral dhe fizik të individit. (Sadushi & Kumbaro, 2012:75)

⁴⁴ DATA PROTECTION, Compilation of Council of Europe texts, Directorate General of Human Rights and Legal Affairs Council Europe Strasbourg Cedex, F-67075 www.coe.int/justike Council of Europe 2010, Reprinted with corrections, (September 2011:87)

Subjektet e të dhp, të cilët të dhënat e tyre i kanë dhënë në disponim të kontrolluesit për realizimin e interesave të tyre legjitime personale, kanë të drejtë në çdo kohë të bllokojnë dhe të ndalojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale, përkohësisht apo në mënyrë të përhershme, nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesin publik. Subjektet e të dhënave, po kështu kanë të drejtë që të kërkojnë nga gjykata, deri sa të lëshohet vendimi përfundimtar, që ta detyrojë kontrolluesin të ndërpresë çfarëdo përpunimi të të dhënave personale, përderisa lënda është në shqyrtim, nëse përpunimi i të dhënave subjektit të të dhënave i shkakton dëme të pariparueshme, nëse shtyrja e përpunimit të të dhënave nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as nuk ka rrezik që palës kundërshtare do t'i bëhej dëm i madh i pariparueshëm.

Kufizime të përpunimi i të dhp mund të ndërmerren nga institucionet e caktuara ligjore e kushtetuese të shtetit për shkaqe të mbrojtjes kombëtare dhe sigurisë nacionale të vendit, dhe ky kufizim mund të bëhet me ligj.

Masat e këtilla të kufizimeve të vëna mund të aplikohen për aq kohë sa është e nevojshme që të arrihen qëllimet, për të cilat janë vënë masat e këtilla të kufizimeve dhe përjashtimeve.

Në rastin i sulmeve terroriste në Francë, sipas artikullit të Telegraf⁴⁵ të datës 14 nëntor 2015 “158 të vdekur nga sulmet në Paris”,⁴⁵ siguria vendosë supermacinë në raport me mdhp, ku rrezikshmëria ka atakuar seriozisht sigurinë kombëtare dhe nacionale.

Këto aspekte kufizuese dhe përjashtuese të të drejtave dhe detyrimeve të kontrolluesve hollësisht janë përshkruar në kornizën ligjore të BE-së, të Vendimit Kornizë. Në këtë vendim është rregulluar edhe afati i zbatimit tek shtetet anëtare të BE-së duhet ta njoftojnë Komisionin Europian deri më 27 nëntor 2013 me tekstin e dispozitave të inkuorpuara në legjislacionin e tyre nacional (shtetëror), të Vendimit Kornizë.

Të gjitha vendet në kuadër të BE-së sipas kornizës juridike të hapësirës së UE janë të detyruara të bëjnë rregullimin ligjor për mdhp të qytetarëve të huaj.

⁴⁵<http://www.telegrafi.com/lajme/158-te-vdekur-nga-sulmet-ne-paris-video-4-28899.html>, shikuar, 14 nëntor 2015

Përfundime të përpunimi i të dhp mund të ndodhin për kohë të caktuar dhe për masa të caktuara, në rastet kur kjo është e ndaluar me marrëveshje ndërkombëtare.

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë së informimit dhe komunikimit, analizuar nga aspekti i të drejtave të njeriut, me mundësi të ndërhyrjeve të thella në jetën private të individit, pashmangshëm me mundësinë e shkaktimit të dëmeve të pariparueshme për jetën dhe të ardhmen e njeriut, veçmas në sektorin e policisë, prokurorisë dhe gjyqësisë, bëri që përpunimi i të dhp, bazuar në Traktatin e BE-së për bashkëpunim, të rregullohet me vendim të veçantë, si; i ashtuquajtur Vendimi Kornizë 2008/977/JHA dhe të jepet si detyrim për të gjitha shtetet anëtare që ta vënë në legjislacionet e tyre.

Sipas këtij Vendimi Kornizë të KE-së 2008/977/JHA, sipas Titullit VI të Traktatit, shih, Vendimi Kornizë i Këshillit 2008/977/JHA (nëntor, 2008) të BE-së, nenit 1 paragrafit 2a të Propozimit për një Direktivë, kërkohet nga KE dhe BE që të inkorporohen në Direktivat e ardhshme, për të “. . mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë dhe në veçanti të drejtën e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale . . .” (Vendimi Kornizë i Këshillit 2008/977/JHA, nëntor, 2008, neni 1, paragrafi 2a i Vendimit), dhe për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë, dhe në veçanti të drejtën e tyre për privatësi, në lidhje me përpunimin e të dhp në kuadër të bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësorit në çështjet penale për mdhp.

Të dhëna të rëndësishme të parapara për adaptimet ligjore në nivele nacionale (shtetërore) në shtetet anëtare, me këtë vendim për mbrojtjen e parimeve të këtilla, janë veçuar:

“Parimi i ndalimit me rezervimin e lejes, parimi i qartësisë, parimi i domosdoshmërisë, parimi i përshtatshmërisë, parimi i qëllimit të kufizuar, parimi i ruajtjes së kufizuar”.⁴⁶

Me këto parime nënkuptojmë se, kur përpunimi i të dhp është i ndaluar, përveç kur lejohet në mënyrë eksplicite, dispozitat ligjore duhet të jenë të qarta dhe specifike, të dhp nuk duhet të procedohen, në qoftë se nuk është e nevojshme në një kuptim të rreptë dhe të domosdoshëm për përmbushjen e detyrave të policisë, dhe fakti se këto të dhëna janë të dobishme nuk është

⁴⁶Dokumenti i TAIEX-it, Analize e ligjit nr.04/L-76 për policinë dhe kodin e procedurës penale duke përfshirë sugjerimet për ndryshime, TAIEX 48700, (shtator, 2012:6).

i mjaftueshëm. Një aktivitet i policisë mund të jetë i paligjshëm (kuptohet te ndërhyrja e cenimit të të dhp dhe të privatësisë), nëse nuk është i përshtatshëm; ndryshimi në qëllimin e të dhënave të ruajtura është i lejuar vetëm nëse ekziston një dispozitë ligjore që rregullon këtë ndryshim dhe specifikimi i ruajtjes së të dhënave duhet të jetë i qartë. “Të dhp mund të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme dhe kjo është e kontrolluar rregullisht, veç tjerash edhe me mjete automatike të përpunimit të të dhp. Duhet pasur parasysh se incidentet që ndodhin në publik mund të jenë pjesë e jetës private të një individi dhe ato mund të kenë një masë pritshmërie të privatësisë” (Sadushi & Kumbaro, 2012:71).

Konfliktet e hapura në regjione të ndryshme botërore, organizata të shumta të terrorizmit deri te ato shumë të forta në nivel ndërkombëtar, larmia e madhe e organizatave terroriste me karaktere të ndryshme vepruese në nivele rajonale e ndërkombëtare të krimit financiar, krimit kibernetik, krimit ekonomik, trafikimit të drogës, trafikimit të qenieve të gjalla, shtypjet sociale, shtypjet dhe mohimi i të drejtave elementare të njeriut, mohimi i të drejtave dhe lirive të grupeve etnike, sulmet, shkatërrimet dhe bllokimet e faqeve zyrtare të institucioneve të rëndësishme jetike të kompanive, të agjencive financiare politike e diplomatike të shteteve anekënd botës sot përbëjnë sfidën kryesore të shoqërisë njerëzore për ruajtjen dhe promovimin e paqes në botë.

Në këtë kuptim, në mbrojtje të paqes dhe lirisë së përgjithshme të njerëzimit, sot ka misione të shumta të organizuara nëpër botë, sidomos nga OKB-ja, përmes forcave paqeruajtëse, të cilat, shikuar nga funksioni i tyre historik, vazhdojnë të luajnë rolin në “. . . diplomacinë parandaluese, arritjen e paqes, ruajtjen e paqes, ndërtimin e paqes” (Bashkurti, 2010:246).

Për këtë arsye fitohet e drejta e përjashtimeve të kufizuara te përpunimi dhe ruajtja e të dhp, sipas rregullave të shpjeguara më lart dhe sipas legjitimitetit të përpunimit të tyre.

Duke ndërlidhur të drejtën e sigurisë, të sundimit të ligjit, të drejtën e qasjes në informata dhe të drejtën e privatësisë, shohim se ndërveprimi i këtyre të drejtave pothuajse nuk dallon për nga rëndësia. Por përparësia mund të jepet për secilin rast të analizuar veç e veç në kontestin e zhvillimeve dhe realitetit të mohimit të të drejtave të subjekteve të të dhp dhe rrezikimit serioz të tyre me rastin e abuzimit dhe shkeljes së të dhp. Nëse analizojmë rastin e sulmeve të 11 Shtatorit në vitin 2001 nga Al-Kaeda në Qendrën Botërore të Tregtisë në Nju Jork, me

ç‘rast u shkatërruan kullat binjake dhe u sulmua edhe Pentagoni, përfundimet tona janë të qarta se rreziku nga këto përmasa terroriste rrezikuan plotësisht paqen, stabilitetin, jetët e njerëzve dhe mbrojtjen e SHBA-ve. Në përpjekje për të siguruar emrat e udhëtarëve që ishin në aeroplanët që përplaseshin në kullat binjake, Xhorxh Tenet, drejtor i CIA-s, kur ishte fjala te privatësia dhe mdhp, deklaroi si vijon:

“Më vonë tregova përgjigjen fillestare për disa pjesë të burokracisë (pjesë të braktisura me dashje) se listat e udhëtarëve nuk mund të përdoren edhe nga CIA. Aty përfshiheshin çështje private. Disa prova të vogla dhe vetëm katër fjalë të shkruara më vonë, listat erdhën...” (Tenet, 2012:211)

Si rezultat i burokracisë dhe mosharmonizimit ligjor, shpjegon më vonë Tenet, theksoheshin dilemat e supermacive ligjore, ku vonesat në minuta dhe sekonda shndërroheshin pashmangshëm në tragjedi njerëzore (Tenet, 2012:213).

Në përgjithësi, rrezikimi i Mbrojtjes Kombëtare dhe Sigurisë Nacionale përbën raste përjashtimore të dispozitave të caktuara, ndaj mund të kapërcehet aplikimi i dispozitave të kërkesave ligjore kur bëhet fjalë rreth regjistrimit, njoftimit dhe katalogut të dosjeve nga ana e kontrollorëve, si dhe informacionin për subjektin e të dhp. Këto masa merren për aq kohë sa është e nevojshme që të arrihet qëllimi për çfarë edhe janë vënë këto masa.

7.8 Kufizimet te mbrojtja e të dhp për shkaqe të sigurisë publike

Siguria publike në shumicën e rasteve rrezikohet me rastin e atakimit dhe luhatjes së sistemit financiar të një vendi, përhapjes së sëmundjeve të rrezikshme ngjitëse që kalojnë edhe kufijtë lokalë, epidemive të ndryshme, kur nga grupe kriminale apo individ të përfshirë në veprimtari kriminale rrezikohet liria e personave tjerë. Këto janë disa arsye, kur disa dispozita të caktuara të ligjit të mdhp kanë kufizime, për aq kohë deri sa nuk përfundon arsyetimi për çfarë edhe janë vënë këto masa.

Elemente të kufizimit për shkaqe të sigurisë publike dhe nacionale dhe fshehtësisë së ligjshme për shkaqe gjithashtu sigurie, në vete bartin edhe elementin e fshehtësisë, ku subjekt i fshehtësisë vlerësohet se është vet ai subjekt, të cilit i përket informata. Edhe “përfaqësuesit

e doktrinë gjermane Shenke dhe Shreder subjektin e fshehtësisë e kanë quajtur ‘pronar të fshehtësisë’ ”(Najman, 1967:124).

Masa kufizuese mund të ketë edhe tek rastet e hetuesisë: me rastin e vënies së masave mbrojtëse të subjekteve të dhp gjatë procedurave hetimore, kur jeta e personave është vënë në rrezik, apo hetimi bëhet me rastin e arsyetimit të zbardhjes së veprave penale-kriminale.

Në përputhje me nevojat për një shoqëri demokratike dhe sipas të “Drejtës Penale Europiane”, interceptimi duhet të mbështetet në motive të përshtatshme dhe të mjaftueshme, në mënyrë që parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit të respektohen dhe se e drejta e brendshme duhet të ofrojë garanci procedurale. Këto garanci mund të përputhen me ato që rrjedhin nga kërkesa për parashikueshmëri. Gjithashtu, “garancitë duhet t’i atribuohen atij që pretendon se është viktimë e ndërhyrjes nëpërmjet interceptimit të bisedave të tij telefonike, në sajë të përgjimit të një personi të tretë” (Pradel & Corstens, 2010:414), dhe cenimit të të drejtave personale dhe të privatësisë së tij.

Për të gjitha këto theksime të vendosura në këtë artikull dhe në artikullin te siguria kombëtare, është e vetëkuptueshme se paraprakisht organet e hetuesisë-prokuroria duhet të sigurojnë fillimisht autorizimin e vendimit nga Gjykata e Hetuesisë, për t’i hapur pastaj rrugë veprimit legjitim të organeve shtetërore kompetente. Ndërkaq, përjashtimet mund të ndodhin në masë të kufizuar edhe në rastet e shkeljes së etikës për profesionet e caktuara, interesit të rëndësishëm ekonomik ose financiar të RK-së, duke përfshirë çështjet monetare, buxhetore dhe të taksave si dhe të mbrojtjes së subjekteve të të dhënave ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve (ligji për mdhp i Republikës së Kosovës, prill, 2010:17).

Mirëpo, mbrojtja e privatësisë dhe e drejta për t’u informuar mbi privatësinë duhet të sigurohen me mbrojtje adekuate në zbatimin e “..parimeve të privatësisë së dizajnuar në projektimin dhe funksionimin e shtetit, në vendosjen e mbikëqyrjes ligjore dhe insistimin mbi vendosjen e rregullave dhe normave juridike të sistemit gjyqësor dhe pavarësisë së sistemeve tjera të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies ligjore” (Cavoukian, 2013:8).

Procedurat dhe masat organizative teknike rreth aspekteve të përshkrimit të masave mbrojtëse konform kornizës ligjore të Procedurës Penale, të Kornizës Ligjore Penale, në harmoni me Vendimin Kornizë të KE-së 2008/977/JHA dhe Direktivës EC 95/46 për mdhp,

nxirren akte të veçanta të udhëzimeve administrative apo rregulloreve për sektorë të caktuar të prokurorisë, policisë dhe gjyqësisë, ndër të tjera, përcaktohen edhe afatet kohore të ruajtjes së këtyre të dhënave, bllokimit të tyre, kufizimit për qasje, si edhe shkatërrimit të tyre.

7.9 Përjashtimet dhe masat tjera kufizuese në sektorët tjerë të të dhp

Në sektorë të ndryshëm të jetës dhe punës, në përditshmërinë e jetës së njeriut shumë të drejta të njeriut janë të garantuara me konventa ndërkombëtare dhe si të tilla këto të drejta janë bartur në kushtetutat nacionale dhe pastaj janë bërë pjesë e ndërtimit të kornizave të veçanta ligjore.

Nga këto ligje kanë dalë edhe shumë autoritete me detyra specifike p.sh. sindikatat e punës, si shoqata të punës kujdesen dhe veprojnë konform Ligjit mbi Sindikatat.

Autoritetet e pavarura të mediave veprojnë dhe kujdesen për veprimtarinë ligjore të mediave në bazë të ligjit mbi mediat. Partitë politike veprojnë në bazë të ligjit mbi partitë politike dhe në bazë të procedurave zgjedhore të ligjit zgjedhor, duke hyrë në garë për marrjen e timonit të shtetit dhe udhëheqjen e tij. Veprimtaritë shkencore, hulumtuese, botuese, artistike etj. të një vendi organizohen dhe veprojnë me ligje specifike të fushave respektive me synim të zhvillimit të shoqërisë njerëzore në të gjitha fushat e jetës. Shoqatat e ndryshme të shoqërisë civile, bashkësitë fetare dhe asociacionet e ndryshme humanitare, shoqatat e ndryshme sportive e sociale dhe të karaktereve të përafërta veprojnë në të mirën e shoqërisë, dhe që të gjitha janë të organizuara mbi bazën ligjore të nxjerrë dhe të aprovuar nga ana e shtetit dhe e përmbushin gamën e kërkesave të dala nga të drejtat universale të njeriut, si:

- për t'u organizuar politikisht,
- për mbrojtje të të drejtave të punës,
- për mbrojtje të të drejtave të autorësisë, patentave dhe rregullit të konkurrencës në sferën e prodhimit,
- të drejtën e besimit të lirë fetar,

- të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur,
- të drejtën e bashkimit në shoqata dhe asociacione të ndryshme për interesa dhe fusha të ndryshme të jetës dhe punës,
- të drejtën për t'u informuar dhe për të ditur,
- të drejtën për qasje në dokumente publike-zyrtare etj.

Të gjitha këto veprimtari e aktivitete sot zhvillohen në të mirën e njerëzimit, andaj edhe shumica syresh janë edhe kategori e të drejtave të garantuara kushtetuese dhe bien në grupin e të drejtave dhe lirive të njeriut, të cilat detyrimisht kërkohet që të zbatohen në praktikë, përderisa si pushtet i tretë në nivel të Europës, sistemi juridik europian, këto të drejta i merr nën mbrojtje përmes GjD me seli në Strasburg.

Privatësia dhe të dhp bien në grupin e të drejtave themelore të njeriut; ndërvarësia e këtyre të drejtave natyrisht se prek edhe fushat e të drejtave që u theksuan më lart dhe në këtë rast subjekti i të dhënave, për shkak të anëtarësimit në subjektet kontrolluese, organizatat e ndryshme, si: partitë politike, organizatat fetare e sindikale, shoqatat, veprimtaritë botuese, shtypit etj, për ushtrim të pavarur dhe pa ndërhyrje të shtetit e gëzon lirinë e veprimit, dhe të dhënat e grumbulluara personale për këto anëtarësime përdoren pa pasur nevojë që autoritet e mdh të marrin njoftimin e regjistrimit të tyre. Gjithashtu, nuk kanë nevojë edhe kategoritë e përpunimit të këtyre të dhënave dhe të sistemimit të tyre në katalogun e dosjes në faqet zyrtare të autoriteteve mdhp (AShMDhP). Ligji i mdhp aplikohet dhe zbatohet edhe te këto kategori të theksuara më lart, në të gjitha rastet, përveç atyre të theksuara sipas ligjit.

Për këtë kategori të operuesve dhe përpunuesve të të dhp janë dhënë shpjegime të hollësishme te përpunimi dhe grumbullimi i të dhp në kapitullin 9 të ligjit për mdhp, te përpunimi i të dhënave të ndjeshme (sensitive). Aspektet procedurale mund të jenë një ndër faktorët që përbëjnë shkelje të të dhp dhe privatësisë së individit. Prandaj, mungesa e procedurave, e cila shkakton “pamundësinë e realizimit të një mbrojtje efektive në të drejtën për respektimin e jetës private, cenon nenin 8 (tet)” (Corstens2010:220); në këtë rast vlerësohet se janë të cenuara të drejtat mbi privatësinë e individit.

KAPITULLI VIII: PAJISJET QË PËRPUNOJNË TË DHËNA PERSONALE DHE MASAT E MBROJTJES DHE SIGURISË SË TË TYRE

8.1 Pajisjet që përpunojnë të dhënat personale

Pajisjet që përpunojnë të dhp, janë të shumëllojshme. Ato mund të ndahen dhe grupohen sipas mënyrës së punës dhe fushës në të cilën përdoren.

Por, shikuar në aspektin e aplikimit të përgjithshëm, ato mund të ndahen në:

- pajisje kompjuterike,
- pajisje telefonike/telekomunikuese (telefonja celulare),
- pajisje videovëzhguese,
- pajisje kriptuese dhe inkriptuese,
- pajisje bartëse (çipa të ashtuquajtura fleshe apo usb),
- pajisje serverike,
- pajisje shtypëse ose makina printuese,
- pajisje skanuese.

Në kohën e sotme, të gjitha këto pajisje e kanë mundësinë e funksionimit dhe lidhjes së përnjëhershme, duke mundësuar kështu punën e përbashkët të të gjithave në procesin e kryerjes së një pune gjatë përpunimit të të dhp. Pra, në sajë të këtij zhvillimi, është e mundur që të bëhen përpunimi, arkivimi, ruajtja dhe shumëzimi, transferimi-dërgesa nga një vend në një vend tjetër, printimi, telepërpunimi, dekriptimi dhe inkriptimi i të dhp, duke shfrytëzuar angazhimin e përnjëhershëm të të gjitha këtyre pajisjeve në procesin e procesimit të të dhp.

Për rëndësinë që ka procesimi dhe përpunimi automatik i të dhënave edhe (OECD) Organizata për Zhvillim Ekonomik dhe Kooperim (deri në tetor të vitit 2013, kishte 33 shtete anëtare dhe plus partnere në bashkëpunim është edhe BE-ja)⁴⁷, ka evidentuar sfidat globale në të cilat duhet punuar, veçmas për problematikat ligjore gjatë përpunimit automatik të të dhënave dhe të drejtat mbi privatësinë dhe liritë individuale në këtë proces të automatizimit të njerëzimit në nivel global, dhe ka bërë rekomandime për zgjidhjen e këtyre sfidave.

Në këtë grumbull të përdorimit të këtyre pajisjeve, me rëndësi është të krijohen rregulla dhe të përdoren masa adekuate të sigurisë, të cilat garantojnë përpunim dhe mbrojtje të sigurt të të dhp.

Në vazhdim po japim disa shpjegime themelore për këto pajisje, me qëllim të plotësimit të njohurive tona themelore lidhur me mundësitë e tyre tekniko-teknologjike të operimit me të dhp, pa pretenduar që të futemi në konstruksionet dhe karakteristikat e tyre të ndërtimit teknik, ngase ky nuk është objektivi i këtij studimi.

8.2 Pajisjet kompjuterike

Makinat kompjuterike e kanë modernizuar punën e njeriut dhe kanë sjellë avantazhe të reja të perceptimit shkencor në rrjedhat e përgjithshme të zhvillimit njerëzor në tërë globin tonë, duke vendosur kështu edhe teza të perceptimeve shkencore në përgjithësi për dukuritë e ndryshme në univers.

Përdorimi kaq i gjerë i kompjuterit ka bërë që kjo pajisje të përsoset tej mase, dhe veçmas përdorimi i kësaj makine do të zë vend të rëndësishëm në përpunimin, ruajtjen dhe transferimin e të dhp.

⁴⁷Shënim: Shtetet anëtare në këtë organizatë janë: Australia, Austria, Belgjika, Kanada, Qili, Çekia, Danimarka, Finlanda, Franca, Estonia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlandë, Izraeli, Italia, Japonia, Koreja, Luksemburgu, Meksika, Holanda, Zelanda e Re, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndërsa edhe BE-ja është në partneritet me këtë organizatë. Deri në shkrimin e këtij libri shtete anëtare të OECD janë të evidentuara shtetet e theksuara më lart.

Se sa ka rëndësi aspekti i punës, përpunimit të të dhë dhe privatësisë në kompjuter, me dekada të tëra në aspektin shkencor, nga ekspert, shkencëtarë, universitete, institute dhe autoritete të ndryshme europiane organizohen për çdo 26 janar konferenca shkencore të kësaj tematike.⁴⁸

Kompjuteri në pjesët e memories mund të ruajë shumë të dhëna, edhe pas daljes nga përdorimi. Kështu që, kontrollorët (organet publike dhe private), pas largimit nga përdorimi të këtyre pajisjeve, duhet pasur kujdes që pjesët harduerike (integralet e memories) të hiqen dhe të asgjësohen, me qëllim që t'i ikin mundësisë për ekspozimin e rrezikut me të dhë, përmes pjesëve harduerike, të cilat tashmë si pjesë të vjetruara mund të dalin në depo të shitjes.

Masat organizative teknike të sigurisë mbeten obligim për kontrolluesin që paraprakisht të krijohen rregullat e përdorimit të këtyre pajisjeve, si: emërtimi i përdoruesit të pajisjes, çelësi (fjalëkalim) i sigurisë nga përdoruesi i pajisjes, evidentimi i qasjes nga të tjerët (kush dhe kur i është dhënë qasja, si dhe përshkrimi i arsyes), pranimi dhe dorëzimi i pajisjes, inventarizimi i saj etj. Këto janë parakushtet themelore që ndihmojnë suksesin e menaxhimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të masave mbrojtëse për mdhp.

Punimet e Konferencës së 35-të Ndërkombëtare të Autoriteteve mdhp, mbajtur në Varshavë të Polonisë, më 26 shtator 2013, kanë adresuar si çështje prioritare qarkullimin kompjuterik të të dhë përmes rrugëve të internetit dhe lidhur me këtë janë adresuar kërkesa sidomos në hartimin e aplikacioneve të këtyre pajisjeve që kane masa mbrojtëse për të dhë, (Web faqja e Konferencës së 35-të Ndërkombëtare për mdhp, mbajtur në Varshavë të Polonisë, 23-26 shtator 2013, shikuar më 01.12.2013.)

8.3 Pajisjet telefonike – telekomunikuese

⁴⁸ [https://www.google.com/search?q=konference+26+january+and+privacy+kompjuter & rlz = 1T4ADFA_en__487__488&oq=Konference+26+january+an+Pvacy+kompjuter&gs_l = heirloom-serp](https://www.google.com/search?q=konference+26+january+and+privacy+kompjuter&rlz=1T4ADFA_en__487__488&oq=Konference+26+january+an+Pvacy+kompjuter&gs_l=heirloom-serp).

Në shpjegimet e sipërme është folur për telefonin, zhvillimin e tij dhe mundësitë që posedon telefonia në komunikimin njerëzor. Pajisjet telefonike me ndihmën e internetit dhe stacioneve satelitore kanë hapur faqe të re gjigante të mundësisë për përcjelljen e informatës kudo. Në qendër të vëmendjes për marrjen dhe dhënien e informatës është njeriu, edhe si operator, edhe si objekt me tërë arsenalin e të dhënave të jetës së tij personale dhe private.

Sot, pa humbur kohë, njerëzimi pa përjashtim përcaktimi politik, besimi fetar, sistemi organizativ shtetëror, gjinie dhe aspekti social, dhe pa u hamendur po vepron në përmbushje të detyrimeve të Kornizës Ndërkombëtare Juridike në mbrojtjen e të drejtave personale të individit.

Në këtë aspekt çdo vit po organizohet Konferenca Ndërkombëtare për mdhp, Konferenca pranverore e autoriteteve europiane e mdhp (çdo dy vjet), Konferenca Regjionale e autoriteteve të mdhp të Europës Juglindore, Konferenca Regjionale e autoriteteve dhe grupeve të ndryshme të punës për tema të caktuara të interes, të cilat janë të shpeshta në secilin kontinent.

Aspekti i komunikimeve elektronike, të drejtat e subjekteve, detyrimet e tyre si shfrytëzues të shërbimeve telefonike dhe autoritetet mbikëqyrëse në këtë fushë më së miri janë rregulluar nga BE, i cili ka nxjerrë Direktivë të veçantë mbi përpunimin dhe komunikimin në sektorin elektronik (Direktive on privacy and electronic communications) për shtetet anëtare të BE-së, e cila ka marrë bazën mbështetëse të Direktivës 95/46 për mdhp, por ka “nxjerrë edhe rregulla specifike për sektorin e komunikimeve elektronike.”⁴⁹

Bashkëpunimi ndër-institucional i autoriteteve të mdhp, autoritetit rregullator të sektorit të komunikimeve elektronike, operatorëve të telekomunikimit dhe autoriteteve shfrytëzuese të këtyre shërbimeve garanton respektimin reciprok të legjislacionit dhe jep garanci për siguri dhe mbrojtje adekuate të të dhënave në nivel vendi për ngritje efikase të

⁴⁹ (Direktiva 2002/58/EC of dhe European Parliament and of dhe Council of 12 July 2002 concerning the processing of personal data and dhe protection of privacy in dhe electronic communications sector. Web.faqja e Bashkimit Europian për Komunikimet Elektronike, shikuar më 10 tetor 2012)

komunikimeve elektronike dhe cilësi të shërbimeve në këtë sektor. Parlamenti European dhe Këshilli më 15 mars 2006 e kanë nxjerrë dhe aprovuar, njëherazi duke sjellë amendamente të reja dhe plotësime në direktivën e re, Direktivën 2006/24/EC.

8.4 Pajisjet videovëzhguese

Në kapitullin e shtatë të “Privatësia në zhvillimin e teknologjisë së informimit dhe komunikimit” është folur dhe janë dhënë shpjegime lidhur me pajisjet video dhe audiovëzhguese. Këto pajisje sot përdoren në masë shumë të madhe, dhe kryesisht përdorimi i tyre justifikohet me arsyetime për masa sigurie të pronës dhe të njerëzve. Përdorimi i këtyre pajisjeve bëhet edhe për qëllime informimi të teletransmetimit dhe nevojave ushtarake në sektorin e mbrojtjes dhe atë të politikave.

Vëzhgimet e imazheve, me ndihmën e këtyre pajisjeve mund të bëhen në distanca të gjata dhe me rezolucione të forta të fotografisë dhe zërit, në rastet kur kemi të bëjmë drejtpërdrejt me të dhp të ndjeshme për individin.

Pajisjet janë me mundësi regjistrimi të incizimit në disketa, CD, flesha dhe VHS-kaseta, ku imazhet dhe zëri mund të përcillen përmes serverëve në monitor dhe me rrugë transmetuese të internetit përcjellja e regjistrimeve mund të bëhet në secilin skaj të rruzullit tokësor.

Nisur nga ky aspekt është krejtësisht e qartë se privatësia e individit, të dhënat e tij personale dhe jeta e tij private është e atakuar seriozisht, nëse ky aspekt i jetës private nuk do të ishte i rregulluar me masa ligjore të mbrojtjes së privatësisë dhe të dhp.

Autoriteti shtetëror që bën mbikëqyrjen e vëzhgimit me kamerë, pa përjashtuar edhe autoritetet e organeve private, për qëllime të sigurisë së pronës dhe njerëzve dhe sigurisë së përgjithshme të specifikuar sipas ligjit, duhet të jetë e kufizuar dhe duhet vendosur me shkrim zyrtar, apo individ të caktuar, si “oficer policie”(në bazë të përgjegjësisë ligjore dhe detyrës zyrtare policia janë vëzhguesit dhe përdoruesit më të mëdhenj të këtij sistemi). Një rregullim i mbikëqyrjes shtetërore mund të shmang dyshimet e

panevojshme dhe të kota, duke treguar se të dy efektivet me të vërtetë janë të mundura “Siguria Publike dhe Mbrojtja Rigoroze e Privatësisë” (Cavoukian, 2013:16,17)

Andaj, njerëzimi po vendos masa strikte të mdhp në këtë sektor kaq të ndjeshëm. Kështu, ekzistojnë rregullore të veçanta dhe udhëzues lidhur me përdorimin e sistemeve të vëzhgimit me kamera⁵⁰ në sektorin publik dhe atë privat, ku specifikohen saktë rregullat, si: vendimi i përdorimit të këtyre sistemeve, arsyeja e përdorimit, afati kohor i ruajtjes së këtyre incizimeve, masat mbrojtëse, e drejta e qasjes, njoftimet standarde lidhur me hapësirat vëzhguese etj. Shkelja e këtyre rregullave, rrezikon edhe ndërmarrjen e masave administrative nga autoritetet mbikëqyrëse të mdhp.

Mirëpo, vëzhgimi i hapësirave publike nga sektori i policisë për qëllime sigurie ende kërkon qartësime dhe vendosje të rregullave akoma më të qarta për sa i përket afateve të ruajtjes së këtyre vëzhgimeve, sigurisë së tyre dhe të drejtave për qasje nga ana e subjekteve të të dhp.

8.5 Pajisjet inkriptuese dhe dekriptuese

Përcjellja e dërgesave të fajlave me të dhp nga një vend në një vend tjetër, qoftë brenda një shteti apo jashtë tij, përmes rrugës elektronike duke shfrytëzuar internetin, çdo herë është në rrezik të ndërhyrjeve të mundshme nga ajri: të deshifrimit, leximit ose marrjes së shënimeve, nëse ato nuk kodohen paraprakisht nga IP-ja dërguese.

Inkriptimi si proces është kodim i informacionit i cili ruhet në një pajisje me një shtresë të mëtejshme të sigurisë. Kjo konsiderohet si masë themelore e sigurisë kurë të dhp ruhen në një pajisje portative apo transmetohen përgjatë një rrjeti publik.

Pajisjet për kriptim mund të vendosen në pajisjen kompjuterike (pajisja inkriptuese) dhe të gjitha shënimet inkriptohen, në mënyrë që të evitohet mundësia e deshifrimit dhe leximit të tyre nga ndërhyrjet e fshehta të jashtëligjshme, para se të nisen në drejtim të marrësit të materialit, në adresën e të cilit është nisur dërgesa. Gjithashtu, edhe IP-ja

⁵⁰ www.amdp-rks.org net, Web faqja e Agjencisë Shtetërore për MDhP, shikuar më 20.12.2013)

pranuese duhet të jetë e pajisur me pajisje dekriptuese, e cila ka shifra të kodeve njohëse me pajisjen inkriptuese që është e vendosur në IP-në e dërguesit, në mënyrë që mundësia e njohjes reciproke për leximin e dërgesës të jetë e mundshme dhe shënimet pas dekriptimit t'i kthehen origjinës (tek adresa e pranuesit). Pasi që rëndësia e mdhp ka alarmuar të gjitha shtetet e botës, nga email updates në informatën e fund vitit (19 Dhjetor 2014), në zhvillimet fundit në mbrojtjen e privatësisë në mbarë botën gjejmë, në mes tjerash, se: “edhe Afrika e Jugut miraton ligjin e plotë për mbrojtjen e të dhënave personale”, ndërmerren ndryshime në mdhp në Azi (Kazakistan, Singapor, Tajlandë, Kore të Jugut)”, “ShBA shkon në një perspektivë vendosjeje për Safe Harbor gjatë vitit 2014”, në Kinë “mbrojtja e të dhënave personale në Kongresin e Popullit Kinez zgjerohet dhe futet në ndryshimet e ligjit të prodhimeve të konsumit”.

“Kompanitë e përpunimit të të dhënave të ndjeshme përballen me inspektime të fuqishme në Belgjikë” marrë nga www.Privacylaws.com/subscription_info, informata të pranuar, nga International OUT NOW, (19 dhjetor 2013, shikuar në ora 10.00h). Shikuar nga këndvështrimi i këtyre zhvillimeve, plotësisht është i justifikuar aplikimi dhe përdorimi i këtyre pajisjeve gjatë përpunimit dhe transferimit të të dhp.

Të dhënat, standard, të inkriptimit janë të rregulluara me standarde. ”Për herë të parë DES (Data Encryption Standard) u botua në vitin 1977 nga Zyra Kombëtare e Standardeve (me këtë emër u quajt nga Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë), për përdorim në aplikimet komerciale dhe të paklasifikuara nga Qeveria e ShBA-ve” (Kaufman & Periman, 201:62).

DES është më tepër efikas kur zbatohet në pajisjet e “forta”/harduerike se sa te pajisjet “programore”/softuerike, ku zbatimi është relativisht më i ngadalshëm.

Kjo rrugë e dërgesave të sigurta e ka një kosto të konsiderueshme, por siguria e të dhënave personale dhe privatësisë është shumë e avancuar dhe në këtë rast kjo metodë e punës më tepër përdoret gjatë komunikimit në mes dikastereve të shtetit me nivelin e sigurisë së lartë, kabineteve të kryetarëve të shteteve, agjencive të inteligjencës, ambasadave, njësive speciale të ushtrisë etj.

Në përpjekjet globale të njerëzimit përmes proceseve nëpër të cilat po kalon njeriu dhe sfidës për ruajtje dhe mbrojtje të privatësisë si nevojë imediate e “shekullit të teknologjisë”, përdorimi i pajisjeve për kriptim dhe dekriptim pothuajse është bërë i pashmangshëm.

Adaptimi i rregullave dhe masat e nevojshme të sigurisë janë pjesë e pandarë e punës së institucioneve mbikëqyrëse të mdhp, natyrisht edhe e kontrollorëve dhe operatorëve që operojnë me të dhp të qytetarëve kudo qofshin ata, pa marrë parasysh kategorinë sociale, nacionale, racore e gjinore të tyre.

8.6 Pajisjet harduerike/bartëse (fleshat, CD, disketat, kasetat, zip-drajverët etj.)

Bartja, përcjellja dhe ruajtja e të dhp kryesisht bëhet me mjete dhe pajisje ndihmëse, të cilat mundësojnë manipulim të lehtë dhe komod nga secili qytetar, me ç’rast eliminohet barra e rëndë e letrave dhe dosjeve të shumta, që dikur ishin ngarkesa sa të shumta, aq edhe të mërzitshme për individin.

Këto pajisje janë të shumëllojshme dhe të përshtatshme për pajisjen e shtëpizës kompjuterike kur shfaqet nevoja për bartje të materialeve për printim, deponim apo demonstrim. Fuqia dhe kapaciteti i tyre sillet nga ato me kapacitete të vogla deri tek ato me kapacitete tejet të mëdha, që ia kalojnë edhe kapaciteteve të vet kompjuterëve. Përderisa, zip-drajverat kanë mundësi për të pranuar materiale shumëfish më shumë se sa vet mundësia e kompjuterit në një hapësirë tejet të vogël, ku shënimet në formë të presuar apo me “ngjeshje” e krijojnë mundësinë që pajisja/disku të jetë e konstruksioneve të vogla, tani praktikohen që këto pjesë në formë të disqeve të jenë pjesë e kompjuterit, ku ruhen të dhënat dhe shënimet e përgjithshme gjatë punës.

Të gjitha këto pajisje, përfshirë laptopet, kompjuterët, telefonat e mençur, kompjuterët portabël etj., ndryshe quhen pajisje portative, ku veçanërisht janë të cenueshme nga vjedhjet dhe humbjet aksidentale. Kështu që kontrolluesi i të dhënave duhet ta konsideron esenciale ruajtjen e të dhp. Andaj duhet të kemi në mendje që këto pajisje duhet të inkriptohen.

Varësisht nga lloji, këto pajisje (vegla) ndihmëse dhe bartëse ndahen në:

- flesha (USB),
- disqe (CD),
- disketa/kartela,
- kaseta.

Gjatë operimit me to, duhet të kemi kujdes të shtuar në ruajtjen e tyre nga lagështia dhe temperaturat e larta. Ndërsa, sa i përket sigurisë gjithnjë duhet të jemi vigjilent kur kemi të bëjmë me mdhp, duke bërë kodimin e tyre me çelësa (fjalëkalim) dhe gjithmonë duke patur parasysh mbrojtjen nga viruset përmes instalimit të sistemeve mbrojtëse të antivirusëve.

Ruajtja, kodimi dhe mbrojtja e informatave në këto vegla mund të bëhet edhe veç e veç me rastin e fjalëkalimit në fjalë të veçantë, dhe secilës dosje mund t'i vendosim fjalëkalim (çelës) të veçantë (hapja e dosje kërkon njohjen e fjalëkalimit).

Në kompjuterët ku kyçen këto pajisje duhet të sigurohemi paraprakisht se ata kompjuterë janë të mbrojtur nga viruset, në mënyrë që pajisja jonë të jetë e sigurt dhe materialet tona mos të shkatërrohen ose “kapen nga hakerët kujdestarë”, të cilët lundrojnë në hapësirën e rrjeteve kompjuterike dhe çdo ditë ne dëgjojmë informata në kanalet televizive, në gazeta, në radio dhe në internet, se: “Hakerat kosovarë sulmuan 13 faqe zyrtare të Serbisë”, “Hakerët rrëzojnë League of Legends, EA dhe Blizzard”, “Një grup i quajtur DERP ka ndërmarrë sulme DdoS ndaj serverëve NA/EU/OCE të League of Legends”, “Ata janë duke rrëzuar”⁵¹

Mundësia dhe kapaciteti pranues i shënimeve, imazheve, rezolucionit dhe dinamikës së incizimit ka nxitur të gjithë kontrollorët, të cilët me veprimtarinë e tyre kanë në përdorim të gjerë këto pajisje, të mendojnë për krijimin e rregullave dhe masave mbrojtëse gjatë përdorimit të tyre. Për sigurinë e individit si pjesë e sigurisë në kuptimin

⁵¹[http:// www.pcworld.al/](http://www.pcworld.al/) Artikulli, “Hakerët rrëzojnë Leagua of Legends, EA dhe Blizzard”; Artikulli, “Hakerët Shqiptarë sulmojnë faqen zyrtare të Muzeut të Serbisë”; Artikulli, “Hakerët Kosovarë sulmojnë 8 faqe zyrtare të serbisë”, shikuar më 08. 01.2014, ora 15.30.

antropocentrik sipas Shkollës së Kopenhagës ky ligjërim, artikujt para tij dhe artikujt pasues, janë pikërisht në vijën e kërkesave të kohës në “botën digjitale”, të sigurisë së individit duke vepruar në preventive.

8.7 Serverët

Pajisjet përmes të cilave regjistrohen hyrjet e dërgesave, nga të cilat pastaj bëhet shpërndarja në një numër të caktuar IP adresash, të një subjekti kontrollues dhe anasjelltas në të njëjtën pajisje regjistrohen edhe daljet nga i njëjti subjekt kontrollues, të cilat e luajnë edhe rolin e një **hardueri** ku mund të zhvillohet dhe instalohet një program pune i një aplikacioni të quajtur **softuer** quhen **server**.

Serverët kanë fuqi të ndryshme të pranimi të materialeve, varësisht nga roli dhe kërkesa e madhësisë së subjekteve kontrolluese dhe informatave që përpunojnë ato. Nga ky kapacitet varet edhe numri i hosteve (kompjuterëve), të cilët lidhen në server- pikën në të cilën lidhen të gjithë kompjuterët dhe përmes të cilës pikë po kështu furnizohen të gjithë kompjuterët e një organizate punuese çfarëdo çoftë ajo, në mënyrë që organizata punuese/kontrolluesi brenda saj të ketë mundësinë e një vendi ku të gjitha operacionet e kryera të punës t’i ketë të ruajtura dhe të mbrojtura për një kohë të caktuar.

Përparësia dhe roli i përdorimit të serverit qëndron pikërisht në faktin se mbrojtja e kompjuterëve dhe siguria e tyre është shumë më e avancuar, sistemi mund të mbrohet me sukses nga sulmet dhe ndërhyrjet e jashtme, informatat mund të ruhen pa u humbur për secilën IP adresë me kapacitete të mëdha dhe në kohë të gjata, kompjuterët nuk kanë nevojë që të ruajnë informata në kohë të gjata, por fokusohen ma tepër në obligimet ditore dhe në kryerjen e punës me shpejtësi dhe efikasitet karshi kërkesave të subjekteve të të dhp.

Për sigurinë dhe mdhp vlen siguria e informacionit për secilën pajisje, çfarëdo çoftë ajo, andaj informacioni i sigurt është kur informata e ka të siguruar: besueshmërinë, integritetin dhe qasjen.⁵²

Mbrojtja dhe siguria e të dhënave gjatë punës e që janë të vendosura në server varen nga përgatitja profesionale e stafit operativ dhe udhëheqës, dhe ka tri mundësi nga të cilat vijnë pasojat dhe rreziqet e shkatërrimit dhe abuzimit me të dhënat: të jashtme, të brendshme dhe natyrore.

Njohuritë e stafit operativ duhen ngritur vazhdimisht, varësisht zhvillimeve dhe prurjeve të reja në këtë fushë: në njohjen e teknologjisë, ligjeve dhe rregullave mbi pajisjet elektronike dhe kompjuterizimin, si dhe njohje të domosdoshme të ligjeve, rregulloreve apo udhëzimeve mbi përdorimin dhe mbrojtjen e këtyre pajisjeve dhe këtyre sistemeve, si dhe njohjen e rregullave të posaçme lidhur me mdhp për kategori të veçanta të të dhënave.

Çdoherë, kur diçka humbet apo shkatërrohet në kompjuterin e zyrtarit tuaj, duhet të siguroheni që këto informacione mund t'i gjeni në server. Qasja në server duhet të jetë e kontrolluar dhe duhet të mbahet evidence: kush, kur dhe arsyeja e qasjes, në mënyrë që mbrojtja dhe siguria të jenë funksionale. Gjithashtu, hapësira e vendosjes së serverit duhet të jetë e mbrojtur dhe e lidhur me personin përgjegjës për mbikëqyrjen e lokaleve dhe pajisjeve.

Regjistrat dhe gjurmët e auditimit. Sistemet konsiderohet se kanë një siguri të avancuar nëse kanë mundësi që t'i identifikojnë qasjet e paautorizuara. Ne vazhdimisht në këtë drejtim duhet të instalojmë mjetet për auditimin e këtyre qasjeve respektivisht të identifikimit të shenjave dhe gjurmëve për të mësuar se kur dhe kush ka pasur qasje në një dosje nga përdoruesit e ndryshëm.

⁵² ISO 27001 ZAŠTITA OSOBINIH PODATAKA I RAČUNALSTVO U OBLAKU, azop, Izdavač: Agencija za zaštitu osobinih podataka, Za izdavača: Dubravko Bilić, mag. Phillol.Croatia, Zagreb, (Grgiq, S. 2012)

8.8 Pajisjet shtypëse dhe skanuese

Pajisjet printuese (shtypëse) për nga konstruksioni, firma prodhuese dhe shpejtësia e printimit (shtypjes së materialeve) kanë dallime dhe emërtime të ndryshme. Disa nga këto pajisje punojnë në parimin e makinave të thjeshta daktilografike dhe gjatë printimit kërkojnë letër të posaçme me kopje të indigos (dy kopjesh apo tri kopjesh), ndërsa disa printerë (shtypës) punojnë në parimin e dirigjimit laserik pa letër shtypëse me indigo. Pavarësisht këtij dallimi, të gjithë printerët (shtypësit) aktivizohen për punë nga urdhri i marrë për shtypje të fajlit (materialit) për ta pasur materialin në kopje të fortë-letër. Të gjitha të dhënat që duam t'i kemi të printuara regjistrohen në memorien e printerit dhe dalëngadalë përmes kokës shtypëse hidhen në letër bardhë e zi, apo me ngjyrë, varësisht prej asaj se cilin lloj dhe cilësi të shtypjes e kemi përzgjedhur, tekst të shkruar apo fotografi (sipas mundësive teknike që disponon pajisja shtypëse).

Ngjyrat gjithashtu varën nga tipi i makinës shtypëse dhe mund të jenë në formë të pluhurit dhe të lëngshme.

Në të njëjtin parim të përafërt punojnë edhe pajisjet skanuese, por cilësia dhe aplikimi i teknikës është krejtësisht në bazë të parimit të fotografisë dhe puna kryesisht bëhet në formë të kopjimit identik të materialit (gati 100% ashtu siç janë të dhënat origjinale të cilat kopjohen). Kjo formë kërkon më shumë energji dhe puna bazohet kryesisht përmes aplikimit të llambave me dritë të fortë për kopjim. Skanimi më tepër aplikohet te riprodhimi i dokumenteve të rëndësishme së veçantë, fotografisë, projekteve inxhinierike dhe materialeve riprodhuese të cilat duhet ta ruajnë origjinalitetin e tyre. Edhe shtypësit, edhe skanerët kanë mundësi të lidhjes unike me kompjuterin, përkatësisht monitorin e kompjuterit dhe pajisjet apo veglat bartëse (ndihmëse) siç janë: fleshat (USB), CD-të, disqet e ndryshme nga të cilat mund të barten shënimet direkt nga këto vegla në printer apo skaner.

Letra e cila përdoret për shtypje apo skanim ka kualitet dhe cilësi në bazë të kërkesave të synuara nga ana jonë dhe me formate të ndryshme A4, A3, etj. të letrave dhe shtypit sipas standardeve të njohura ndërkombëtarisht.

Ruajtja dhe mbrojtja kryesisht bëhet për shkak të dëmtimeve mekanike, lagështisë, dritës së fortë, temperaturave tepër të ulëta dhe tepër të larta, pluhurit etj. Mirëpo, gjithashtu është e nevojshme që qasja dhe masat e mbrojtjes dhe të sigurisë, si parakushte në aspektin e mdhp, duhet paraprakisht të jenë të përshkruara për përdorimin edhe të këtyre pajisjeve.

Edhe këto pajisje në konstruksionin e tyre kanë integrale harduerike me memorie ku mbesin shumë të dhp, të cilat nga pakujdesia jonë mund të rrjedhin pa dashje jashtë institucionit, gjë që bie në kundërshtim me ligjin për mdhp dhe përbën shkelje ligjore të të dhp të subjektivit, njëherazi paraqet imazh negativ të kushtueshëm për kontrollorin e të dhp.

Nxjerrja jashtë përdorimit e këtyre pajisjeve, afati i shërbimit në punë, qasja dhe mënyra e përdorimit, për shkaqe sigurie, duhen përshkruar nga ana e kontrolluesit me anë të një udhëzuesi specifik për mënyrën e përdorimit të tyre.

8.9 Masat mbrojtëse dhe të sigurisë me rastin e përdorimit të pajisjeve kompjuterike gjatë përpunimit të të dhp

Me rastin e përdorimit të pajisjeve dhe makinerisë teknologjike të informimit dhe procesimit me të dhp, detyrimisht është e domosdoshme të vendosim rregulla përmes të cilave rregullojmë aspektet procedurale të masave organizativo - teknike mbrojtëse dhe të sigurisë.

Siguria, privatësia dhe ligjshmëria në relacion të zhvillimit të teknologjisë, sigurisht se nuk kanë nevojë të vendosjes superiore të njëres para tjetrës. Kështu, mendimtari John Poindexter, në këtë relacion shprehet “Unë mendoj vërtetë se nuk kemi nevojë t’i shkëmbejmë sigurinë dhe privatësinë. Mendoj se teknologjia na jep mundësinë t’i kemi të dyja.” Marr nga <http://mason.gmu.edu/~rhanson/PAM/PRESS2/ChiefSecurityOfficer-8-04.htm>, artikulli; Jeta e shkurt, Ekzekutimi publik sekret, Ringjallja e vetedijes se informacionit tonë, shikuar 16.04.2016, 15.30 h

Kujdesi parësor vërehet në tri shtylla kryesore të sigurisë dhe mdh:

1. Rreziku që vjen nga mundësitë e ndërhyrjeve nga jashtë - rreziku i jashtëm;
2. Rreziku që vjen nga keqpërdorimi i brendshëm - rreziku i brendshëm; dhe
3. Rreziku që vjen nga aspekti i dëmtimeve fizike.

Rreziqet e jashtme zakonisht vijnë nga rrjetet kompjuterike të internetit, të ndërhyrjeve të hakerave të ndryshëm, nga sulmuesit e faqeve, lançimi i viruseve etj, dhe për pasojë kemi prishjen e shënimeve, bllokimin e faqeve, shkatërrimin e dosjeve të caktuara apo edhe marrjen e të dhënave nga kompjuteri, deri te shkatërrimet e serverëve, kompjuterëve dhe programeve të ndryshme.

Lidhur me këto të dhëna dhe të dhënat e ndryshme statistikore të piraterisë në internet, sa për ilustrim po përmendim konstatimin e artikullit me titull “Ngarkimet në Pirate Bay rriten me 50%”, ku në mes tjerash thuhet: “Pirate Bay gjatë vitit 2013 është karakterizuar me prishje të bllokadave të ISP-ve, ndryshime të domenit dhe vazhdimi i burgimit të vetëthemeluesit Gottfrid Svartholm, si dhe me një numër prej 50 % në reagimet e bëra gjatë vitit 2013. Kjo e rrit numrin e skedarëve të tipit torrent që janë në dispozicion në faqe në 74 195”.⁵³

Menaxhimi i dobët me pajisjet teknologjike, njohja e dobët dhe personeli i pakualifikuar, mungesa e rregullave dhe masave mbrojtëse për teknologjinë informative, njohuritë e pakta në programet kompjuterike, mungesa e udhëzuesve që përcaktojnë procedurat e përdorimit të pajisjeve të teknologjisë informative-kompjuterëve dhe pajisjeve të tyre janë vetëm disa nga shkaqet e rreziqeve të brendshme prej nga vijnë edhe rreziqet e keqpërdorimit me të dhp.

Dëmtimet fizike ndikojnë në fshirjen e të dhp, në bllokimin e tyre, në asgjësimin e tyre të pjesshëm etj. Rrugët prej nga mund të ndodhin dëmtimet janë të ndryshme: nga tensionet e luhatshme të rrymës elektrike, nga dëmtimet mekanike, nga temperaturat tepër të larta, nga lagështia dhe temperaturat tejet të ulëta, nga induksioni

⁵³ www.pcworld.al/ Artikulli; Ngarkimet në Pirate Bay rriten me 50%, kërkuar më 08. 01.2014, në ora 15.30 h

elektromagnetik dhe magnetizimet, nga disqet joadekuate, nga afatet e përdorimit të pajisjeve, nga programet (softuerët) joadekuate etj.

Për këto masa dhe efektet anësore me ndikim në natyrën e të dhp, në sigurinë e tyre, në koston dhe cilësinë e secilit operator që merret me përpunimin e të dhp, duhet të njoftohen të gjithë zyrtarët lidhur me pasojat që vijnë si rrjedhojë e këtyre rreziqeve me rastin e përdorimit jo të drejtë të pajisjeve kompjuterike që përpunojnë të dhp.

Tashmë, janë të njohura standardet ndërkombëtare të ashtuquajtura ISO standarde 27001 dhe 27002, të cilat pasurohen vazhdimisht me njohuri të reja, varësisht të arriturave në fushën e teknologjisë së informimit. Në këtë drejtim, janë me efekte pozitive njohuritë e masave mbrojtëse të sigurisë së informacionit, ndonëse specifikisht me standarde 27001 dhe 27002 flitet, për aspektet e sigurisë së informacionit me impakt pozitiv të mdhp. Njohja e këtyre standardeve rezulton me çertifikim të personelit i cili aplikon zbatimin e tyre në praktikë.

“Kriteret për vlerësimin e sigurisë për mbrojtjen e sistemeve kompjuterike janë të ndara në katër kategori hierarkike” (Целков, &Стоянов, 2010:28), si:

Kategoria D –siguria minimale,

Kategoria C-siguria e pjesshme,

Kategoria B –siguria sipas detyrës-mandatore,

Kategoria A-siguria e vërtetuar-verifikuar.

Këto kategori janë të ndara nëpër klasa dhe nënklasa të kategorive të sipër-renditura (D,C,B,A). Personeli i çertifikuar sipas standardeve ISO për sigurinë e mdhp, përveç njohurive të teknologjisë informative (IT) duhet të jetë edhe njohës i aspekteve ligjore në fushën e mdhp dhe njohës i kornizës ligjore Europiane të kësaj fushe, e cila çdo ditë e më tepër pasurohet me rregulla dhe udhëzime të reja ligjore.

“Milionë kompjuterë të lidhur në rrjetëzime përmes website-ve (faqeve) të ofruesve të shumtë të shërbimeve të internetit, me mundësi të shumta të operacioneve ekzekutojnë me shpejtësi dhe kapacitete marramendëse sasi shumë të mëdha të të dhp, të cilat përmes

web komponentit Save Results” shih, (Rodiqi, 2010:145, 146) ruhen në dosje dhe mund të kodohen, të regjistrohen në diskun e kompjuterit dhe si të tilla e kanë mundësinë e daljes publike të tyre, në rast se nuk menaxhohen në bazë të ligjit për mdhp, dhe pa dashje mund të vijë deri te keqpërdorimi i të dhp të subjekteve.

8.10 Masat e sigurisë për mdhp gjatë punës

Masat e sigurisë për mdhp janë pjesë e mbrojtjes paraprake të të dhp. Aplikimi i masave të sigurisë e shton efikasitetin e mdhp, duke sjellë siguri të përgjithshme gjatë punës në njërën anë, dhe në anën tjetër e rrit dhe krijon besim te subjektet e të dhp, ndërsa kontrolluesit (institucionit) ia shton imazhin dhe reputacionin e punës.

Ka disa aspekte të masave të sigurisë, të cilat dallohen për nga përdorimi i pajisjeve, për nga niveli i arsimimit, për nga mënyra dhe metodat e punës, për nga lloji i standardeve të aplikuara, për nga niveli i organizimit, për nga kushtet e punës etj.

Mdhp dhe siguria e informacionit janë të lidhura ngushtë gjatë procesit të punës dhe janë të mbrojtura me ligjin për mdhp, përveç nëse me ligje tjera është specifikuar ndryshe. Në nivel europian është e themeluar Agjencia Rrjetëzuese Europiane e Sigurisë së Informacionit e cila ka për detyrë këshillimin dhe asistimin e shteteve anëtare dhe të komisionit mbi çështjet e sigurisë së informacionit, mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi incidentet e sigurisë në Europë si dhe promovimin, rrezikun e menaxhmentit dhe vlerësimin e rrezikut: “metodat dhe ngritjen e vetëdijes dhe bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm në fushën e sigurisë së informacionit”. (Kuner, 2012:12).

Artikujt pasues sqarojnë disa nga këto aspekte të masave të sigurisë për mdhp dhe japin njohuritë elementare mbi masat e sigurisë që duhen të aplikohen nga secili zyrtar që operon me të dhp dhe kujdeset për mbikëqyrjen e zbatimit të kornizës ligjore për mdhp, gjithnjë duke u pajisur me njohuri të zhvillimeve të reja të teknologjisë e cila përdoret në fushën e përpunimit të të dhp.

Kompjuterët, pajisjet kompjuterike, operacionet e komunikimit dhe aplikimi i disa rregullave elementare, duke dhënë informacione lidhur me masat fizike të mbrojtjes dhe të sigurisë, janë disa nga temat që pasojnë në vazhdim.

8.11 Masat e sigurisë gjatë punës me kompjuter

Për të pasur një siguri të avancuar gjatë punës me kompjuter, duhet ndërmarrë këto masa mbrojtëse:

- Secili përdorues i kompjuterit duhet të krijoj fjalëkalimin/çelësin, për hapje të kompjuterit, i cili duhet të jetë i lehtë për t'u mbajtur mend, por shumë i vështirë për t'u qasur nga të tjerët.
- Vendosja e çelësit bëhet duke ndjekur rregullat dhe konsultimet me ekspertin e teknologjisë informative në institucionin përkatësisht apo organizatën shtetërore ose private ku secili prej nesh ushtron veprimtarin e vet punuese.
- Në kompjuterin tuaj ju duhet të keni të instaluar virus-kontrollin apo të ashtuquajturin firewall programin, dmth mbrojtja e kompjuterit të bëhet me instalimin e programeve të ashtuquajtura firewall, të sigurta ndaj sulmeve të jashtme të hakerëve të ndryshëm.
- Lejoni qasjen e stafit tuaj vetëm në informacionet që u duhen për punën e tyre, por mos lejoni të ndani fjalëkalimin me ta.
- Merrni informacionet tuaja nga sistemi i kompjuterit dhe vendosni në një vend të veçantë, dhe në rast se humbni kompjuterin tuaj, ju nuk i humbni të dhënat tuaja, pasi ato tashmë i keni të sigurta. Për të siguruar ruajtjen të dhënave tuaja dhe evitimin e humbjeve dhe shkatërrimit të tyre, ju mund të krijoni një sistem rezervë i ashtuquajtur „bekap“.
- Para se ta eliminoni kompjuterin e vjetër dhe ta zëvendësoni atë me një kompjuter të ri, i largoni të gjitha të dhënat nga kompjuteri. Hard diskun e kompjuterit të vjetër duhet ta shkatërroni apo ta ruani në një vend të sigurt të organizatës tuaj punuese, para se ta largoni nga vendi juaj i punës.

- Duhet të instaloni një mjet anti-“spyware”⁵⁴, i cili ndihmon për të mbrojtur kompjuterin tuaj nga kërcënimet Spyware. Përditësoni këtë mbrojtje në mënyrë që siguria juaj kompjuterike nga këto ndërhyrje të jetë e përhershme. Përveç virusit spyware, ka edhe lloje tjera të shumta të hakerëve, por ata janë më pak të rrezikshëm.
- Inkriptoni të dhënat tuaja personale, të cilat i ruani në formë elektronike në kompjuter, flesha, CD, disketa, do t’u shkaktojnë dëm apo shqetësime nëse ato ju humbin ose ju vidhen.
- Mos shkarko dhe mos e hap çdo dërgesë që ju është dërguar në adresën tuaj elektronike, nëse nuk e dini prejardhjen-adresën prej nga ka ardhur emaili. Nëse kompjuteri juaj nuk ka mbrojtje adekuate dhe sistemi juaj operativ nuk e ka sigurinë për të marrë përditësimet automatike, mbrojtja nga këto shkarkime duhet të realizohet me programe të sigurt të përditësuar.

8.12 Masat e sigurisë gjatë dërgimit të e-mailave

Për të qenë të sigurt gjatë dërgesave të e-maileve, ju/ne duhet të ndër-merrni/marrim disa veprime, dhe të sigurohemi gjithnjë paraprakisht, se:

- Vlerësoni përmbajtjen e e-mailit tuaj, nëse ajo duhet të jetë e mbrojtur dhe e mbyllur me fjalëkalim. Në këtë rast IT-ja e juaj apo ekipi i sigurisë duhet të jetë në gjendje që t’u ndihmojë në inkriptim.
- Kur filloni të shkruani emrin e marrësit të e-mailit tuaj, programi juaj softwerik do t’u sugjerojë disa adresa që ju i keni përdorë më parë me emra apo adresa që fillojnë me të njëjtin emër. Ju gjithmonë duhet të siguroheni që të zgjidhni adresën e saktë të cilës i dedikohet e-maili juaj, para se të klikoni në veglën e dërgesës (send).

⁵⁴Data protection In England. Faqja zyrtare e Zyrës së Komisionerit për Informim në Britaninë e Madhe, shikuar më datën 06.01.2014, në ora 14.00h, Masat e sigurisë të të dhp, artikulli zyrtar; Çfarë masa të sigurisë duhen marrë për të mbajtur të mdhp?

- Nëse dëshironi të dërgoni një e-mail tek një marrës, pa dashur që dërgesën ta zbuloni tek personat tjerë (që të mos shihen personat tjerë të cilëve u keni shkruar), ju duhet të përdorni kopjen karbonit të verbër të dërgesës, të ashtuquajtur “BCC”.
- Nëse dëshironi që e-maili juaj të shkojë në adresa të një grupi personash, ju kontrolloni se fokusimi i dërgesës është saktë i dedikuar për gjithë grupin që ju synoni ta njoftoni me mesazhin tuaj. Në shkrimin e përditshëm ky veprim i njoftimit për gjithë grupin përmban shenjën “CC” në veglën kompjuterike.
- Nëse dërgesa e juaj e një e-maili me shënime të ndjeshme niset nga një server i sigurt, në drejtim të një marrësi të pasigurt, siguria e juaj është e kërcënuar. Ju, në këto raste, duhet të siguroni bazën ligjore dhe të kontrolloni se marrëveshja juaj paraprake është e mjaftueshme, për sa i përket synimit tuaj të sigurië për dërgesën elektronike (mesazhin) që ju planifikoni ta realizoni.

Se sa kanë rëndësi e-mailat e sigurt, ne mund t'i referohemi artikullit: “Sulmohen serverët e Washington Post, Dyshohet që janë hakerët kinezë”, ku veç tjerash thuhet se zyrtarët janë duke planifikuar që të pyesin të gjithë punëtorët që të ndryshojnë emrat e tyre të përdoruesve dhe fjalëkalimet. Gazeta “Washington Post” deklaroi që fjalëkalimet ishin të enkriptuara. Sidoqoftë, hakerët kanë qenë në gjendje në disa raste që të dekodojnë fjalëkalimet e enkriptuara”.⁵⁵

8.13 Masat e sigurië gjatë fax dërgesave

Përveç dërgesave kompjuterike me rrugë interneti, shpeshherë dërgesat tona me shumë të dhp dhe shumë të dhëna të ndjeshme dërgohen përmes fax-it. Për një dërgim dhe pranim të sigurt të “faksit të sigurië”, ne duhet të fokusohemi në këto veprime:

⁵⁵[http:// www.pcworld.al/](http://www.pcworld.al/) Artikulli; “Sulmohen serverët e Washington Post, dyshohet që janë hakerët kinezë”, kërkimi është bërë më 08.01.2014, ora 15.30h

- Paraprakisht sigurohuni që dërgesën tuaj të fax-it jeni duke e dërguar në një zyrë ku masat e sigurisë janë adekuate me tuajat dhe me ato që ju synoni se duhet t'i ketë fax-i pranues.
- Ju duhet të dini në rast se dërgesën e fax-it e dërgoni në zyrën e hapur, me mundësi të qasjes nga persona të paautorizuar, ku masat adekuate të sigurisë fizike përbëjnë kërcenim dhe rrezikshmëri për fax-in tuaj të dërguar.
- Nëse dërgesa juaj e fax-it është e ndjeshme, pyesni paraprakisht marrësin (pranuesin), nëse ai momentalisht është pranë makinës së fax-it dhe është duke pritur dërgesën. Ai duhet ta konfirmojë kërkesën tuaj dhe njëherazi duhet të sigurohet se aktualisht në makinën e fax-t ka letër të mjaftueshme për pranimin e fax-it tuaj.
- Sigurohuni saktësisht në numrin e fax-it drejt të cilit synoni ta nisni dërgesën tuaj. Këtë mund ta bëni edhe përmes thirrjes telefonike, në mënyrë që të verifikoni sakt numrin e fax-t për mesazhin që dërgoni.
- Sigurohuni se të dhënat tuaja që i dërgoni janë specifike dhe jo të shumta nga ato që janë kërkuar prej jush. Përmbajtja e fax-it tuaj duhet të ketë sa më pak të dhëna, ngase më e sigurt është edhe mdh.
- Para se të vendosni që të përdorni shërbimin me fax, ju duhet të vlerësoni se përdorimi i fax-it është më i përshtatshëm, se sa dërgesa me rrugë të tjera elektronike, (korrier apo e-mail).
- Verifikoni gjithnjë nëse dokumenti është marrë dhe pranuar në mënyrë të sigurt. Këtë mund t'a verifikoni edhe përmes telefonit, përmes e-mailit, fax-it, mesazhit telefonik.

8.14 Masat tjera plotësuese të sigurisë

Masat tjera të sigurisë janë po kështu të domosdoshme, në mënyrë që t'i kemi të konsideruara në këtë rreth të “unazës” sonë komunikuese, siç janë:

- Siguria fizike e lokaleve tona dhe lokaleve ku mbërrijnë mesazhet tona.
- Staf i të punësuarve i trajnuar, i përgjegjshëm dhe i disiplinuar.
- Konfidencialiteti, hierarkia e komunikimit dhe llogari

dhënia gjithnjë duhet të jenë në relevancë të plotë me normat adekuate të kërkesave të vendit të punës.

• Informacioni nuk duhet të jetë i zbuluar për personat të cilët nuk kanë nevojë të kenë qasje në informata dhe në të dhëna të këtilla.

- Hierarkia e funksionimit sipas kriterëve të standardeve të sigurisë ISO, ISMS.
- Kufizimi i qasjes në dhomat e serverëve.
- Ruajtja e dosjeve fizike me të dhëna, në vende të sigurta, jashtë zonave me qasje publike.
- Ju duhet të copëtoni të gjitha mbeturinat, copat e letrave dhe letrat, CD-et etj. që janë konfidenciale dhe që në përmbajtjen e tyre kanë të dhëna të ndjeshme personale. Shkatërrimin duhet ta bëni në makinat shkatërruese të letrave dhe CD-ve.

• Që niveli i sigurisë të jetë adekuat, kujdesi duhet të mbahet në çdo kohë përmes trajnimit të vazhdueshëm të stafit të IT dhe stafit operator për marrjen e njohurive të reja në rrafshin e zbulimeve, të arriturave dhe modernizimit të përgjithshëm në fushën e teknologjisë informative, telekomunikacionit dhe elektro-komunikimit, veçmas kur bëhet fjalë për masa të përshtatshme dhe të veçanta të sigurisë të ruajtja e informacionit dhe mdhp, në përputhje me kërkesat e standardeve të kohës në të cilën jetojmë.

Pa përjashtuar këto që u thanë më lartë, vlerësohet se masat e sigurisë luajnë rolin kyç në mdhp, paralel me ato organizativo-teknike dhe ligjore. Në përpjekje për zbatimin në praktikë të këtyre rregullave ligjore të vëna nga BE, të inkuorpuara në legjislacionin e shteteve anëtare të BE-së, ka filluar vendosja e gjobave të fuqishme.

P.sh. “Autoriteti Francez i mdh më 03 janar 2014, duke konstatuar se Google nuk është në përputhje me Aktin e Mbrojtjes së të Dhënave të Francës, vendosi gjobë për këtë kompani në

shumën prej 150000 Eurove”.⁵⁶ Një gjobë prej 300.000 në vitin 2013 e kishte vendosur edhe Spanja kundër Google. Në përkushtim të zbatimit të rregullave ligjore, të ligjeve nacionale dhe vendimeve të Grupit Punues sipas artikullit 29 të Direktivës 95/46 të MDhP për shkelësit e mëdhenj të të dhp, sidomos të kompanive të mëdha të përhapjes dhe shërbime të internetit, ka filluar zbatim i vendimeve të fuqishme edhe nga Gjermania, Holanda, Britania e Madhe dhe Italia. Vendosja e gjobave për sigurinë dhe mdhp tashmë çdo ditë po aplikohet me të madhe te kontrollorët e papërgjegjshëm në të gjitha shtetet.

Përhapja dhe rritja e përdorimit të teknologjisë së komunikimit në kryerjen e aktiviteteve kriminale dhe krimit kompjuterik meritojnë vëmendje të shtuar, duke i dhënë prioritet miratimit dhe marrjes së masave të përshtatshme ligjore në implementimin e mjeteve efektive teknologjike dhe shtrënguese për reduktimin e këtyre aktiviteteve kriminale.

Dukuria e krimit kompjuterik është tendencë globale në rritje, andaj fokusi orientues i të gjitha shteteve në nivel ndërkombëtar kërkon bashkëpunim institucional, rajonal e ndërkombëtar në aspektin ligjor dhe profesional në mes agjencive të sundimit të ligjit, duke krijuar kështu një rrjet të bashkëpunimi dhe ngritje të kapaciteteve humane, duke shkëmbyer informacione dhe duke ngritur një rrjet të fuqishëm botëror me qëllim të parandalimit të këtij krimi të organizuar në nivel ndërkombëtar.

⁵⁶www.Privacylaws.com/subscription_info, informata të pranuar, nga International OUTNOW, shikuar më 09.01.2014. 09.00h.

KAPITULLI IX: TRANSFERIMI I TË DHËNAVE PERSONALE, RREGULLAT E MBROJTJES DHE NDIKIMI I TYRE NË INTEGRIMET EUROPIANE, SIGURINË KOMBËTARE DHE RAJONALE

9.1 Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale-njohuri elementare

Të dhp që përpunohen ose që do të përpunohen nga kompanitë ose korporatat e mëdha ndërkombëtare si dhe nga organet publike të shteteve të ndryshme, me shtrirje rajonale e ndërkombëtare, e të cilat gjatë operimit të tyre me të dhp transferojnë (bartin) të dhp të qytetarëve bashkë me lëvizjen e lirë të mallrave dhe njerëzve nga një shtet në shtetin tjetër, nga një rajon në një rajon tjetër, nga një kontinent në një kontinent tjetër, në terminologjinë tonë ligjore e juridike të hapësirës së UE e quajmë transferim (transfer) të të dhp.

Lidhur me transferimin, në varësi të nevojave të transferimit brenda apo jashtë shtetit, dallojmë dy lloje të transferimit:

1. transferimin e brendshëm,
2. transferimin e jashtëm (ndërkombëtar).

Përderisa qarkullimi kufitar i njerëzve dhe mallrave tashmë është pjesë e qarkullimit ndërkufitar në mes shteteve dhe bashkësive federale e konfederale të shteteve të ndryshme, duke nënkuptuar këtu se transferimi i të dhënave është po kështu pjesë përbërëse edhe e kalimit ndërkufitar, OECD ndër objektiva e saj rekomandon që në kuadër “të rregullatorit ndërkufitar të perspektivës” të krijohen rregulla në funksion të të drejtave, lirive të njeriut dhe mbrojtjes së privatësisë, si dhe “zhvillimin e kornizës ligjore lidhur me aktivitetet e OECD edhe në fushën e informimit, kompjuterizimit dhe politikave të komunikimit...”⁵⁷.

⁵⁷THE OECD PRIVACY FRAMEWORK, OECD, 2013. Cover image: © kentoh – Fotolia. ComApplikatinos should be sent to OECD Publishing. **rights**© **oecd.org**, (2013:49), duke përfshirë udhëzime të veçanta në këtë fushë.

Transferimi i brendshëm i të dhp mund të rregullohet përmes legjislacionit dhe masave organizativo-teknike të cilat përputhen plotësisht me nivelin e duhur të mdhp brenda një shteti, të cilat mbikëqyren nga autoriteti ligjor që vepron brenda territorit të atij shteti. Prandaj, në shpjegimet tona në vazhdim, do të fokusohemi veçanërisht te transferimi ndërkombëtar i të dhp.

Edhe Vendimi Kuadër i Këshillit dhe Komisionit të BE-së, 2008/977/JHA të datës 27 nëntor 2008 jep detyrime për shtetet anëtare të BE-së në kuptim të transferimit të të dhënave dhe qarkullimit ndërkufëtar në fushën e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit. Për transferimin ndërkombëtar të të dhp, janë të nevojshme të ndërmerren një sërë veprimesh dhe aktivitete, ndër të cilat veçojmë:

- Procedurat për përcaktimin e nivelit të duhur për mdhp;
- Shikimi i listës së shpallur nga Komisioneri Evropian të vendeve dhe organizatave ndërkombëtare me nivelin e duhur të të dhp dhe përditësimi i saj në ëeb faqen e autoritetit shtetëror (nacional) të mdhp;
- Marrja e vendimit (vendimmarrja) nga autoriteti i mdhp për lejimin e transferimit së të dhp;
- Lejimi i transferimit ndërkombëtar të të dhp te vendet dhe shtetet që nuk e kanë nivelin e duhur të mdhp;
- Procedurat dhe masat që duhet të ndërmerren për lëshimin e autorizimit për transferimin e të dhp për një kontrollues, në drejtim të shteteve dhe organizatave ekonomike që nuk sigurojnë nivelin e duhur të mdhp.

Pra agjencia, përkatësisht autoritetet e mdh në faqet e tyre zyrtare mbajnë një regjistër për të gjitha ato organe, organizata, të cilave u është lejuar transferimi për kategorinë, vendin dhe llojin e të dhënave të transferuara.

9.2 Përcaktimi i nivelit të duhur të mbrojtjes të dhp

Komisioneri i BE-së për mdhp, përkatësisht BE-ja, në faqen e vet zyrtare e ka të shpallur listën e vendeve, organizatave ekonomike dhe zonave ekonomike që e kanë nivelin e duhur të mdhp.

Në grupin e vendeve me nivelin e duhur të mdhp, BE-ja ka konsideruar dhe konsideron të gjitha vendet anëtare të Zonës Ekonomike të BE-së dhe vendet anëtare të KE-së të cilat e kanë ratifikuar tashmë Konventën Europiane të mdhp, dhe gjatë përpunimit automatit të të dhp e kanë vendosur detyrimin ligjor të Direktivës EC 95/46 në ligjet e veta nacionale dhe i kanë të ngritura autoritetet nacionale/shtetërore për mdhp.

Përveç autoriteteve dhe organizatave ekonomike në hapësirën e Europës, ka edhe kontrollues, qofshin privatë apo shtetëror të shteteve tjera, nga rajone dhe kontinente jashtë hapësirës Evropiane, të cilët përditësohen në listën e BE-së.

Ndërsa, AShMDhP apo autoritet e mdhp të shteteve tjera mund të përcaktojnë me vendim formal vende/shtete apo organizata, duke nxjerrë një listë në të cilën konsiderohet se, ato sigurojnë nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhp në pajtim me ligjin në fuqi⁵⁸.

Autoriteti shtetëror i të mdhp, përkatësisht, AShMDh në RK-së, në mënyrë të detajuar sigurohet se cilin informacion, cilin kriter, cilat masa të sigurisë, cilat garanci të mdh ofrojnë shtetet apo organizatat tjera ekonomike të të dy sektorëve, të cilat konsiderohen të domosdoshme, për të vendosur, nëse shteti apo organizata e ka nivelin e duhur të mdhp, në pajtim me ligjin në fuqi të mdhp.

Për vendim marrje autoritet kombëtare/shtetërore, zakonisht me nivel të mjaftueshëm i konsiderojnë:

- Shtet anëtare të BE-së,
- Shtetet anëtare të Zonës Ekonomike Europiane,

⁵⁸ shih, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, (prill, 2010: 26) në fuqi.

- Palët e Konventës nr.108 të KE-së “Për mbrojtjen e individit lidhur me përpunimin automatik të të dhp”, si dhe të protokollit të saj, të vitit 1981,
- Shtet ku mund të transferohen të dhp, sipas një vendimi të Komisionit të BE-së.

9.3 Lista e vendeve dhe organizatave me nivelin e duhur të mdhp

AShMDhP, me kornizën Kushtetuese-juridike të RK-së, është autoriteti i vetëm në nivel të vendit që menaxhon dhe mbikëqyr zbatimin e Ligjit për mdhp të qytetarëve në Kosovë.

Agjencia, në përputhje me ligjin, mban një listë të shteteve (vendeve) dhe organizatave ekonomike, për të cilat konstaton se sigurojnë nivelin e duhur për mdhp. Brenda territoreve të ndryshme të shteteve ka territore të tipit organizativ federal, kantonial, rajonal, krahinor me specifika të theksuara të organizimit administrativ, dhe në këto raste, agjencia mund ta konsiderojë një njësi federale, brenda territorit shtetëror të shtetit ku bën pjesë ai territor, me nivel të duhur të mdhp, edhe në rast se këtë konstatim nuk ka arritur ta ketë shteti ku bën pjesë ai territor.

Lista mund të ketë në përfshirje të vet shtete anëtare të BE dhe të Zonës Ekonomike të BE-së.

Ndërkaq, sa i përket përfshirjes së vendeve dhe organizatave tjera që e plotësojnë nivelin e duhur për të mdhp, për të cilat është vlerësuar siguria, masat mbrojtëse, masat organizative etj.dhe të cilat janë konsideruar nga BE-ja me nivel të duhur të mdh, Agjencia mund të marrë dhe të zbatojë të njëjtin vendim të BE-së, duke marrë vendim formal në koordinim me atë të BE-së.

Autoriteti i mdhp në nivel nacional të një vendi (në rastin tonë në nivel të Republikës së Kosovës), AShMDhP, në përputhje me ligjin në Gazetën Zyrtare e publikon listën e shteteve dhe vendeve të cilat posedojnë nivelin e mjaftueshëm të mdhp.

Pothuajse të njëjtat detyrime dhe veprime i kanë edhe agjencitë apo komisionerët e mdhp të shteteve tjera, duke qenë se obligimet që dalin nga Direktiva EC 95/46 për mdhp janë të njëjta në zbatim për secilin shtet veç e veç.

Shtetet që kanë disa autoritete të mdhp brenda territorit të vet, psh. në Gjermaninë Federale, e cila posedon organizimin territorial gjerman nëpër “lande”, veprojnë nëntëmbëdhjetë autoritete të mdhp (të quajtura komisioner apo agjenci). Ndërsa, në nivel federal, gjithashtu, e ka edhe Komisionerin e Përgjithshëm Federal Gjerman për mdhp, dhe në nivel të shtetit ky Komisioner mund ta ketë të shpallur listën e vendeve me nivel të duhur të mdhp në faqen e vet zyrtare dhe në gazetën zyrtare në nivel të shtetit.

Kjo mund të shërbejë për të gjitha autoritetet e të gjitha “landeve”. Mund të mos jetë detyrim edhe për nivelin e autoritetit në nivel të “landit”, por mund të shpallet një listë e tillë për transferim të të dhënave në nivel të “landit”.

Organizime të tilla të komisionerëve/agjencive të shumta në kuadër të një shteti i kanë edhe shumë vende tjera, si: Zvicra, Belgjika, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Spanja etj.

Lista e vendeve me nivelin e duhur të mdhp në kuadër të BE-së është e përditësuar dhe në të përfshihen të gjitha shtetet anëtare të Zonës Ekonomike të BE-së, shtete të tjera të cilat i kanë përmbushur kriteret, shih, Ëeb faqja zyrtare e Komisionerit të BE-së për mdhp, (më 10 mars 2014) e kërkuar sipas Konventës 108 të KE-së, protokolleve shtesë të kësaj Konvente, Direktivës 95/46, korporatat dhe organizatat të cilat i kanë përmbushur kriteret mbrojtëse dhe të sigurisë të kërkuara sipas legjislacionit Evropian në fushën e mdhp sipas KE-së dhe BE-së.

Lista e vendeve dhe organizatave me nivel të duhur të mdhp, vazhdimisht freskohet nga Agjencia dhe mbahet e përditësuar.

Lista me nivelin e duhur të mdhp mund të ketë edhe vende apo organizata tjera që nuk janë konsideruar, apo nuk gjenden në listën e faqes zyrtare të BE-së, dhe për të cilat agjencia, në bazë të të gjetjeve dhe konstatimeve të veta konsideron edhe vende apo organizata tjera jashtë listës së BE-së, të cilat i plotësojnë në mënyrë të mjaftueshme kriteret për t'u shpallur me nivelin e duhur të mdhp.

“Fluksi ndërkufitar i të dhp, në kuptim të transferimit përtej kufijve shtetërorë, që bëhet me çfarëdo lloj mjeti, që i nënshtrohen përpunimit automatik ose që mbliidhen me qëllim të përpunimit të automatizuar, për qëllim të mbrojtjes të jetës private, një palë nuk i ndalon ose kushtëzon me autorizim të veçantë flukset ndërkufitare të të dhp që shkojnë në territoret e një pale tjetër”shih, Konventa Për Mbrojtjen e Individit në lidhje me përpunimin automatik të të dhp, Strasburg, 28.01.1981, thuhet në konventën për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave.

Gjithashtu, më tej, sipas kësaj Konvente thuhet se secila palë e ka të drejtën e shmangies, kur me anë të rregullave specifike të kategorive të caktuara të të dhënave personale ose dosjeve me të dhp të automatizuara, është i lejuar transferimi për shkak të natyrës së këtyre të dhënave, në rast se rregullat e palës tjetër e sigurojnë një mbrojtje identike.

Përveç marrjes së vendimit për publikimin e listës në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në përputhje me ligjin për mdhp, gjithmonë lista shpallet edhe në faqen zyrtare të agjencisë.

9.4 Vendimmarrja dhe autorizimet për vendet dhe organizatat me nivel të duhur të mdhp

9.4.1 Vendimmarrja Secili autoritet i mbrojtjes së të dhp, para marrjes së vendimit lidhur me nivelin e duhur të mdhp për organizatën ekonomike përpunuese apo vendin për të cilin kërkohet të bëhet transferimi i të dhp, agjencia apo komisioneri i mbrojtjes së të dhënave duhet të ndërmarrë një seri veprimesh, sipas rregullave ligjore:

- fillimisht duhet të merren informata se për cilin lloj të të dhp kërkohet transferimi,
- qëllimin e përpunimit të të dhënave,
- aspektin e rregullimit ligjor në vendin e origjinës dhe në vendin e marrësit,
- aspektin e rregullave ligjore të qytetarëve të huaj (mbrojtja ligjore e të dhp për qytetarët e huaj),

- masat mbrojtëse dhe të sigurisë të të dhp që përdoren në vendet dhe organizatat ku bëhet transferimi.

Në RK-së, por edhe në vendet tjera, autoritet e mdhp i kanë rregulluar procedurat me akte të veçanta të brendshme, duke nxjerrë rregullore për transferim e ndërkombëtar të të dhp si dhe formularë të veçantë për kërkesën për transferim ndërkombëtar (shih, Ëeb faqet zyrtare të autoriteteve të mdhp të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës)⁵⁹, të cilat administrohen me kujdes që nga pranimi e deri te vendimmarrja (vendimmarrja dhe procedurat janë të rregulluara me ligj).

Në RK-së, Agjencia për vendimin e marrë të transferimit të të dhp e njofton edhe Kuvendin e RK-së, respektivisht komisionin funksional tek i cili raporton për punën e vet.

Agjencia, gjithashtu, ka parasysh edhe aspekte tjera rreth transferimit të të dhp, si:

- nëse të dhënat përdoren vetëm për qëllimin për çfarë është lejuar transferimi;
- nëse qëllimi i përpunimit për çfarë është lejuar transferimi mund të ndryshojë me lejen dhe pëlqimin e kontrolluesit të të dhp që i siguron të dhënat;
- nëse qëllimi i përpunimit për çfarë është lejuar transferimi mund të ndryshojë në bazë të pëlqimit personal të subjektit të të dhp;
- Nëse subjekti i të dhënave ka mundësi që të përcaktojë dhe të dijë qëllimin për të cilin të dhënat e tij/saj janë duke u përdorur dhe kujt i janë dërguar ato (të dhp);
- mundësinë e korrigjimit, shtimit, asgjësimit të të dhënave të pasakta apo të vjetruara, nëse kontrolluesi i huaj në cilësinë e përpunuesit apo kontraktuesit i përmbush të gjitha masat e duhura mbrojtëse dhe organizativo-teknike për **mdhp**;

⁵⁹Web.faqja Zyrtare e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Republika e Shqipërisë, Web faqja Zyrtare e ASHMDhP Republika e Kosovës si dhe Web faqja Zyrtare e Drejtorisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Republikës së Maqedonisë, pare më 18.01.2014.

- duhet të dihet nëse është caktuar personi kontaktues i autorizuar për ofrimin e informatave për subjektin e të dhënave ose agjencinë, për përpunimin e të dhp të subjekteve të cilat janë transferuar;

- duhet të dihet nëse marrësi i huaj i të dhënave mund të transferojë të dhp, me kusht që marrësi tjetër i huaj i të dhënave të sigurojë mbrojtje ligjore të të dhp për shtetas të huaj.

Vendimet që ndërmerr agjencia për dhënien e autorizimit duhet të administrohen, të ruhen dhe të regjistrohen në një regjistër me dedikim të veçantë për këtë qëllim. Prandaj, sektori që merret me regjistrin dhe dosjen e administron një regjistër të veçantë të vendimeve dhe të autorizimeve të këtij lloji të Katalogu i Sistemit të Dosjeve, apo autoritetet e shteteve tjera mund të vendosin në bazë të rrethanave të veta ligjore lidhur me administrimin e autorizimeve për transferim ndërkombëtare.

Transferimet bëhen edhe nga shtetet anëtare të BE-së me nivel të duhur të **mdhp** në drejtim të shteteve me nivel jo adekuat. Kjo realizohet edhe kur është fjala te përpunimi automatik i të dhp:

“Nga territori i saj në territorin e një shteti jo-anëtar, nëpërmjet ndërmjetësimit të territorit të një pale tjetër, me qëllim që të evitohen të tilla transferime që rezultojnë në anashkalimin e legjislacionit të palës së përmendur”.⁶⁰

9.4.2 Autorizimet Pavarësisht asaj se nëse nuk sigurohet një nivel i duhur për mdhp, AShMDhP e RK-së mund të autorizojë një transferim ose një sërë transferimesh në shtetin tjetër ose në ndonjë organizatë ndërkombëtare. Kjo lejohet atëherë kur kontrolluesi i të dhënave merr obligimet e duhura mbrojtëse për mdhp si dhe të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve.

Edhe në rast se kontrolluesi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme të të dhp, transferimi i të dhp mund të bëhet, nëse:

⁶⁰ Shih, Konventa “Për Mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të Dhënave Personale”, Strasburg, 28.01.1981, Dispozita e nenit 12.

- Autorizohet nga aktet e ratifikuara ndërkombëtare nga Republika e Kosovës dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë,
- Kur subjekti i të dhënave e ka dhënë pëlqimin për transferim ndërkombëtar,
- Është detyrim ligjor i kontrolluesit,
- Është i nevojshëm apo përbën një kërkesë ligjore për një interes të rëndësishëm publik, apo ushtrimin dhe mbrojtjen e një të drejte ligjore,
- Është në interes të mbrojtjes jetësore të subjektit të të dhp,
- Është i nevojshëm për kryerjen e kontratës ndërmjet subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit ose për zbatimin e masave të parapara kontraktore, të marra si përgjigje ndaj kërkesës së subjektit, ose transferimi është i nevojshëm për përmbushjen apo kryerjen e një kontratë ndërmjet kontrolluesit dhe një pale të tretë, në interes të subjektit të të dhënave.

Obligimet dhe masat e marra për mbrojtjen e të dhp duhet të rezultojnë në dispozita të shkruara të kontratës dhe në kushtet e aktivitetit ekonomik, tregtar, shërbyes dhe në përgjithësi biznesor për transferimin e të dhp jashtë vendit.

“Kontrolluesi i të dhënave, transferimin e të dhp jashtë vendit mund ta bëjë vetëm pas marrjes së autorizimit nga agjencia, i vetmi organ ky i mandatuar me ligj për lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhp në nivel vendi”.⁶¹

Pavarësisht, parashtruesit të kërkesës për autorizim, kontrolluesi i të dhënave i siguron Agjencisë informacionet e nevojshme lidhur me transferimin e kërkuar, duke përfshirë kategoritë e të dhënave, qëllimin e transferimit, masat mbrojtëse në fuqi për mdh, vendin apo organizatën ku transferohen të dhënat, adresën e kontrolluesit apo organizatës ku bëhet transferim dhe informacionet tjera relevante për këtë qëllim.

Pas sigurimit të informacioneve lidhur me kërkesën për transferim, agjencia, duke respektuar afatet kohore të parapara në ligj, sipas aktit nënligjor që përcakton procedurat e brendshme të procedimit të kërkesave për lejimin e dhe dhënien e autorizimit për

⁶¹Shih, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, (prill 2010:29).

transfer, merr vendim, i cili si akt administrativ është përfundimtar. Në rast mospajtimi dhe kundërshtimi, mund të ngrihet padi administrative në gjykatën kompetente.

9.5 Bashkëpunimi me organet tjera

Me fjalën bashkëpunim, nënkuptojmë bashkëpunimin e brendshëm dhe atë të jashtëm. Bashkëpunimi i brendshëm realizohet nga autoritetet mdhp në kuadër të shtetit, duke nënkuptuar bashkëpunimin midis organeve qofshin ato në sektorin publik apo atë privat, lidhur me të gjitha çështjet që konsiderohen të rëndësishme për mdhp.

Bashkëpunim i jashtëm konsiderohet bashkëpunimi me organet e BE-së dhe të KE-së, bashkëpunimi me organet dhe organizatat ndërkombëtare, me autoritetet simotra të shteteve fqinje, me grupimet rajonale, europiane dhe ndërkombëtare.

Lidhur me mbrojtjen e të dhp, sigurinë gjatë përpunimit të tyre dhe transferimit ndërkombëtar, në interes të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të qytetarëve në fushën e të dhp dhe privatësisë së tyre, AShMDhP, në kuadër të bashkëpunimit të brendshëm dhe avancimit në fushën e mdhp, memorandume bashkëpunimi ka nënshkruar me:

- Forcën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë së Republikës së Kosovës,
- Radio Televizionin e Kosovës,
- Agjencinë e Policisë,
- Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë,
- Universitetin e Biznesit dhe të Teknologjisë,
- Shoqërinë civile/ FIT

Kështu, edhe autoritet simotra të mdhp, në interes të zhvillimit dhe shtrirjes së ndikimit në mdhp, realizojnë bashkëpunime të brendshme midis organeve të tyre.

Asistenca jepet edhe merret në mënyrë të ndërsjellë midis autoriteteve të mdhp, me qëllim që rregullat e mdhp të respektohen në mënyrë të plotë në Bashkimin Evropian.⁶²

Për ngritjen e nivelit të bashkëpunimit, kryesisht atij rajonal, nga Konferenca Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, përmes “Deklaratës së Vjenës” të vitit 1993 dalin edhe rekomandime të shumta për fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë drejtim AShMDhP e RK-së, ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi dypalëshe dhe shumëpalëshe.

9.5.1 Memorandume dy palëshe me:

- KMDhP të Republikës së Shqipërisë,
- Komisionon për MDhP të Bullgarisë
- AShMDhP të Malit të Zi,
- AShMDhP të Republikës së Kroacisë,
- Drejtorinë Shtetërore për MDhP të Maqedonisë,
- Komisionerin për Informim të Republikës së Sllovenisë,
- Inspektoratin Kryesor të MDhP të Polonisë,
- Autoritetin e MDhP të Italisë,
- Komisionerin për Informim dhe MDhP të Hungarisë.

Memorandumet e kësaj natyre në promovimin e lirisë së lëvizjes dhe qarkullimit të njerzve, japin kontribut në promovimin e fqinjësisë së mirë dhe të sigurisë.

9.5.2 Memorandum bashkëpunimi shumëpalëshe Agjencia e Republikës së Kosovës ka nënshkruar mes shteteve: Shqipëri-Mali i Zi–Bullgari-Kosovë. Puna lidhur me bashkëpunimin e brendshëm dhe atë të jashtëm vazhdon pa ndërprerë, si dhe

⁶²Shih, Direktiva 95/46 e KE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, (tetor 1995:15)

bashkëpunimet e reja janë në fazën finale të përgatitjeve. Memorandumet janë me interes për stabilitetin, promovimin e demokracisë dhe të vlerave universale të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e privatësisë

9.6 Dispozitat e veçanta

Në kuadër të këtij kapitulli më lart u theksua se, edhe nëse një vend apo organizatë nuk ofron kushte adekuate të nivelit të duhur të mdhp, të dhp mund t'u transferohen apo zbulohen këtyre vendeve apo organizatave: nëse një gjë e tillë është e parashikuar me marrëveshje ndërkombëtare detyruese; nëse subjekti i të dhp e ka dhënë pëlqimin e vet dhe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat e këtij transferimi; nëse transferimi është i domosdoshëm për përmbushjen e kontratës ndërmjet kontrolluesit të të dhënave (ndërmarrjes apo organizatës punuese) dhe subjektit të të dhp, me qëllim të realizimit të masave para kontraktuese në përgjigje të kërkesës së subjektit të të dhp; kur transferimi është i domosdoshëm dhe realizohet ligjshëm në bazë të rëndësisë dhe interesit publik; kur transferimi është i domosdoshëm për të mbrojtur jetën dhe trupin e subjektit të të dhp; kur transferimi është i domosdoshëm dhe bëhet në interes të mbrojtjes të kërkesave ligjore; kur transferimi është kryer nga një regjistër që ka për qëllim informimin e publikut dhe i cili është i hapur për publikun për t'u konsultuar nga çdo person, i cili shpreh interes legjitim për aq sa janë të përmbushura dhe të përcaktuara kushtet në këtë rast të veçantë për konsultim.

Gjithashtu, transferimi ndërkombëtar i të dhp është rregulluar edhe me Direktivën EC 95/46 të MDhP si dhe me Konventën e Përpunimit Automatik në lidhje me të dhp e vitit 1981 dhe Protokollet shtesë të saj, ku thuhet:

“Secila palë mund të lejojë transferimin e të dhp: a) nëse ligji i brendshëm e parashikon këtë për shkak të interesave të veçanta të subjekteve të të dhënave ose të interesave legjitime dhe të larta, sidomos të interesave të rëndësishme publike.”⁶³

9.7 Kodi i etikës për zyrtarët e të dhp

Si rrjedhojë e shtjellimit kronologjik të materialit, vetvetiu, në kuadër të përfundimeve, del nevoja për njohuritë elementare mbi Kodin e Etikës. Fjala etikë rrjedh nga greqishtja dhe “ethos” ka kuptimin “karakter”, “sjellje”, “zakon”. Është një normë që di të dallojë të mirën, të drejtën dhe të moralshmen nga sjelljet që përcaktohen si të këqija, të dëmshme ose të pamoralshme. Etika mund të përcaktohet edhe si një standard i kriterëve që i lejojnë individit përshtatjen e të drejtave dhe lirive të tij me të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Ndërkaq, në vigjilencë të përditshme të kodit të mirësjelljes të secilit të punësuar në institucionet e mdhp, ne e krijojmë ambientin që ta arrijmë praktikisht këtë synim.

“Të jesh etik do të thotë të bëhesh me të vërtetë duke menduar (të jesh i tillë), thotë Albert Scheitzer”, marrë nga www.Vikipidia.com, parë më 26.01.2014, ora 16:00, por edhe duke punuar për çdo ditë pa ndërprerë në këtë drejtim.

Përgjithësisht dallojmë dy lloje të kodeve etike:

9.7.1 Kode etike normative dhe

9.7.2 Kode etike metaetike

Të dy kodet kanë për qëllim avansimin e rregullit të përgjithshëm të mesit social të shoqërisë.

⁶³ Shih, protokollin shtesë i Konventës mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave, dispozita e nenit dy (2), Strasburg, 08.11.2001.

1) Ne kryesisht do të flasim për llojin e parë i cili shtjellon aspektin socio-juridiktë kodit të etikës.

Sa i përket vendosjes së normave socio-juridike, hartuesit e kodeve etike kanë mundësi që materialet t'i përgatisin përmes akteve normative, duke filluar nga kodi etik, rregulloret etike, udhëzimet administrative dhe udhëzimet apo kodekset specifike për fusha të caktuara të jetës dhe punës së njeriut.

2) Ndërsa, lloji i dytë lidhet kryesisht për kodet etike të jetës së përgjithshme profesionale, siç janë: kodi mjekësor, kodi pedagogjik, kodi i avokatisë, kodi në tregti, kodi ushtarak, kodi i sistemit financiar etj.

Në procesin e punës me të dhp ka një numër të konsiderueshëm të punësuarish të cilët merren me këtë punë, e të cilët janë:

- a) Zyrtarët për mdhp,
- b) Zyrtarët administrativ që operojnë me të dhp (operatori),
- c) Zyrtarët e teknologjisë informative (IT) ,
- d) Të gjithë zyrtarët që punojnë në institucionin agjencisë,
- e) Zyrtarët që merren me masat mbrojtëse dhe të sigurisë.

9.7.a Zyrtari për mbrojtjen e të dhp është boshti kurrizor mbi të cilin dhe rreth të cilit lidhet zbatimi funksional i ligjit të mdhp.⁶⁴

Por, duhet përmendur se secila organizatë i ka specifikat e veta të punës rreth përpunimit dhe operimit me të dhp. Duke marrë parasysh automatizimin në procesin e procesimit të të dhënave personale në prizmin e teknologjisë moderne të informimit, akoma më shumë janë vlera kërkuese etika morale profesionale dhe gjithanshmëria, veti këto me të cilat duhet të jetë i pajisur një zyrtar i emëruar për mdhp.

⁶⁴Shih, Ligji për MDhP i Republikës së Kosovës, (Prill, 2010:36) në të gjitha organet publike dhe private, ku bëhet përpunimi i të dhp, për të cilat u dhanë shpjegime më lart rreth detyrave, angazhimeve dhe raporteve të punës me Agjencinë e të Dhënave Personale*.

Edhe pas emërimit të zyrtarit të dhp, përgjegjës për keqpërdorimin e të dhënave ndaj subjektit është kontrolluesi i të dhp edhe ndaj autoritetit kompetent mbikëqyrës.

“Detyrime ligjore të emërimit të këtij zyrtari kanë vendosur shumë shtete të BE-së si: Gjermania, Greqia, Sllovakia, Hungaria e Zvicra, ndërsa; Franca, Holanda, Suedia, Estonia, Lituania e Letonia e kanë opsional. Kurse Spanja dhe Polonia kanë zyrtarë të sigurisë së të dhënave personale”. Kurrikula e përgjithshme për trajnimin e ZMDh-ve, mbi mdhp, numri i projektit: Europe Aid/133806/C/SER/XX, 2013/333-753, Rosana Lemut Strle, (2015:4). Zyrtarët për mdhp janë pjesë e regjimeve ligjore të mdhp edhe në shtet tjera të botës si: Kolumbi, Singapor, Kanada, Zelandë e Re, ShBA (sektorin e shëndetësisë) etj.

Zyrtari për mdhp duhet të jetë i pajisur me njohuri rreth fushës së të drejtave të njeriut, të jetë njohës i mirë i dispozitave ligjore mbi të drejtat e njeriut duke filluar nga ato civile e kushtetuese deri te aktet e kornizës ligjore Europiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, e veçmas atyre mbi privatësinë dhe mdhp. Kontrolluesi, përmes zyrtarit për mdhp, në vazhdimësi duhet të marrë informacione lidhur me aktet e reja që nxirren në nivel European e ndërkombëtar, gjithashtu, lidhur me shkeljet që mund t'i bëhen subjektit të të dhënave dhe shqetësimet që ai mund t'i ketë në llogari të kontrolluesit. Ai ka obligim që ta informojë drejt kontrolluesin lidhur me pasojat ligjore, në mënyrë që të mund të përballlet me shqetësimet e ngritura nga ana e subjekteve të të dhp, si dhe masat administrative që mund të ndërmerren nga agjencia.

Një rregullore e aprovuar e Kodit të Etikës për zyrtarin e mdhp mund të nxirret dhe hartohet nga secili kontrollues i të dhënave në bashkëpunim me agjencinë. Një iniciativë e tillë e ndërtimit të një Kodi Etik të përgjithshëm për ZMDhP, në nivel të një shteti-rajoni, mund të vijë direkt edhe nga vetë Agjencia. Kjo mund të bëhet në bashkërendim dhe koordinim me Komisionin European, të cilit duhet t'i dërgohet drafti i kodit të hartuar paraprakisht nga autoriteti kombëtar i mdhp–AShMDhP, për të cilin duhet të merret mendimi i Komisionit, respektivisht i Grupit të Punës të Komisionit dhe të Këshillit sipas Direktivës 95/46 dhe nenit 27.

9.7.b Zyrtari administrativ që operon me të dhp, është zyrtar i caktuar nga organi publik apo privat për punë administrative që lidhen me të dhp, për nevoja të kontrollit dhe subjekteve të të dhënave e që lidhen me: kalkulimin e pagesave, llogaritjen e stazhit të punës, evidencat e suksesit, evidencat me rastin e hapjes së historive të sëmundjeve, analizat dhe diagnostikimet e sëmundjeve të subjekteve të të dhp, mbajtja e testeve dhe intervistave, udhëheqja me personelin, evidenca e mysafirëve të vendosur në hotel etj.

Në përgjithësi, ky zyrtar kryen punë administrative, gjatë kryerjes të të cilave gjithnjë janë në procedim shënimet e të dhp, prej nga edhe del vetvetiu përgjegjësia morale, etike dhe profesionale e punës së një zyrtari të tillë, i cili në organizatën e tij gjithsesi do t'i nënshtrohet kodit të shërbimit civil sipas ligjit, duke e nënshkruar edhe deklaratën e konfidencialitetit. Ndërkaq, ky zyrtar, në relacion me kodin etik të mdhp, duhet të pajiset patjetër me njohuri dhe të ketë trajnime të posaçme për fushën e përpunimit dhe mdhp.

Gjatë punës së përditshme, në veprimtaritë e ndryshme të jetës së njeriut ngritën shumë çështje për t'u vështruar, për t'u konsideruar dhe pse jo edhe për ndërmarrjen e veprimeve praktike nga institucionet dhe agjencitë përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

“Në jetën e përditshme me petkun e konfidencialitetit mbështillen shënimet e fakteve të ndryshme të mjeteve dhe proceseve” (Najman, N.1967:53) të cilat, shpesh herë janë të nevojshme për transparencë dhe hapje për publikun për t'i dhënë impuls demokracisë, por pa e lënduar “privatësinë” e individit.

Në kuptim të mendimit të shkëputur në citatin e sipërthënë, vijmë deri te konstatimi se sa e rëndësishme dhe komplekse është puna kur bëhet fjalë për shërbimin në funksion të qytetarëve dhe të drejtave legjitime të tyre, në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, e veçmas të dhp dhe të jetës së tij private.

9.7.c Zyrtari i teknologjisë informative, është personi që në aspektin operativ është i lidhur drejtpërdrejt me përpunimin automatik të të dhënave, duke qenë kështu pjesë e domosdoshme e zbatimit të detyrimeve ligjore, etike, morale, të konfidencialitetit dhe mdhp. Prandaj, Deklarata e Konfidencialitetit, Udhëzimi Administrativ për Zyrtarët e mdhp, Kodi i Etikës për Shërbyesit Civil, Kodi i Etikës për Zyrtarët e mdhp duhet të jenë dokumente të njohura mire për të dhe të zbatueshme gjatë punës në vendin e tij të punës.

Në këtë kohë të shkrimit të këtij libri, në administratën e shërbimit civil të Kosovës zyrtarët e TI marrin kompensim shtesë, i cili në proporcion me kualifikimin e shërbyesve tjerë të rangut të barabartë të përgatitjes akademike, arrin gati sa dyfishi i pagës së kualifikimit të të njëjtit nivel akademik të kolegëve të tyre. Kjo diferencë në pagë ishte vendosur për shkak të kërkesave të mëdha të tregut për këtë profil të përgatitjes profesionale, dhe mungesës së theksuar të tyre në tregun e punës.

Por, marrë në tërësi, kjo shtesë në të ardhurat personale të kësaj kategori e të punësuarve është obligim i dyfishtë i marrjes së përgjegjësisë dhe konsiderimit me kujdes të vet natyrës së punës, të theksuara në përshkrimin edhe të vet detyrave të punës të kësaj kategorie ekspertësh, të cilët çdo ditë duhet të përcjellin risitë e teknologjisë informative, të arriturat dhe t'ia përshtatin ato nevojave të punës.

9.7.d Zyrtarët që punojnë në institucionet e autoriteteve për mdhp, përkatësisht në AShMDhP si dhe zyrtarët e këtij niveli që merren me përpunimin dhe operimin e të dhp të kontrolluesit janë zyrtarët më të thirrur në aspektin e kompetencave, detyrimeve, obligimeve dhe përgjegjësisë ligjore në fushën e mdhp në nivel vendi për të gjithë qytetarët, në të gjitha fushat dhe sektorët e jetës, ku të dhp të qytetarëve jepen për ushtrimin e ligjshëm të interesave të tyre.

Në këtë kuadër një kod i etikës i punuar enkas me përfshirje në të të aspekteve dhe normave etike, morale, profesionale nga ligji i shërbimit civil, ligji i administratës publike, ligji i punës, ligji i mdhp dhe me përfshirje të detyrimeve dhe rekomandimeve nga Direktiva e BE-së dhe e KE-së EC 95/46 si dhe nxjerrja dhe adaptimi i akteve të reja që dalin nga Parlamenti Evropian, Komisioneri Europian i mdhp, Grupi 29 i Direktivës EC 95/46 janë dhe mbeten detyrë e përhershme e autoriteteve të mdhp.⁶⁵

Zyrtari i mdhp, i emëruar në këtë institucion (te kontrolluesi) i nënshtrohet veçmas një detyrimi specifik përmes një deklarate të nënshkruar të konfidencialitetit dhe direkt

⁶⁵Shih, DIREKTIVA 95/46 eParlamentit Evropian dhe e Këshillit (tetor, 1995), për mbrojtjen e individit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale si edhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (Gazeta Zyrtare L281, 23.11.1995, f.31) Rregullorja (KE) nr.1882/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 29 shtatorit 2003.Neni 29 i Direktivës.

duhet t'i përgjigjet titullarit të institucionit. Gjithashtu, Kodi i Etikës i punuar me bazë të përgjithshme në nivel vendi është detyrues për këtë zyrtar.

AShMDhP në vitin 2012 e ka nxjerrë dhe e ka vënë në zbatim në kuadër të institucionit Rregulloren e Kodit të Etikës, marrë nga www.amdp-rks.org, Faqja zyrtare e AShMDhP, linku; aktet nënligjore, Rregullore e Kodit të Etikës për punëtorët e AShMDhP, shikuar më 01.02.2014 për të punësuarit në AShMDhP. Kështu, AShMDhP mund të llogaritet një ndër institucionet e para në nivel vendi që ka nxjerrë dhe ka vënë në zbatim një kod të këtillë.

9.7.e Zyrtarët që punojnë për masat mbrojtëse dhe të sigurisë e kanë rolin dhe përgjegjësinë kryesore në mbarëvajtjen e rregullit të përgjithshëm në secilin institucion publik dhe privat. Përveç njohurive specifike të sigurisë ky zyrtar duhet të ketë njohuri të përgjithshme. Për nga etika dhe kodi i sjelljes është më i dalluar nga të tjerët.

Pajisja me njohuri të përgjithshme është e domosdoshme sepse puna e zyrtarit për siguri është pika e parë e kontaktit të një organizate dhe institucioni qoftë me të punësuarit e brendshëm qoftë me klientelën-subjektet e jashtme që marrin shërbime të ndryshme në organet publike dhe private. Zyrtarët e sigurisë me punë specifike rreth sigurisë mund t'i hasim në institucionet e sigurisë, por në disa vende si Polonia dhe Spanja janë të vendosur dhe specifikuar në ligj si zyrtarë të sigurisë së të dhp.

Psh. në Poloni Kontrolluesi duhet të emërojë “një administrator të sigurisë së informacionit”, i cili ka si detyrë mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me parimet e sigurisë të parashikuara me ligjin e mdhp (përveç kur këto aktivitete kryhen nga kontrolluesi).⁶⁶

9.8 Kodi i fshehtësisë-ruajtja e konfidencialitetit

Rëndësia e ruajtjes së konfidencialitetit ka karakter multifunksional dhe shkon në interes të shumanshëm, duke filluar nga interesat jetike të vet qytetarit si subjekt i të dhp, në

⁶⁶ Shih, Udhëzuesin Praktik për Personat e Kontaktit të Ngarkuar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AndrashJori, Joakuin Katalan, Tiranë (2013:11)

interes të kontrollorit-korporatës-organizatës punuese, të organeve shtetërore apo private dhe në interes të vet shtetit, respektivisht administratës shtetërore. Mirëpo, fshehtësia jo gjithmonë ishte në interes të paqes dhe demokracisë, si psh në kohën e luftërave botërore dhe para tyre, diplomacia e fshehtë dhe marrëveshjet bilaterale shpesh binin në kundërshtim me paqen e proklamuar dhe lidheshin marrëveshje të fshehta në mes të shteteve në llogari të interesave të ngushta, duke u rreshtuar kështu në prishjen e paqes dhe nxitjen e luftimeve, duke përdorur edhe rastin e ashtuquajtur “kasus-belli” i njohur gjatë luftërave në ekuilibrin e forcave në raste lufte. Kështu kishte ndodhur deri në vitin 1919, në përfundim të Luftës së Parë Botërore, kur presidenti amerikan Uillson nga pikat e fjalimit të tij bëri thirrje që të gjitha marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale në mes shteteve të bëhen publike. Kjo më vonë u vendos edhe në Konventën Diplomatike të Vjenës.

Fshehtësia në ligjet që e rregullojnë këtë fushë kryesisht bëhet për nevoja të sigurisë shtetërore, dhe për këtë krijohen autoritete të veçanta që e mbikëqyrin zbatimin e këtij ligji. Natyrisht efektet kryesore janë ruajtja e fshehtësisë ushtarake, shtetërore që lidhet me personalitetet, respektivisht zyrtarët shtetëror të niveleve dhe funksioneve të rëndësishme në të gjitha sistemet e jetës dhe punës shtetërore, por edhe të korporatave të fuqishme të rëndësisë vitale për funksionimin e shoqërisë dhe shtetit.

Konfidencialiteti është në shumë mënyra një nocion më pak abstrakt, është më konkret dhe më i menaxhueshëm se jeta private. Por, privatësia është më afër thelbit të personalitetit. William W.Lowrance, CAMBRIDGE UNIVERSITY PRESS; *Privacy, ConfidentialityandHealthResearch*, Cambridge University Press, 2013)

Sot, të rëndësishme janë edhe ruajtjet e fshehtësive të formulave të ndryshme të prodhimtarisë, të patentave të shpikjeve inovative, të veprave autoriale etj, për të cilat krijohen rregulla të veçanta për ruajtjen e sekreteve në fushën e prodhimtarisë dhe të korporatave dhe kompanive në fusha të ndryshme të jetës dhe punës. Kjo bëhet për arsye të ruajtjes së privilegjit në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së bizneseve, në interes të fuqizimit ekonomik të këtyre firmave çfarëdo qofshin ato.

Sektori i inteligjencës shtetërore me ligjin mbi inteligjencën rregullon nivelet e dokumentacionit të klasifikuar, bën verifikimin dhe cakton nivelin e klasifikimit të zyrtarëve për qasje në informatat dhe dokumentacionin e klasifikuar. Në këtë drejtim, Agjencia duhet të bashkëpunojë ngushtë me Agjencinë e Inteligjencës kur bëhet fjalë për të drejtat e subjekteve të të dhp dhe privatësisë së tyre, veçmas kujdesi duhet të jetë permanent te përpunimi i të dhënave të ndjeshme të cilat mund të përpunohen vetëm kur është e lejuar me ligj dhe për përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Nga zyrtarët që detyrimisht i nënshtrohen kodit të fshehtësisë janë të gjithë ata zyrtarë që merren me përpunimin e të dhp, me përpunimin automatik të të dhënave, me futjen dhe bartjen e shënimeve me të dhp në data baza të shënimeve, të gjithë zyrtarët që mbikëqyrin dhe kontrollojnë procesin e përpunimit të të dhp, si dhe të gjithë zyrtarët që nga institucioni (kontrollori) janë të obliguar që në përmbushje të detyrimit ligjor të jenë caktuar në rolin e marrësit të të dhp nga institucionet (kontrollorët) tjera për marrjen e kategorive të caktuara të të dhp.

Gjatë kryerjes së punës, të gjithë zyrtarët që merren me përpunimin e të dhënave, nëse hasin në të dhëna të ndjeshme të subjekteve, pa marrë parasysh nënshkrimin e deklaratës së konfidencialitetit, janë të obliguar që të shënojnë datën, kohën, llojin e të dhënave të ndjeshme dhe të dhënat e veta personale si zyrtar i autorizuar nga institucioni që ka përpunuar të dhp të subjektit, duke nënvizuar qëllimin e përpunimit.

9.9 Roli i mdhp në sigurinë rajonale dhe atë ndërkombëtare

Sot siguria ka rolin kyç në funksionimin dhe zhvillimin normal të shoqërisë njerëzore në nivel global. Për të përmbushur kërkesën për sigurinë individuale është i domosdoshëm një numër i madh i faktorëve që duhet të përmbushur. Njëri ndër faktorët që nuk mund të kalohet pa u përmbushur në kohën e sotme të zhvillimeve të mëdha të komunikimit është padyshim mdhp, dhe lirisht mund të themi se luan rol shumë të rëndësishëm në sigurinë e përgjithshme.

Stabiliteti i përgjithshëm i një vendi rrjedhimisht vjen si rezultat i sigurisë së përgjithshme, mirëqenies ekonomike, sociale, financiare, shëndetësore, kibernetike, mbrojtjes së ambientit, mbrojtjes dhe sigurisë nga katastrofat humanitare, harmonisë njerëzore dhe paqes së qëndrueshme midis njerëzve, strukturave të zhvilluara të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare të një vendi. Inputin që do ta sjellë mdhp dhe siguria e tyre brenda sigurisë shtetërore (kombëtare), rajonale, ndërkombëtare është tejet i madh, sepse roli i mdhp nuk është vetëm aspekti i sigurisë dhe kaq, por ndikimet janë të shumëfishta dhe me shtrirje në shumë fusha tjera.

Të drejtat e individit, liria, të drejtat e intimitetit dhe privatësisë në botën e sotme luajnë rol kyç në sigurinë shtetërore, rajonale dhe ndërkombëtare.

Individi i lirë reflekton siguri në ambientin që jeton. Gjithashtu, lokaliteti me siguri kolektive të individëve reflekton siguri në bashkësinë ku jeton ai dhe reflektimet e tilla nga ky këndvështrim në aspektin e sigurisë padyshim ndikojnë pozitivisht në sigurinë e përgjithshme të një vendi.

Marrëdhëniet e vendosura midis shteteve, respektivisht autoriteteve të mdhp në baza ligjore sipas kërkesave së Konventës 108 të përpunimit automatik të të dhp dhe Direktivës 95/46 të vitit 1995, janë në funksion të të drejtave dhe lirive të individëve të shteteve të cilat bashkëjetojnë në një rajon dhe kontinent. Ky është, mbase edhe kontributi më i mirë që mund të jepet edhe në segmentin e sigurisë rajonale, kontinentale dhe ndërkombëtare.

Zgjerimi i KE-së, anëtarësimi i vendeve të reja në këtë mekanizëm, bashkimi i ish vendeve komuniste të Europës Lindore statutit të KE-së, ish vendet e bllokut socialist detyroheshin me përmbushjen e detyrimeve dhe standardeve, fillimisht me ratifikimin e Konventës për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut. Në tetor të vitit 1993, Samiti i KE-së rithekson zotimin e vet ndaj demokracisë pluraliste dhe parlamentare, pandashmërisë dhe universalitetit të të drejtave të njeriut, sundimit të së drejtës dhe një trashëgimie të përbashkët të pasuruar nga diversiteti; për më tepër Samiti proklamoi se do të mirëpriste anëtar të rinj të Këshillit nga demokracitë e Europës, të çliruara nga shtypja komuniste. Nga faqja zyrtare e KE-së shohim se Shqipëria anëtare e KE-së u bë më 13.07.1995,

ndërsa ratifikimin e Konventës së Drejtave dhe Lirive të Njeriut e bëri më 02.10.1996. Kosova ende pritet që t'i përmbush këto detyrime.

Për të gjithë aplikantët që kërkonin anëtarësimin, KE-së kërkonte përmes autorizimit të Raporteve të Juristëve Eminent, si në rastin e Ruisë, e cila ishte pranuar më 1991 për të testuar se aplikanti i ka sjell institucionet e veta dhe sistemin politik në vijë me parimet e vlerave të demokracisë dhe sistemin legal, në vijë me parimet bazike të demokracisë, sundimit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut.⁶⁷ Këto ishin njëherazi edhe parimet bazë të OSBE-së, që në programin e vet gjithmonë në fokus e ka sigurinë dhe bashkëpunimin në mes shteteve. Kjo kërkohet edhe në procesin e integritimeve Evropiane, dhe në artikullin në vazhdim do të vëmë më tepër në spikamë aspektin e integritimeve nga këndvështrimi i të dhp.

9.10 Mbrojtja e të dhp dhe ndikimi tyre në proceset integruese europiane

Mdhp në proceset integruese, veçmas, në rastin e Kosovës, si shteti më i ri në rajon, është njëra ndër detyrat me prioritet në fushën e të drejtave të njeriut, e që është kërkuar të përmbushet në rrugën drejt proceseve të integritimeve Evropiane. Jo vetëm për shkak të përmbushjes së një detyrimi formal karshi BE-së, por kjo është një detyrë obligative për shkak të nevojave të popullsisë tonë në rrafshin e standardeve dhe zhvillimeve të reja në përmbushjen cilësore të të drejtave dhe lirive të njeriut, në këtë kuadër edhe të mbrojtjes ligjore të privatësisë së individit si thelbi i të drejtave universale të njeriut.

Gama e kërkesave në proceset integruese është mjaft komplekse, ku në fushën e zbatimit të ligjit dhe të drejtave e lirive të njeriut si dhe mbrojtjes të lirive të të drejtave personale dhe të privatësisë, parimi i pranimi të ACQUIS së BE është një kusht i panegociushëm. “Identiteti `communaautaire` (komunitar) është ndërtuar progresivisht përgjatë më shumë

⁶⁷Plani i Veprimit i Qeverisë së Kosovës për Liberalizimin e Vizave dhe përmbushjen e Kritereve në fushën e Integritimeve Evropiane, aprovuar (2013). Shih, Mark E. Richard S. Tekst dhe Materiale, E drejta Evropiane 2002, përkthyer nga Zejnullah dhe Armend Gruda, Publikimi i I, (1995:21).

se pesëdhjetë viteve të ekzistencës së komuniteteve europiane, të transformuara në BE, që nuk pushon së rrituri dhe së ndryshuari“(Lendita & Kameri (2011:197)

Në rajone të ndryshme shumë shtete kanë ngritur mekanizma të veçantë, agjenci, drejtori, ministri apo dikaster të veçantë të specializuar posaçërisht për t’u marrë me përgatitjen e vendit në rrugën drejt integritimeve europiane. Në rajonin tonë shtetet ndërtuan struktura të veçanta për t’u marrë me procesin e integritimeve. Në Kosovë fillimisht është ngritur një agjenci për integritime europiane, e cila pastaj u shndërrua në Ministri të Integritimeve, pas Pavarësisë së Kosovës. Në Shqipëri dhe Maqedoni po kështu u ngritën Ministri të Integritimeve. Në Mal të Zi gjithashtu u ngrit një dikaster i veçantë për integritime europiane.

Komisioni European për fushën e liberalizimit të vizave dhe MSA ka hartuar kritere që kërkohen të përmbushen nga shtetet aplikante në procesin e integritimit. Kështu, njëri ndër blloqet e kritereve ishte ai i “Lirisë, Drejtësisë dhe Sigurisë”, ku vend të rëndësishëm zë edhe “mbrojtja të dhp dhe privatësisë“. Se sa e rëndësishme është arritja e standardeve në fushën e të drejtave të njeriut te procesi i integritimit në BE, më së miri flasin detyrimet që dalin, eventualisht nga çështjet që mund të ngrihen nga qytetarët në drejtim të Gjykatës së Strasburgut. Psh nga 24 raste të përmbledhura dhe të analizuara nga avokatët Ardita Buna dhe Gjok Buna, për çështjet e ngritura kundër Shqipërisë, vlerësojnë se ka pasur shkelje dhe ka pranuar në favor të ankuesve më së shumti shkelje të nenit 6 të KELDNj. Gjithashtu. Ka pasur edhe ankesa ku gjykata ka pranuar shkelje të nenit 8 të Konventës (Buna, A.Buna 2010:19) e cila ka të bëjë me “privatësinë dhe fshehtësinë e korrespondencës”. Ndërkaq, shumë ankesa tjera kishin të bënin me pronat. Këta shembuj tregojnë për përgjegjësitë dhe detyrimet që kanë institucionet për sundimin e ligjit dhe jetësimin praktik të të drejtave të njeriut, duke përfshirë privatësinë e individit si e drejtë fundamentale e të drejtave dhe lirive të njeriut. RK-së në përmbushje të këtij standardi, në vitin 2010 e ka nxjerrë dhe aprovuar ligjin mdhp, dhe në qershor të vitit 2011 e ka ngritur edhe autoritetin për mdhp, i cili është autoritet i pavarur, për punën e vet i raporton Kuvendit të Kosovës dhe ka një buxhet të siguruar nga buxheti i shtetit, i cili menaxhohet në mënyrë të pavarur nga vetë agjencia. Buxheti i ndarë për agjencinë duhet të ketë masën buxhetore të nevojshme, në mënyrë që agjencia

të mos e ketë detyrimin që për shkak të “mos financimit apo financimit të ulët” nga buxheti i shtetit të humb pavarësinë e vet.

Kjo mundësi e shpejtë e operimit me të dhp dhe teknologjia e përkryer e programeve softuerike, duke nënkuptuar zhvillimin e madh të teknologjisë së deshifrimit, të leximit, të përgjimit dhe kopjimit të informatës ka vënë në rrezik të dhp të individit. Të integruar në një platformë të përbashkët veprimi, kjo sfidë mund të tejkalohet me sukses. Kosova në këtë drejtim i ka përmbushur me sukses të gjitha obligimet e veta. Autoriteti i AShMDhP ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha shtetet e rajonit dhe më gjerë, si dhe është anëtarësuar në shumë mekanizma dhe organizata përmthp, veprime këto që në proceset integruese janë të domosdoshme. Përpjekjet për ngritjen e një institucioni të qëndrueshëm, dhe të respektuar prej kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhp në organet publike dhe private dhe me kredibilitet në rajon dhe më gjerë, duke qenë përherë profesionalisht në nivel të detyrës dhe në shërbim të subjekteve të të dhp, përbën bazën kryesore të përmbushjes së të gjitha kriterëve në rrugën e IE.

Ky nuk është vetëm një proces i thjeshtë, por është domosdoshmërisht një kërkesë e kohës për unifikim veprimesh në nivel europian në fushën e mdhp, nuk është vetëm një dëshirë e një autoriteti kombëtar për integrim në autoritetet europiane të mdhp, por kërkesës për përshpejtim të bashkimit të të gjitha kombeve, të të gjitha rajoneve dhe kontinenteve të botës, sepse bota tashmë, në kuptim të marrjes dhe vendosjes së të informacionit e ka ndryshuar rrjedhën e mdhp dhe privatësisë së subjektit të dhp kudo që ndodhet ai. Integrimi dhe proceset integruese në këtë drejtim janë të domosdoshme, njëherazi janë edhe kërkesa të strukturave integruese të KE-së dhe BE-së me efekte pozitive integruese për të gjitha fushat tjera të jetës dhe punës së shoqërisë. Debatet e ngritura nga ana e shtypit rreth përgjimeve të personaliteteve të niveleve të larta perëndimore dhe të ShBA-ve, njerëzimin akoma më shpejt po e dërgojnë në unifikim dhe integrim global rreth gjetjes së platformës unifikuese në mdhp dhe privatësisë së individit. “Në ShBA kompetencat për mbikëqyrjen e rregullave në fushën e mdhp i ka autoriteti i Komisionit Federal të Tregtisë (FTK)”⁶⁸.

⁶⁸Marrë nga Ueb faqja zyrtare e Komisionit Federal të Tregtisë në SHBA, shikuar më 10 qershor 2014.

KAPITULLI X: NJOHURI TË PËRGJITHSHME MBI MEKANIZMAT NDËRKOMBËTAR TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

10.1 Mekanizmat ndërkombëtarë të mdhp

Në fushën e mdhp sot bëhen organizime, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e këtyre të dhënave, tejkalimin e sfidave gjatë përpunimit automatik të të dhp dhe unifikimin e përbashkët të masave mbrojtëse të sigurisë dhe rregullave ligjore.

Sa i përket fushës për mdhp, e gjithë bota është e përfshirë në mekanizma të ndryshëm, qofshin ato të karakterit rajonal, kontinental apo grupime tjera.

Në mënyrë të detajuar për shumë mekanizma të organizmave të tillë do të flasim në artikujt në vazhdim.

Aspekti organizativ, kriteret e anëtarësimit, roli veprues i tyre etj, do të jenë disa nga shpjegimet që përmbajnë këta artikuj, me qëllim që njohuritë tona të mos mbesin të mangëta lidhur me rëndësinë që kanë të dhp në kohën e fluksit të madh të qarkullimit dhe procesimit automatik të tyre.

10.2 Konferenca ndërkombëtare e mdhp

Konferenca Ndërkombëtare e mdhp organizohet për çdo vit, që nga fillimi i viteve tetëdhjetë. Ky mekanizëm tubon të gjitha autoritetet e mdhp të të gjitha shteteve në nivel ndërkombëtar.

Kriteret e pjesëmarrjes dhe të anëtarësimit me të drejta të plota janë të thjeshta dhe kërkohet që autoriteti pjesëmarrës të jetë autoritet kombëtar apo të ketë kompetenca territoriale për një territor të caktuar për mdhp, të ketë pavarësi të plotë të funksionimit, të ketë ligj për mdhp, regjistrim paraprak, pagesa paraprake të participimit nga kuotizimi i cili caktohet nga Komiteti Ekzekutiv i Konferencës. Për anëtarësim me të drejta të

plota të këtij mekanizmi apo anëtar vëzhgues vendos Konferenca në seancë të mbyllur në bazë të rekomandimeve paraprake të Komitetit Drejtues të Konferencës, i cili përbëhet prej 5-7 shteteve, dhe në komitet drejtues përfshihet edhe vendi mirëpritës i konferencës.

AShMDhP e RK-së është anëtarësuar me të drejta të plota në këtë mekanizëm në tetor të vitit 2013, në Varshavë të Polonisë dhe njëherazi është përfshirë në grupin e punës prej 13 shtetesh, të cilin e kryesonnte Zelanda e Re për hartimin e Strategjisë Globale Botërore për edukimin dhe trajnimet në fushën e mdhp për një periudhë trevjeçare.

Konferenca trajton tema me interes global të sfidave të përgjithshme në fushën e mdhp dhe të privatësisë. Përveç autoriteteve dhe mekanizmave kombëtare të shteteve të kontinenteve të ndryshme të botës, në konferencë marrin pjesë edhe studiues, ekspertë ligjorë dhe njohës të teknologjisë së komunikimit, korporata të fuqishme të prodhuesve të pajisjeve dhe menaxhimit të programeve të ndryshme të teknologjisë informative, menaxhues të fuqishëm të faqeve sociale ndërkombëtare (puna e të cilëve lidhet në një mënyrë me përpunimin e të dhp dhe privatësinë e qytetarëve).

Në konferencë marrin pjesë dhe japin kontributin e tyre, gjithashtu edhe struktura të të drejtave të njeriut, të mdhp dhe agjenci të ndryshme të KE-së dhe zonës ekonomike të BE-së.

Konferenca çdo vit e ndërron vendin e mbajtjes, në varësi të gatishmërisë së organizimit të ndonjë shteti mikpritës, por për vendin e radhës së mbajtjes së konferencës vendoset në njërën nga seancat e mbyllura apo të hapura të konferencës dhe rekomandimet jepen nga Komitetit Ekzekutiv i Konferencës.

Konferenca nga fusha e veprimtarisë së punimeve të veta në nivel mbarëbotëror, me kompetencë në fushën e mdhp, i ndjek të gjitha zhvillimet, risitë, të arritjes dhe jep sugjerime në përputhje me dokumentet ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut, duke aprovuar dhe nxjerrë: rezoluta, vendime, rekomandime dhe deklarata.

10.3 Konferenca pranverore e autoriteteve europiane të mdhp “Spring Confferency”. *(Quhet konferencë pranverore, sepse punimet e kësaj konference organizohen dhe mbahen në pranverë).*

Konferenca organizohet në çdo dy vjet, por ndodh që konferenca të thirret edhe më shpesh, në bazë të rëndësisë dhe peshës që kanë temat (nëse duhen trajtuar me shpejtësi në interes të zhvillimeve të kësaj fushe dhe nevojave të KE-së), apo rëndësisë dhe interesit të përgjithshëm të subjektit të të dhp dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Konferenca organizohet qe tri dekada dhe në të me të drejta të plota marrin pjesë autoritetet e mdhp të BE-së dhe të KE-së, të cilat për anëtarësim në këtë mekanizëm duhet domosdoshmërisht të plotësojnë disa kritere.

Autoritetet e shteteve duhet të jenë nënshkruese dhe nga parlamentet apo qeveritë e tyre ta kenë të ratifikuar Konventën 108/1981 dhe protokollet e saj të mdhp gjatë përpunimit automatik të të dhp.

Duhet ta kenë adaptuar dhe inkorporuar në sistemin kushtetues-juridik të shtetit të vet Direktivën EC 95/46 të KE-së të vitit 1995 për mdhp dhe të privatësisë.

Duhet ta kenë të nxjerrë dhe të aprovuar ligjin e veçantë për mdhp dhe të privatësisë, i cili duhet të përmbajë materien ligjore të kërkuar nga Direktiva EC 95/46 e mdhp dhe privatësisë e KE-së.

Duhet ta kenë të ngritur autoritetin funksional dhe të pavarur për mdhp.

Paraprakisht, nga parlamenti i shtetit aplikues duhet të jetë e ratifikuar Konventa Europiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut e vitit 1953 dhe protokollet e saj shtesë.

Autoriteti kosovar i mdhp është anëtarësuar në qershor të vitit 2013 në Lisbonë të Portugalisë, në cilësinë e vëzhguesit permanent (të përhershëm), dhe tani agjensia nuk ka nevojë për aplikime të herëpashershme (status ky i cili për herë të parë fillon me Kosovën). Në rastin e parë kur, Kosova ta ratifikojë Konventën 108/1981 të mdhp gjatë

përpunimit automatik të tyre dhe protokollet shtesë të saj, autoriteti kosovar do ta fitojë statusin e anëtarit të përhershëm dhe me të drejta të plota.

Për pjesëmarrje në konferencë, autoritet e anëtarësuar nuk kanë nevojë për participim kotizues apo pagesë të ndonjë provizioni tjetër.

Konferenca në punimet e veta trajton tema me interes të fushës së mdhp, të transferit të të dhënave në shtetet e treta, të sigurisë dhe mdhp gjatë përpunimit automatik, të zhvillimeve në fushën e mdhp në hapësirën Europiane dhe më gjerë.

Konferenca nga punimet e veta nxjerr apo aprovon:

- opinione apo këshillime,
- vendime,
- rekomandime,
- rezoluta,
- deklarata.

Konferenca organizohet nga autoriteti i radhës i cili do ta marrë kryesimin e konferencës, dhe pjesë e punës organizative është Zyra e Sekretarit të KE-së me mekanizma të ndryshëm, si: Komisioneri i KE-së për mdhp, Eurojust, Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut etj. Me ndikimin e vet dhe rolin e fuqishëm që luajnë në mdhp dhe privatisë si dhe përgjithësisht në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut KE dhe BE, ratifikimin e Konventës 108/1981 të KE-së e kanë bërë edhe shtete të tjera jashtë hapësirës së Europës, si Uruguai, Maroku etj, të cilat kanë kërkuar edhe anëtarësimin në “SpringConfereency”.

10.4 Konferenca e autoriteteve “frankofone” të mbrojtjes së të dhp

Kjo konferencë organizohet për çdo vit dhe mbahet nën patronazhin e autoritetit francez të mdhp. Tubimet zhvillohen në vendet e autoriteteve të cilat janë anëtare të shoqatës së

shteteve frankofone (aty ku flitet frëngjishtja dhe shtrihet kultura e ndikimit frankofon). Në konferencë marrin pjesë dhe japin kontributin e tyre edhe ekspertë nga korporata të fuqishme biznesi dhe akademikë të universiteteve prestigjioze ndërkombëtare.

Kriteret e anëtarësimit në këtë mekanizëm janë:

- Autoriteti që aplikon duhet të ketë miratuar ligjin e mdhp në përputhje me Direktivën EC 95/46 të vitit 1995.
- Shteti aplikues duhet të ketë autoritetin e pavarur të ngritur në përputhje me kërkesat e Konventës 108 dhe Direktivës EC 95/46 të vitit 1995 të KE-së.
- Autoriteti që aplikon për anëtarësim duhet të dëshmojë se shteti prej nga vjen autoriteti është anëtar i shoqatës së shteteve frankofone.
- Autoriteti i shtetit konkurrues për anëtarësim duhet të paguajë tarifën e caktuar për anëtarësim. Komiteti Organizativ i Konferencës i ka të përcaktuara tri shkallë të tarifave për anëtarësim, të cilat varen nga numri i banorëve dhe fuqia ekonomike e shtetit prej nga vjen autoriteti konkurrues (tarifat nuk janë edhe aq të larta).
- Autoriteti i mdhp i shtetit që anëtarësohet në këtë mekanizëm duhet të caktojë pikën e kontaktit, respektivisht zyrtarin kontaktues, i cili duhet detyrimisht të jetë njohës i gjuhës frenge dhe komunikimi lidhur me konferencën duhet të zhvillohet në gjuhën frënge.

Kosova, respektivisht agjencia kombëtare, edhe pse ka aplikuar për anëtarësim, nuk është e anëtarësuar në këtë mekanizëm, pasi Kosova si shtet nuk është e anëtarësuar në frankofoni. Agjencia është ftuar si vëzhguese menjëherë pas aplikimit në vitin 2013. Ndërsa në qershor 2015 në Konferencën e AFMDhP të Brukselit është pranuar me të vetmin kusht që të ketë një zyrtar frëngjisht-folës në autoritetin e vetë i cili do të shërbejë si pikë kontakti me Asamnblenë Frankofone të mdhp.

Organi më i lartë vendimmarrës i autoriteteve frankofone të mdhp është Asambleja, që përbëhet nga të gjitha shtet anëtare me të drejta të plota në këtë mekanizëm.

Konferenca gjatë zhvillimit të punimeve të saj merret me problemet e mdhp, me këmbimin e përvojave të punës, arritjeve dhe sfidave të autoriteteve të mdhp dhe nxjerr

opinione, rezoluta dhe deklarata për mekanizmat e Këshillit dhe Komisionit European dhe mekanizmave të ngjashëm për mdhp dhe opinionin ndërkombëtar.

10.5 Konferenca ndërkombëtare e mdhp e autoriteteve “anglosaksone”.

Konferenca tubon autoritet e mdhp pa dallim dhe pa kriterin e domosdoshëm „anglishtfolës“, për dallim nga ai i frankofonisë, ku kriter i domosdoshëm është të qenit autoritet i shtetit anëtar të frankofonisë.

Për organizimin dhe të menaxhimin e këtyre konferencave, zakonisht kujdeset autoriteti Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe.

Pjesëmarrja është e lirë dhe pa ndonjë kufizim të caktuar. Natyrisht, autoriteti pjesëmarrës i mdhp duhet të jetë autoritet i pavarur që të menaxhojë me ligjin e mdhp.

AShMDhP e Republikës së Kosovës në prill të vitit 2014 ishte pjesëmarrëse në punimet e kësaj konference, e cila u mbajt në Mançester të Anglisë.

Konferenca merret me trajtimin e temave me interes permanent në mdhp. Gjatë seancave, ligjëratave dhe debateve, konferenca trajton tema nga aspekti praktik, sfida dhe përvoja nga terreni që dalin gjatë mbrojtjes praktike të dhp.

Kështu, angazhimi permanent i këtij mekanizmi është i orientuar në rrjetëzimin e autoriteteve në tejkalimin e përbashkët të sfidave dhe qasjen e përbashkët në fushën e inspektimeve, aty ku mundësitë legale të kompetencave territoriale të veprimit në fushën e zbatimit të ligjit të mdhp, nuk kanë mundësi të zbatohen ndaj kontrolluesve, ndaj të cilëve zhvillohet hetimi/inspektimi, dhe selinë e veprimit të vet ligjërishit e kanë jashtë territorit ku kontrolluesi ka bërë shkelje ligjore. Por veç tjerash rrjetëzimi i këtyre autoriteteve shqyrton edhe aspekte tjera të praktikave më të mira të mdhp si ato legjislative e teknologjike dhe bashkëpunon edhe në projekte dhe ekspertiza të përbashkëta të kësaj fushe.

Konferenca gjatë prezantimit të praktikave dhe përvojave të punës nxjerr opinione, jep këshilla dhe rekomandon veprime në fushën e mdhp për mekanizmat europian dhe ndërkombëtar të mdhp.

Përveç autoriteteve të mdhp, në këto punime marrin pjesë edhe ekspert të instituteve, universiteteve prestigjioze, kompanive dhe korporatave të fuqishme të zhvillimit të legjislacionit, të së drejtës ndërkombëtare mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, mbrojtjen e privatësisë dhe interneti.

10.6 Komiteti konsultativ i Konventës 108 për mdh gjatë përpunimit automatik të të dhp

Komiteti Konsultativ i Konventës 108 është i përbërë nga anëtarët e autoriteteve të mdhp dhe të privatësisë nga të gjitha shtetet anëtare nënshkruese dhe ratifikuese të Konventës 108.

Komiteti Konsultativ i ashtuquajtur “Komiteti Konsultativ 108” tubohet për çdo vit, por mund të ndodhë edhe më shpesh, në rast nevojë.

Komiteti nxjerr rekomandime, jep opinione dhe këshilla për Komisionin Europian, për Grupin 29 të ashtuquajtur “WorkingGroup 29”, të ngritur sipas Direktivës EC 95/46 të KE-së, të cilat kanë të bëjnë me kornizën ligjore të Konventës 108, me pasurimin e saj, me zbatimin e detyrimeve që dalin nga Konventa 108 lidhur me mdhp të shteteve anëtare të Konventës, lidhur me harmonizimin ligjor dhe vendosjet e zbërthimeve të materies nga natyra e mdhp nga Konventa 108 në Direktivën 95/46 të KE-së dhe kornizave ligjore të vendeve anëtare nënshkruese dhe ratifikuese të konventës në fjalë.

Komiteti Konsultativ mund të rekomandojë opinione dhe propozon materiale me interes të ngritjes cilësore dhe të tejkalimit të sfidave aktuale me të cilat aktualisht përballet qytetërimi europian dhe ndërkombëtar edhe për Konferencën Pranverore të autoritetet e mdhp.

Komiteti Konsultativ jep mendime për Komisionin Europian dhe mekanizmat e KE në rastet e propozimeve me interes të shtimit të protokolleve të reja të Konventës 108, të rregullimit të dispozitave dhe paragrafëve të saj.

Kosova, autoritetin e saj të mdhp, respektivisht agjencinë, mund ta ketë të përfshirë dhe të anëtarësuar në Komitetin Konsultativ, atëherë kur Parlamenti i Kosovës ta ketë ratifikuar Konventën 108/81 të mdhp gjatë përpunimit automatik të të dhënave. Tani Kosova ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale me organet e BE-së dhe të KE-së.

Komiteti Konsultativ 108, bazën ligjore të veprimit të vet e ka në Konventën 108/1981 dhe jetëgjatësinë e veprimit dhe punës së vet e ka më tepër se tri dekada.

10.7 Konferenca e autoriteteve të mdhp të Europës Qëndrore dhe Lindore

Këto konferenca organizohen për çdo vit dhe herë-herë edhe çdo dy vjet, kryesisht në vendet e autoriteteve të Europës Juglindore të cilat kanë dalë nga sfera e bllokut komunist, përfshirë këtu edhe autoritetet e mdhp të Ballkanit, të cilat janë anëtarësuar ose presin anëtarësimin në strukturat Europiane.

Sekretariati për organizimin e këtyre strukturave është i angazhuar nga autoriteti polak i mdhp “GIODO”, i quajtur ndryshe Inspektor Kryesor i mdhp. Kriteret e anëtarësimit janë tejet të thjeshta: së pari kërkohet një vullnet i proklamuar i autoriteteve për mdhp, më pas paraqitja e një kërkesë nga autoriteti i cili do të bëhet pjesë e këtij mekanizmi.

Në konferenca diskutohen dhe zhvillohen debate për temat në fushën e mdhp, duke paraqitur shembuj të praktikave të mira ligjore në këtë fushë, duke trajtuar tema që kanë të bëjnë me sfidat e sotme të sigurisë dhe mdhp në sektorë të ndryshëm të jetës dhe punës në fushën e teknologjisë informative dhe internetit dhe sektorëve tjerë që janë të rëndësishëm në aspektin e përpunimit automatik të të dhënave.

Konferenca trajton edhe aspektet e legjislacionit të KE-se dhe BE-së dhe reformat rreth Projekt Rregullores së Re, e cila pritet të aprovohet nga KE dhe Parlamenti Europian.

Kosova, respektivisht, AShMDhP është anëtarësuar në këtë mekanizëm me të drejta të plota në prill të vitit 2015, në konferencën e mbajtur në Durrës të Shqipërisë.

Përveç autoriteteve të mdhp, pjesëmarrës në konferenca të këtij lloji mund të jenë edhe ekspertë të fushave të ndryshme të të drejtave të njeriut, të shkencave juridike, të drejtësisë ndërkombëtare, të korporatave të fuqishme të faqeve sociale dhe avokatëve të popullit.

10.8 Grupi i Berlinit për mdhp në fushën e telekomunikacionit dhe teknologjisë së informimit

Grupi i Berlinit në takime të këtilla tubon të gjitha autoritet Evropiane të Europës Qendrore, Europës Juglindore etj.

Ky mekanizëm kryesisht fokus dhe objektiv pune ka aspektin e trajtimit të temave në fushën e telekomunikacionit, të makinerisë së internetit dhe teknologjisë së përpunimit automatik të të dhë.

Organizatore e këtyre konferencave është autoriteti qendror gjerman i mdhp, me seli në Berlin. Fokusi kryesor është aspekti profesional dhe tubimi i ekspertëve të autoriteteve të mdhp dhe ekspertëve të korporatave të fuqishme të telekomunikacionit dhe të informimit, me ç'rast trajtohen tema të praktikave dhe përvojave më të mira për sigurinë dhe mdhp.

Konferenca bënë mbajtjen e tubimeve vjetore apo dy vjetore, ndërsa vendet dhe autoritetet e mbajtjes së tubimeve kryesisht janë: Gjermania, vendet e Europës Qendrore dhe Juglindore, por pjesëmarrja është edhe e vendeve tjera

Për pjesëmarrje në këtë konferencë nuk ka kritere të veçanta dhe specifike, nuk ka as barriera të anëtarësimit dhe pjesëmarrjes permanente.

10.9 Grupe punuese sipas artikullit 29 të Direktivë EC 95/46 të KE-së “WorkigParty 29”

Ky grup punues është i themeluar sipas Direktivës Europiane të MDhP 95/46, i cili ka status këshillimi dhe veprimit të pavarur.

Grupi i punës formohet nga përfaqësuesit e autoriteteve mbikëqyrëse nga çdo shtet anëtar dhe nga një përfaqësues i autoritetit të komuniteteve të themeluara nga institucionet dhe organet e komuniteteve dhe një përfaqësues i komisionit, Direktiva EC 95/46 të KE dhe Parlamentit të BE (1995:38).

Çdo shtet anëtar në grupin e punës përcaktohet nga institucioni, autoriteti ose autoritetet që ai përfaqëson. Nëse një shtet anëtar ka më tepër se një autoritet mbikëqyrës, ato shtete (autoritete të shteteve) nominojnë një përfaqësues të përbashkët. E njëjta zbatohet edhe për autoritetet e themeluara për institucionet dhe organet e Komunitetit.

Grupi i punës vendimet e veta i merr me një shumicë të thjeshtë të përfaqësuesve të autoriteteve mbikëqyrëse pjesëmarrëse në takim.

Grupi i punës e zgjedh kryetarin e vet (drejtuesin), mandati i të cilit është dy vjeçar dhe me të drejtë të rizgjedhjes. Sekretari i grupit të punës caktohet nga Komisioni European, ndërsa grupi punues i cakton rregullat dhe procedurat e punës.

Agjenda e takimeve organizohet nga kryetari, por në axhendë mund të përfshihen edhe propozimet e përfaqësuesve të autoriteteve mbikëqyrëse të mdhp dhe të Komisionit European.

Detyrat kryesore të grupit të punës janë:

- mbikëqyr zbatimin e masave kombëtare të adaptuara sipas Direktivës dhe aplikimin uniform të masave të këtilla;
- i jep Komisionit opinione për nivelin e mdh në komunitete dhe në shtetet e treta;
- e këshillon Komisionin lidhur me propozimet dhe mendimet sipas Direktivës 95/46 për ndonjë shtim ose masë specifike për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve

lidhur me përpunimin e të dhp, si dhe i propozon Komisionit ndonjë ide që ndikon në të drejtat dhe liritë e këtilla;

- jep mendime lidhur me kodet e etikës të hartuara në nivelin e komunitetit.

Grupi i punës mund të japë rekomandime me iniciativë të tij në të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen dhe përpunimin e të dhp në komunitet.

Mendimet dhe rekomandimet e grupit të punës i dërgohen komisionit dhe komiteteve, të cilat i referohen dispozitës së nenit 31 të Direktivës EC 95/46.

Komisioni e njofton grupin e punës për veprimet e ndërmarra në përgjigje të mendimeve dhe rekomandimeve të tij. Komisioni e përgatit një raport, i cili u dërgohet Parlamentit European dhe Këshillit. Raporti bëhet publik.

Grupi i Punës e harton raport vjetor për situatën e mdhp gjatë përpunimit të tyre në komunitete dhe në shtetet e treta, i cili i përcillet Komisionit European, Parlamentit European dhe Këshillit European. Raporti bëhet publik.

AShMDhP e RK-së aplikimin e vet në këtë mekanizëm e ka adresuar qysh në vitin 2012. Por, pranimi në grupin e punës do të bëhet pas ratifikimit të Konventës 108 të mdhp gjatë përpunimit automatik të të dhp, natyrisht, duke u marrë në konsiderim edhe përmbushja e kriterëve të kërkuara për anëtarësim në “WorkingGroup 29” nga ana e Kosovës.

10.10 Grupi Ndërkombëtar i Rrjetëzimit të Autoriteteve të MDhP “GIPEN”

Grupi Punues Ndërkombëtar i Rrjetëzimit të Autoriteteve të MDhP është grupim i autoriteteve mbikëqyrëse të mdhp të shteteve të ndryshme në nivel ndërkombëtar. Kujdesi, organizimi dhe menaxhimi i këtij grupimi realizohet, kryesisht, nën përkujdesjen e autoritetit mbikëqyrës të mdhp të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe.

GIPEN është relativisht grupim i ri dhe është i organizuar kryesisht mbi bazën e organizimit të OECD-së (Organizata e Zhvillimit Ekonomik Evropian), dhe deri tani (deri në korrik të vitit 2014, kur u konfirmua pranimi i AShMDhP), janë anëtarësuar 38 autoritete mbikëqyrëse të mdhp. Anëtare të këtij grupi rrjetëzues janë edhe autoritetet mbikëqyrëse të dhp pothuajse nga të gjitha kontinentet e botës.

Ky grupim për objektiv pune ka qasjen e përbashkët të autoriteteve mbikëqyrëse të mdhp nga shtetet e ndryshme të botës, pa marrë parasysh distancën e largësisë gjeografike në mes tyre, në hetime dhe inspektime të përbashkëta ndaj kontrollorëve që janë shkelës të rregullave dhe ligjeve të mdhp dhe të privatësisë, ngase me shkeljet që ata bëjnë, u sjellin dëme të mëdha dhe të pariparueshme subjekteve të të dhp edhe jashtë territorit ku ndodhet selia e regjistrimit të këtyre kontrolluesve. Qëllimi kryesor është qasja e përbashkët në sfidën globale të njerëzimit të operatorët e korporatave të mëdha që përpunojnë të dhp në fushën e telekomunikimit dhe të internetit, e konsideruar si njëra ndër fushat me mundësitë më të mëdha të ndërhyrjeve të jashtëligjshme në të dhp dhe në privatësinë e individit. Ky rrjetëzim punon dhe koordinon aktivitet e veta edhe në aspektin e njohurive si të atyre të sigurisë, të legjislacionit dhe të teknologjisë digjitale dhe të automatizimit.

Tani, si një organizim i përkushtuar i operacioneve të përbashkëta në interes të të drejtave dhe lirisë së individit, në mbrojtjen e privatësisë dhe të dhp zhvillohen diskutime ndërkombëtare mbi vendosjen e bazës ligjore të veprimit të Grupit Rrjetëzues ndërkombëtar të autoriteteve mbikëqyrëse të mdhp dhe krijimit të një platforme dhe të një domeni të përbashkët të veprimit mirë të kontrolluar dhe pa mundësi të ndërhyrjeve të hakerëve të jashtëm në këtë platformë.

AShMDhP e Kosovës në vitin 2014 ka aplikuar për pranim dhe ka marrë konfirmimin e anëtarësimit në këtë mekanizëm. Për pranim në këtë grupim, autoriteti kosovar i mdhp i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara për anëtarësim.

Njëri ndër kriteret obligative është edhe një participim me një pagesë të vogël për anëtarësim vjetor, i cili kryesisht nevojitet për mirëmbajtjen e ueb faqes së përbashkët të grupit.

10.11 Konferencat ndërkombëtare të karakterit shkencor për mdhp dhe të privatësisë

Këto lloje të konferencave janë organizuar në vazhdimësi që nga viti 2007 në hapësirën e Europës, ndonëse organizime të këtilla mund të bëhen edhe nga vendet tjera. Në një agjendë shkencore lidhur me privatësinë dhe mhp, në të gjitha temat që trajton konferenca që nga viti 2007, janë bashkuar në një platformë për të sjellë inovacione dhe publikime shkencore një grup hulumtuesish nga universiteti “Vrije” i Brukselit, “Universiteti de Namur” dhe “Tirburg University” në bashkëpunim me disa institute tjera kërkimore dhe 20 qendra më të mira akademike nga Europa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me qëllim të nxitjes dhe nxjerrjes së publikimeve shkencore në një atmosferë plotësisht të pavarur. Ky organizim unikal nën formulën shkencore multidisiplinare mbi mdhp dhe privatësinë shënon edhe kulmin e suksesit të këtij lloji të konferencave në nivel European dhe atë botëror. CPDP, në vitin 2014, si pjesë të nivelit të lartë dhe kërkimeve inovative nga PhD studentët dhe hulumtuesit e rinj, kishin arritur të organizoheshin dhe zhvillonin në këtë frymë komplet sesione të punëtorive www.cdpconferences.org, shikuar, 01.10.2014, artikulli: Computers, Privacy and Data Protection Conference (CPDP); Brussels, 22-24 janar (2014:2) gjatë konferencës.

Ndërkaq, një vit më vonë, si tema qendrore nën reformën e mdh konferenca kishte paraparë: zhvillimet europiane dhe globale në teknologjinë mobile, teknologjinë variable, videovëzhgimin, qarkullimin ndërkufitar; EU-US zhvillimet dhe rregulloret qeveritare të mbikëqyrjes me videovëzhgim; mdhp në shëndetësi; privatësia dhe mbroja e të dhënave; mbrojtja e të dhënave në kohën e rilindjes në botën digjitale; interneti qeveritar dhe privatësia marrë nga www.cdpconference, Konferenca e Tetë Ndërkombëtare, 21,22,23 janar, 2015, Brussels, Belgium, shikuar më 01.10.2014, Artikulli CPDP COMPUTERS, PRIVACY AND DATA PROTECTION/2015 DATA PROTECTION ON THE MOVE, CPDP, (postuar më 05.08.2014). Ndërsa, në vazhdimësi, konferenca në saje të sfidave të reja që ndeshen në jetën e përditshme në fushën e privatësisë në nivel global, çdoherë aktivizon tema të reja, organizon debate nëpër shumë panele dhe nxjerr përfundime për rrugën që duhet ndjekur në fushën e

mdhp dhe privatësisë, si e drejtë elementare e dinjitetit të njeriut dhe lirive të tij individuale.

10.12 Organizimet tjera rajonale e ndërkombëtare në fushën e mdhp

Në kontinente dhe rajone të ndryshme bëhen organizime të ndryshme të përbashkëta të grupimeve në fushën e mbrojtjes së të dhp dhe të privatësisë me fokus: sigurinë, të drejtat dhe liritë e individit, të drejtën fundamentale për mbrojtjen e privatësisë.

Grupimet dhe organizimet e këtilla janë relativisht të reja, por nxitja e këtij bashkëpunimi kryesisht shtrihet në hulumtimin e gjetjeve të praktikave më të mira të zbatimit të ligjit të kësaj fushe: të këmbimit të përvojave të përbashkëta, zhvillimit të projekteve të përbashkëta dhe marrjes së njohurive të reja në fushën e teknologjisë së telekomunikimit dhe internetit dhe teknologjisë së përpunimit të të dhp dhe privatësisë së individit.

Një organizim të tillë nga viti 2011 e kan filluar autoritet e shteteve skandinave të mdhp të emërtuar si “Komitetit i Europes Veriore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, që tubon shtet skandinave për çdo vit me temat nga fusha e mdhp dhe privatësisë.

Fluksi tejet i madh i qarkullimit të të dhp, shpejtësia tejet e madhe e komunikimit dhe koleksioni tepër i madh i përpunimit të të dhënave nga një teknologji tejet e sofistikuar e komunikimit njerëzor, me mundësi të pakontrolluara të përgjimit, ka nxitur organizimet dhe grupimet e shpejta të autoriteteve të fushës së mdhp në të gjitha rajonet në nivel ndërkombëtar për qasjen e përbashkët në kapërcimin e kësaj sfide.

Demokracitë moderne dhe të përparuara shumë më herët, kur është fjala për të drejtat e njeriut dhe zbatimin praktik të dispozitave ndërkombëtare në interes të qytetarëve të tyre, në sistemin e brendshëm kushtetues nxorën ligje dhe miratuan rregulla të sigurisë dhe dispozita të veçanta të kësaj fushe. Kështu, e drejta e publikut dhe liria e informacionit në vitin 1966 u mundësua me rastin e nxjerrjes së Ligjit për Lirinë e Informacionit (jo vetëm për qytetarët amerikan), në mënyrë që qytetarët të dinë se ç'bën qeveria, (Douglas K.Stevenson, 1989:10), në kohën kur këto të dhëna për qeveritë tjera

të botës ishin sekrete për publikun, me përjashtim të Suedisë. Ndërkaq, në vitin 1974 qytetarëve amerikan, përmes ligjit mbi Fshehtësinë Private, iu mundësua që të shohin të gjitha informatat që qeveria federale, qeveritë lokale apo institucionet shtetërore kanë mbledhur rreth tyre (Douglas K.Stevenson, 1989:10)

Por, për organizime të këtilla më mirë të konsoliduara dhe mirë të organizuara, me bazë të konsoliduar të legjislacionit ndërkombëtar, tani për tani prinë KE, Parlamenti dhe BE-ja, falë bazamentit juridik të vendosur specifikisht në Konventën 108/1981 për mdhp gjatë përpunimit automatik të të dhënave. Pothuajse të gjitha këto grupime, si orientim pune kanë Konventën 108 dhe Direktivën EC 95/46 të mdhp të KE-së dhe Parlamentit European.

Mbi bazën e lirisë së qytetarëve pa dallim, sundimit të ligjit (drejtësisë) dhe sigurisë së përgjithshme, sot pashmangshëm duhet ngritur kuadro të afta dhe me kredibilitet moral, profesional dhe etik në mënyrë që guximshëm dhe profesionalisht të vendosin proporcionalitetin e ballancës në mes të lirisë së informacionit, qasjes në dokumente publike, të drejtës për ripërdorimin e informatës, të drejtën për të harruar, të drejtën për të ditur, sigurinë e informacionit dhe klasifikimit të informatave dhe mdhp. Këto të drejta të aplikuara, në interes të lirive fundamentale të njeriut janë vlera të demokracisë dhe progresit të përgjithshëm të shoqërisë njerëzore.

Në shumë shtete tashmë autoritet e mdhp, përshkak të ndërlidhjes së ngushta ligjore po vazhdojnë të marrin nën mbikëqyrje, përveç ligjit të mdhp, edhe ligjet tjera njëkohësisht, si: atë të lirisë së informacionit dhe atë të qasjes në dokumente publike.

KAPITULLI XI: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

11.1 Konkluzione

Studimi sjell njohuri themelore për të drejtat e njeriut me theks te ngritja graduale e vetëdijes së shoqërisë në kontestin e zhvillimit të njohurive elementare mbi sigurinë dhe mdhp. Aktorët ndërveprues, individit dhe institucionet shtetërore marrin informacionet e nevojshme mbi të dhp si pjesë e pandarë e të drejtave universale të njeriut.

“Nga kjo mund të konstatohet se koncepti mbi strukturën teorike, konsideratat ndaj përvojës dhe sidomos problemi i zgjidhjes teorike nuk janë pikëpamje të izoluara ose të shkëputura . . . e që do të shtjellohen në vazhdim” (Abazi, 2014:166) gjatë kësaj analize në shumë nivele; ku koncepti i sigurisë së individit dhe dilemat e tij rreth mdhp janë dhënë përmes analizës që subjektit dhe kontrolluesit të dhënave t’i sqarohet rreziku i cenimi të sigurisë së të dhënave dhe njohja me të drejtat, instrumentet dhe veprimet që duhet ndërmarrë për mdhp.

- Prandaj në përputhje të qëllimit dhe objektivave të shtruara në fillim është rishikuar litaratura në lidhje me mdhp, janë shtruar pyetjet kërkimore dhe hipotezat, është hulumtuar historikisht dhe kronologjikisht problematika e mdhp, përmes analizës dhe metodologjisë se përdorur mendojmë se ja kemi dalur për ta bindur lexuesin me këtë sfidë mjaft serioze.
- Bazuar në të dhënat e analizuara, krahasimeve dhe vlerësimeve, përfundojmë se mungesa e njohurive është shumë e theksuar. Njohurit janë të domosdoshme dhe me shumë interes për institucionet e Kosovës; veçmas për strategjitë, planet dhe programet e mdhp.
- Sfidat e mdhp dhe sigurisë së tyre, karshi përpunueseve të mëdhenj të dhp mbetën preokupim kryesor i institucioneve mbikëqyrëse, veçmas të aspekteve praktike të mdhp.

- Nuk dëshirojmë të analizojmë një vendim pasi ta zbatojmë, dhe pastaj ta diskutojmë atë nga suksesi apo dështimi, andaj para dështimeve dijet e sjella përmes rekomandimeve janë infuzion për suksesin e synuar.
- Punimi sjell impakte në sfondin e bllokut; Siguri-Sundimit i ligjit-të Drejtat dhe liritë e njeriut, për të gjitha organet, veçmas për ato publike, dhe ndikon pozitivisht në sigurinë e qytetareve dhe rrit besimin te institucionet.
- Përmes punimit japim kontribut në rritjen e sigurisë; duke mos qenë vetëm konsumues i saj por edhe kontributor në zhvillimin e vlerave të demokracisë.
- Në aspektin e sigurisë kemi bërë identifikimi e objektit referues; aktorin sigurizues; aktin e ligjërimit; hapat për sigurizimin dhe desigurizimin. Suksesi i punimit lidhet me ligjërimitin shumë dimensional për të bindur audiencën për ekzistencën e kërcënimit real ndaj privatësisë së individit dhe sulmeve kibernetike mbi të dhp.
- Institucionet e sundimit të ligjit gjatë trajtimit të problemit të shtruar për analizë, çështjet e mdhp mund t'i përfshin në procesin e sigurizimit, për shkak të implikimit të tyre në sigurinë e individit, sigurinë ekonomike, sigurinë shoqërore, sigurinë kombëtare të një vendi. Në Kosovë dhe rajon duhet përfshirë këto çështjet në procesin e sigurizimit, si mënyrë për minimizimin kërcënimeve ndaj mdhp.
- Kemi arritur të kuptojmë se; drejtat dhe liritë themelore, përmes abuzimit me të dhp. Janë të rrezikuara. Kufizimi i lirive individuale përbën pasiguri dhe pengon zhvillimin e të drejtave universale dhe demokracisë ku ndikon në nxitjen e pasigurisë “të jetës politike përtej nivelit të shtetit drejt gjithë njerëzimit” (Burshill & Linklater, 2010:179).
- Studimi nxjerr përfundimet se aktorët të cilët duhet veprojnë për t'u sigurizuar janë Institucionet shtetërore Qeveria dhe Kunvendi bashkë me institucionet mbikëqyrëse

te mdhp dhe organet publike e private qe përpunojnë të dhp. “kur kemi parasysh edhe shpërthimin e skandale të përgjimeve muajin maj 2016 në Shqipëri”⁶⁹

- Rreziku potencial i dhunës kibernetike kalon kufijtë shtetëror dhe përbën kërcënim serioz jo vetëm për individin por edhe për shtetin. Këto arsye ndikuan që Republika e Kosovës në vitin 2015 të formojë grupin e punës, në kuadër të “Ministrit të Punëve të Brendshme për nxjerrjen e strategjisë kibernetike në nivel shtetëror dhe planin e veprimit 2016-2019 (Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe Planin e Veprimit 2016–2019” (2015:3) të Republikës së Kosovës.
- Punimi nxjerr në pah nevojën e debatit dhe aktit të ligjërimit dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit më të madh midis institucioneve të zbatimit të ligjit për t’u përballur me kërcënimet që kapërcejnë kufijtë veçmas, “duke nxitur masa emancipuese si akte preventive të konceptit sigurisë politike” (Collins, 2013:455).

Ndonëse problematika është e re kemi përdorur edhe citime, që përforcojnë konkludimet tona. Si rregull nuk preferohen citime të konkluzionet por as nuk hedhen plotësisht. Matthews (2010:425) thekson se: “Disa specialist rekomandojnë që si mbyllje mund të shërbej ndonjë citim i mirë nga ndonjë shkencëtar i njohur në fushën tuaj”

Dukurit e vëzhguara nga burime të ndryshme të literaturës dhe institucioneve shkencore profesionale, nga të metat e institucioneve dhe instrumenteve ligjore, në diskutim me ekspert të institucioneve të fuqishme nga BE-ja si njohës të kësaj fushe, duke e analizuar problemin hap pas hapi në formë të rrethana të ndryshme, pas përfundimeve nxjerrim para lexuesit rekomandimet në vazhdim, bindëse dhe argumentuese.

11. 2 Rekomandime

Rekomandimet rrjedhin nga shtjellimi i tërësishëm i materialit. Në mbështetje të përfundimeve rekomandojmë, se:

⁶⁹Merkel pyetet për përgjimet në Shqipëri”, <http://tvklan.al/merkel-pyetet-per-pergjimet-ne-shqiperi/>

1. Është e nevojshme që në Kosovë të fillohet me harmonizimet ligjore me Rregulloren e Re të mdhp të KE-së, harmonizimi të filloi edhe në nivel të institucioneve në Rajon (rregullorja tashmë është nxjerr dhe fuqinë detyruese për zbatim e ka nga 20 maji 2018).
2. Shtetet e BE-së, veçmas në Rajonin e Ballkanit t'i ndërtojnë mekanizmat e mdhp me ngjashmëri dhe me shumë pak dallime. Dallimet e këtyre mekanizmave mund të lidhen kryesisht me specifikat tepër të theksuara të institucioneve, qofshin ato nga sistemet e ndryshme të përpunimit të dhënave apo veçorive që vijnë prej trashëgimisë nga e kaluara.
3. Institucionet e ngritura për mdhp të jenë të tipit të Komisionerëve, dhe jo organe kolektive të cilat janë joefikase gjatë vendimmarrjes, me organe dyshkallëshmërie të drejtës për ankesë nga ana e kontrollorëve dhe subjekteve të dhp.
4. Sa më parë të vendosen masa specifike administrative, në legjislacionin e mdhp, me qëllim që Komisionerët direkt, nga vet autoriteti të kenë mundësinë e shqiptimit të gjobave kundërvajtëse për kontrollorët e papërgjegjshëm dhe ato të jenë më të larta.
5. Nxjerrja e një buletini informativ rajonal me informata, artikuj shkencorë profesional dhe shembuj të punës dhe praktikave të mira.
6. Nxjerrja e ligjit të veçantë për videovëzhgimin me kamera në Kosovë, që specifikon; përgjegjësitë, përdorimin, sigurinë, të drejtat, obligimet për subjektet e të dhp.
7. Specifikimi i afateve të ruajtjes së të dhp në kornizat e brendshme rregulluese, ngase në shumë korniza ligjore mungon një specifikim i tillë.
8. Siguria e sistemeve të bazave të të dhënave, përmes funksionalizimit të ISMS-it dhe certifikimit të ekspertëve të TI.
9. Efikasiteti i gjyqësorit dhe ngritja e kapaciteteve në drejtim të harmonizimit dhe aplikimit të standardeve të GjED, lidhur me sigurinë dhe mdhp ku të drejtat e njeriut, në legjislacionin e vendit, të mos parashkruhen. Të vlen standardi i njejtë si në hapësirën juridike të UE-së
10. Nxjerrja e rregulloreve lidhur mdhp te përdorimi i “dronëve” si dhe nxjerrja e rregullores së veçantë lidhur me mdhp nga ana e “mediave” dhe “portaleve”.

11. Organizimi i një instituti në nivel rajonal për hulumtimin e praktikave të mira për mdhp, duke bashkërenduar përvojat e shteteve europiane e ndërkombëtar me ato të rajonit në aspektin ligjor, të teknologjisë informative dhe të përpunimit automatik të dhp. Dhënia e inputeve profesionale dhe aspekteve tjera hulumtuese në funksion të avancimit të drejtave individuale do të ishte një nga detyrat prioritare të këtij instituti.

12. Ngritja e bazave të veçanta të punës në sferën e arsimit me themelimin e njësive akademike të veçanta lidhur me mdhp. Ngritja e një katedre/seksioni të veçantë për sigurinë dhe mdhp, në kuadër shkencave të sigurisë, juridike ose sociale, do të mundësonte përballje efikase me sfidën që ka sjellë “epoka digjitale” në fluksin e madh të qarkullimit të dhp brenda dhe jasht shtetit në relacione të fluksit të madh të tregtisë botërore.

13. Të vendoset me prioritet profilizimi i punës në sektor specifik të organeve që përpunojnë të dhp në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të mdhp përmes ekspertëve, specialistëve dhe inspektorëve të ASHMDhP me qëllim të kapërcimit të sfidave në mes të mdhp, qasjes në dokumente publike, sigurisë së informacionit dhe të drejtës së informimit.

14. Abuzimi me të dhënat e ndjeshme të trajtohet si vepër penale dhe të rregullohet me ligjin e mdhp dëm shpërblimi i viktimave nga shkelësit dhe abuzuesit e të dhp.

15. Krijimi i një platforme të përbashkët të veprimit unifikues në sektorin e inspektimeve dhe hetimeve të përbashkëta në mes të autoriteteve Europiane mbikëqyrëse për mdhp, duke vendosur një mjet të përbashkët të informacionit për shkelësit e mëdhenj të të dhp në fushën e internetit.

16. Fuqizimi i grupit të përbashkët rrjetëzues të autoriteteve mdhp, vendosja e plotë e bazës ligjore dhe sigurimi i funksionimit profesional të teknologjisë së komunikimit, me sigurimin dhe garantimin e funksionimit të përbashkët pa mundësinë e ndërhyrjeve dhe cenimit të privatësisë së komunikimit.

17. Sa më parë mekanizmat ndërkombëtare dhe autoritetet e sigurisë dhe mdhp të niveleve kombëtare, duhet të ushtrojnë ndikimin e tyre në rrjetet globale të internetit për të ndërhyrë në përcaktimin e afateve kohore të ruajtjes së të dhp të profileve të qytetarëve, të cilat pa

kurrfarë rregullash dhe pa afate kohore gjenden në profilizimet e ndryshme në “Google” dhe rrjete tjera.

18. AShMDhP duhet të ngrejë aktivitetin proaktiv të veprimit në terren dhe të përmbyllë aktivitetin e anëtarësimit në mekanizmat e mbrojtjes së të dhp, veçmas atyre europiane, siç është “Working Party 29”.

19. Kosova, organet kompetente; Qeveria dhe Parlamenti, sa më parë të gjejnë forma dhe të bashkërendisin aktivitetet e ratifikimit të Konventës 108/1981 të mdhp gjatë përpunimit automatik të të dhp dhe të privatësisë së individit, si dhe të jetë vazhdimisht e kujdesshme në përcjelljen e kornizës legjislative të të drejtave të njeriut të KE-së dhe BE-së.

20. Bashkëpunimi është i domosdoshëm, me të gjitha autoritetet e mdhp që të sigurohet dhe fuqizohet akoma më shumë mdhp për subjektin e të dhënave, të fuqizohen liritë dhe të drejtat e njeriut në rajon, në Europë dhe në nivel ndërkombëtar, njëherazi “integrimi i këtij rajoni në komunitetin euroatlantik është garanci për qëndrueshmëri dhe përparim ekonomik dhe politik” (Ribaj & Cami, 2015:779), këto janë detyrime nga e drejta publike ndërkombetare në rrafshin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

LITERATURA E PËRDORUR

Libra dhe botime të ndryshme

1. Abazi, H. (2014): SHQYRTIME TË RACIONALIZMIT NË EPISTEMOLOGJI, Prishtinë
2. Ademaj, Xh. (2008): SHKENCA E DAKTILOSKOPISË, UNIVERSITETI "FAMA", Prishtinë.
3. America's Climate Choices: Panel on Advancing the Science of Climate Change, National Research Council (2010).
4. Bajrami, A. (2011): SISTEMI KUSHTETUES I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Prishtinë.
5. Bashkurti, L. (2010): KOMBET E BASHKUARA DHE RENDI I RI BOTËROR, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, AKADEMIA DIPLOMATIKE SHQIPTARE, "GEER" Tiranë.
6. Bashkurti, L. (2007): NEGOCIATAT Historia, teoria, praktika, GER, Tiranë.
7. Bica, R. (2000): ENCIKLOPEDI E VOGËL, 777 pyetje - 777 përgjigje, "Rilindja" Prishtinë.
8. Bilić, D. dhe Croat, P. (2012): ISO 27001 Zaštita osobnih podataka, Zagreb.
9. Bello, M. (2010): E DREJTA INSTITUCIONALE KOMUNITARE EUROPIANE, Tiranë, 2010.
10. Both, K. (1991): SECURITY AND EMANCIPATION, botuar nga Review of International Studies, vol.17; 316-320
11. Buna, A. dhe Buna, Gj. (2010): Përmbledhje vendimesh të GJYKATËS SË STRASBURGUT kundër Shqipërisë, "Alb Juris" Tiranë.
12. Buna, Gj. (2012): KODI CIVIL (me ndryshimet e vitit 2012, i pasuruar me praktikat gjyqësore), "Alb Juris" Tiranë.

13. Burchill, S., Linklater, A. (2010): TEORI TË MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE, Titulli në original: Theories of International Relations, Tiranë.
14. Cavokian, A. (2012): OPERATIONALIZING PRIVACY BY DESIGN: A Guide to Implementing Strong Privacy Practices, Ph.D. Information and Privacy Commissioner, Ontario, Canada.
15. Cavoukian, A. (2013): SURVEILLANCE, THEN AND NOW: Securing Privacy in Publik Spaces, Ph.D. Information and Privacy Commissioner, Ontario, Canada.
16. Collins, A.: STUDIME BASHKOHORE TË SIGURISË, 2013, Titulli në original: Contemporary security studies OXFORD PRESS UNIVERSITY UET Press, Tiranë. www.uet.edu.al / info@uet.edu.al.
17. Целков, В. dhe Стоянов, Н. (2010): МЕЖДУНАРОДНИ СТАНДАРТИ И ДОБРИ ПРАКТИКИ ЗА ЗАЩИТА НА ИНФОРМАЦИЯТА, Издателство: “а буквите – О писменеиехъ”, Sofija.
18. DACI, J. (2011): TË DREJTAT E NJERIUT, Botimi i tretë, Tiranë.
19. David A. Boldwin (1997): Artikulli “The Concept of Security, Revista REVIEW OF INTERNATIONAL STUDIES ASSOCIATION, copyrig©British International Studies, f.23
20. Directorate General of Human Rights and Legal Affairs (2011): DATA PROTECTION, Compilation of Council of Europe texts, Council Europe Strasbourg Cedex, F-67075, , www.coe.int/justike Council of Europe 2010, Reprinted with corrections.
21. DZLP (2010) : KOMENTAR , na zakonot za zaštita na lićnite podatoci, Shkup.
22. DZLP (2014): ЗБОРНИК, Приватност е само tvoja! Скопје.

23. European Agency for Fundamental Rights (2014), Council of Europe (2014): Handbook on European data protection law, Luxemburg Publikations Office of the European Union, Belgium.
24. Ferati, H. (2013): Gjeopolitike dhe gjeostrategjija, botim i tret, Prishtinë.
25. Dhima, A. (2010): HYRJE NË ANTROPILOGJI, botimi i tretë, idearti, Tiranë.
26. Gutwirth, S. dhe Leens, R. (2012): EUROPEAN DATA PROTECTION: IN GOOD HEALTH? Springer Dordrecht Heidelberg, London - New York, Springer is part of Springer Science + Business Media.
27. Goldstein, J. (2003): MARRËDHËNET NDËRKOMBËTARE, Përkthyer dhe Përgaditur për Botim, Shtëpia Botuese “Dituria”, 2003, Tiranë.
28. Gray, J.: LIBERALIZIMI (t.o.Liberalism), 1986, Open University Press, përktheu: Raxhimi, A.; bot. Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, ISBN 978-99956-750-7-3.(Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tel.+ 355 42 371865).
29. Gruda, Z. (2001): MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERUT I, botimi i dytë, Prishtinë.
30. Gruda, Z. (2001): MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERUT – DOKUMENTE II, botimi i dytë, Prishtinë.
31. Gruda, Z. (2010): MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT- DOKUMENTE DHE MATERIALE, botimi i pestë, “UBT” PRISHTINË.
32. Gruda, Z. (2013); E DREJTA NDËRKOMBËTARE PUBLIKE, 2013, Prishtinë
33. Halili, R. (2005): Kriminologjia, Universiteti i Prishtinës, botimi i katërt, Prishtinë.
34. Instituti i Studimeve Publike dhe Ligjore (2012): GJYKATA EUROPIANE DHE E DREJTA PËR JETË PRIVATE, “Guttenbeg” Tiranë.

35. Janis, M.W. dhe Richard S. (1995): Tekste dhe Materiale, E drejta Europiane e të Drejtave të Njeriut, Libri Shkollor, Prishtinë (2002), përkthyer nga Gruda, Z., dhe Gruda, A. botimi i I-rë, Prishtinë.
36. Kajtazi, B. (2007): NDIKIMI I SHTYPIT NË KRIMINALITET, “ALBANIKA” Lubjan.
37. Kajtazi, B. (2009): PËRMBLEDHJE PËR TË DREJTËN E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE, Drejtoria Ligjore e Zyrës së Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe (GIZ) GmbH, Prishtinë.
38. Keesing, R., dhe Strathern, A. (2008): ANTROPOLOGJIA KULTURORE-NJË PERSPEKTIVE BASHKOHORE, Publikimi në anglishte (1998), Botimi në shqip (2008), Shtëpia botuese UFO pres, Tiranë, Shqipëri.
39. Komisioneri, MDHP. (2012): PERMBLEDHJE LIGJORE për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Republikën e Shqipërisë, Tiranë.
40. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, (19996): TË DREJTAT E NJERIUT - NJË SFIDË E PËRHERËSHME PËR KËSHILLIN E EUROPËS, MNS, Tiranë.
41. Kolegji Universitar i Gazetarisë “FAIK KONICA”, (2006-2007): MEDIAT DHE KOMUNKIMI, Prishtinë.
42. Kondili,V. (2008): E DREJTA CIVILE I, Pjesa e Përgjithshme, ribotim, “GEER” Tiranë.
43. Kocani, A. (1997): Hyrje në epistemologji, botoi “LBRI UNIVERSITAR“, Tiranë.
44. Kuner, Ch (2007, 20012): EUROPEAN DATA PROTECTION LAW, Corporate, Complaine and Regulation; Second Edition; OXFORD University Pres; Great Clrandom Street, Oxford OX2 6DP United Gingdom; British Library Cataloguing in Publikation Data, data available.
45. Lègier, G. (2009): E drejta civile DETYRIMET, Botimi i 19-të (2008), përkthyer e botuar në shqip nga “Papirus”, Tiranë.

46. Lègier, G. (2009): E drejta civile DETYRIMET, botimi i 19 (2008), përkthyer dhe botuar në shqip nga Papirus, Tiranë.
47. Lowrance, W.W. (2013): Privacy, Confidentiality and Health Research, USA by Cambrigde University Press, Newyork, publikim i parë (2012).
48. Matthews, B. dhe R.L (2010): Metodatat e Hulumtimit, Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane; www.cde.edu.al, London, Tiranë.
49. Malues, R. dhe Midgaard, K. (2007): FILOZOFIA POLITIKE, Botimi i dytë, përkthyer nga Ermir Pulaha, “Rozafa” Prishtinë.
50. Memia, A. (2010): NJERIU DHE NATYRA NË GLOBALIZËM (Rasti Shqipëria), Teoritë Liberale të Majta Konservatore dhe Media, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Akademia Diplomatike Shqipëtare, Toni, Imazhi dhe Media, Tiranë.
51. Memeti - Kamberi, L. (2011): SHTETI KANDIDAT I BASHKIMIT EUROPIAN, “West Print” Tiranë.
52. Mekuli, G. (2006): MEDIAT DHE POLITIKA, 1999 - 2006, Qendra Informative “Mekulipress“, Oslo - Norvegji.
53. Najman, V. N. (1976): ŠTA JE TAJNA? TAJNA U RAZMERIMA KRIVIČNOPRAVNE ZAŠTITE, EXPORT – PRES – BEOGRAD.
54. OECD, (2013): THE OECD PRIVACY FRAMEWORK, Publishing organization for economic co-operation and development.
55. Puto, A (2010): E DREJTA NDËRKOMBËTARE PUBLIKE, botim i ripunuar, “Guttenber” Tiranë.
56. Periman, R., Spekiner, M. (2011): RRJETI I SIGURISË - Komunikimi PRIVAT në Publik, botimi i dytë, shtypur në Shtetet e Bashkuara në letër të ricikluar, në Courier Wstford, Westford Massachuesetts.
57. Pradel, J. dhe Corstens, G. (2010): E DREJTA PENALE EUROPIANE, përkthyer nga Edmond Xhabija dhe Valbona Nano, “Papirus” Tiranë.

58. Paris, Roland (2001): Human Security - Paradigm Shift or Hot Air? In: *International Security*, Vol. 26, No. 2. 87-102.
59. Përmbledhje e Instrumenteve Ndërkombëtare, Vëllimi i I, pjesa e parë, Instrumentet e Përgjithshme KOMBET E BASHKUARA New York dhe Gjenevë, 1994, Finish-OHCR Human Rights Suport Programme - Kosovo, Prishtinë, Kosovë.
60. QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (2009): VLERSIMI I SEKTORIT TË SIGURISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, Perspektiva e Shoqërisë Civile, Prishtinë.
61. Reka, B. (2007): Kushtetuta e UE, Rubikon i Supernacionales, Shtypi, Fokus-Shkup, LOGOS – A, SHKUP-PRISHTINË-TIRANË.
62. RODIQI, S. (2010): Teknologjia e informimit dhe e komunikimit, gjimnazi i gjuhëve, gjimnazi i shkencave natyrore, gjimnazi i shkencave shoqërore, gjimnazi i përgjithshëm, “Libri Shkollor” Prishtinë.
63. Ribaj, P., Cami, Sh. (2015): Lufta, Paqja, Siguria-realitete Ballkanike, Tirane.
64. Rija Hurski, R, Suksi, M. (2001): HYRJE NË MBROJTJEN NDËRKOMBËTARE TË DREJTAVE TË NJERIUT, Instrumente për të Drejtat e Njeriut ABO (AKADEMI TURKU), ART-HOUSE, Prishtinë.
65. Rose, G & Tepperman, J. (2012): Përplasja e ideve/*Betejat ideologjike që krijuan boten moderne dhe do të formësojnë të ardhmen*, Instituti i botimeve ndërkombëtare, Tiranë.
66. Stevenson, D. K. (1989): JETA DHE INSTITUCIONET AMERIKANE (1981), Shtutgard (Federal Republic of Germany. Bareu of Edukational and Cultural Affairs United States Information Agency).
67. Strauss, B. dhe Corbin, J.M. (1990): Basics of Qualitative Research: Grounded Theory Procedures and Techniques (Bazat e Hulumtimit Cilësor: Procedurat dhe Teknikat e Teorisë së Bazuar), London: Sage.

68. Tenet, G. (2012): ME BILL HARLOW, NË SYRIN E CIKLONIT, Vitet e mia në CIA, përkthyer nga Xhevdet Shehu, “Albgraf” Tiranë.
69. Ticher, P. (2009): Data Protection for voluntary organizations, In association with Bates Wells end Braithwaite solicitors DSC published by Directory of Social Change, Directory of Social Change Northern Office; Directyoro of Social Change, British Library Cataloguing in Publication Data, Copyright Directory of Social Change, Third Edition.
70. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (1996): Të drejtat e njeriut *një sfidë e përhershme për Këshillin e Europës*, finacuar nga Këshilli i Europës, MNS, Tiranë, 1996.
71. Kuhn, Th. (1970): The Structure of Scientific Revolutions, 1962, 1970 by The University of Chicago. All rights reserved. Published 1962. Second Edition, enlarged, 1970; Printed in the United States of America.
72. Ujkani, E. (2012): E DREJTA E BASHKIMIT EUROPIAN – Parimet, Institucionet dhe Praktikrat Gjyqësore, botim i dytë, “Grafoprint” Prishtinë.
73. THE OECD: (2013): PRIVACY FRAMEWORK, Cover image: kertah - Fotolia.com OECD Publishing. Rights. oecd_org.
74. Zajmi, I. (2010): E DREJTA EUROPIANE, (cikël ligjëratash), botimi i dhjetë, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tiranës.
75. Zenel, U. B. (2010): BASHKIMI EUROPIAN; Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori” Tiranë.
76. Gjeqovi, Sh.(2001): KANUNI I LEKË DUKAGJINIT, “GEER” Tiranë.
77. [Weber, M. \(2004\): Sudime Sociologjike, Plejad; Përkthyer nga origjinali; Enida Rusi, Titulli origjinal: Studies in Sociology, Botimi i parë \(2004\), “Grand Prind”, Plejad, Tiranë.](#)
78. Weber, M. (2010): Mbi disa kategori të sociologjisë, kuptimore, Nocionet e sociologjisë themelore, përktheu Muço, V., SHTËPIA BOTUESE FAN NOLI, TIRANË, 2010.

Konventa, direktiva, protokolle dhe pakte të ndryshme ndërkombëtare

1. Konventa Europiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (1950), Romë dhe hyrë në fuqi në (1953), me Protokolet shtesë të saj.
2. Konventa Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional, 2000).
3. Konventa Europiane e të Drejtave të Fëmijëve.
4. Konventa 108 për Mbrojtjen e të Dhënave gjatë Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale (28 janarit 1981), me protokollin shtesë saj.
5. Konventa për luftën kundër diskriminimit në fushën e arsimit, miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, (14 dhjetor 1960), hyrë në fuqi më (22 maj 1962).
6. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i OKB-së, miratuar (19 dhjetor 1966), hyrë në fuqi (23 mars 1976), me protokollin shtesë.
7. Pakti mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i OKB-së me protokollin shtesë.
8. Komisioni Europian, Rregullorja e Këshillit të Europës e Komisionit dhe Parlamentit (EUROPEAN COMMISSION, Brussels, 25.i.2012 COM (2012) 11 final/ 20012/0011 (COD) Proposal for a REGULATION OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL on dhe protection of individuals with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data (General Data Protection Regulation), (draft).
9. Protokollin Opsional i Paktit për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën nr. 44/128, (15 dhjetor 1989).
10. PROTOKOLLI SHITESË I KONVENTËS MBI MBROJTJEN E INDIVIDIT NË LIDHJE ME PËRPUNIMIN AUTOMATIK TË TË DHËNAVE PERSONALE NGA

ORGANET MBIKËQYRËSE DHE FLUKSI NDËRKUFITAR I TË DHËNAVE, Strasburg, (08.11.2001).

11. Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut “Pakti i San Hozesë, (22 nëntor 1969).

12. Rregullorja e Parlamentit European dhe Këshillit 679/2016, e 27 prillit 2016 e cila do të hyn aplikohe nga 25 maj 2018.

Deklarata dhe akte ndërkombëtare të ndryshme

1. Deklarata Univerzale e të Drejtave të Njeriut e OKB-së (1948).

2. Deklarat e Teheranit e vitit (1968).

3. Deklarata e Vjenës e vitit 1993 dhe Plani i Veprimit i kësaj Deklarate-Viena Deklaration and Programme of Action, adopted by the World Conference on Human Rights, in Viena on (25 june1993).

4. TË DREJTAT E NJERIUT 2 deklarata dhe konventa të kombeve të bashkuara, NPT-VALTON, Prishtinë (1994).

5. Deklarata e Sekretarit të Përgjithshëm të KE-së, z.Thorbjon Jagland, Bruksel, (28 janar 2011).

6. Universal Deklaration of Human Rights, Preamble (1948).

7. The French Declaration on the Rights of Man and Citizen (1789).

8. Magna Carta Libertatum (1215).

9. Deklarata Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve e vitit (1981).

10. Deklarata Franceze për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit e vitit (1793).

11. Deklarata e Kajros mbi të Drejtat e Njeriut në Islam e vitit (1990).

12. Deklarata Amerikane për të Drejtat dhe Detyrat e Njeriut (2 maj 1948).

13. Deklarata e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (1776).

14. Deklarata e Kajros mbi të Drejtat e Njeriut në Islam.

15. Direktiva 95/46 e KE-së e Parlamentit dhe Këshillit (24 tetorit 1995), Luksemburg.

16. Direktiva 2002 / 58 / EC of dhe European Parlament and of dhe Concull of (12 july 2002) concerning dhe processing of personal data and dhe protection of privacy dhe electroniC comunikations sector; web faqja zyrtare e BE-së për komunikimet elektronike, shikuar (10 tetor 2012).

Kushtetuta të Ndryshme

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovë, (9 maj 2008), e hyrë në fuqi, (15 qershor 2008).

2. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë.

3. Kushtetuta e Malit të Zi.

4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

5. Kushtetuta e Republikës së Kroacisë.

6. Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë.

7. Kushtetuta e Bullgarisë.

8. Kushtetuta e Polonisë.

Web - faqe Zyrtare të Institucioneve të Ndryshme

1. www. kmdp. web faqja zyrtare e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Republikën e Shqipërisë, kërkuar (2014-2015-2016).

2. www. amdp. web faqja zyrtare e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Republikën e Kosovës, kërkuar (2014-2015-2016).

3. www. art. Web faqja zyrtare e Autoritetit Rregullues të Telekomunikacionit dhe Shërbimeve Postare në Republikën e Kosovës, shikuar (4 shtator 2013).

4. [www.european comision](http://www.european-commission.eu) dhe faqja zyrtare e KE dhe Parlamentit të BE-së, shikuar (26 korrik 2013).
5. [www. Privacylaws.com/subscription_info](http://www.privacylaws.com/subscription_info), informata të pranuar nga International OUT NOW, shikuar (19 dhjetor 2013).
6. [www. Information and data protection](http://www.information-computer-protection.com) Komisioner in England, artikulli zyrtar “Çfarë masa të sigurisë duhen marrë për të mbrojtur të dhënat personale”, shikuar (06 janar 2014).
7. www.azop.hr, Web faqja zyrtare e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kroacisë, shikuar (10 tetor 2013).
8. [www. Data Protection European](http://www.data-protection.eu) Komisioner (web faqja zyrtare e Komisionerit European për Mbrojtjen e të Dhënave Personale), shikuar (10 mars 2014).
9. www.cpdpconferences.org, artikulli “Computers, Privacy and Data Protection Conference (CPDP)”; Brussels, 22-24 January 2014, shikuar (01 tetor 2014).
10. [www.cpdpconference](http://www.cpdpconference.com), Konferenca e Tetë Ndërkombëtare, 21, 22, 23 janar 2015, Brussels, Belgium, artikulli CPDP COMPUTERS, PRIVACY AND DATA PROTECTION/2015 DATA PROTECTION ON THE MOVE, CPDP Call for dhe Papers, postuar më 05.08.2014, shikuar (01 tetor 2014).
11. Faqja Zyrtare e Parlamentit European, Rregullorja e Parlamentit dhe Këshillit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 679/2016, askësuar, 12 maj 2016.

Web - faqe nga Interneti.

1. [http:// www.ohcr.org/EN/News Events/Pages/ Meetings.aspx](http://www.ohcr.org/EN/News_Events/Pages/Meetings.aspx), e shikuar (10 dhjetor 2013).
2. [http:// www.Sobranie.Mk/al/default.asp? ItemID=254A796A2FD50349A30 BEED6E9 FD6AB](http://www.Sobranie.Mk/al/default.asp?ItemID=254A796A2FD50349A30BEED6E9FD6AB), 10.03.2013, web faqja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, shikuar (10 mars 2013).

3. [http:// www.Parlamenti](http://www.Parlamenti.al/) al/ web faqja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, shikuar (10 qershor 2013).
4. [http:// www.wikisource.Org/wiki/ustav_Crne_Gore](http://www.wikisource.Org/wiki/ustav_Crne_Gore), web faqja e Kuvendit të Malit të Zi, shikuar (10 mars 2013).
5. [http:// www.al/Artikulli](http://www.al/Artikulli); Arrestohen 8 persona në Spanjë të dyshuar për vjedhjen e 45 milion \$, nëpërmjet bankomatëve, shikuar (08 janar 2014).
6. Booking. Com (email. [Compaing @ sg.booking.com](mailto:Compaing@sg.booking.com)), shikuar (10 dhjetor 2013).
7. [http: // www.pcworld.al/](http://www.pcworld.al/) Artikulli “Hakerët rrëzojnë Leagua of legends EA dhe Blizzard” dhe artikulli “Hakerët shqiptarë sulmojnë faqen zyrtare të Serbisë”, shikuar (08 janar 2014).
8. [http: // www.pcworld.al/Artikulli](http://www.pcworld.al/Artikulli) “Ngarkimet në Pirate Bay rriten me 50 %”, shikuar (12 janar 2014).
9. [http: // www.al/](http://www.al/) Artikulli; “Sulmohen serverët e Washington Post, dyshohet që janë hackerët kinez”, shikuar (14 janar 2014).
10. [http: //www., google.com /search/? q= ustav+ republike+hrvatske+2012](http://www.google.com/search?q=ustav+republike+hrvatske+2012), shikuar (10 mars 2013).
11. [http:// www.ohcr.org/EN/ News Events/Pages/Meetings.aspx](http://www.ohcr.org/EN/NewsEvents/Pages/Meetings.aspx), shikuar (10 dhjetor 2013).
12. <http://www.vikepidia.com>, shikuar (26 janar 2014).
13. <http://www.dw.de/hakerat> -rusë-vjedhin-të-dhënat-e-gjysmës-së-përdoruesve-të-internetit-në-botë, Rubrika e web faqës së Dijqe Weles, FOKUS/SHKEN dhe EDUKIM, shikuar, shikuar (qershor dhe gusht 2014).
14. [www.http// Booking. Com](http://www.booking.com) (email.compaing@sg.booking.com) , shikuar (13 gusht 2014).

15. <http://www.telegrafi.com/lajme/158-te-vdekur-nga-sulmet-ne-paris-video-4-28899.html>.
16. <https://www.google.com/search?q=konference+26+january+and+privacy+kompjuter&rlKonference+26+january+an+Pvacy+kompjuter&gs>, shikuar (27 nentor 2015).
17. <http://tvklan.al/merkel-pyetet-per-pergjimet-ne-shqiperi/>, shikuar (20 dhe 21 maj 2016).
18. http://www.b92.net/info/intervju/index.php?yyyy=2012&nav_id.06/2016, Ora 11.30
19. <http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=69356>, 08/06/2016, 23.30h.
20. https://www.google.com/search?sourceid=navclient&ie=UTF-8&rlz=1T4ADFA_en_487_488&q=the+structure+of+scientific+Revolutions;
Artikulli: “The Strukturë of Scientific Revolutions “, shikuar 08.12.2016.
21. Web. Faqja e Qeverisë së Kosovës <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs> Strategjisë për të Drejtat e Njeriut (2013-2017).
22. Web. Faqja e Qeverisë së Kosovës Strategjia dhe plani nacional i veprimit për të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës 2009 – 2013 <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategy>.
23. Web. Faqja e Qeverisë së Kosovës, Strategjia për sigurinë kibernetike 2016-2019 Dhe plani i veprimit <https://www.mpb>.
24. Web faqja e ASHMDhP, Strategjia e Mbrojtjes e të Dhënave Personale 2014-2017 <https://www.amdp-rks.com>.
25. Web Faqja e Qeverisë së Kosovës, Strategjia e Kosovës për Teknologji Informativë http://stikk.org/fileadmin/user_upload/Strategjia_e_Kosoves_per_TI_11.11.2015.pdf.
26. Web Faqja e Qeverisë së Kosovës, Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës kundër krimit të organizuar dhe plani i veprimit 2012-2017.
27. Web Faqja e Qeverisë së Kosovës, Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për menagjimin e integruar të kufirit, 2009 <http://www.mpb-ks.org>.
28. Web Faqja e Qeverisë së Kosovës, Strategjia kombëtare kundër korrupsionit dhe plani i veprimit 2013-2017.

Konferenca ndërkombëtare, rajonale dhe vendore

1. Konferenca e organizuar nga “Lens”, financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur - SOROS (Korrik 2012) Prishtinë “Progres through responsible use of modern technology”.
2. Konferenca e 35-të Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbajtur në Varshavë, Poloni (23-26 shtator 2013) web faqja zyrtare e Konferencës, shikuar (01 dhjetor 2013).
3. Konferenca Europiane e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Lisabon, (17 maj 2013) dhe Strasburg (05 qershor 2014).
4. Konferenca e organizuar nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e Kosovës (28 janar 2014), “Sukseset dhe sfidat ne mbrojtjen e te dhenave personale”, Prishtinë.
5. Konferenca shkencore “Java e Shkencës 2014”, organizuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (maj 2014).
6. Konferenca Ndërkombëtare për kulturë, turizëm, drejtësi dhe mirëqenie sociale e organizuar nga Universiteti Shtetëror i Durrësit dhe Albanian University, (maj 2014).
7. Konferenca Regjionale për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, organizuar në Shkup me ndihmën e TAIEX-it, me temën “Modernizimi i Legjislacionin European për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (maj 2012).
8. Konferenca Regjionale për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e organizuar në Podgoricë, me temën “Mbrojtja e të Dhënave Personale dhe Qasja në Dokumente Publike” (prill 2013).
9. Konferenca e organizuar nga Qendra për Studime të Avancuara FIT, me temën “Vlerësimi i përdorimit të internetit, rreziku dhe siguria në mesin e fëmijëve nga mosha 9-16 vjeç në Kosovë/promovimi i mënyrave të sigurta të hulumtimit në internet nga ana e fëmijëve, Prishtinë (31 mars 2014).

10. Konferenca Rajonale për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e organizuar nga ASHMDhP me temën “Privatësia dhe Mbrojta e të Dhënave Personale në Botën Digjitale”, mbajtur më (28 janar 2015).

11 Konferenca Rajonale për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, organizuar nga ASHMDhP, “Alternativat e fuqizimit të mbrojtjes së të dhënave personale”, mbajtur (28 janar 2016).

Ligje të ndryshme

1. Ligji për MDhP i RK-së, shpallur në Fletorën Zyrtare të Republikës së Kosovës me nr.70, 03/L-172, hyrë në fuqi në maj 2010, Prishtinë.

2. Ligji për MDhP i Republikës së Shqipërisë, i nxjerrë dhe hyrë në fuqi në mars 2008.

3. Ligji për MDhP i Republikës së Malit të Zi, aprovuar dhe hyrë në fuqi në dhjetor 2008.

4. Ligji për MDhP i Republikës së Kroacisë, aprovuar dhe hyrë në fuqi në tetor 2003.

5. Ligji për MDhP i Republikës së Maqedonisë, aprovuar dhe hyrë në fuqi më 25 janar 2005, nr. 07-377, Skopje, Predsedatel na Makedonia, Branko Crvenkovski, Predsedatel na Sobranieto na Republika Makedonia D-p Ljupčo Jordanovski, s.r.

6. Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor të Republikës së Kosovës 2004/38, aprovuar më 08 shtator 2008.

7. Ligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, nr.03/L-189, i miratuar (16 shtator 2010) hyrë në fuqi në tetor 2010.

8. Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nr.03/L-149, miratuar në maj 2010.

9. Ligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, i aprovuar më 16 dhjetor 2008, hyrë në fuqi në janar 2009.

10. English Bill of Rights (1689).

11. International Labor Organization (1919).

12. International Bill of Human Rights.

Raporte dhe Dokumente nga Institucione të ndryshme

1. Raporti i Progresit nga Komisioni i KE-së dhe BE-së për Kosovë, shkurt 2013.

2. Revista Ushtarake – Organ teorik – shkencor i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjeve, Nr.1/2012. Mars -Tiranë 2012; Miratuar me urdhër të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë Nr.1538/18.08.2010.

3. Bernard Banach dhe Mario Osvald, ekspert gjerman në fushën e mdhp, dokument “Analiza Funksionale e Nevojave të Agjencisë Kombëtare për MDhP të Kosovës”, Prishtinë, gusht 2012.

4. Dokument “Analiza e Ligjit për Policinë nr.04/L-76 dhe Kodin e Procedurës Penale”, përfshirë sygjerimet për ndryshime, projekt i TAIEX-it 48700, KOSIND/EXP 47109 (TAIEX ndihmë në Agjencinë Kombëtare për MDhP të Kosovës, 17 shtator 2012).

5. Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DZLP), Raporti vjetor i punes, 2011, Shkup.

6. Plani i Veprimit i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Liberalizimin e Vizave dhe Përbushjen e Kriteve në Fushën e Integriteteve Europiane, i punuar nga Ministria e Integriteteve Europiane, nxjerrë dhe aprovuar në vitin 2013.

7. COMMISSION DE LA PROTECTION DE LA VIE PRIVEE, RAPPORT ANNUEL 2010, Edituer Responsable: M. Debeuckelaere, vzm Atomium – SABAM, Belgium, Bruxelles, 2010.

8. Kurrikula e përgjithëshme për trajnimin e ZMDH-ve, mbi mbrojtjen e të dhënave, numri i projektit: Europe Aid/133806/C/SER/XX, 2013/333-753, Rosana Lemut Strle, faqe 4.

9. Udhëzues Praktik për Personat e Kontaktit të Ngarkuar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Andrash Jori, Joakuin Perez Katalan, Dorota Skolimovska, Stevan Szyszko, Tiranë 2013, Faqe 11.
10. Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2016-2019, i Republikës së Kosovës, i nxjerrur nga MPB, 2015.
11. Udhëzimet me rekomandime praktike për zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave në sektorin e policisë (prill 2016), ndihmuar nga IPA projekti dhe realizuar përmes Human Dynamics.
12. Udhëzimet me rekomandime praktike për zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave në sektorin e finhtanciar (Maj 2016), ndihmuar nga IPA projekti dhe realizuar përmes Human Dynamics.
13. Kalendari vjetor (2014) i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, Prishtinë.
14. Ligjërata të autorizuara nga Bashkim Nikolla mbi të drejtat e Njeriut dhënë pranë Akademisë Diplomatike Shqiptare në Tiranë gjat vitit 2011.

Akte nënligjore me rregulla të masave të sigurisë

1. Udhëzimi Administrativ i Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, faqja zyrtare e ASHMDhP të Republikës së Kosovës, 2012.
2. Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.02/2011 (24 mars 2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.
3. Vendimi Kornizë i Këshillit European 2008/977 JHA, (27 nëntor 2008) Bruksel, nënshkruar për Këshillin nga Presidenti M. ALLIOT – MARIE.
4. Udhëzues i hartuar lidhur me përdorimin dhe përpunimin e të dhënave biometrike nga komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë, shikuar (09 shkurt 2014).

5. Rregullorja e (KE) nr.1882/2003 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit (29 shtator 2003).

6. Udhëzime për zyrtarët për mbrojtjen e të dhënave personale në kompanitë e sigurimit shëndetësor, hartuar nga IPA projekti i BE-se per ASHMDHP, 2016.

7. Kurrikulla e përgjithëshme për zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave personale, hartuar nga IPA projekti i BE-së për ASHMDHP, 2016.

Shtypi

1. Gazeta e përditëshme “KOHA DITORE“, Botuar në Prishtinë, aksesuar maj 2016,

2. Tv. Klani, aksesuar, maj 2016 (web faqja).

3. Rtk. aksesuar, prill 2016 (web faqja).

4. B92. aksesuar, maj 2016 (web faqja).